



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**AVOKATI I POPULLIT**

**RAPORTI VJETOR**  
**2010**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**

# **R A P O R T**

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit**  
**1 Janar – 31 Dhjetor**  
**Viti 2010**

# PERMBAJTJA

	Faqe
Hyrje	4
Prezantimi i shkurtër i strukturës së Raportit Vjetor 2010	6
<b>KREU I</b>	<b>8</b>
Opinione dhe rekomandime për gjëndjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri	8
<b>KREU II</b>	<b>20</b>
Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit ne zgjidhjen e ankesave konkrete, e ndare sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore	
1. Barazia përpara ligjit dhe ndalimi i diskriminimit	20
2. E drejta për informim	27
3. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë	35
4. Kufizime të lirise se personit	35
- Veprimtaria e Policise se Shtetit	35
- Veprimtaria e Avokatit te Popullit ne lidhje me Forcat e Armatosura	48
5. Çështje të administrimit të drejtësisë	49
- E drejta për një proces të rregullt ligjor	49
- Intitucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor	50
- Veprimtaria e Prokurorise	52
- Veprimtaria e Zyrave të Shërbimit Përmbarrimor Shtetëror	55
- Ndhima ligjore falas	61
6. E drejta e Pronës	62
7. E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës	73
8. E drejta për të përfituruar nga sistemi i sigurimeve shoqerore	76
9. E drejta për arsimim	81
10. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim	82
11. Ndhima ekonomike	84
12. Mbrojtja e konsumatorit	85
13. E drejta për kujdes shendetesor	92
14. Synimi për një mjedis të shëndetshëm	98
15. Çështje të mirëadministrimit	100
16. Veprimtaria e Zyrës Rajonale Shkodër	111
- Veprimtaria e Nenseksionit të Drejtave të Fëmijëve	112
- E drejta për Kujdes Shendetesor	115
- E drejta për Arsim	115
- E drejta për Mbrojtje Sociale	116
- E drejta e Pjesemarrjes	116
- Te drejtat e komunitetit Rom ne Qarkun Shkoder	116

<b>17. Trajtimi i ankesave te të përndjekurve politikë</b>	<b>121</b>
<b>18. Të tjera</b>	<b>122</b>
<b>Kreu III</b>	<b>130</b>
<b>Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar kundër Torturës</b>	
<b>1. Mandati ligjor dhe veprimtaria monitoruese</b>	<b>130</b>
<b>2. Bashkëpunimi me OJF-të dhe veprimtaria promovuese</b>	<b>153</b>
<b>3. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe proçesi raportues</b>	<b>156</b>
<b>4. Rekomandimet legislative</b>	<b>158</b>
<b>5. Vlerësime të Përgjithshme</b>	<b>160</b>
<b>Kreu IV</b>	<b>162</b>
<b>Informacion i përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit</b>	<b>162</b>
<b>1. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun</b>	<b>163</b>
<b>2. “Ditët e Hapura”</b>	<b>165</b>
<b>3. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse</b>	<b>169</b>
<b>4. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare</b>	<b>170</b>
<b>5. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010</b>	<b>172</b>
<b>6. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit</b>	<b>172</b>
<b>7. Buxheti i Institucionit për vitin 2010</b>	<b>173</b>
<b>8. Statistika përmbledhëse e vitit 2010</b>	<b>175</b>

**E nderuar Zj. Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,  
Të nderuar deputetë,**

Teksa Institucioni i Avokatit të Popullit paraqitej vjet, para jush, me raportin vjetor të radhës, kam qenë e vëmendshme ndaj vërejtjeve dhe sugjerimeve tuaja, si përsa i përket strukturës, ashtu edhe elementëve të veçantë të përmbajtjes së Raportit.

Bashkë me koleget kemi qenë në një mendje se diçka duhej ndryshuar. Jo thjesht si reflektim ndaj vërejtjeve tuaja, por qoftë edhe për faktin se, një Raport Vjetor, sado i mirëformatuar, herët a vonë, e ka të nevojshëm një ndryshim. Kjo, natyrisht që nuk është e thjeshtë, pasi synimi për riformatim, frenohet deri diku, nga inercia e të punuarit sipas një formati të caktuar.

Rrjedhimisht, sot keni para jush një raport të ngjeshur në më pak se gjysmën e vëllimit të raportimit të përvitshëm, por njëkohësisht jemi munduar të orientohemi sipas strukturës kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pronar i të cilave është individi shqiptar, ndaj të cilit, si administratë publike, jemi të gjithë borxhlinj në drejtim të mirëqeverisjes, që tashmë konsiderohet si e drejtë e njeriut.

Duke ngelur e hapur për çdo vërejtje dhe sugjerim të mëtejshëm,

**Me respekt,**

**Florina Nuni**

**Avokati i Popullit në Detyrë**

**Tiranë, më 21 shkurt 2011**

# Hyrje

Raporti i Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2010 është një rezultat i përpjekjeve të bëra në vite nga stafi i Institucionit të Avokatit të Popullit. Ky raport, me ndryshimet strukturore të tij, reflekton në të njëjten kohë dhe ndryshimet që kanë ndodhur në fushën e të drejtave të njeriut në Shqipëri, të para dhe me gjerë, tashmë nga një këndvështrim europian i së drejtës në vende anëtare të Këshillit të Europës. Ajo që vjen e re në këtë raport është se, opinionet dhe raporti në teresinë e tij reflektojnë çështjet më të rëndësishme lidhur me standartet e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Eksperiencia ka treguar se zgjidhja e një rasti individual në fakt, shpesh evidenton një problem në fushën e respektimit të drejtave të njeriut, duke nxitur përgjegjësinë e organeve të administratës publike.

Një kritikë, e cila mund t'i behet punës së Avokatit të Popullit është përmendja e rekomandimeve të bëra në vite dhe të përsëritura në këtë raport. Në fakt, e verteta është se këto janë rastet, kur organet e administratës publike kanë deshtuar në zgjidhjen e tyre, duke mos garantuar respektimin e së drejtës, si dhe duke mos rivendosur në vend të drejtën e shkelur të individit.

Avokati i Popullit nuk është një institucion për të gjykuar ngjarje individuale, fakte historike apo sisteme politike. Të drejtat e njeriut, liritë personale, demokracia, parimet e shtetit të së drejtës, drejtësia dhe mirëqeverisja, janë sot dhe do të mbeten në të ardhmen drejtimit e nevojshme, për të cilat Avokati i Popullit duhet të japë mendime apo të veprojë.

Raporti vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit është një detyrim ligjor për këtë institucion. Në të njëjtën kohë, është një përgjegjësi e institucionit të japë një paraqitje të pranueshme të gjetjeve dhe opinionëve të tij, lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut në vendin tonë. Çështje të tilla si e drejta e pronës, të drejtat e fëmijëve, mbrojtja nga diskriminimi i grupeve vulnerabel, janë çështje të cilat kanë ekzistuar dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë.

Gjatë raportimit të Institucionit të Avokatit të Popullit vitin e kaluar, nga ana e deputeteve u ngritën çështje, të cilat kishin të bënin, si me strukturimin e Raportit Vjetor të Avokatit të Popullit, ashtu edhe me

përmbajtjen e tij. Për këtë vit është evidente së jemi përpjekur të ndryshojme këtë strukturë, duke i dhene një fizionomi të re, por pa cenuar ate që është produkti i punes sonë një vjeçare. Duke dhënë një strukturë të bazuar ne analizen e të drejtave themelore të individit, të cilat garantohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kuvendi do të këtë një panorame të qarte të situates së të drejtave themelore ne vend, pare ne kendveshtrimin e veprimtarise një vjeçare dhe të gjetjeve që janë bërë nga institucioni i pavarur kushtetues, i Avokatit të Popullit.

## **Prezantim i shkurter i struktures se Raportit Vjetor 2010**

Raporti Vjetor është instrumenti më i rëndësishëm i Institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet të cilit bëhet e mundur njohja e anëtarëve të Kuvendit me punën e Avokatit të Popullit gjatë vitit për të cilin ai bën raportimin. Në të njëjtën kohë, ky raport synon të ndihmojë administratën publike dhe agjensitë e ndryshme që ofrojnë shërbime për publikun, të përmirësojnë administrimin e tyre. Ky është raporti i njëmbëdhjetë i veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili në ndryshim nga raportimet e mëparshme, përmban një analizë të veprimtarisë së Institucionit, të ndarë sipas katalogut të të drejtave dhe lirive të garantuara në Kushtetutë dhe në përputhje me to, edhe të rasteve më të spikatura të prezantuara pranë nesh, e për të cilat ne kemi bërë ndërhyrjet tona pranë organeve përkatëse. Ai përmban refleksionet tona për çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë vitit si dhe identifikon disa nga problemet të cilat kanë nevojë për përmirësime në të ardhmen.

Raporti është ndarë në katër krerë.

Kreu i parë përmban një prezantim të situatës së të drejtave dhe lirive të individëve gjatë vitit për të cilin bëjmë raportimin, e trajtuar kjo në vështrim të ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Kreu i dytë, i cili zë dhe pjesën më të madhe në raport, ka të bëjë me ankesat, kërkesat dhe njoftimet e trajtuara nga Avokati i Popullit, të ndara sipas të drejtave të cënuara nga veprimet e organeve të administratës publike dhe të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore në fuqi, hetimet e kryera për disa raste si dhe rezultatet. Këtu kemi prezantuar dhe mjetet për zgjidhjen e rasteve tipike dhe të përsëritura, të cilat mendojmë se duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme.

Kreu i tretë prezanton performancën e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe çdo Dënimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe disa analiza të detajuara për raste të veçanta, të cilat sipas këndvështrimit tonë, janë konsideruar të rëndësishme dhe që do të vazhdojnë të jenë në vëmendjen tonë në të ardhmen.

Kreu i katërt paraqet veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, ku përfshihen ndër të tjera aktivitete të informimit dhe komunikimit të tij, organizimit të “Ditëve të hapura” dhe bashkëpunimit



me mediat, nëpërmjet të cilave kemi siguruar në vazhdim aksesin e nevojshëm në publik, bashkepunimin me zyrat homologe, të dhëna statistikore për ankesat, kerkesat dhe njoftimet e shqyrtuara gjatë vitit 2010 si dhe të dhëna të tjera lidhur me strukturen e Institucionit.

## Kreu I

### **Opinione dhe rekomandime për gjëndjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri**

Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit 2010, e ka ngritur zërin në çdo rast që ka konstatuar shkelje të të drejtave të individit nga policia, për respektimin e të drejtave të të burgosurve, për të drejtën e informimit, të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, për cilesine e jetes dhe ndotjen e ambientit, për zvarritjet në procedurat gjyqësore, për përfitimin nga sistemi i sigurimeve shoqerore, për të drejtën e pronës, për ushtrimin e lire dhe efektiv të së drejtës për arsimim etj. Reagimet tona të forta ndjehen në të gjitha rekomandimet që kanë pasuar inspektimet dhe kontrollet periodike nëpër burgje, në dhomat e paraburgimit, në spitalet psikiatrike apo ambiente të tjera të mbyllura. Në të gjitha këto raste, ne kemi qenë tepër kërkues ndaj punonjësve të administratës së ketyre institucioneve, për dhunën, torturën dhe çdo formë tjetër keqtrajtimi të lidhur me to.

Duke pasur një fushë të gjere të veprimtarise së tij, ne kuader të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, Ligji Nr.8454 date 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, por ne veçanti Ligji Nr.8503 date 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, i ngarkojne institucionit tone një mision të veçante, i cili lidhet me ate të kujdestarit të zbatimit dhe respektimit të kesaj të drejtë të publikut të gjere, nga ana e administratës së te dyja niveleve. Ne këtë kuader vlen të theksojme së e drejta për informim dhe ushtrimi efektiv i saj, ul rrezikun e veprimit arbitrar dhe kontribuon në reduktimin dhe kthimin e korrupsionit në një fenomen të rrallë në administratën publike.

Çështjet e shqyrtuara për shkelje të së drejtës për informim gjatë vitit 2010, kanë nxjerrë ne pah problematikën e zbatimit të ligjit nga administrata publike, nga e cila konstatohet se, nuk zbatohen afatet ligjore për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion, qoftë për refuzimin, qoftë për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, është konstatuar së legjislacioni mbi të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare, njihet pjesërisht në një nivel jo të kënaqshëm nga administrata publike, dhe zbatohet ne po te njejtin nivel, duke shmangur kështu përgjegjësinë për dhënien e dokumentacionit të kërkuar. Kjo sjell vështirësi dhe pengesa në funksionimin normal dhe transparent të administratës, në marrëdhëniet e

kësaj të fundit me publikun. Edhe publiku, nga ana tjetër, nuk ka njohuri të mjaftueshme në lidhje me të drejtën e tij për informim.

Pikerisht, duke qenë se Avokati i Popullit është një nga aktoret kryesore për përmiresimin e standarteve për të drejtën e informimit në vend, kemi vlerësuar faktin e fillimit të procesit për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për të drejtën e aksesit në dokumentat zyrtare”, datë 27.11.2008, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Ratifikimi i kësaj konvente, do të përbejë një hap cilesor dhe të domosdoshëm në këtë drejtim dhe padyshim është një zgjerim i garancive për respektimin e të drejtës për informim.

Gjate vitit për të cilin po raportojmë, nuk ka patur raste, ku të jete pretenduar shkelja e lirisë së ndërgjegjes dhe e fese nga ana e organeve të administratës publike. Në vazhdimësi të trajtimit që zyra jone i ka bërë kësaj çështjeje, jemi në dijeni të faktit se, është duke u përgatitur një ligj i posaçëm, që pritet të garantojë të drejtën e ushtrimit të besimit dhe të funksionimit të komuniteteve fetare në vend. Modeli, sipas të cilit do të hartohet ligji, jemi të bindur se, do të ketë parasysh traditën e bashkekzistencës paqësore fetare në vend, sikundër edhe dimensionin evropian që shteti shqiptar synon të zhvillojë në këtë fushë, ku si shteti, ashtu dhe feja kanë të njëjtin objektiv: individin shqiptar.

Të drejtat e fëmijëve kanë qenë dhe janë një nga prioritetet e punës së Avokatit të Popullit. Akoma më i ndjeshëm dhe konkret bëhet problemi nën fokusin e konventave për të drejtat e fëmijëve, të kësaj shtrese që edhe Avokati i Popullit, ashtu si të gjitha strukturat e shtetit dhe shoqëria shqiptare, mendon se i është borxhli, në kuptimin se mund të kishte bërë më shumë brenda mundësive juridiksionale.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve duhet të përbëjë një prioritet për të gjithë aktoret dhe faktoret në vend që veprojnë për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Duke vënë si kriter paresor interesin me të lartë të fëmijës, e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve duhet të përbejë edhe kryefjalën e veprimtarisë së të gjithë organeve të administratës publike e me gjerë. Promovimi dhe koordinimi i veprimtarive të të gjitha mekanizmave qeveritare, për çështjet me fëmijët, në të gjitha nivelet, është i domosdoshëm. Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, vlerësojmë si shumë të rëndësishëm miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë, i Ligjit nr.10347 datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, i cili shënon një hap përpara për mbrojtjen efektive e përkujdesin e posaçëm lidhur me të drejtat e fëmijëve në vendin tonë. Me hartimin dhe miratimin e këtij ligji, vendi ynë ka përmbushur një detyrim në kuadrin e integritetit të vendit në BE, duke bërë që institucionet përkatëse të marrin përgjegjësi konkrete për mbrojtjen reale të drejtave të fëmijëve. Në këtë mënyrë është realizuar dhe përcaktimi i “Strategjisë Kombëtare për Fëmijët” dhe “Plani i Veprimit” të saj, që parashikonin si

masë legjislative edhe hartimin e një ligji për të drejtat e fëmijëve. Me këtë rast, tërheqim vëmendjen për miratimin në kohë dhe të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Në lidhje me të drejtat e grave, konstatohet që vitet e fundit ka rënie të ndjeshme të trafikut të femrave. Kjo ka ardhur edhe si rrjedhojë e fushatave ndërgjegjësuese të ndërmarranga OJF-të e ndryshme në media, shkolla, universitete etj. Por kryesore ka qenë ndjekja dhe zbatimi me rreptësi i ligjit ndaj trafikantëve, miratimi dhe zbatimi i politikave dhe programeve të posaçme për mbrojtjen e viktimave të trafikut si dhe monitorimi i këtij procesi nga organizmat që janë krijuar enkas nga strukturat qeveritare. Në këtë drejtim ne kemi patur një bashkëpunim të mirë edhe me Zyrën e Koordinatorës Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut pranë Ministrisë së Brendshme.

Një çështje tjetër që mbetet problem serioz ka të bëjë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave, fëmijëve apo vajzave.

Situata duket që përmirësohet ngadalë. Puna parandaluese, që bëhet nga organizatat joqeveritare, është shoqëruar me miratimin e ligjeve përkatëse për dhunën në familje, por edhe me kujdesin për të hetuar dhe gjykuar me rreptësi çdo shfaqje dhune që përbën vepër penale. Duhet të ketë më shumë mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Duhet punuar më mirë nga organet shtetërore për realizimin e detyrimeve të tyre për t'i shkuar drejtësisë deri në fund, pavarësisht se viktimat e kësaj dhune mund të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër. Nuk duhet harruar se dhuna në familje nuk është atribut vetëm i familjeve të varfra apo atyre me shkollim të pamjaftueshëm. Ajo ka prekur dhe prek edhe familjet në gjendje të mirë ekonomike dhe me arsim të lartë.

Mbrojtja nga diskriminimi, natyrshëm përben thelbin dhe moralin e çdo ligji që derivon nga kartat ndërkombetare, nga kushtetutat kombetare dhe nga çdo burim tjetër i së drejtës që, dallon jo vetëm një shtet demokratik nga ai jodemokratik, por mbi të gjitha edhe një shoqëri demokratike, tolerante, false, përfshirëse, nga një shoqëri e kundërt me keto, pra në thelb përjashtuese, ndëshkuese, intolerante.

Aktualisht, konstatojmë se në vend ekziston një bazë e mirë ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacioni i cili është pasuruar çështje me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10221 datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji, vlerësojmë se tashmë është hedhur një hap çështje në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, i konkretizuar edhe me krijimin e institucionit të Komisionerit për

Mbrojtjen nga Diskriminimi, me kompetenca jo thjesht rekomanduese por, edhe vendimmarrese.

Ndihma konkrete e drejtëpërdrejte ligjore ndaj individeve, e ofruar nga organizma të shoqërisë civile që veprojnë në vend, nxjerr si nevojë shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve dhe bashkëpunimin real dhe të vazhdueshëm ndërmjet shoqërisë civile dhe organeve të specializuara të administratës shtetërore.

Në të gjithë veprimtarinë e të gjithë aktoreve dhe faktoreve në luftën ndaj diskriminimit, prioritet duhet të mbetet promovimi dhe njohja nga ana e individeve e të drejtave të tyre themelore, veçanërisht i së drejtës për mbrojtjen nga diskriminimi në të gjitha format e shfaqjes së tij.

Duke vlerësuar të drejtën e barazisë së të gjithë shtetasve përpara ligjit si një të drejtë themelore kushtetuese të individit, Avokati i Popullit, për vetë natyrën e funksionimit të tij, synon thelbesisht të shmange diskriminimin dhe padrejtësinë që qytetari ndjen teksa përballet me administratën.

Për këtë arsye me datë 20 Dhjetor 2010, Avokati i Popullit në bashkëpunim me shoqatën TLAS-Albania, dhe me pjesëmarrjen aktive të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe të një sere aktoresh të rëndësishëm të shoqërisë civile, organizoi Seminarin Kombëtar me temë "Shoqëria Shqiptare - Sfidat e Mosdiskriminimit".

Nga punimet e seminarit, Institucioni i Avokatit të Popullit përvijoi me disa rekomandime drejtuar aktoreve që veprojnë direkt në luftën kundër diskriminimit. Rekomandimet në fjale kishin të bënin me standartin e trajtimit të kategorive të caktuara, si fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, me komunitetin rom apo dhe me personat e moshës së tretë. Ndërhyrjet tona kanë konsistuar, si në drejtim të përmirësimit të legjislacionit, ashtu dhe në zbatimin konkret të tij nga organe të caktuara të administratës publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se, megjithëse numri i ankesave të shtetasve për torturë dhe keqtrajtim nga punonjësit e policisë gjatë vitit 2010 ka qënë më i vogël se në vitet paraardhese, përsëri ky problem ngelet shqetësues, sepse përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të individit. Gjatë trajtimit të rasteve nga ana jone, nuk është konstatuar asnjë rast në të cilin drejtuesit e organeve të policisë të bëjnë denoncime kur konstatojnë kryerjen nga ana e vartësve të tyre të kësaj shkeljeje të rëndë. Kemi konstatuar se, ka patur edhe nga ata drejtues të policisë vendore që e stimulojnë këtë veprim me qëndrimin e tyre të heshtur. Për këtë arsye, kemi kërkuar nga drejtuesit e Policisë së

Shtetit të reagojnë menjëherë për të ndryshuar këtë gjendje. Probleme kemi hasur dhe me shoqërimin e personave në organet e policisë, i cili bëhet jo gjithmonë sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ "a" dhe "b" dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit". Të shoqëruarve u bëhet kontroll personal, u hiqen e bllokohen sendet personale si telefona etj. dhe u merren gjurmët e duarve, veprime të cilat nuk janë në përputhje me ligjin. Librat e shoqërimit të shtetasve, në organet e policisë, nuk janë riformatuar e plotësuar me rubrikat e nevojshme, të kërkuara nga dispozitat ligjore, pasi mungon kolona për njoftimin e familjarëve të të shoqëruarit. Në të gjitha Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, Komisariatet e Stacionet e Policisë në vend, nuk ka dhoma shoqërimi të shtetasve, sipas standarteve dhe konceptimit të bërë nga ligji nr. 9749, dt. 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*" të ndara për meshkujt, femrat dhe të miturit. Ne dhomat ekzistuese të shoqërimit ne komisariatet e inspektuara gjatë vitit 2010, verehet mungesë orendish të nevojshme për qëndrim si dhe kushte të papërshtatshme, si nga përmasat, ndriçimi natyral, higjena ashtu edhe nga konceptimi dhe trajtimi i personave të shoqëruar, pasi realisht ato janë dhoma izolimi, sepse janë të ftohta, me dyer hekuri, të mbyllura me dryna dhe pa ndriçim nga rrjeti.

Në ambjentet e shoqërimit, gjithashtu nuk ka postera me të drejtat ligjore të të shoqëruarve.

Nga inspektimet e bëra ne dhomat e sigurisë, në të gjitha Drejtoritë dhe Komisariatet e Policisë në vend, ka rezultuar se, ne disa drejtori e komisariate policie (Drejtoritë e Policisë së Qarqeve Fier, Lezhë, si dhe në Komisariatet e Policisë Kavajë dhe atë Nr.5 Tiranë), dhomat e sigurisë (Paraburgimit) janë të përshtatshme për banim pasi ofrojnë kushte normale për jetesë, ushqim, ajrim, higjenë, kubaturë, trajtim të diferencuar për të mitur, femra dhe të sëmurë.

Megjithatë, duhet theksuar fakti se për ambjentet e sigurisë (Paraburgimit) nuk ka standarte të përcaktuara në ligj, pasi kjo pjesë e veprimtarisë së Policisë së Shtetit, nuk është përfshirë në Ligjin Nr.9749 date 04.06.2007 "Për Policinë Shtetit". Në asnjë nen të ligjit nuk përmendet detyra e këtij institucioni për të kryer detyrën e paraburgimit. Po t'i referohemi nenit 4 të këtij Ligji, i cili ekziston ende, për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, për të mbuluar përgjegjësinë për shërbimin e paraburgimit me të gjitha elementët që shoqërojnë këtë shërbim, në asnjë paragraf nuk përmendet detyra e këtij institucioni për të kryer detyrën e paraburgimit. Ky shërbim, sipas legjislacionit në fuqi, i është ngarkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe organeve të saj vartëse.

Aktualisht, siç është deklaruar edhe më parë nga ana jonë, Policia e Shtetit e kryen këtë detyrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Madje, hartimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së

Shtetit i manualit për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi është refuzuar me argumente juridike nga ana jonë, pasi një akt i tillë nuk është i autorizuar nga Ligji "Për Policinë e Shtetit".

Për të zgjidhur këtë problem ligjor është i domosdoshëm ndryshimi i nenit 4, të Ligjit "Për Policinë e Shtetit", duke e parashikuar një detyrë të tillë për Policinë e Shtetit ose ndryshimi i nenit 15/1, të Ligjit Nr.8328 dt.16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (i ndryshuar), në të cilin duhet shtuar një paragraf që, në Institucionet e Paraburgimit të mbahen edhe individë, ndaj të cilëve është vendosur masa e arrestit ose e ndalimit nga Policia e Shtetit ose Prokuroria. Këto masa ligjore i hapin rrugë për ligjies së veprimtarisë së Policisë së Shtetit për kryerjen e detyrës së paraburgimit ose lehtësimit të veprimtarisë së saj nga ky shërbim.

Gjatë vitit 2010 kemi konstatuar se ka patur ankesa. ku vendin kryesor e zënë ato me objekt për zvarritje të padrejta dhe të pajustificuara të gjyqësorëve, pra për shkelje të procedurave gjyqësore, si për çështje civile, ashtu edhe për çështje penale. Në zyrën tonë, edhe gjatë këtij viti, janë paraqitur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore, duke ngritur pretendime të ndryshme se ato janë vendime të padrejta dhe të pabazuara në ligj, ose janë marrë me veprime korruptive nga gjyqtarë të veçante.

Vlen të ritheksojme se, me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr.9398, datë 12.05.2005, "Për Avokatin e Popullit", nevojiten ndryshimet përkatëse në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile, si rruga e duhur ligjore për trajtimin nga Avokati i Popullit të ankesave të qytetarëve kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Duke mbetur pa u zgjidhur ligjërisht kjo çështje deri tani, Avokati i Popullit e ka të pamundur ushtrimin e kësaj kompetence ligjore.

Instituti i shërbimit ligjor falas, si një e drejtë e individëve, rregullohet aktualisht nga legjislacioni ynë. Ky është një fakt pozitiv. Por nga ana tjetër konstatojmë se, ky shërbim ka ende probleme, sidomos në kërkesat e ndryshme për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë, për çështje të ndryshme penale. Gjatë zbatimit të ligjit "Për Ndihmën juridike", në praktikë verëhet se kanë dalë probleme të ndryshme si në drejtim të cilësisë së kësaj mbrojtjeje nga ana e avokatëve, ashtu edhe në mos pagimin e këtij shërbimi nga shteti, për arsye të ndryshme dhe të pajustificuara. Kjo në fakt përben cenim efektiv të kësaj të drejtë.

Ankesat e individëve ndaj veprimtarisë së Prokurorive të Rretheve Gjyqësore kanë konsistuar në moskryerjen e hetimeve të gjithanshme, zvarritjen e pajustificuar të hetimeve, moskthimin e përgjigjes apo kthimin me vonesë të memorieve apo kërkesave me shkrim, kryesisht për kryerje të ekspertimit autoteknik, në kthimin me vonesë të sendeve prova materiale etj; veprime këto me pasojë pushimin e padrejtë të hetimeve të procedimeve penale.

Mbetet problem mosmarrja në konsideratë e kërkesave të palëve për caktim eksperti, sidomos për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, eksperteve kontabël etj.

Shkeljet e mësipërme bien ndesh me nenet 324 e 325 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat bëjnë fjalë për “zgjatjen e afatit të hetimit” dhe ankimin ndaj tij, si dhe me përcaktimin e dhënë në pikën 3, të nenit 28, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Pikërisht, mbi këtë shqetësim, jemi duke përgatitur studimin, me qëllim që, gjatë vitit 2011, të dalim me rekomandime përkatëse për ndryshime në dispozitat procedurale të parashikuara në nenet 263 dhe nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga veprimtaria e shërbimit përmbartimor gjyqësor vërehet se, shqetësues është mosekzekutimi i titujve ekzekutiv, ku debitore janë institucionet buxhetore. Organet e administratës shtetërore nuk kryejnë përmbushjen e detyrimeve të vendosura në vendimin përkates të gjykates, jo vetëm në afatin ligjor për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, nga dita e lajmërimit të këtij detyrimi prej Shërbimit të Përmbartimit, por edhe as pas kalimit të këtij afati.

Nga ana tjetër, përmbartuesit gjyqësor të çështjeve, menjëherë pas kalimit të afatit ligjor për ekzekutimin vullnetar të detyrimit prej palës debitore, nuk kryejnë veprimet përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv.

Në analize të rasteve të hetuara konstatohet, gjithashtu, mosrespektim prej përmbartuesve gjyqësor të sanksioneve të parashikuara në nenin 583, nenin 588 dhe nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile. Vërehet gjithashtu, mosaplikimi prej përmbartuesve gjyqësor i së drejtës së tyre, të parashikuar në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile, për vendosjen e sanksionit të gjobitjes ndaj personit të tretë që, sipas urdhërit të ekzekutimit ose ligjit, është i detyruar të kryej veprime të caktuara.

Në trajtimin e titujve ekzekutiv, me objekt detyrimin e institucioneve buxhetore të paguajnë shuma të caktuara në të holla, konstatohet se Shërbimi i Përmbartimit nuk kryen në mënyrë rigoroze procedurën ligjore të parashikuar në nenin 589 të Kodit të Procedurës Civile, për çdo rast të paraqitur. Mbajtja e qëndrimit refuzues për kryerjen e veprimeve përmbartimore në ekzekutimin e titujve ekzekutiv, haset në një numër rastesh, qëndrime këto të paragjyqësme, sidomos kur kryhen pas disa muajve apo viteve, nga data e depozitimit të kërkesave për ekzekutimin e ketyre titujve. Keto konstatime janë në koherencë me problematiken, që sot është bërë dhe objekt gjykimi nga ana e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

Eshtë shumë i nevojshëm, në këtë moment, një ndërgjegjesim i aktoreve politike dhe administrative, në mënyrë që, fatura financiare e ketyre detyrimeve, të mos shumëfishohet, pikërisht pasi ato përfundojnë së gjykuari nga gjykata, ashtu siç edhe ka ndodhur deri tani.



Garantimi i të drejtës së pronës ka qenë ndër prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010. Nderhyrjet tona kanë qenë, si në drejtim të ligjeve të caktuara, të cilët sipas argumenteve të dhëna prej nesh në kërkesat e drejuara Gjykatës Kushtetuese, cenonin të drejtën e pronës dhe të drejtën për t'a gezuar lirisht atë, ashtu edhe në drejtim të vendimmarrjes individuale të organeve të administratës, pra të shqyrtimit të ankesave individuale, të cilët në përmbushje të interesit publik të ngarkuar nga ligji, duke ushtruar kompetencat e tyre, duhet të garantojnë mbrojtjen e të drejtës së pronës.

Konkretisht, kemi konstatuar shkelje të së drejtës së pronës nëpërmjet mosrespektimit të dispozitave të Ligjit 9235 datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave", i ndryshuar, kjo përsa i përket mosrespektimit të afateve ligjore për dhënien e një vendimi. Afati për marrjen e një vendimi nga institucioni i sipërcituar, referuar Ligjit 10207 dt. 23.12.2009 "Për disa ndryshime në ligjin 9235 dt. 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompesimin e pronës", neni 2, pika 1, gërma "b", është tre muaj, por faktikisht ky afat, rëndom, konstatohet i pazbatuar në pjesën më të madhe të praktikave të trajtuara nga ana jone.

Institucioni ynë gjithashtu ka konstatuar cenim të së drejtës së pronës nga moszbatimi i dispozitave të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar, nga ana e organeve që veprojnë në këtë fushe, përkatesisht prej Inspektoriateve Ndërtimore Urbanistike të çdo rangu.

Cënimi i së drejtës për të gëzuar lirisht pronën, nëpërmjet ndërtimit të objekteve pa leje ndërtimi, gati në të gjitha rastet, shoqëruar me mosrespektim të distancave urbane ndërmjet objekteve ekzistuese dhe atyre në ndërtim, përbën një shqetësim serioz.

Gjithashtu, është konstatuar shkelje e së drejtës mbi pronën për shkak të mosrespektimit të parashikimeve të bëra në nenin 1 dhe nenin 2, të Ligjit nr. 8651 dt. 22.12.2009, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik".

Konkretisht, shkelja vërehet në trajtimin e rasteve të ndryshme në lidhje me moskryerjen e procedurave të shpronësimit, përkundër përdorimit të pronës për interes publik.

Shkelje e së drejtës për të gëzuar lirisht pronën është shkaktuar në të njëjtën kohë edhe nëpërmjet mosrespektimit të dispozitave, të Ligjit nr.9482 dt. 03.04.2006 "Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.

Cënimi i së drejtës së pronës për shkak të mosrespektimit të këtyre dispozitave ligjore, përkatesisht të neneve 26 dhe 40, të Ligjit 9482 dt. 03.04.2006 "Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, sjell si pasojë mospezullimin e procedurave të

legalizimit, edhe kur jemi në kushtet e parashikuara në nenet e sipërpërmendura.

Avokati i Popullit, gjatë shqyrtimit të ankesave, ka konstatuar se një numër i konsiderueshëm i drejtohet kryesisht Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të cilat me veprimet dhe mosveprimet e tyre janë bërë premise për shkeljen e të drejtës së pronës.

Konkretisht, detyrimet ligjore anashkalohen nga nëpunësit e Zyrave, duke shkaktuar sorollatje të individëve, mohim të të drejtave të tyre të njohura dhe garantuara nga aktet normative ne fuqi. Gjatë trajtimit të ankesave është konstatuar tejkallim i afateve administrative dhe ligjore për shqyrtimin dhe përpunimin e kërkesave të tyre, në regjistrimin e kërkesave të parashtruara.

Shkeljet kane shkuar deri edhe ne diskutimin per shuarjen e të drejtës së pronësisë, përmes interpretimit që ZVRPP-te u bëjnë akteve të vjetra, vendimeve gjyqësore apo titujve të tjerë të pronësisë, duke i konsideruar ato si të paqëna apo të pavërteta, si dhe duke kërkuar, në çdo rast, konfirmimin e tyre nga organe të ndryshme të administratës apo ato organe që i kanë lëshuar këto akte apo vendime. Kjo gje shpesh është absolutisht e pamundur, për shkak se këto organe apo akte nuk mund të gjenden më, për shkaqe objektive. Qëndrime të tilla negative dhe adresimi i individëve në procese të gjata gjyqësore për të vërtetuar një fakt apo të drejtë, që ato e kanë ushtruar prej vitesh, janë absolutisht të padrejta. Për këtë arsye, është e domosdoshme të ndërmerret iniciativa ligjore për ndryshimin e Ligjit nr.7843 datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe përshtatjen e tij, dhe të sistemit aktual të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me kërkesat dhe ndryshimet aktuale që kanë ndodhur në Shqipëri. Ky ndryshim është i nevojshem edhe për shkak të kërkesës së përputhjes së këtij ligji, me aktet e tjera ligjore të brendshme ne fuqi.

Gjykojmë se është e padrejtë dhe diskriminuese, ndaj individëve të thjeshtë apo asaj shtrese popullore që disponon pasuri të vjetra, mbi të cilat ushtron të gjitha tagret e pronësisë, që t’u mohohet pajisja e tyre me dokumentacionin aktual të pronësisë, për shkak të faktit të sipërcituar dhe mungesës së shkaqeve objektive për konfirmimin apo vërtetimin e dokumentacionit të vjetër, me të cilin ato janë bërë pronarë të asaj pasurie të paluajtshme.

Dhënia fund e procesit të ndarjes dhe rindarjes së tokës bujqësore, të krijimit të titujve të rinj të pronësisë mbi të dhe mbarimit të funksionimit të veprimtarisë së komisioneve të ndarjes së tokës me Ligjin nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, ka sjellë rritjen e ndjeshmërisë së shumë familjeve bujqësore që nuk kanë gjetur zgjidhje përfundimtare.

Lidhur me standartin e respektimit të së drejtës për punë, nga ana e organeve të administratës publike, konstatohen çështje që kanë të bëjnë me largime të pamotivuara nga puna, mosrespektim të afateve ligjore paraprake të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga ana e punedhënesit dhe shkelje të procedurave të parashikuara në ligj për largimin nga puna dhe mosarsyetim të vendimeve, gje e cila pengon realisht subjektet të infomohen lidhur me arsyet e vendimit dhe, për rrjedhojë, të parashtrajnë kundër argumentet e tyre. Realisht këto shkelje kanë një pasoje finale që bie pikërisht mbi buxhetin e shtetit, pasi shumica e këtyre individëve i fitojnë proceset gjyqësore. Në fakt, këto rezultate kanë bërë që, për këtë çështje, në vitin në vazhdim në të bëjmë një studim nepërmjet të dhënave statistikore të sakta. Përmendim këtu ankesat që në kemi marrë, por edhe vendimet gjyqësore të formës së prera, për të arritur në konkluzionin se cilat duhet të jenë nismat, si në nivel politik, ashtu dhe administrativ, në mënyrë që të garantohet e drejta e punës.

Lidhur me të drejtën për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore, pavarësisht natyrës sociale të saj, konstatojmë se mbetet përparësi çështja e reformimit të sistemit të sigurimeve shoqërore në vend. Çështja e pensioneve minimale shumë të ulta, krejt të pamjaftueshme për një jetë normale për personat që i përfitojnë ato, mbetet një çështje e ndjeshme publike. Duke qendruar pikërisht në problemin e pamjaftueshmërisë së të ardhurave minimale për jetesë, vlen të përmendim edhe çështjen e ndihmës ekonomike, e cila është shumë e ulët dhe nuk i plotëson nevojat baze jetësore. E themi këtë, mbështetur dhe në faktin se ende nuk kemi të formalizuar minimumin jetik.

Pavarësisht se gjatë vitit 2010 nuk ka patur ankesa lidhur me standartin e kujdesit shëndetësor në vendin tonë, kjo nuk do të thote aspak së ky shërbim garanton dhe përmbush ato standarte, të cilat në synojmë të arrijmë. Në këtë kontekst, kemi vendosur që studimi tjetër, që do të jetë prioritet i punës tonë këtë vit, do të jetë pikërisht vlerësimi në terma konkrete i nivelit të këtij shërbimi dhe sa ky shërbim cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë, të drejtën themelore të jetesë.

E drejta për një ambient të shëndetshëm është e lidhur pazgjidhshëm me cilësinë e jetesë. Këtë vit, vihet re një tendencë në rritje sa i përket ndotjes së mjedisit në qendra të mëdha urbane, nëpërmjet ndotjes akustike shkaktuar nga subjekte shërbimi, përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Paraqitja e ankesave ka qenë e shpeshtë edhe për shkak të kapaciteteve të limituara në personel dhe teknikë të Agjencive Rajonale të Mjedisit (A.R.M.) në qarqe, të cilat, sidomos në qendra të mëdha urbane nuk arrijnë të monitorojnë plotësisht tejkalinimin e nivelit të zhurmave të lejuara nga mijëra subjekte shërbimi.

Plotësimi i nevojës së shtetasve për strehim, përsëri prezantohet si një problem madhor dhe jetik. Numri i familjeve të pastreha dhe kërkesat e tyre vijnë të rriten, duke sjellë zgjidhje të pamjaftueshme të këtyre kërkesave, në drejtim të projekteve minimale të realizuara nga pushteti vendor. Gjatë trajtimit të ankesave, kemi konstatuar se qytetaret vijnë të pretendojnë që mungon transparenca në përzgjedhjen e kategorive apo në vendimarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese dhe radha e trajtimit të shtetasve, probleme të cilat janë prezantuar dhe në raportet e mëparshme. Zvarritja e procedurave për t'u trajtuar me strehim ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve që kanë Bashkitë për trajtimin me strehim, për t'u ardhur në ndihmë të qytetarëve. Mbetet gjithashtu problematike çështja e trajtimit me strehim apo shtesë sipërfaqeje banimi për ushtaraket.

Lidhur me respektimin e të drejtave të konsumatoreve, gjatë vitit 2010, u vu re se kompani të tilla, si: shoqëria ALBTELECOM sh.a; shoqëria OSSH sh.a. CEZ dhe Ndermarrja e Ujesjelles Kanalizimeve, nuk respektonin të drejtën për informim të qytetarëve, të përcaktuara në kontratat respektive në fuqi ndërmjet paleve, si dhe të drejtat e ndryshme që burojnë nga legjislacioni përkates për konsumatorin. Duke anashkaluar qëllimisht këto të drejta, shoqëritë e mesiperme realizonin veprimtaritë e tyre, duke sjelle shpesh herë një kosto të madhe për jetën e qytetarëve.

Është konstatuar se nga Ndermarrja e CEZ Shpërndarja sh.a gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj për sigurimin ndaj klientit të një shërbimi sa më efikas dhe cilësor, nuk është parashikuar një procedurë transparente në trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të dhe për rastet që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit të furnizimit konsumatorëve, për pretendimet e tyre lidhur me mbifaturimin e energjisë elektrike, si me energji elektrike.

Një operator tjetër problematik në këtë aspekt ka qenë edhe Ndermarrja e Ujesjelles Kanalizimit, e cila shpesh ka treguar mungesë informimi të klienteve për sa i përket ardhjes së faturave në banesa, mbifaturimit abuziv moskthimit të përgjigjes nga operatori, etj.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian u shpall në Samitin e Nises, në Dhjetor 2000. Ky akt përmbledh të drejta të tilla themelore të qytetarëve, si e drejta për administrim të mirë dhe e drejta për t'u ankuar tek Ombudsmeni Europian ndaj keqadministrimit. Por çfare duhet të kuptohet në praktike me të drejtë për Administrim të Mirë? Pavaresisht faktit se sa i detyrueshem është ky akt dhe parashikimet e tij momentalisht në vendin tonë, në një të ardhme të afert secili prej nesh do të ballafaqohet me standarte të tilla, të cilat kushtezojnë veprimtarinë e organeve të administratës publike dhe të tregëve që veprojnë për llogari të saj. Megjithatë, mund të themi se, këto parime janë tashme të

sanksionuara ne legjislacionin tone, nepërmjet dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative dhe, në njëfarë mënyre, në këtë analize kemi bërë një grupim të tyre, duke i konceptuar si rregulla të cilat garantojnë mirëadminstrimin.

Gjatë shqyrtimit të ankesave që janë depozituar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, kemi konstatuar se jo pak prej tyre kanë patur të bëjnë me shkelje të elementeve të ndryshëm, që garantojnë parimin e mirëadministrimit, me qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, me ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave, realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, e të shpejta etj.

Pavaresisht standarteve të mireqeverisjes, të garantuara si ne Kodin e Procedurave Administrative, edhe ne të drejtën tone pozitive, për administratën publike shqiptare mbetet ende një sfide respektimi i ketyre elementeve gjatë vendimmarrjes së saj individuale. Ne realitet, respektimi i elementeve procedurale ne një vendimmarrje është, së pari, në favor të individit, pasi ky i fundit, duke u bërë pjese e saj, duke u informuar, duke u dëgjuar, duke marrë vendimin në kohë, bindet në realitet për drejtësinë e kësaj vendimmarrjeje. Nga ana tjetër, sa më pak konflikte administrative dhe gjyqësore të ketë, aq më shumë rritet kredibiliteti i administratës publike në realizimin e misionit të saj, atë të mbrojtjes së interesit publik. Për këtë, një nga prioritetet tona ka qenë dhe do të jetë pikërisht edukimi administratës publike për implementimin e parimeve të mirëadministrimit, duke përfshirë konkretisht në termat e kontrollit tonë administrativ, kërkesat e parashtruara në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe në ligjet e posaçme.

Gjetjet e mësipërme, nga njëra anë, kanë për qëllim që të japin një panoramë të respektimit të të drejtave dhe lirive nga ana e organeve të administratës publike, parë në syrin e një organi kushtetues të pavarur. Nga ana tjetër, ato përbëjnë një pikë referimi për punën tonë gjatë vitit në vijim, i cili pothuajse i ka të ngritura shinat nëpër të cilat do të ecë.

## Kreu II

### **Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit ne zgjidhjen e ankesave konkrete, e ndare sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore**

#### **1. Barazia përpara ligjit dhe ndalimi i diskriminimit**

Neni 18 i Kushtetutes së Republikës së Shqipërise, garanton barazine e të gjithë shtetasve përpara ligjit.

Askush nuk mund të diskriminohet për shkak te gjinise, races, fese, etnise, gjuhes, bindjeve politike, fetare a filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose perkatesise prinderore, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Kuptimi i konceptit të barazisë, ne frymen e Kushtetutës është parë gjithmone ne kuptim të mosdiskriminimit. Megjithate, kendveshtrimi i vleresimit të kesaj barazie, mbetet gjithmone, raporti aktual dhe real qe ekziston ndërmjet koncepteve të barazise formale dhe asaj thelbesore, rast pas rasti, raport i cili evidenton diskriminimin ne një nga format e tij të njohura tashme.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, ne nenin 14 të saj vendos ndalimin qe individet t'i nenshtrohen një trajtimi diskriminues vetem ne rastet qe kane të bëjnë me gezimin e një prej të drejtave themelore të garantuara nga ky akt ndërkombetar apo protokollet e saj. Barazia ne trajtim quhet e dhunuar nese diskriminimi nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshem.

Aktualisht, ne vendin tonë ekziston një baze e mire ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacion i cili, sikunder u permend dhe ne Kreun e Pare, është pasuruar cilesisht me hyrjen ne fuqi të Ligjit nr.10221 date 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Ky ligj ka sherbyer si baze për krijimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me kompetenca jo thjesht rekomanduese, por edhe vendimmarrese.

Megjithese krijimi i ketij institucioni të ri, ne kuader të institucioneve kombetare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, i jep teresisht tagrat dhe kompetencat, ne këtë fushe, vetem atij, veprimtaria e Institucionit te Avokatit të Popullit për mbrojtjen e individeve nga

diskriminimi, nuk mbaron ketu, pasi jo vetem që ai ka luajtur dhe do të luajë një rol aktiv edhe në këtë drejtim, por edhe sepse tashme është hapur një dritare e re bashkepunimi me një institucion të pavarur të krijuar me ligj.

Theksojme se, mbrojtja nga diskriminimi është jo vetem një e drejtë e individit, por edhe një detyrim i organeve të administratës shtetërore si dhe i të gjithë aktoreve dhe faktoreve të tjere në vend, të cilët kanë dhënë dhe japin një kontribut të rëndësishëm në këtë fushë.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2010, ka shqyrtuar me vëmendje të veçantë raste, në të cilat është pretenduar nga subjekte, trajtimi diskriminues nga organe të administratës publike. Kjo edhe për vetë faktin e problematikës së veçantë që ato paraqesin, por edhe të cilësive të veçanta të subjekteve ankues. Megjithatë, pas trajtimit të tyre, nuk është arritur të provohet, se ka patur trajtim diskriminues, ashtu siç është pretenduar. Nepërmjet rasteve që do të listojmë më poshtë tregohet se Institucioni i Avokatit të Popullit i ka trajtuar këto çështje me kujdes, pa anashkaluar pretendime paraqitura.

Në dukje pa lidhje me nocionin e diskriminimit, por pretenduar si i tillë, një numër jo i vogël ankuesish kanë paraqitur ankesa pranë institucionit tone, lidhur me problemin e masës së pensionit që ata përfitojnë, të cilën e shohin në këndvështrimin e një diskriminimi që u bëhet atyre nga shteti, për punën që ata kanë bërë për vite me radhë. Në këtë këndvështrim, kërkohet të ketë një bazë më të mirë për politikën që ndjek shteti në fushën e sigurimeve shoqërore. Megjithëse kohe pas kohe janë bërë përmirësime ligjore në këtë fushë, përsëri vihet re se ka kundërtënie, evazivitet, diferenca të masës së pensioneve të qytetarëve në kushte të njëjta pune etj.

#### **Nder rastet e trajtuara përmendim:**

Ankesën me **nr.201001204**, me anë të së cilës ankuesi shprehte pretendimin e tij ndaj Zyrës Rajonale të ALUIZNI-it Tiranë, për zvarritje në procedurat e shqyrtimit të dosjes së tij, të paraqitur pranë kësaj Zyre, duke hedhur dyshime se një zvarritje e tillë bëhej pikërisht për faktin se ai ishte qytetar me origjinë greke, dhe se ndaj tij dhe pronës së tij të paluajtshme, të ndërtuar pas viteve 1990, po ndërmerreshin veprime abuzive dhe të njëanshme, duke i sjellë atij një dëm të konsiderueshëm pasuror, pasi nga zvarritja e procedurave të legalizimit, rrezikohej edhe shembja e objektit të ndërtuar, për t'i lënë më pas vend investimit dhe zbatimit nga ana e Bashkisë Tiranë të një projekti për interes publik.

Avokati i Popullit ndërmori procedurat e hetimit për këtë rast dhe, në përfundim të hetimit, i rekomandoi drejtorit të ALUIZNI-it Tiranë, verifikimin dhe përfundimin sa më shpejt të procedurës administrative të

parashtruar. Nga ana e këtij organi të administratës publike janë kryer verifikimet e duhura dhe ankuesi figuron tashmë në listat e personave, prona e të cilëve do të legalizohet dhe që do të pajiset me aktin e pronësisë. Por, evidentojmë se, në përfundim, nuk u konfirmua diskriminimi i pretenduar nga ankuesi.

Në kuadër të së drejtës për mosdiskriminim, përmendim gjithashtu edhe ankesën e një grupi romësh (me nr.201001380, 201001381, 201001382, 201001383, 201001384, 201001385, 201001386) me banim afër bregut të Liqenit të Bunës, me anë të së cilës shprehnin pretendimin për zvarritje të procedurave të regjistrimit të tyre në Zyrën e Gjendjes Civile të Bashkisë Shkodër, duke u mohuar kështu një sërë të drejtash civile, sociale e shëndetësore, të cilat burojnë nga qenia e tyre si banorë të një njësie të caktuar vendore apo edhe aktet e ndryshme që lëshojnë këto njësi për përmbushjen dhe kryerjen e shërbimeve të tjera në organe të ndryshme të administratës publike.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit filloi shqyrtimin e kësaj ankese, e cila prekte një numër të konsiderueshëm të kësaj shtrese popullsie, duke synuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave të tyre dhe regjistrimin e tyre në regjistrat e gjendjes civile, pra qënien e tyre *de jure* banorë të njësisë vendore.

Pas verifikimeve të bëra pranë njësisë së qeverisjes vendore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, Avokati i Popullit arriti në konkluzionin se këta shtetas ishin regjistruar tashmë në regjistrat e gjendjes civile, por të një njësie tjetër të qeverisjes vendore, e në këtë kuadër ato u informuan më tej për rrugën ligjore që duhet të ndiqnin për përmbushjen e të drejtave të tyre që buronin nga ekzistenca e tyre si banorë të një njësie të caktuar vendore.

Duke vlerësuar të drejtën për te mos u diskriminuar për shkaqet e listuara në nenin 18/2 të Kushtetutës, si një të drejtë themelore të individit, me datë 20 Dhjetor 2010, Avokati i Popullit në bashkëpunim me shoqatën TLAS-Albania, dhe me pjesëmarrjen aktive të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta, si dhe të një sere aktoresh të rëndësishme të shoqërisë civile, organizoi Seminarin Kombëtar me temë "Shoqëria Shqiptare - Sfidat e Mosdiskriminimit".

Nga punimet e seminarit, Institucioni i Avokatit të Popullit përvijoi me disa rekomandime drejtuar aktoreve që vepronë direkt në luftën kundër diskriminimit. Ajo që konkludojmë me rekomandimet tona është se :



1. - I duhet dhene një frymemarrje me e gjere dhe evidente, rolit të shoqerise civile, i konkretizuar ne ndihmen konkrete ndaj individeve subjekte të diskriminimit, apo me oponencen direkte ndaj veprimtarise se organeve të administratës shteterore e me gjere, qe mbron individin nga diskriminimi.

2. - Ndihma konkrete e drejtpërdrejtë ligjore ndaj individeve, e ofruar nga organizma të shoqerise civile qe veprojne ne vend, nxjerr si nevoje shfrytezimin maksimal të kapaciteteve dhe bashkepunimin real dhe të vazhdueshem ndërmjet shoqerise civile dhe organeve të specializuara të administratës shteterore.

3. - Ne të gjithë veprimtarine e aktoreve dhe faktoreve ne luften ndaj diskriminimit, prioritet duhet të mbetet promovimi dhe njohja nga ana e individeve e të drejtave të tyre themelore, veçanerisht i se drejtës për mbrojtjen nga diskriminimi ne të dyja format e tij, pra të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Lidhur me të drejtat e fëmijëve në këndvështrim të mbrojtjes së tyre nga diskriminimi, konkludam se:

- Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve duhet të përbeje një prioritet për të gjithë aktoret dhe faktoret ne vend qe veprojne për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Duke vene si kriter paresor interesin me të larte të fëmijës, e drejta për mbrojtjen nga diskriminimi të fëmijëve përben edhe kryefjalën e veprimtarise së të gjithë organeve të administratës publike e me gjere.

- Duke pare me shqetesim pjesemarrjen e gjere të fëmijëve ne fushatat elektorale të partive të ndryshme politike, me synimin e sensibilizimit të të gjitha forcave politike shqiptare për të mos përfshire fëmijët ne mitingjet elektorale, jemi shprehur publikisht, duke tërhequr vëmendjen qe fëmijët nuk kane pjekurine intelektuale, fizike apo mendore njesoj si të rriturit, dhe shpesh ata nuk e kuptojne qellimin e ketyre organizimeve apo mitingjeve. Është pikërisht kjo mungesë e pjekurisë intelektuale të tyre arsyeja qe fëmijët kane nevoje për një mbrojtje të veçantë.

Nisur nga monitorimi i shtypit dhe mediave televizive, për respektimin e të drejtave të fëmijëve, nga punimet e seminarit u arrit ne konkluzionin se :

- Duhet të rritet pasqyrimi i problemeve të fëmijëve ne media dhe eshte i nevojshem zgjerimi edhe me analiza i gjendjes së të drejtave të fëmijëve;

- Fëmijët duhet te trajtohen si gjithë njerezit e tjere dhe jo ne mënyrë paternaliste, sensacionale, viktimizuese apo shfrytezuese;

- Media duhet të tregojë vëmendje të veçante për gjuhën dhe termat qe duhen të përdoren, sidomos kur pasqyrohen krime dhe ceshtje te drejtësise për të mitur;

- Duhet të respektohen gjithmone të dhënat personale dhe të ruhet identiteti i fëmijëve, sidomos në kronikat e zeza.

Krahas sa me sipër rezultoi se nevojitet një përmbledhje e legjislacionit që të përfshijë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fëmijët dhe të drejtat e tyre. Dispozitat që ekzistojnë në lidhje me fëmijët janë të shpërndara në shumë ligje të ndryshme dhe akte nënligjore. Po kështu është i nevojshëm një përqendrim mbi fëmijët më të cënuar, që jetojnë në kushte të vështira, të diskriminuar dhe të nxjerrë në plan të dytë nga mungesa e burimeve dhe kushteve për një jetë me cilësi të mirë.

Edukimi duhet të shërbejë si një nga kushtet e nevojshme për shmangien e diskriminimit ndaj fëmijëve dhe individëve në teresi. Denoncimi me forcë i çdo rasti diskriminimi, duhet të vlerësohet si mjet i rëndësishëm për parandalimin e këtij fenomeni.

Lidhur me gjendjen e Moshës së Tretë, rezultoi se mungon kuadri ligjor, që të parashikojë një mbështetje të veçantë për moshën e tretë, si shtrese në nevojë. Moshimi përbën një problem jo vetëm për vëndet e zhvilluara, por edhe për vëndet në zhvillim dhe prek të gjithë aspektet e jetës social - ekonomike e politike të individit. Për këtë arsye, kujdesi për të moshuarit, për plotësimin e nevojave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, duhet të jetë një nga prioritetet në kuadër të kujdesit social. Evidentohet se në zbatim të Planit të Veprimit të Dokumentit të Politikave Ndersektoriale për Moshën e Tretë, miratuar në Vendimin nr. 763 date 11.06.2009, të Këshillit të Ministrave, është hartuar projektligji "Për kujdesin e Moshës së Tretë". Në këtë kontekst, theksojmë se është i domosdoshëm miratimi sa më shpejt i këtij ligji, me qëllim që kjo shtrese të mos e ndiejë veten të diskriminuar.

Përsa i përket situatës së personave me aftësi të kufizuara u konkludua se:

- Aktualisht është miratuar me VKM nr.8, date 7.01.2005, "Strategjia Kombëtare për personat me aftësi të kufizuara", me objektiva dhe me plan konkret veprimi. Gjithashtu, është ecur në mënyrë progresive drejt përmirësimeve ligjore apo hartimit të ligjeve të reja, ku trajtimi i problematikave të personave me aftësi të kufizuara po zë vend gjithnjë e më shumë. Të tilla përmirësime janë bërë në Ligjin nr.9355, date 10.03.2005, "Për ndihmen dhe shërbimet shoqërore"; Ligjin nr. 7952, date 21.06.1995, "Për sistemin arsimor parauniversitar", Dispozitat normative, i ndryshuar; Ligjin nr.10019, date 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"; Ligji nr. 10119 date 23.04.2009, "Për planifikimin e territorit"; Ligji nr.7995 date 20.09.1995 "Për nxitjen e punësimit", i ndryshuar; Ligji nr.9232 date 13.05.2004 "Për programet

sociale për strehimin e banoreve të zonave urbane", i ndryshuar; Ligji nr.10221 date 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

Megjithate, kuadri ligjor ekzistues ne fuqi nuk garanton nivelin e duhur të mbrojtjes ligjore ndaj diskriminimit për disa kategori personash me aftesi të kufizuara, duke i bërë ata vulnerabel ndaj diskriminimit. të tille persona, janë personat me aftesi të kufizuara mendore dhe shqisore.

Me konkretisht, lidhur me keta persona rezultoi se:

- Nuk përfitojne sherbim kujdestarie personat me aftesi të kufizuara mendore. Një gjë e tille parashikohet vetem për ata persona qe kane aftesi të kufizuara të thella, ne kuptim të ligjit, apo për personat e tille deri ne moshen 7 vjeç, duke përjashtuar keshtu të gjithë pjesen tjeter të ketyre individeve.

- Nuk përfitojne sherbime rezidenciale apo ditore. Edhe kur këto sherbime jepen, ato janë të kufizuara dhe ofrohen mbas moshes 25 vjeç.

- Nuk përfitojne sherbimin e përkthimit të gjuhes së shenjave, personat me aftesi të kufizuar ne degjim, gje qe, për rrjedhoje, sjell edhe humbjen e së drejtës së tyre për t'u arsimuar.

- Nuk përfitojne sherbime, personat me aftesi të kufizuar pas moshes së punes, pra ata persona qe ne këto kushte kane dale ne pension.

- Nuk janë të parashikuara ne legjislacionin përkates, alternativa votimi jashte qendrave të votimit, për personat me aftesi të kufizuara, qe nuk paraqiten dot ne këto qendra, gje qe sjell për pasoje humbjen e së drejtës së tyre për të votuar.

- Nuk ka procedura transparente dhe gjyqesisht të kontrollueshme për përcaktimin e nivelit të aftesise së kufizuar dhe as trajtime të diferencuara për personat me kufizime me të renda ne aftesine e kufizuar.

Për të gjitha këto raste nevojitet përmiresimi i kuadrit ligjor ekzistues ne fuqi, apo edhe plotesimi i legjislacionit me akte të reja ligjore, të cilat logjikshem do të parandalojne gjendjen e diskriminimit real ndaj kesaj kategorie personash, duke sherbyer njekohesisht edhe si garanci për ushtrimin real të te drejtave të tjera themelore kushtutese të ketyre personave me aftesi të kufizuara.

- Mosnxjerrja e akteve nenligjore, ne zbatim të ligjit, nga ana e organeve përkatese të administratës publike, sikurse ne rastet e Ligjit nr.7995, date 20.09.1995, "Për nxitjen e punesimit", apo Ligjit nr.9232, date 13.05.2004, "Për programet sociale për strehimin e banoreve të zonave urbane", i ndryshuar, ben qe personat me aftesi të kufizuara të ndjehen të diskriminuar ne këto fusha. Për rrjedhoje, del si kerkese imperative nxjerrja e akteve nenligjore ne zbatim të ligjeve të mesipërme, me qellim ndalimin e gjendjes diskriminuese të krijuar ndaj personave me aftesi të kufizuar për këtë shkak.

- Shkak kryesor për diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara është moszbatimi i legjislacionit në fuqi, i cili sanksionon të drejta për këtë kategori individesh.

- Duhet ndërmarre hapa konkretë për përmbushjen dhe sigurimin e kriterit të aksesimit të arsyeshëm, si një kërkesë kryesore e parashikuar në Konventën "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara" dhe si një parakusht për integrimin e vendit në BE.

- Nga të gjitha institucionet e specializuara shtetërore apo edhe nga organizmat përkatës të shoqërisë civile, duhet të jepet shembulli dhe modeli konkret i respektimit të së drejtës së individit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Përsa i përket çështjes së pakicave, konkluduar se është i domosdoshëm:

- Përmirësimi i të dhënave statistikore në fushën e edukimit (arsimi parashkollor - arsimi i lartë), me qëllim analizimin e gjendjes arsimore të fëmijëve Romë. Hartimi i një legjislacioni me karakter me liberal, në fushën e arsimit për Romët.

- Eliminimi i qëndrimeve përjashtuese dhe përçmuese ndaj Romëve në komunitetin shkollor dhe transformimi i diversitetit kulturor në një burim njohurish dhe atmosfere të respektit reciprok, tolerancës dhe mirëkuptimit ndaj tyre.

- Rritja e përfitimeve për komunitetin Rom, nga skemat e mbrojtjes sociale, me anë të ndërmarrjes së masave lehtësuese.

- Ofrimi i mundësive për akses në strehim dhe në infrastrukturë në përputhje me standardet shtetërore në zonat me popullsi Romë.

- Kryerja e rregullt dhe periodike, si një proces në vazhdim, i regjistrimit të popullsisë romë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Angazhimi i strukturave shtetërore për regjistrimin e fëmijëve të braktisur (dorezuar të afërmeve të prindërve nga vetë prindërit, por pa dokumentacion ligjor),

- Identifikimi i rasteve të abuzimit të fëmijëve romë, që punojnë në rrugë dhe pakësimi i tyre me anë të masave ndëshkuese.

- Rritja e numrit të individëve romë, në skemën e detyruar të sigurimeve shoqërore, me qëllim që të përfitojnë nga kjo skemë, nëpërmjet krijimit të lehtësirave procedurale specifike për shkak të nivelit të ulët arsimor, kulturor dhe ekonomik.

- Rritja e aksesit të komunitetit Rom në sistemin shëndetësor publik. Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare në vendbanimet e popullsisë Romë.

- Krijimi i kushteve për ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë Kulturore të Romëve. Krijimi i një ambjenti social përfshirës dhe vlerësues ndaj diversitetit kulturor të Romëve.

- Arsimimi i komunitetit rom dhe punësimi i tyre, duhet pare nga Qeveria, jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat me efikase për integrimin e tyre të plote ne shoqëri. Pa ndërhyrje energjike ne këto dy fusha prioritare, për daljen e komunitetit rom nga gjendja ku ndodhet, nuk mund të flitet për pjesëmarrje të barabartë, ne kuptimin e plote të fjalës, në një shoqëri të hapur dhe ne përputhje me qëndrimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut, që kërkojnë parandalimin dhe dënimin e çdo lloj diskriminimi, direkt ose indirekt, që mund të bëhet ndaj çdo individi.

## **2. E drejta për informim**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e informimit si një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila është rregulluar për herë të parë me një ligj specifik, Ligjin nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Mbrojtja e të drejtës së aksesit në dokumentat zyrtare, e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përcakton dhe vendos rregulla në mirëfunksionimin dhe transparencën e Administratës Publike, karshi publikut të gjerë. Nocioni i të drejtës së informimit, në vetëvete do të thotë që çdokush ka të drejtën që t’i bëhet i njohur informacioni me interes publik si dhe të njihet me dokumente zyrtare. E thënë më thjeshtë, çdo person ka të drejtën për të studjuar dokumentet e mbajtura nga autoritetet publike.

Dokumenti më i rëndësishëm në kuptimin e akteve normative që garantojnë të drejtën e informimit, është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila ne nenin 23 të saj garanton te drejtën per informim.

Si pjesë e paketës së ligjeve në zbatim të Kushtetutës, është miratuar nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe ka hyrë në fuqi, Ligji Nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Kodi i Procedurave Administrative miratuar me Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, e parashikon të drejtën e informimit si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike. Ai bën një rregullim specifik të së drejtës për informim, duke ia njohur këtë të drejtë subjekteve që janë palë në një procedim administrativ ose atyre që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me këtë proces.

Duke u trajtuar si pjesë e katalogut të të drejtave të individit dhe si një nga të drejtat themelore vetjake, e drejta e informimit ka gjetur pasqyrim në akte të rëndësishme ndërkombëtare.

Qënia palë në këto akte, sjell për rrjedhojë detyrimin e shtetit për marrjen e masave për respektimin e detyrimeve të parashikuara në to, ose

të paktën të një pjese të këtyre detyrimeve. Ndër aktet ndërkombetare, më të rëndësishme në këtë fushë, mund të listojmë:

a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në 10 Dhjetor 1948, e cila në nenin 19 të saj afirmon të drejtën për informim si një nga të drejtat themelore të individit;

b) Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në paragrafin e parë të nenit 10 të saj, bëhet një riformulim dhe theksim i përcaktimit të bërë në nenin 19, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut;

c) Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (Dhjetor 1966). Ky është një akt i rëndësishëm, i cili njeh dhe garanton të drejtën për informim;

d) Deklaratën e Këshillit të Europës, mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit, të vitit 1982, e cila shpreh si një nga përparësitë në veprimtarinë e Këshillit të Europës, aksesin në informacion. Në këtë deklaratë jepen parimet kryesore në lidhje me të drejtën e informimit dhe rolin që luan kjo e drejtë në shoqëri “si një kusht i nevojshëm për zhvillimin e shoqërisë”.

e) një akt tjetër që elaboron këtë të drejtë, në një fushë të caktuar është Konventa e Aarhusit, “Mbi të drejtën e publikut për informim, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin”.

Çështjet e shqyrtuara për shkelje të së drejtës për informim, gjatë vitit 2010 nga ana e Institucionit tone, kanë nxjerrë edhe problematikën e zbatimit të ligjit në Administratën Publike, nga e cila konstatohet se:

- Nuk zbatohen afatet ligjore për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion, qoftë për refuzimin, qoftë për përmbushjen e tyre.

- Legjislacioni mbi të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare, njihet pjesërisht në një nivel jo të kënaqshëm nga Administrata Publike, por ai nuk zbatohet, duke shmangur kështu përgjegjësinë për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Gjithmonë, duke ju referuar kësaj praktike, por edhe pa përjashtuar mjedisin social dhe zhvillimet e tij në këtë drejtim, mund të thuhet se Ligji Nr.8503 datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, njihet në masë jo të mjaftueshme dhe nga një pjesë e kufizuar e administratës, gjë që sjell vështirësi dhe pengesa në funksionimin normal dhe transparent të Administratës Publike, në marrëdhëniet e kësaj të fundit me publikun.

Gjatë vitit 2010 rastet e shqyrtuara në të cilat është pretenduar nga ana e ankuesve shkelje të së drejtës për informim, janë drejtuar në kuader të veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror, njesive të pushtetit

vendor, të veprimtarise së enteve publike, si dhe të personave juridike që ofrojnë shërbime publike.

Duhet theksuar se, pavarësisht punës konkrete që bëhet në lidhje me çështjet përkatëse në këtë fushë, duhet kuptuar fakti se vetë procesi i shqyrtimit të çështjeve në tërësi, nga ana e Avokatit të Popullit, dhe informimi që i bëhet ankuesve apo kërkuesve rast pas rasti, në thelb është realizim direkt i së drejtës për informim ndaj individit. Në thelb veprimtaria e këtij institucioni mbart realizimin e të drejtës për informim.

### **Raste konkrete, rekomandime.**

Një shtetase nga Tirana, nëpërmjet ankeses **nr.20100038**, ankohej ndaj Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për mosdhënie informacioni ndaj një kërkese të paraqitur nga ana e saj. Konkretisht, duke qënë se ankuesja ishte pronare mbi një sipërfaqe trualli pranë Qendrës Kombëtare të Panairëve (ish ekspozita Shqipëria Sot), ka kërkuar një kopje të kontratës të lidhur midis M.E.T.E-s dhe Top-Channel për dhënie ambjenti me qera. Nga ana e M.E.T.E ky informacion nuk i është dhënë, duke tejkaluar të gjitha afatet ligjore, pa shkaqe të përligjura. Për këtë ankesë, ne si institucion, pasi konstatuam shkeljen e të drejtës së ankuses për informim, bëmë ndërhyrjet pranë M.E.T.E-s, duke i përcjellë gjithë informacionin e kërkuar në përputhje edhe me dispozitat ligjore të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Ankesa me **nr.201000474**, me ane të së ciles pretendohej nga ankuesi për mungese informimi lidhur me rezultatet e mbledhjes së Keshillit Bashkiak, të njesisë nr. 9-ë në Tiranë. Konkretisht shkak ishte bërë prezenca e tij në mbledhjen e fundit të Këshillit Bashkiak, nr.9 Tirane, ku anëtarët e Këshillit i kishin komunikuar, pak pas fillimit të mbledhjes, se duhet të dilte jashtë, “për arsye se mbledhja do zhvillohej pa praninë e tij”.

Në kushtet, kur ankuesi parashtronte se duhej t`i jepej një vendim zyrtar për largimin nga mbledhja e Keshillit Bashkiak, në baze të nenit 3, pika 3 të “Ligjit për të drejtën e informimit”, ai kerkoi ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, në drejtim të respektimit të së drejtës së tij për informim, në baze të Kushtetutes, por dhe korrigjimit të sjelljes së antareve të Keshillit ndaj qytetareve.

Për sa me sipër, zyra e Avokatit të Popullit komunikoi në rrugë zyrtare me autoritetet e njesise Bashkiake nr. 9 Tirane, për të marre një sqarim, dhe pasi u informua mbi zhvillimin e situates së krijuar, sqaroi ankuesin se: Në baze të Ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore, në nenin 34 përcaktohetin procedurat e ndjekura për mbledhjet e hapura, ku çdo qytetar lejohej të

ndiqte mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Ne piken 3, të po kesaj dispozite, përcaktohej se Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendoste për rastet kur mbledhja bëhej e mbyllur.

Pra në këtë rast, vetë anëtarët e Keshillit kishin vendosur për mënyrën e mbyllur të zhvillimit të mbledhjes dhe, për këtë fakt, nuk kishte nevojë për ndonjë vendim me shkrim, sikundër pretendohet nga ankuesi, por mjaftonte gjykimi i shumices së ketyre antarëve, për të vendosur mënyrën e procedimit të mëtejshëm. Ky veprim kryej, gjithashtu, edhe në përputhje me rregulloren, mbi të cilin funksiononte çdo Këshill. Në rastin me të mire, konkluzionet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, sipas nenit 35/3 të po këtij ligji, përcaktohej se afishoheshin në vende publike, të caktuara nga Këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli caktonte edhe forma të tjera të publikimit të tyre.

Pra, ankuesit iu komunikua fakti se, informimi i publikut për rezultatet e mbledhjes ishte bërë tashme nepërmjet afishimit në njesinë përkatese nga vetë këshilli, për këtë qëllim.

Ne ankesën me **nr.201000308**, ankuesi shprehte shqetësimin për trajtimin e një kerkese për informim, që ai i kish drejtuar Bashkisë Tiranë, ku kish kërkuar një informacion në lidhje me emertesat e kopshteve private për fëmijë, në juridiksionin e Bashkisë Tiranë, me adresat përkatese të tyre. Ankuesi pretendonte, në ankesën e tij, se zyra e protokollit në Bashkinë Tiranë, pa paraqitur asnjë justifikim ligjor, i kishte refuzuar pranimin e kesaj kerkese, duke mos e protokolluar atë, ndërkohe që punonjës së zyrës juridike i kishin thënë verbalisht se, informacioni që ai kerkonte ishte konfidencial, ndaj nuk mund t'i jepej.

Me marrjen në shqyrtim të kësaj çështjeje, pasi verifikuam situatën pranë Bashkisë Tiranë, u sqaruam nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, në Bashkinë Tiranë, e cila ishte e vetmja struktura që mbante këto të dhëna se, në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 24, të Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ankuesi nuk përfshihej në grupimin e subjekteve të parashikuara nga ky ligj, të cilat legjitimohen për të kërkuar informacionin tatimor, lidhur me kopshtet private dhe adresat e tyre. Pra informacioni i kërkuar nga ana e kërkuarit, në këtë rast, ishte një informacion tatimor.

Informacioni i mbajtur nga ana e Bashkisë Tiranë, përkatesisht Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, lidhur me kopshtet private dhe adresat e tyre (ashtu siç edhe ishte kërkuar shprehimisht nga ana e ankuesit), sipas ligjit të sipërcituar, përben informacion konfidencial për subjektin përkates juridik, i cili ushtron



veprimtarine ekonomike të “Kopshtit për fëmijë, privat”, gje e cila përcaktohet shprehimisht ne nenin 31 të ligjit te sipercituar.

Në këto kushte, kemi sqaruar ankuesin se, përcaktimi i bërë ne nenet 24 dhe 31, të Ligjit “Për procedurat tatimore ne Republiken e Shqipërisë”, i ndryshuar, është një nga rastet e kufizimit të së drejtës për informim të parashikuar ne paragrafin e dyte dhe të trete, të nenit 3, të Ligjit nr.8503 date 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”, ku thuhet se:

“Autoriteti publik është i detyruar të jape çdo informacion ne lidhje me një dokument zyrtar, *përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.*

Çdo informacion, për një dokument zyrtar, qe i është dhene një personi, nuk mund t'i refuzohet asnje personi tjetër qe e kerkon ate, *me përjashtim të rastit kur ky informacion përben të dhena vetjake të vete personit, të cilit i është dhene informacioni”.*

Nga ana tjetër, jemi vene ne dijeni të faktit se drejtoria përkatëse ne Bashkine Tirane, e cila mbulon çerdhet dhe kopshtet publike, i kishte dhënë një informacion ankuesit në lidhje me numrin e tyre si dhe adresat në të cilat ato ndodhen.

Në këto rrethana kemi gjykuar se shqyrtimi i mëtejshëm nga ana jonë nuk mund të vazhdohej për këtë çështje, pasi nuk rezultonte shkelje së drejtës për informim.

Në ankesën me **nr.201000802**, qytetari ankohej në lidhje me mosrealizimin e së drejtës së tij për informim, për shkak të mosdhenies së një informacioni zyrtar qe mbahej nga ana e Ministrise së Integritimit. Konkretisht, ai kishte kerkuar t'i jepej një kopje e dokumentit zyrtar, Pyetesori i Komisionit European drejtuar vendit tone. Ai shprehej se i ishte drejtuar ketij institucioni me disa letra për këtë qellim, por megjithese kishte kaluar afati ligjor i përcaktuar, nuk kishte një përgjigje nga ana e këtij institucioni.

Pas marrjes ne shqyrtim të kesaj çështjeje nga ana jone, Ministria e Integritimit, ne përgjigjen e saj të derguar me shkresen nr.823/1 date 13.07.2010, sqaronte shprehimisht se:

“*Ministria e Integritimit e ka konsideruar si të panevojshëm informimin individual të personave, që mund të kenë kërkuar të zotërojnë një kopje të Pyetesorit gjatë procesit të përgjigjes së pyetjeve të Pyetesorit nga administrata shqiptare, për shkak se zj. Ministre e Integritimit ka deklaruar disa herë radhazi, publikisht, nëpër konferenca për shtyp, takime pune në Ministrinë e Integritimit apo edhe në mbledhje të Këshillit të Ministrave, se Pyetesori është një dokument konfidencial pune dhe si i tillë nuk mund të publikohet, aq më pak t'u shpërndalet individëve të caktuar.*

*Ju informojme gjithashtu se dokumenti i konsoliduar me pyetjet dhe përgjigjet e Pyetesorit të KE, do të behet publik brenda një kohe të shkurter.”*

Referuar rastit konkret, kemi konstatuar se:

1. Ne përputhje me kërkesat e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, kerkuesi ka paraqitur ne përputhje me ligjin, një kerkese formale zyrtare për marrje informacioni dhe dokumentacioni.

2. Kerkeses formale zyrtare ne fjale, për dhenie informacioni dhe dokumentacioni zyrtar, institucioni ne fjale, me cilesinë e autoritetit publik, nuk i kishte kthyer përgjigje me shkrim, brenda afatit të përcaktuar ne nenin 10, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ne të cilin thuhet shprehimisht se:

*“Autoriteti publik vendos për mospranimin e plote ose të pjesshem të kerkeses brenda 15 diteve nga depozitimi i saj. Ne rast të mospranimit të kerkeses, përgjigja negative, e plote apo e pjesshme, jepet e arsyetuar, me shkrim nga autoriteti publik”.*

Dispozita ligjore ne këtë rast, nuk e ka përcaktuar kthimin e përgjigjes së refuzimit të kerkeses si një çështje të diskrecionit të ketij institucioni, por si një detyrim ligjor, ku përgjigja ndaj kerkeses duhej të përmbante arsyetimin për shkaqet e refuzimit të saj.

Nga analiza qe i beme rastit konkret, konkluduar ne mosrespektim te procedures së percaktuar ne ligjin “Per te drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”, dhe ne mbeshtetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 date 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, si dhe paragrafit 2 të nenit 3 dhe atij 1 te nenit 18 të Ligjit nr.8503, date 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i kemi rekomanduar Ministrise Integritimit, korrigjimin e kesaj praktike, të ndjekur ne rastet e moskthimit të një përgjigje, ndaj kerkeseve për informim, dhe dhënien e përgjigjes ndaj subjekteve kërkues, në përputhje me nenin 10, të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

**Nevoja per permiresime ne ligjin “Per te drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”.**

Funksionimi i regjimit të informimit publik në vend vazhdon të ketë probleme të dukshme. Arsytet për gjendjen e krijuar janë të karakterit infrastrukturor, të ndikuara nga mungesa e një vullneti politik të mjaftueshëm, dhe të shprehura në dobësinë e kapaciteteve administrative, tendencat autokratike të trashëguara nga administrata, por edhe të kushtëzuara nga mangësi të kuadrit ligjor të së drejtës së informimit, i cili ka mbetur i pandryshuar që prej vitit 1999.

Aktualisht, mbeten parësore ndryshimet dhe përmirësimet e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si një kërkesë e përshtatjes së legjislacionit të brendshëm me “Acquis Communautaire”.

Bazuar në eksperiencën 10 vjeçare të rolit si kujdestar për respektimin e të drejtës për informim, si nga shqyrtimi i ankesave në institucionin tone, ashtu edhe nga bashkeveprimi yne me organizata të ndryshme joqeveritare që veprojnë në këtë fushë, kemi arritur në konkluzionin se, për të mundur ushtrimin sa më efikas të kësaj të drejte nga ana e individëve, nevojiten ndryshime në bazën ligjore ekzistuese që garanton të drejtën për informim.

Ndryshimet e mundshme të ligjit duhet të konsistojnë në:

- *Zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrim, dhënien e informacionit*, duke përfshirë;

i. personat fizikë ose juridikë që përmbushin funksione publike ose administrative (p.sh. kompanitë private që kanë monopole ose koncesione për furnizimin me ujë, energji elektrike etj),

ii. personat juridikë që operojnë, tërësisht ose pjesërisht, me fonde publike (p.sh. kompanitë që janë në pronësinë/kontrollin e shtetit; personat privatë, fitimprurës ose jofitimprurës, që subvencionohen nga shteti në një masë të konsiderueshme etj).

- *Shtesën e kritereve përjashtimore*, që do të thote të parashikohet një listë shteruese e kritereve për mosdhënien e informacionit;

- *Rishikimin e afateve për dhënien e informacionit*, duke patur parasysh se praktika e zbatimit të afateve të percaktuara në ligjin e sipercituar ka evidentuar konfondimin e termit “ditë pune” me “ditë kalendarike”, gjë që ka sjellë vonesa apo zgjatje të afatit të ligjit, edhe përtej asaj çfarë është parashikuar shprehimisht. Efektivisht, diskrecioni që i është njohur administratës publike, në kuptimin e shfrytëzimit të afateve për trajtimin e kërkesave për informim, deri tani ka rezultuar në sensin e abuzimit me afatet dhe, për më tepër, nuk ka justifikuar veprimtarinë e administratës për këtë qëllim.

- *Detyrimin për të ndihmuar kërkuesin të identifikojë dokumentet që kërkon* pasi administrata ka njohuri më të plota se çfarë dokumentesh zyrtare mban dhe në fund të fundit, sqarimi i kërkesës thjeshtëzon punën e të dyja palëve, duke pranuar detyrimisht kërkesën, në rast se i disponon dokumentet në fjalë, ose në të kundërt, detyrimi është që, për sa të jetë e mundur, të drejtohet kërkesa ose kërkuesi te subjekti kompetent që duhet të japë informacion sipas ligjit.

- *Formën e dhënies së informacionit*, pasi ligji shprehet se kërkuesit i jepet një “kopje e plotë” e dokumenteve që kërkon ose një përgjigje “në formë verbale”.

Megjithëse në ligj shprehet se kërkuesit i jepet informacioni në formën më të përshtatshme, në rastet e personave me aftësi të kufizuara, duhet të parashikohet shprehimisht dhënia e informacionit në formën më të përshtatshme për ta, në varësi të paaftësisë që ata kanë. P.sh në rastin e

të verbërve, mund të jepet në formën e shkrimit të veçantë që aplikohet në shkollat e të verbërve.

Gjithashtu një parashikim që duhet shtuar është që kërkuesit i jepen dokumentet në formatin e preferuar prej tij, duke përfshirë dhe formatin elektronik, përveçse kur kjo paraqet vështirësi teknike të konsiderueshme.

- *Koston e pagesave për dhënien e informacionit*, pasi në praktikë verehen subjekte, që caktojnë tarifa tepër të larta dhe artificiale për të vështirësuar marrjen e informacionit, gje që çon në përfundimin se formulimi i dispozitave përkatëse ligjore nuk është i saktë dhe ndoshta evaziv.

- *Ne caktimin e sanksioneve dhe dëmshpërblimin*, pasi sanksionet për moszbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nëse shkelja nuk përbën vepër penale, caktohen sipas ligjit nr.7697 datë 7.04.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.<sup>1</sup>

Ndërkohë, lidhur me shpërblimin e dëmit, parashikohet se: “Çdo person, që ka pësuar një dëm, për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga subjekti që shkel të drejtën.

Procedurat për ankim dhe për shpërblimin e dëmit rregullohen me ligj”.<sup>2</sup>

Nga praktika e deritanishme është evidentuar se, zbatimimi i këtyre dispozitave mbi sanksionet dhe dëmshpërblimin ka qenë pothuajse inekzistent.

Duke pasur parasysh që e drejta e informimit mund të përdoret nga individët, edhe për të mbrojtur interesat e tyre private, është mëse e logjikshme që pamundësia për të përfituar nga kjo e drejtë të përkthehet në dëm për qytetarët. Në kontekstin e të drejtës së informimit, do të mjaftonte të vërtetohej që refuzimi i administratës, për të servitur dokumentacionin e kërkuar, të ishte i pambështetur në ligj, si dhe të tregohej një lidhje shkakësore midis këtij veprimi të paligjshëm të administratës dhe një dëmi të pësuar nga personi privat, që ky i fundit të legjitimohej për një dëmshpërblim nga administrata fajtoresh, sipas parashikimeve të Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

Adoptimi në ligj, i sanksioneve të posaçme për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, do të bënte që ato të njihen më mirë nga subjektet e interesuara dhe që ato të kishin potencial më të madh për zbatim. E njëjta gjë mund të thuhet për procedurat e shpërblimit të dëmit.

---

<sup>1</sup> Shih nenin 14 të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”

<sup>2</sup> Shih nenin 17 të Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”

### **3. Liria e ndërgjegjes dhe e fese**

Ne analize të lirise së besimit ndërgjegjes dhe fese, eidentojme se Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010, nuk ka patur ankesa, ku të jete pretenduar cenimi i kesaj të drejtë nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike.

Kontributi yne ka qenë ne vijimesi për hartimin e projektligjit “Për fene”, i cili është ne vazhdimesi të punes së bërë për hartimin e mareveshjeve tip me komunitet fetare ne Shqipëri, detyrim ky qe buron nga neni 10 i Kushtetutes.

Njekohesisht, po ndjekim me vemendje zhvillimet e projektligjit “Per sistemin arsimor parauniversitar, i cili duhet te mbeshtet ne parashikimet e bera ne Kushtetute dhe ne Konventen Europiane të Drejtave të Njeriut , si pjese e legjislacionit te brendshem.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e fese përfaqeson një prej themeleve të një “shoqerie demokratike” dhe renditet ndër elementet me thelbesore të identitetit të besimtareve dhe të konceptit të tyre për jeten, por është gjithashtu një gje e çmuar për ateistet, agnostiket, skeptiket apo indiferentet. Ne reference të projektligjit, i cili parashikon ndalimin e mbajtjes së simboleve fetare ne shkolle, eidentojme se, natyrisht politika e ndjekur nepërmjet ligjit, kryesisht ne arsimin parauniversitar, duhet të këtë si qellim qe të akomodoje çdo njeri ne menyren sa me të arsyeshme të mundshme, për të krijuar një klime të përshtatshme, ne të cilen fëmijët të mund të mesojne dhe të jetojne sebashku ne harmoni.

### **4. Kufizime të lirise së personit**

#### **- Veprimtaria e Policise së Shtetit**

Policia e shtetit përben strukturen qe përfaqeson fuqine shtrenguese të shtetit. Për vete specifiken e funksionit të saj, Policia e Shtetit është organi, i cili lidhet ne mënyrë direkte me cenimin e të drejtës dhe lirive të individeve, ne kendveshtrim të veprimtarise kryesore të saj, qe është ruajtja dhe sigurimi i rendit publik.

Gjate 11 viteve të funksionimit të tij, Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur ne vijim ankesa të qytetareve të ndryshem për veprime të caktuara të organit të policise së shtetit. Edhe për vitin 2010 mjaft ankues na janë drejtuar për veprime të paligjshme dhe të parregullta të punonjesve të policise, gjatë ushtrimit të detyres së tyre. Pretendimet e ankuesve kanë qënë për torturë dhe keqtrajtim të tyre nga punonjësit e policisë, për arrestime e ndalime të kundërligjshme, për shoqërime të paligjshme në organet e mjediset e policisë, për mosmarrje apo

mosndjekje të kallëzimeve, të ankesave, të kërkesave të bëra nga shtetasit dhe për veprime të tjera të paligjshme apo të parregullta nga organet dhe punonjësit e policisë. Ankesat, të cilat kane objektin e sipërpërmendur, janë rreth 130.

Është e rëndësishme që të theksojmë se, megjithëse numri i ankesave të shtetasve për torturë dhe keqtrajtim nga punonjësit e policisë, gjatë vitit 2010, ka qënë më i vogël së ne vitet paraardhese, përsëri ky problem ngelet shqetësues, sepse përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të individit.

Nga ana jonë nuk është konstatuar asnjë rast që drejtuesit e organeve të policisë të bëjnë denoncime kur konstatojnë kryerjen nga vartësit e tyre të kësaj shkeljeje të rëndë. Ky fakt është një tregues negativ i Policisë së Shtetit dhe për këtë arsye drejtuesit e saj duhet të reagojnë menjëherë për të ndryshuar këtë gjendje. Ata duhet të organizojnë më mirë punën edukuese dhe profesionale me efektivat e tyre, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni të papranueshëm në një shtet të së drejtës dhe shoqërinë demokratike.

Problem shqetësues vazhdon të mbetet shoqërimi i shtetasve në organet, zyrat dhe ambjentet e policisë. Gjatë ndjekjes së ankesave të ardhura për këtë çështje dhe nga inspektimet e bëra në organet e policisë janë konstatuar disa shkelje të cilat do t'i rendisim më poshte.

Në të gjitha Drejtoritë e Policisë së Qarqeve, Komisaritet e Stacionet e Policisë në vend, nuk ka dhoma shoqërimi të shtetasve, sipas standarteve dhe konceptimit të bërë nga ligji nr. 9749, dt. 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*", të ndara për meshkujt, femrat dhe të miturit. Megjithëse në disa drejtori policie të qarqeve kane filluar punimet për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të shtetasve, sipas standarteve të parashikuara në ligj, verehen në disa raste projekte të papërshtatshme zbatimi (Drejtoria dhe Komisariti i Policisë Gjirokastër), që kompromentojnë rëndë ambjentin e shoqërimit dhe cilësinë e personave të shoqëruar .

Në dhomat ekzistuese të shoqërimit, në komisaritet e inspektuara gjatë vitit 2010, verehen mungese orendish të nevojshme për qëndrim, si dhe kushte të papërshtatshme, si nga përmasat, ndriçimi natyral, higjena, ashtu edhe nga konceptimi dhe trajtimi i personave të shoqëruar, pasi realisht ato janë dhoma izolimi, sepse janë të ftohta, me dyer hekuri, të mbyllura me dryna dhe pa ndriçim nga rrjeti. Për këto arsye, është i nevojshëm rikonstruksioni i ambjenteve të dhomave të shoqërimit, si dhe ndarja e tyre për persona të mitur dhe femra, në të gjitha Komisaritet e Policisë në vend, sipas konceptimit të bërë në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007, "*Për Policinë e Shtetit*".

Kjo tregon se sa pak vlerësohet nga Strukturat e Policisë së Shtetit, mbrojtja e të drejtave të shtetasve në këto ambjente.

Nga ballafaqimi i praktikave të punës së policisë me librat e shoqërimit të shtetasve, rezulton që, në shumë raste, janë shoqëruar në polici, persona jashtë kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ “a” dhe “b” dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, pasi janë shoqëruar përsëri persona që kanë kryer apo dyshohen se kanë kryer vepra penale si, vrasje, vjedhje, kundërshtim të punonjësve të policisë, persona që janë në kërkim, persona për shkak të konflikteve midis tyre, për prishje rendi, për rrahje, për dhunë në familje, shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor etj, megjithëse këta persona kanë qenë të identifikuar.

Konstatohet se shkelja e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar nga policia vjen edhe nga mosnjohja e veprimtarisë së institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Punonjësit e policisë, së rolit bazë, kane mangësi të njohurive për Ligjin e Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, si dhe të Konventës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kategorite e personave të shoqëruar në mënyrë të paligjshme janë si më poshtë ;

1.Trajtohen si të shoqëruar personat që kanë kryer apo dyshohen se kanë kryer vepra penale si, vrasje, vjedhje, kundërshtim të punonjësve të policisë, rrahje, prishje të rendit dhe qetësisë publike, dhunë në familje etj (Komisariatet e Policisë Tepelenë, Gjirokastër, Vlorë, Pogradec, Shkodër, Durrës dhe në Komisariatit e Policisë Nr.3 dhe 6 në Tiranë). Në këto raste personi duhet të ndalohet sipas dispozitave ligjore parashikuar në nenin 253 të K.Pr.Penale.

2.Trajtohen si të shoqëruar personat për shkak të një konflikti, veprim i cili nuk është i parashikuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Këto janë rastet që dominojnë pothuajse në të gjitha Komisariatet e Policisë në vend. Por meqënëse qëllimi i shoqërimit nga policia në këtë rast është i mirë, sepse parandalon ndodhjen e ndonjë krimi të mundshëm ndërmjet të konfliktuarve, atëherë e ritheksojmë që ky rast duhet të rregullohet në ligj.

3.Trajtohen si të shoqëruar personat për të cilët lind nevoja për të marrë prej tyre informacion për parandalimin e një rreziku, për të identifikuar persona që mund të kenë dijeni për rrezikun apo incidentin dhe për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit. Në këto raste nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore për “njoftim për paraqitje në polici”, e parashikuar në nenin 100 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e policisë. (Komisariatet e Policisë Peshkopi, Vlorë, Durrës Shkodër si dhe Komisariatet e Policisë 1, 2, 3 dhe 4 Tiranë).

4.Trajtohen si të shoqëruar personat që tregojnë rrethana të dobishme për hetimin. Në këto raste nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore e parashikuar në nenin 312 i K.Pr.Penale, duke i thirrur ata me urdhër apo fletë thirrje dhe paralajmëruar për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje, pa patur pengesë të ligjshme. Komisariati i Policisë Vlorë.

5.Trajtohen si të shoqëruar personat e kapur në kushtet e flagrancës, kur dihet se ndaj autorit të veprës penale që kapet gjatë kryerjes së veprës penale apo menjëherë pas kryerjes së saj, duhet të bëhet arrestimi i tij konform dispozitave ligjore parashikuar në nenin 251 të K.Pr.Penale dhe pa e mbajtur atë në gjëndje shoqërimi 10 orë. (Komisariatet e Policisë Sarandë, Shkodër, Gjirokastrë, Tepelenë dhe Korçë).

6.Konstatohet se trajtohen si të shoqëruar edhe personat në kërkim. Vlen të theksohet se, për këtë kategori personash, ndaj të cilëve është nxjerrë urdhër ekzekutimi i një vendimi penal, si dhe në rastet kur një person ka kryer më parë (është fjala kur nuk jemi në kushtet e flagrancës) apo dyshohet si autor i mundshëm i një vepre penale, ai duhet të ndalohe sipas dispozitave ligjore, parashikuar në nenin 464 të K.Pr.Penale. Kjo dukuri ndodh pothuajse në të gjitha Strukturat e Policisë në vend.

7.Pjesa më e madhe e të shoqëruarve është në rastet, kur arsyeja e shoqërimit në organin e policisë është “*për verifikim*”. Arsyeja e shoqërimit është e përgjithshme dhe ka nevojë që të specifikohet konkretisht se për çfarë verifikohet. Nga verifikimet e bëra në librat e shoqërimit dhe pyetja e punonjësve të policisë, ka rezultuar se, arsyeja e shoqërimit shënohet “*për verifikim*” edhe kur në fakt personi shoqërohet për rastet e përmendura më lart.

Nga shqyrtimi i rasteve të mësipërme ka rezultuar se këto shkelje të ligjit janë pasojë e mosnjohjes së konceptimit të kriterëve ligjore të shoqërimit të përcaktura në ligjin nr.9749, dt. 04.06.2007 “*Për Policinë e Shtetit*”.

Personat e arrestuar dhe të ndaluar nuk duhen regjistruar në librin e shoqërimit, sikurse ndodh shpesh herë, por në librin e personave të arrestuar dhe të ndaluar.

Librat e shoqërimit të shtetasve në polici, shpesh plotësohen pa shumë përgjegjësi. Në to nuk pasqyrohet saktë shkaku ligjor i shoqërimit. Kështu p.sh në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë, Pogradec, Fier, Lezhë, Durrës, Shkodër dhe Tepelenë, shtetasit e ndaluar si autor vjedhje, figuronin të regjistruar në librin e shoqërimit, si të shoqëruar në polici për verifikim. Ka raste që shtetasit e shoqëruar nuk regjistrohen fare në librin e shoqërimit të shtetasve. P.sh në Komisaratin e Policisë Peqin e Librazhd, edhe pse në raportin e shërbimit të punonjësve të policisë



thuhej se ishte bërë shoqërimi i shtetasve në librin e personave të shoqëruar, ata nuk figuronin të regjistruar.

Në librat e shoqërimit nuk regjistrohet njoftimi i familjareve të të shoqëruarve. Kujtojmë se njoftimi i familjarëve të të shoqëruarit, për shoqërimin e tij në polici dhe arsyet ligjore, përbën detyrim ligjor për punonjësit e policisë, sikurse është parashikuar në nenin 107 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Megjithëse nga punonjësit e policisë u pretendua se bëhet njoftimi i familjarëve, fakti që nuk pasqyrohet në libër ky veprim (emri dhe numri i telefonit të të njoftuarit), lë vend për dyshime. Por ka edhe raste të regjistrimit në libër të numrave telefonik, sikurse kemi konstatuar gjatë një sondazhi që bëmë në Komisarariatet e Policisë Mirditë dhe Delvinë. Në prezencë të Shefave të Komisariateve përkatëse u telefonuan nga ekspertët në numrat e telefonit të regjistruar nga policia dhe u konstatua se numrat telefonikë ishin regjistruar në mënyrë të sakte, pasi ishin të disponueshëm, dhe personat që komunikuam deklaruan se ishin telefonuar e njoftuar nga policia.

Në dinamikën e punës të Policisë së Shtetit konstatohet se të shoqëruarëve, në të gjitha organet e policisë, u bëhet kontrolli personal dhe u hiqen e bllokohen sendet personale si telefona, rrip, lidhëse këpucësh etj, veprim i cili nuk është në përputhje me ligjin nr.9749, dt. 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”.

Lidhur me kontrollin e të shoqëruarve, sjellim në kujtesë se, në nenin 106, pika 3 e ligjit “Për Policinë e Shtetit”, është parashikuar e drejta e punonjësit të policisë, që mund të bëjë kontrollin dhe kqyrjen fizike me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse. Pra, vetëm në këtë rast mund të ushtrohet kontrolli fizik i personit të shoqëruar dhe jo në të gjitha rastet e shoqërimit. Ndërsa, në nenin 108 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, është parashikuar bllokimi i sendeve, si përjashtim vetëm në rastet kur sendet përbëjnë kërcënim të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike.

Gjithashtu, konstatohet se, në rastet kur shtetasve të shoqëruar u hiqen dhe bllokohen sendet personale, nga punonjësit e policisë nuk mbahet (hartohet) e nuk u jepet poseduesve proces-verbali përkatës, siç parashikohet në nenin 108, paragrafi i dytë i ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Kontrolli i personave të shoqëruar përbën shkelje të hapur të së drejtës kushtetuese të paprekshmërisë personale të personit. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 37/3 të Kushtetutës tonë, ku thuhet se: “Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjanuar një rrezik që i kanoset sigurimit publik”.

Njëkohësisht, ky veprim vjen në kundërshtim edhe me dispozitat e K.Pr.Penale dhe konkretisht me nenet 202 e vijues, të cilat parashikojnë kontrollin e personit. Në nenin 202 të K.Pr.Penale parashikohet se:

*“Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale, gjykata merr vendim për kontrollin personal....*

Në rast flagrante ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur dhe që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298 të K.Pr.Penale.

Në praktikën e punës së policisë konstatohet se të gjithë të shoqëruarve u merren gjurmët daktiloskopike (gishtave). Punonjësit e Policisë justifikohen me faktin se marrja e gjurmëve përdoret si mjet identifikimi duke u bazuar në nenin 103, pika 5 e Ligjit Nr.9749 dt.04.06.2007 *”Për Policinë Shtetit”*. Ky veprim është i paligjshëm pasi në nenin 103, pika 3 e këtij ligji është përcaktuar se gjurmë e gishtave merren në rastet kur personi ndalohet ose arrestohet.

Sa më sipër duket qartë se marrja e gjurmëve të gishtave nga policia në mënyrë të paligjshme bëhet vetëm për t’i përdorur ato si model krahasimi me gjurmët e mbetura në ngjarje të pa zbuluara. Këto veprime vijnë në kundërshtim me nenin 3 dhe 16 të ligjit nr. 9887, d.t 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Në ambjentet e shoqërimit, ku në fakt mbahen shtetasit e shoqëruar, nuk ka postera me të drejtat ligjore të të shoqëruarve.

***Lidhur me ambjentet e sigurisë, ku mbahen personat e ndaluar dhe arrestuar është konstatuar se:***

Gjatë vitit 2010, nga inspektimet e bëra në dhomat e sigurisë në të gjitha Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë në vend, ka rezultuar se, në disa drejtori e komisaritate policie (Drejtoritë e Policisë së Qarqeve Fier, Lezhë, si dhe në Komisaritet e Policisë Kavajë dhe atë Nr.5 Tiranë), dhomat e sigurisë (Paraburgimit) janë të përshtatshme për banim, pasi ofrojnë kushte normale për jetesë, për ushqim, ajrim, higjenë, kubaturë, trajtim të diferencuar për të mitur, femra dhe të sëmurë etj.

Në të gjitha Drejtoritë dhe Komisaritet e tjera të Policisë, ku është përcaktuar se duhet të kenë dhoma sigurie, në pjesën më të madhe të tyre, dhomat janë të trashëguara nga ish-dhomat e Paraburgimit të para viteve 90-të dhe janë po në atë gjëndje të palyera, pa ndriçim nga rrjeti, pa dushe për tu larë, pa krevat, pa dyshek, pa çarçaf si dhe pa orendite e nevojshme për të jetuar si, karrige, stola apo tavolinë. Kjo gjëndje i bënte ato të papërshtatshme për banim, duke mos ofruar kushtet minimale jetike, për ushqim, higjenë, kubaturë, trajtim të diferencuar për të mitur, femra dhe të sëmurë etj. Disa prej këtyre ambjenteve janë të trashëguara me sisteme

arkitekture nentokë dhe, për pasojë, kanë probleme të lagështisë dhe amortizimit të tyre në tërësi.

Duhet theksuar fakti se, për ambjentet e sigurisë (Paraburgimit), nuk ka standarte të përcaktuara në ligj, pasi kjo pjesë e veprimtarisë së Policisë nuk është përfshirë në Ligjin Nr.9749 dt.04.06.2007 "*Për Policinë Shtetit*". Në asnjë nen të ligjit nuk përmendet detyra e këtij institucioni për të kryer detyrën e paraburgimit. Po t'i referohemi nenit 4 të këtij Ligji, i cili ekziston ende për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, për të mbuluar përgjegjësinë (detyrën) për shërbimin e paraburgimit me të gjitha elementët që shoqërojnë këtë shërbim, në asnjë paragraf nuk përmendet detyra e këtij institucioni për të kryer detyrën e paraburgimit. Ky shërbim, sipas legjislacionit në fuqi, i është ngarkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe organeve të saj vartëse. Aktualisht, siç është deklaruar edhe më parë nga ana jonë, Policia e Shtetit po kryen këtë detyrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Madje hartimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit i manualit për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi, është refuzuar me argumenta juridike nga ana jonë, pasi një akt i tillë nuk ishte i autorizuar nga Ligji "*Për Policinë e Shtetit*".

Për të zgjidhur këtë problem ligjor është i domodoshëm ndryshimi i nenit 4, të Ligjit "*Për Policinë e Shtetit*", duke parashikuar një detyrë të tillë për Policinë e Shtetit, ose ndryshimi i nenit 15/1, të Ligjit Nr.8328 dt.16.04.1998 "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*" (i ndryshuar), në të cilin duhet shtuar një paragraf që, në Institucionet e Paraburgimit, do të mbahen edhe individë, ndaj të cilëve është vendosur masa e arrestit ose e ndalimit nga Policia e Shtetit ose Prokuroria. Këto masa ligjore i hapin rrugë përligjies së veprimtarisë së Policisë së Shtetit për kryerjen e detyrës së paraburgimit ose lehtësimit të veprimtarisë së saj nga ky shërbim.

Në disa komisariate mungojnë posterat për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia.

#### ***Lidhur me mënyrën e trajtimit të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar:***

Konstatohet se punonjësit e policisë gjatë kryerjes së veprimeve verifikuese, padrejtësisht trajtojnë si të shoqëruar, edhe personat në rastet e kapjes në flagrancë. Mbajtjen në këtë gjëndje, punonjësit e policisë e justifikojnë me mendësinë se, "në qofte se do t'i arrestojnë që në momentin e parë, atëherë nuk mund të kryejnë asnjë veprim procedural për të provuar veprën e kryer". Ky qëndrim dhe justifikim nuk ka mbështetje ligjore, përkundrazi, bëhet në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale. Sipas neneve 30 dhe 294 të K.Pr.Penale, *policia gjyqësore*, atributet e të cilës i kanë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, *edhe pas*

*referimit të veprës penale të prokurori, ka të drejtë të kryejë me iniciativën e vet, funksionet e tij ligjore si, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të veprës penale, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal.*

Në dhomat e sigurimit (izolimit) të organeve që janë inspektuar vazhdonin të qëndronin persona të paraburgosur, ndaj të cilëve ishte caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, si dhe persona të ndaluar për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim të formës së prerë, të dhënë në mungesë dhe që nuk ishin dërguar në institucionet e paraburgimit dhe ato të burgimit në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për shkak të pengesave që krijonte vazhdimisht kjo e fundit. Koha e qëndrimit të tyre në ambjentet e policisë, pas caktimit të masave të sigurimit, varioje nga 1 deri 10 ditë. Siç e theksuam edhe më lart, kjo situatë vjen për faktin se kjo pjesë e veprimtarisë së Policisë nuk është përfshirë në Ligjin Nr.9749 dt.04.06.2007 ”Për Policinë e Shtetit”, pasi në asnjë nen të tij nuk përmendet detyra e këtij institucioni për të kryer detyrën e paraburgimit.

Të ndaluarve dhe arrestuarve në polici nuk iu bëhet detyrimisht kontroll mjekësor lidhur me sëmundjet që ata mund të kenë, aq më tepër kur bëhet fjalë për sëmundje ngjitëse, të cilat përbëjnë rrezik dhe mund t’i marrin edhe personat që janë në të njëjtën dhomë me të infektuarin. Ata vizitohen nga mjeku vetëm në rastet kur kanë shqetësime dhe e kërkojnë vetë atë. Normalisht, mendojmë se ky kontroll duhet t’u bëhet brenda 24 orëve të para të ndalimit apo arrestimit.

Në të gjitha organet e policisë mungojnë formularë në gjuhë të huaj, për të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar apo arrestuar, kur këta janë shtetas të huaj.

Në pjesën më të madhe të Komisariateve të Policisë në vend, nuk ka libra për të ndaluarit dhe të arrestuarit sepse ata, siç e kemi thënë edhe më sipër, regjistrohen fillimisht në librat e shoqërimit, pasi si të tilla trajtohen. Në librat e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të shtetasve nuk janë hapur rubrika për njoftimin e familjarëve dhe avokatit mbrojtës.

Ekspozimi i posterave për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia është konstatuar në pjesën më madhe të Drejtorive dhe Komisariateve të Policisë në vend.

### **Problematika e mesipërme prezantohet nepërmjet rasteve dhe rekomandimeve të dhena me poshte:**

Në ankesën e shqyrtuar me **nr.201000006**, një shtetas i arrestuar dhe i ndodhur në dhomat e sigurimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, ankohej për veprime të paligjshme të policisë gjatë ndalimit dhe shoqërimit të tij në organin e policisë. Konkretisht, ai është ndaluar në rrugë nga një punonjës policie, i cili me pistoletë në dorë i ka bërë thirrje

që të ndalonte. Ankuesi, ndonëse i është bindur urdhërit, është lidhur me pranga dhe është keqtrajtuar nga disa punonjës të policisë të cilët e kanë shoqëruar në Komisarariat nr 2 Tiranë, ku pretendohet se kishte vazhduar keqtrajtimi i tij. Nga goditjet e forta, ai ka humbur ndjenjat dhe i ka rënë të fikët. Sapo është përmëndur, ata e kanë goditur përsëri, deri sa ai humbiste ndjenjat dhe kjo skenë është përsëritur disa herë. Më pas, ai është dërguar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë dhe është arrestuar, duke u izoluar në dhomat e paraburgimit të këtij organi. Në këto ambiente ai është vizituar dhe mjekuar nga mjeku i policisë.

Ankuesi pretendonte se skenën, kur ai është dhunuar nga punonjësit e policisë, e kishin parë edhe dy shokët e tij të quajtur E.G. dhe S.M., të cilët edhe ata ishin shoqëruar e arrestuar nga policia në të njëjtin komisarariat.

Për hetimin e këtij rasti, ekspertët tanë shkuan në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, morën takim me ankuesin, bënë kqyrjen e tij dhe pyetën edhe dëshmitarët E. G. dhe S. M., të cilët ndodheshin të arrestuar së bashku me të.

Meqënëse u konstatuan shënja të dukshme dhune në kokë, fytyrë dhe në pjesë të tjera të trupit, u thirr një ekspert mjeko-ligjor i Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës.

Gjithashtu, nga ekspertët tanë u bë kqyrja e dokumentacionit të policisë, ku ishin pasqyruar vizitat mjekësore që i ishin bërë ankuesit nga mjeku i policisë.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese dhe nga provat e administruara rezultoi se, pretendimet e ankuesit, për keqtrajtim fizik dhe në mënyrë barbare nga punonjësit e policisë, ishin të vërteta. Veprimet e policisë ishin të paligjshme dhe vinin në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, aktet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi që garantojnë të drejtën e shtetasve *për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës*. Gjithashtu u identifikuan dy nga punonjësit e policisë, Alfons Gjoni dhe Klodian Bala, që kishin kryer veprimet e kundërligjshme ndaj ankuesit.

Për këtë rast, i rekomanduam Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të punonjësve të policisë Alfons Gjoni, Klodian Bala etj., efektiva të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, për veprën penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86 dhe 25 i K.Penal, i ndryshuar.

Rekomandimi ynë u pranua nga organi i prokurorisë, i cili filloi ndjekjen penale ndaj punonjësve të policisë.

Ne ankesën e shqyrtuar me **nr.201000980**, katër shtetas, përkatësisht B. K., M. K., J. T. dhe E. T. ankoheshin se, rreth orës 01.00, duke qënë në një lokal Internet-Kafe, që ndodhej poshtë pallateve të tyre

të banimit, ishin shoqëruar padrejtësisht nga patrulla e policisë në Komisariatin e Policisë Nr. 4 Tiranë. Dy prej ankuesve ishin keqtrajtuar nga punonjësit e policisë dhe, për shkak të dëmtimeve të pësuar, ishin dërguar në spital nga policia për ekzaminim e mjekim, ku njëri prej tyre, që ishte më rëndë, ishte shtruar.

Ankuesit pretendonin edhe për kallëzim të rremë, të bërë ndaj atyre nga punonjësit e policisë, sikur ata i kishin kundërshtuar me dhunë, fyer e kërcënuar policët. Si pasojë e këtij kallëzimi të rremë, shtetasit B. K. dhe J. T. ishin arrestuar padrejtësisht, ndërsa shtetasit M. K. dhe E. T. ndiqeshin penalisht në gjëndje të lirë. Sipas ankuesve, kallëzimin e rremë, punonjësit e policisë e kishin bërë për t'u mbrojtur nga ankimi që të afërmit e tyre, kishin bërë për veprimet e kundërligjshme të policisë.

Këtë ankesë e vlerësuam seriozisht, sepse jo vetëm që bënte fjalë për veprime të kundërligjshme dhe të rënda të policisë, por edhe për faktin se, vitet e fundit, kishim patur disa ankesa të tilla, ku shtetasit, pasi dhunoheshin nga policët, ndiqeshin edhe penalisht në bazë të kallëzimeve të rreme të punonjësve të policisë. Këto kallëzime bëheshin nga punonjësit e policisë, për të justifikuar dhunën e ushtruar dhe pasojat e saj ndaj të dëmtuarëve. Në të njëjtën kohë, kjo sjellje shërbente edhe si presion ndaj të dëmtuarëve, me qëllim që ata të mos ankoheshin kundër punonjësve të policisë. Nga rastet e trajtuara deri në atë kohë nuk kishim mundur që të vërtetonim ndonjërin prej tyre, për shkak të mungesës së provave dhe veçanërisht të dëshmitarëve okularë, të cilët, në raste të tilla, mungojnë ose edhe kur ka, nuk dëshmojnë kundër policisë për arsye të ndryshme.

Në përfundim të hetimit të kësaj ankese dhe nga provat e administruara, si pyetja e të dëmtuarëve, e dëshmitarëve okularë L. B. dhe A. H., e punonjësve të policisë Alfred Thaçi, Armand Isufaj, Vladimir Gega dhe Rudin Baça, që ishin autorë të këtyre veprimeve, nga kqyrja e dokumentave në Komisariatin e Policisë Nr. 4 Tiranë dhe në dy spitalet ku ishin ekzaminuar e mjekuar të dëmtuarit, si dhe aktet e ekzaminimit mjeko-ligjor të dy të dëmtuarëve, arritëm në konkluzionin se, pretendimet e ankuesve për keqtrajtim fizik, për shoqërim të paligjshëm në polici dhe për kallëzim të rremë ndaj tyre, nga punonjësit e policisë, ishin të vërteta. Veprimet e policisë ishin të paligjshme dhe vinin në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, aktet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi që garantojnë të drejtën e shtetasve *për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar, të drejtën për të lëvizur lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit dhe të drejtën për të mos iu kufizuar liria, përveçse në rastet e parashikuara në nenin 27/2 të Kushtetutës.*

Për këtë rast, u përgatit një rekomandim, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të

punonjësve të policisë Alfred Thaçi, Armand Isufaj, Vladimir Gega dhe Rudin Baça, efektiv i Komisarariatit të Policisë Nr. 4 Tiranë, për veprat penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86 e 25 i K.Penal, të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 e 25 i K.Penal dhe të “Kallëzimit të rremë”, parashikuar nga neni 305 e 25 i K.Penal.

Mirëpo, në kohën e përfundimit dhe të dërgimit të këtij rekomandimi, u informuam se, mbi bazën e kallëzimit të ankuesve, organi i prokurorisë kishte filluar ndjekjen penale për këtë çështje. Të ndodhur në këto kushte, kur për të njëjtin rast ishte filluar ndjekja penale nga organi kompetent, ne i vumë në dispozicion ankuesve të gjitha provat e grumbulluara dhe administruara gjatë hetimit administrativ, të kryer nga ana jonë, me qëllim që ata t’i përdornin gjatë hetimit penal.

### **Përmirosimi i legjislacionit**

1. Nga shqyrtimi i çështjeve nga ana e Avokatit të Popullit është konstatuar mangësi në legjislacion, lidhur me detyrën e sigurimit të të arrestuarve dhe të të ndaluarve nga Policia e Shtetit, ashtu sikunder u përmend edhe me sipër. Aktualisht, të arrestuarit dhe të ndaluarit, derisa nga gjykatat bëhet vlerësimi dhe caktimi i masave të sigurimit, sigurohen nga Policia e Shtetit, në ambjentet e sigurimit që ndodhen në godinat e policisë (në Komisarariatet e Policisë në rrethe dhe në Drejtoritë e Policisë në Qarqe). Praktikisht, Policia e Shtetit, ndërmjet detyrave të tjera për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, kryen edhe detyrën për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve. Këtë detyrë, Policia e Shtetit sic referuam edhe me sipër, e kryen pa qënë e autorizuar nga ligji, por për shkak të “trashëgimisë” nga misioni i mëparshëm i saj. Kjo detyrë nuk është parashikuar në ligjin organik “Për Policinë e Shtetit, por ajo e mbeshtet në Rregulloren nr. 1075, dt. 15.09.1999 “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve”, miratuar me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.

Kjo rregullore jo vetëm që nuk është bashkëkohore dhe në përputhje të plotë me Kushtetutën e legjislacionin në fuqi, lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të paraburgosurve, por nga ana formalo-juridike ajo është shfuqizuar dhe është bërë nul, sepse:

a) Sipas pikës 2 të nenit 3 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, çdo detyrim, që i caktohet policisë, me akte normative, duhet të jetë në përputhje me detyrat institucionale, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji, nuk është parashikuar si detyrë e policisë, sigurimi dhe trajtimi i të paraburgosurve.

b) Sipas nenit 70 të ligjit nr. 8553, dt. 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, ligji nr. 7504, dt. 30.07.1991 “Për Policinë e Rendit Publik”, si

dhe aktet e tjera normative në fuqi, që rregullojnë veprimtarinë e policisë, por që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen. Pra sipas kësaj dispozite, Rregullorja nr. 1075, dt. 15.09.1999 “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve”, miratuar me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, meqënëse bie ndesh dhe në mënyrë të hapur me këtë ligj, është shfuqizuar prej tij.

Nga ana jonë është arritur në përfundimin se, që të legjitimohet kryerja e kësaj detyre (sigurimi dhe trajtimi i të arresturve dhe ndaluarve) nga Policia e Shtetit, dhe nxjerrja e miratimi i një rregulloreje, duhen bërë ndryshime dhe plotësime në ligjin nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Këto ndryshime duhen bërë në nenin 4 të ligjit, duke shtuar si përgjegjësi (detyrë) të Policisë së Shtetit edhe *sigurimin dhe trajtimin e të arresturve dhe të ndaluarve deri në vlerësimin dhe caktimin e masave të sigurimit nga gjykata*. Gjithashtu, duhen bërë ndryshime dhe shtesa edhe në dispozita të tjera të këtij ligji, ku *të parashikohet e të autorizohet nxjerrja e një rregulloreje dhe organi kompetent që do ta miratojë atë*.

Rregullimi ligjor i këtij problemi mund të bëhet edhe pa ndryshuar ligjin “Për Policinë e Shtetit”, duke bërë ndryshime e shtesa në nenin 15/1 të ligjit nr. 8328 dt.16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarëve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, në të cilin duhet shtuar një paragraf, *që në Institucionet e Paraburgimit të pranohen e mbahen edhe individë, ndaj të cilëve është vendosur masa e arrestit ose e ndalimit nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore etj.*

Ndërhyrja nëpërmjet këtyre masave ligjore do t’i hapë rrugë përligjies së veprimtarisë së Policisë së Shtetit për kryerjen e detyrës së paraburgimit ose të lehtësimit të veprimtarisë së saj nga ky shërbim, duke i kaluar plotësisht Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Konstatimet dhe konkluzionet e mësipërme ia kemi bërë të njohura Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke i rekomanduar marrjen e masave të nevojshme për rregullimin ligjor të kësaj veprimtarie.

Meqënëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk u ndërmor asnjë hap për zgjidhjen e këtij problemi, nga ana jonë u bë një rekomandim drejtuar Kryeministrit, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Drejtësisë.

Në këtë rekomandim u kërkua me shumë vëmendje dhe angazhim i shpejtë për zgjidhjen e problemit ligjor dhe të përmirësimit të kushteve e standarteve në ambjentet e sigurimit. Gjithashtu, u theksua se këto masa kanë karakter urgjent, për arsye të rëndësisë që paraqesin standartet që duhet të respektohen nga Policia e Shtetit, në kuadër të proceseve integruese, por edhe të monitorimit dhe raportimit periodik që kryhënt nga institucionet ndërkombëtare për këto organe.



Megjithëse kanë kaluar rreth 8 muaj nga dergimi i këtij rekomandimi, nuk na është kthyer asnjë përgjigje lidhur me rregullimin ligjor të rekomanduar nga ana jonë.

**2.**Nisur nga fakti se shumica e dhomave të sigurisë, ku mbahen të arrestuar dhe të ndaluar, janë jashtë standarteve, duke mos ju ofruar atyre kushtet minimale jetike, për ushqim, ajrim, higjenë, kubaturë, trajtim të diferencuar për të mitur, femra dhe të sëmurë, është rekomanduar ndryshimi i Nenit 4 të Ligjit "Për Policinë e Shtetit" duke parashikuar një detyrë të tillë për Policinë e Shtetit ose i Nenit 15/1 të Ligjit Nr.8328 dt.16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (i ndryshuar), në të cilin duhet shtuar një paragraf që, në Institucionet e Paraburgimit, të mbahen edhe individë, ndaj të cilëve është vendosur masa e arrestit ose e ndalimit nga Policia e Shtetit ose Prokuroria. Këto masa ligjore i hapin rrugë për ligjies së veprimtarisë së Policisë së Shtetit për kryerjen e detyrës së paraburgimit ose lehtësimit të veprimtarisë së saj nga ky shërbim. (referencë çështja **Nr. 201000984**)

**3.**Justifikimi nga punonjësit e Policisë së Shtetit, për mungesën e psikologut, gjatë shoqërimit apo marrjes në pyetje të shtetasve të mitur, është bërë me arsyetimin se ky funksion nuk është i përfshirë në organikën e Komisariateve, por vetëm në atë të Drejtorive të Policisë së Qarqeve, si dhe me distancën e madhe mes komisariateve dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve. Gjithashtu, konstatimi se në disa Drejtori Policie, ky funksion nuk është i plotësuar për mungesë punonjesi, e ka nxitur Avokatin e Popullit për të rekomanduar plotësimin organik të këtij shërbimi me personel në të gjitha Strukturat e Policisë së Shtetit, siç është përcaktuar në nenin 35 të K.Pr.Penale. (referencë çështja **Nr. 201000478**)

**4.**Gjatë inspektimeve është konstatuar se shkeljet e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar nga policia, vjen edhe nga mosnjohja e veprimtarisë së institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

*Për zgjidhjen e këtij problemi, Avokati i Popullit ka rekomanduar promovimin e të drejtave të njeriut, me qëllim pasurimin e programit të formimit të kursantit në Qendrën e Formimit Policor, duke përfshirë në të, Ligjin për "Avokatin e Popullit", në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Protokollin Opsional të Konventës Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)" si dhe Konventën ndërkombetare për të drejtat e njeriut etj. (referencë çështja **Nr. 201000477**)*

Gjatë viteve të fundit, në mënyrë të përsëritur, i kemi bërë disa rekomandime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, duke gjykuar se respektimi i tyre do të sillte parandalimin e torturës, keqtrajtimit dhe shkeljeve të ligjit për Policinë e Shtetit.

5. Akoma nuk është nxjerrë udhëzimi (kodi i sjelljes) për marrjen në pyetje nga Policia. Ky kod duhet, ndër të tjera, të trajtojë aspektet e mëposhtme: t'i tregohet sistematikisht të ndaluarit, identiteti i personave të pranishëm gjatë marrjes në pyetje (emri dhe/ose matrikuli); kohëzgjatja e lejuar e një seance pyetjesh; periudhat e pushimit ndërmjet këtyre seanceve dhe pauzat gjatë marrjes në pyetje; vendi apo vendet ku mund të mbahet një seancë e tillë; nëse do t'i kërkohet të ndaluarit të qëndrojnë në këmbë gjatë marrjes në pyetje; dhe që ndalohet marrja në pyetje e personave nën ndikimin e drogës, alkoolit, ilaçeve ose nën një gjëndje tronditjeje. Ky kod duhet gjithashtu të parashikojë që të shënohet sistematikisht momenti i fillimit dhe i përfundimit të çdo marrje në pyetje, identitetin e çdo të pranishmi gjatë çdo seance pyetjeje, si dhe çdo kërkesë të formuluar nga i ndaluari gjatë kësaj seance. Situatat e personave veçanërisht të pambrojtur (për shëmbull, minorenët, personat e prekur nga sëmundje ose mangësi mendore) duhet të bëhen objekt i garancive specifike.

Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Avokatin e Popullit, si Mekanizem Kombëtar Parandalues, në kuadër të punës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, megjithëse ka qënë i mirë, duhet të rritet e përsoset më tej në të ardhmen. Këtij qëllimi do t'i shërbejë edhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, me temë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

#### **- Veprimtaria e Avokatit të Popullit në lidhje me Forcat e Armatosura**

Gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit ka kryer rreth 30 inspektime, ri-inspektime, vizita dhe kontrole tematike në të gjitha repartet dhe bazat ushtarake në vendin tonë, institucione këto, në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Për të gjitha problemet e konstatuara në këtë fushë, janë hartuar dhe paraqitur 7 rekomandime, në lidhje me përmirësimin e standarteve të të drejtave dhe trajtimit të ushtarakëve, si dhe krijimin e kushteve të pranueshme për ambjentet e ndalimit disiplinor ushtarak.

Inspektimi i këtyre ambjenteve ka qënë prioriteti kryesor i punës në kuadër të MKPT-së, sepse ka qënë i lidhur me evidentimin e problematikave të privimit të lirisë së individit dhe rasteve të mundshme të torturës, trajtimit johuman dhe degradues. Gjatë kësaj veprimtarie monitoruese janë mbajtur në konsideratë edhe mënyrat e trajtimit të ushtarakëve të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga punonjësit e Policisë Ushtarake.

Në inspektimet e zhvilluara në repartet dhe bazat ushtarake që kanë në administrim dhoma të ndalimit disiplinor, është konstatuar se kushtet,

në disa prej këtyre dhomave, nuk plotësonin kërkesat e përcaktuara në legjislacionin e mësipërm. Në këto raste, ju është dërguar rekomandim organeve përkatëse për përmirësimin e kushteve, duke parashtruar një sërë kërkesash për zgjidhje.

Aktualisht, në vendin tonë kryejnë funksionet e ndalimit disiplinor vetëm 6 ambjente, në bazat kryesore ushtarake në Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Ambjenti kryesor, në të cilin ka qenë fokusuar veprimtaria monitoruese e MKPT-së, për shkak të madhësisë dhe rëndësisë së tij është Batalioni i Policisë Ushtarake Saur Tiranë. Në këtë qendër kryejnë dënimin me ndalim disiplinor të gjithë efektivat e reparteve që nuk kanë një ambjent të tillë në përdorim. Gjithashtu, në këtë qendër mbahen të ndaluar dhe arrestuar, përkohësisht, efektiva ushtarakë që dyshohet se kanë kryer vepra penale. Për të dy këto kategori, Avokati i Popullit ka qenë i interesuar të verifikojë në vazhdimësi kushtet, në të cilat mbahen dhe trajtohen këta persona.

Për të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet e mësipërme të prezantuara nga Avokati i Popullit, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë dhe strukturat në vartësi, kanë treguar një angazhim tepër serioz, duke marrë masa, brenda një kohë të shkurtër, për ndryshimin e plotë të situatës.

## **5. Çështje të administrimit të drejtësisë**

### **- E drejta për një proces të rregullt ligjor**

E drejta për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore e individit, është e garantuar në nenin 42, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor.”*

Nderkohe, në nenin 42, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionohet se: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”*

Në nenin 6 të “Konvetës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore”, përcaktohet se: *“Gjithkush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila të vendosë qoftë për pretendimet që mund të shfaqen ndaj të*

*drejtave dhe detyrimeve të tij me karakter civil, qoftë për të përcaktuar nëse është e bazuar çdo akuzë e natyrës penale e drejtuar kundër tij... ”*

Duke zgjeruar garancite e saj, në nenin 1 të Protokollit nr.1 të Koventës, parashikohet se: *”Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.*

E drejta për një proces të rregullt ligjor, në thelb, nuk mund dhe nuk duhet të konceptohet si një e drejtë, e cila qendron vetëm tek veprimtaria e organeve gjyqësore, pasi ajo fillon dhe nuk mund të përjashtohet edhe në veprimtarinë administrative të organeve të administratës publike.

Për këtë arsye, një analizë e kësaj të drejte do të përqendrohet jo vetëm në veprimtarinë e organit të Prokurorisë apo të gjykatave, por do të jetë pjesë edhe e analizës për të drejtën për mirëadministrim që gezojnë individët.

#### **- Intitucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor**

Ankesat që i janë adresuar Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2010, lidhur me administratën gjyqësore dhe jo vetëm, kanë patur si objekt, shkeljen e të drejtave ligjore të ankuesve, gjatë gjykimit, apo shkelje të tjera nga ana e administratës gjyqësore dhe, si të tilla, ato janë verifikuar nga ana jonë sipas procedurave të parashikuara nga ligji, duke synuar në nxjerrjen e shkaqeve të këtyre shkeljeve nga gjykatat. Përafersisht numri i ankesave të shqyrtuara me këtë problematike, arrijnë në 100 ankesa.

1. Duke analizuar në tërësi, rastet e shqyrtuara gjatë vitit 2010, rezulton se vendin kryesor të tyre e zënë shkeljet për zvarritje të padrejta dhe të pajustificuara të gjykimeve, pra për shkelje të procedurave gjyqësore si për çështje civile, ashtu edhe për çështje penale.

2. Në zyrën tonë vazhdojnë të paraqiten ankesa ndaj vendimeve gjyqësore, duke ngritur pretendime të ndryshme se ato janë vendime të padrejta dhe të pabazuara në ligj ose janë marrë nën ndikimin e veprimeve korruptive nga gjyqtarë të veçantë. Në disa raste, ankesat kanë lidhje me masa dënimi të rënda dhe të padrejta, të aplikuara nga gjykatat dhe, për këtë arsye, kërkohet ndihmë dhe ndërhyrje për zgjidhjen e tyre nga shkalla e dytë, Gjykata e Apelit, ose nga Gjykata e Lartë.

3. Në disa raste, shtetasit ankohen ndaj gjyqtarëve për shkelje të ndryshme ligjore, duke shprehur dyshime për paaftësinë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme dhe, për këto arsye, kërkojnë ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit tonë për rrugën ligjore që duhet të ndjekin për heqje dorë të tyre nga gjykimi.

4. Rezulton se disa ankesa kanë patur si objekt te tyre, kërkimin e ndihmës dhe ndërhyrjes te Avokatit te Popullit për të përfaqësuar çështje të ndryshme gjyqësore si në Gjykatën e Apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese, me arsyetimin se ato nuk kanë të ardhura të mjaftushme për të përballuar marrjen e një avokati privat.

5. Gjatë këtij viti kanë ardhur ankesa ndaj gjykimeve dhe vendimeve gjyqësore të padrejta, të marra në mungesë të palëve.

### **Problematika e mesipërme prezantohet nepërmjet rasteve të meposhtme:**

Ne ankesen me **nr.201000648**, një shtetas ankohet për shkelje të rënda në procedurat gjyqësore nga një gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Nga verifikimet tona rezultoi se ky gjyqtar mbante në dorë, pa përfunduar, një çështje penale mbi 1 vit dhe, duke analizuar shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore, ky veprim përbënte shkelje të kërkesave të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, dhe të nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për një gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Për këtë arsye, në bazë të përcaktimeve të nenit 17/c të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kjo ankesë iu dërgua për kompetencë shqyrtimi, Inspektoriatit të KLD-së.

Në ankesën e regjistruar me **nr.200901251**, nga ana e ankuesit pretendohet se Gjykata e Lartë kishte zhvilluar ndaj tij një proces të parregullt ligjor, duke gjykuar në mungesë një çështje penale në ngarkim të tij. Nga verifikimi ynë rezultoi se Gjykata e Lartë kishte shqyrtuar çështjet duke cënuar të drejtën e mbrojtjes me avokat, pasi gjykimi i kësaj çështjeje, nga kjo gjykatë, është bërë në mungesën e të pandehurit dhe të mbrojtësit të tij.

Po kështu, rezultoi se, shqyrtimi i kësaj çështjeje në Gjykatën e Lartë, ishte bërë mbi bazën e rekursit të ushtruar nga prokurori dhe njeri prej të gjykuarve, dhe gjykata ka rënduar pozitën procedurale të kërkuesit, duke e dënuar atë me një dënim të rëndë prej 16 vjet burgim.

Në këto rrethana, ankuesi u sqarua nga ana jonë se, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ai mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për një proces të parregullt gjyqësor.

Nga verifikimi i metejshëm nga ana jone, për këtë çështje, rezultoi se me vendimin nr.37 dt.24.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese, është vendosur shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.279 datë 04.06.2008 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për ankuesin I.H.dhe dërgimin për rigjykim të kësaj çështjeje po në Gjykatën e Lartë.

Ne ankesen me **nr.201000684**, një qytetar ngrinte pretendimin se ndonëse dispononte një kopje vendimi gjyqësor të formës së prerë, ky vendim nuk ekzekutohej nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor Durrës.

Duke analizuar në tërësi shkeljet e konstatuara nga shqyrtimi i kësaj ankese, në vështrim të nenit 6 të Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, iu dërgua rekomandim Ministrit të Drejtësisë, duke parashtruar se përmbarruesi gjyqësor, në rastin konkret, nuk ka kryer veprimet e domosdoshme ligjore, të parashikuara nga neni 606 i Kodit Procedurës Civile dhe neni 320 i K.Penal, ndaj personave përgjegjës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ky rekomandim u pranua dhe ndaj përmbarruesit gjyqësor u morën masat e nevojshme, si pasojë e të cilave po kryhen procedurat ligjore të këtij ekzekutimi.

Ne ankesen me **nr.201000648**, ankuesi përkates ankohej se, në 15 seanca gjyqësore, kishte munguar pa shkaqe ligjore Prokurori i ngarkuar, si përfaqësues i akuzës një një çështje penale. Drejtuesi i organit të Prokurorisë pasi analizoi shkaqet e parashtruara nga institucioni ynë, mori masa, duke larguar Prokurorin që kishte munguar, si përfaqësues i akuzës në gjykim, dhe në vendin e tij u caktua një Prokuror tjetër, i cili ka marrë pjesë në të gjitha seancat gjyqësore dhe nuk ka bërë asnjë mungesë.

### ***Përmiresimi i legjislacionit***

Me daljen e ligjit nr.9398 datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”, parashikohet se Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime, për shkelje të të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

Ky ndryshim në legjislacion kishte nevojë që të shoqërohej edhe me ndryshime në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile, si rruga e duhur ligjore për trajtimin nga Avokati i Popullit të ankesave të qytetarëve kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Ky problem ka mbetur akoma pa u zgjidhur, pasi ndryshimet e nevojshme ligjore nuk janë kryer nga Parlamenti, megjithë rekomandimet e bëra nga institucioni ynë.

### **- Veprimtaria e Prokurorise**

Gjate veprimtarise se institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2010, janë shqyrtuar rreth 96 ankesa drejtuar organit të Prokurorise. Nder keto, ankesat e shtetasve ndaj Prokurorisë së Përgjithshme kane konsistuar në kthimin me vonesë të përgjigjeve për letrat drejtuar këtij Institucioni, si përsa i përket mosfillimeve apo pushimeve të procedimeve

penale, ashtu dhe moskryerjes së veprimeve hetimore për çështje penale konkrete. Megjithatë, gjatë verifikimeve të kryera nga ana jone, bazuar mbi këto ankesa, është konstatuar se, në disa raste, ankuesve u është kthyer përgjigje, por ata e kanë përsëritur atë me të njëjtin objekt dhe për rrjedhojë ankesa e tyre është arkivuar.

Ankesat e shtetasve ndaj veprimtarisë së Prokurorive të Rretheve Gjyqësore kanë konsistuar në moskryerjen e hetimeve të gjithanshme, zvarritjen e pajustificuar të hetimeve, moskthimin e përgjigjes apo kthimin me vonesë të memorieve apo kërkesave me shkrim, kryesisht për kryerje të ekspertimit autoteknik, në kthimin me vonesë të sendeve prova materiale etj, veprime këto me pasojë pushimin e padrejtë të hetimeve të procedimeve penale.

Në shumë raste, ankuesit kanë ngritur shqetësimin për zvarritje të pajustificuara në hetimin e çështjes.

Mbetet problem mosmarrja në konsideratë e kërkesave të palëve për caktim eksperti, sidomos për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, kontabël etj.

Shkeljet e mësipërme bien ndesh me nenet 324 e 325 të K.Pr.Penale që bëjnë fjalë për “zgjatjen e afatit të hetimit” dhe ankimin ndaj tij, dhe Pikës 3 të nenit 28 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet ndërmjet të tjerave se, “i paraburgosuri ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm, ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit”.

Pikërisht, mbi këtë shqetësim, jemi duke përgatitur studimin me qëllim që, gjatë vitit 2011, të dalim me rekomandime përkatëse për ndryshime në dispozitat procedurale, të parashikuara në nenet 263 të Kodit të Procedurës Penale “Afati i kohëzgjatjes së paraburgimit”, dhe neni 323 “Afati i hetimeve paraprake”.

Konsumimi i vepres penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit është parë si një shqetësim qytetar e mbarëshoqëror, për pasojat e ardhura nga kjo vepër penale e llogaritur me një mesatare prej 1 vdekje e 2 plagosje në ditë. Për rrjedhojë, edhe kostot e shkaktuara nga aksidentet kapin vlera të konsiderueshme humane, financiare, sociale etj.

Në disa raste të ankesave është konstatuar se organi i Prokurorisë ka vendosur në mënyrë të pabazuar, mosfillimin apo pushimin e procedimit penal, sidomos për vepren penale të falsifikimit të dokumenteve, që lidhen me pronesinë.

Gjithashtu, evidentohet një grup ankesash të drejtuara ndaj organit të Prokurorisë, lidhur me trajtimin e sendeve prova materiale të sekuestruara gjatë hetimit, duke i kthyer ato me vonesë.

## **Problematika e mesipërme prezantohet nepërmjet rasteve të meposhtme:**

Ne disa ankesa të shqyrtuara nga ana jone, përkatesisht me **nr.201000362, 201001122, 201000262, 201000808, 201001144** etj, është konstatuar zvarritje e procedurave ligjore si dhe mosinformim i pales se interesuar për ecurine e trajtimit të kallezimeve penale qe ata i drejtojnë organit të prokurorise. Kështu, në ankesën e tij, shtetasi R.R. ankohet ndaj Prokurorisë Tiranë për moskthim përgjigje, kallëzimit penal të datës 08.04.2010. Vetëm pas tre muajve nga data e depozitimit të ketij kallëzimi, shtetasit të sipërcituar me cilesine e ankuesit, i është dërguar shkresa për mosfillimin e procedimit penal.

Në ankesën me **nr.20100808**, shtetasi qe kish dorezuar një kallëzim penal ne organin e prokurorise ne datën 08.10.2009, nuk kishte dijeni se çfare po behej me këtë kallëzim, pasi ky i fundit ishte dërguar nga Prokuroria për verifikim në Drejtorinë e Policisë Qarkut Tiranë, dhe mandej ky shtetas nuk kishte marre asnje dijeni ne lidhje me këtë çështje. Vetëm pas ankesës të paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit, më datën 09.07.2010, dhe pas verifikimit të kesaj çështje nga ana jone, ankuesi është sqaruar se Prokuroria Tiranë kishte filluar procedimin penal, mbi bazen e kallëzimit qe ai kishte paraqitur.

Ne ankesen me **nr.201001374**, ankuesi qe ndodhet i ndaluar ne dhomat e paraburgimit të I.E.V.P. “Jordan Misja”, Tiranë, ngre shqetësimin, jo vetëm për zbardhjen e vendimeve të formës së prerë nga Gjykata e Apelit, por edhe për nxjerrjen me vonesë të urdhërave të ekzekutimit nga Prokuroria, me qëllim kalimin e tyre nga paraburgimi në mjediset e burgut. Nga shqyrtimi i kesaj ankese, ka rezultuar se vendimi penal ka marrë formë të prerë më datën 31.12.2010, urdhëri i ekzekutimit është lëshuar nga Prokurori më datën 03.01.2011 dhe, në I.E.V.P. “Jordan Misja”, ai ka shkuar më datën 13.01.2011. Këto veprime vijnë ndesh me nenin 9, të ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar me ligjin nr.10024, datë 27.11.2008.

Në ankesën me **nr.201000210**, i është rekomanduar Prokurores së Përgjithshme, shfuqizimi i vendimit të pushimit të procedimit penal nr.1076 të vitit 2007, hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale të “Shkeljes së Rregullave të Qarkullimit rrugor” me pasojë vdekjen e vëllait të ankuesit, parashikuar nga neni 290 e Kodit Penal. Ky rekomandim nuk është pranuar.

Ne ankesen me **nr.20100914**, bazuar ne pretendimin e ankuesit, i kemi rekomanduar Prokurores së Përgjithshme; *“Shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.4576, të vitit 2009, të Prokurorisë*



*Tiranë, që bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 186 e Kodit Penal”. Ky rekomandim nuk është pranuar.*

Ne ankesën me **nr.20100818**, ankuesit pas ndodhjes së një ngjarje automobilistike, iu bë sekuestrimi i mjetit “Benz Mercedes”. Pas kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore me këtë mjet, ky i fundit rezultoi se është dëmtuar rëndë në vëndin e bllokimit e ruajtjes. Për këto arsye ankuesi i është drejtuar gjykatës me padi civile, *me palë të paditur Komisarjatin e Policisë Krujë dhe objekt, zhdëmtim dëmi në vlerën 125.720 lek, e kthim të mjetit në gjëndjen e mëparshme*. Kjo padi është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Në ankesën me **nr.201000156**, ankuesi ngre shqetësimin se mjete taksit, së bashku me dëshminë e aftësisë së drejtimit e pasaportën për jashtë shtetit, i është sekuestruar nga Prokuroria Vlorë, por i është dhënë vetëm pas 1 viti e gjysëm, për faktin se Gjykata nuk është shprehur në vendimin e saj për fatin, disponimin e sendeve prova materiale. Këto veprime vijnë ndesh me nenin 190, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet shprehimisht se: *“Provat materiale mund t’u kthehen personave që u përkasin edhe para mbarimit të procedimit , kur nuk dëmtohet zgjidhja e çështjes”*. E evidentojmë këtë fakt, duke theksuar se, Prokuroria, pasi të kishte mbaruar veprimet me sendet prova materiale, mund t’ia kthente ato të pandehurit gjatë hetimit, pa dëmtuar çështjen.

Për këto arsye, nga ana e jonë i është rekomanduar Prokurores së Përgjithshme; *“Marrja e masave me qëllim që Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të zbatojnë me korrektësi dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të përcaktuara në nenet 187-190 të Kodit të Procedurës Penale, për ruajtjen dhe disponimin e sendeve prova materiale”*. Ky rekomandim është pranuar nga ana e organit të prokurorisë.

### **-Veprimtaria e Zyrave të Sherbimit Përmbartimor Shtetëror**

**Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si përmbushje e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.**

Nje pjese të rëndësishme të respektimit dhe mbrojtjes të së drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor, e ze ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formes se prere apo titujve ekzekutive.

Në nenin 142, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionohet se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”*

Në nenin 6 të “Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore”, sanksionohet se: *“Gjithkush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të*

*arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila të vendosë qoftë për pretendimet që mund të shfaqen ndaj të drejtave dhe detyrimeve të tij me karakter civil, qoftë për të përcaktuar nëse është e bazuar çdo akuzë e natyrës penale e drejtuar kundër tij...”*

Dispozita ligjore, qe rregullojne veprimtarine e Zyrave të Sherbimit Përmbarrimor, janë parashikuar edhe ne Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 Kodi i Procedures Civile, i ndryshuar, si dhe ne Ligji, nr. 7850, date 29.07.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar.

Në trajtimin e rasteve, në të cilat ankuesit ngrenë shqetësimin e mosekzekutimit të titujve ekzekutiv, ku debitore rezultojne institucionet buxhetore (rastet kur këto te fundit detyrohen te rikthejne ankuesit ne pune dhe t’i paguajne pagen per kohen e qendrimit pa pune, apo detyrim per kryerjen e nje veprimi te caktuar), kemi konstatuar se organet e administratës shteterore nuk kryejnë përmbushjen e detyrimeve të vendosura, jo vetëm brenda afatit ligjor për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, nga dita e lajmërimit të këtij detyrimi prej Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, por dhe as pas kalimit të këtij afati. Nga ana tjetër, konstatohet se, përmbarruesit gjyqësor të çështjeve nuk kanë kryer ose nuk kryejnë menjëherë veprimet për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, pas kalimit të afatit ligjor për ekzekutimin vullnetar të detyrimit prej palës debitore, situatë kjo evidente në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor, si p.sh:

a) Vendimi nr. 266, datë 27.04.2006 të K.Sh.C, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin 297, datë 14.12.2006 dhe ajo e Lartë, me Vendimin nr. 236, datë 15.02.2008. Sipas titullit ekzekutiv në fjalë është vendosur, midis të tjerave, për detyrimin e Këshillit të Ministrave të rikthejë ankuesin në vendin e mëparshëm të punës si dhe t’i paguajë atij pagën për kohën e qëndrimit pa punë. Në rastin në fjalë, është kryer ekzekutimi pjesërisht i detyrimit, duke i paguar gjyqfituesit pagën për dy vjet, por nuk është kryer përmbushja tërësisht e detyrimeve. Në trajtimin e kësaj çështjeje me **nr.200902552**, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve të vendosura, por deri më sot rezulton të mos jetë ekzekutuar Titulli Ekzekutiv në fjalë.

Në rastet e trajtuara, gjatë vitit 2010, prej Institucioni të Avokatit të Popullit, në të cilat ankuesit kanë ngritur shqetësimin për mosdorëzimin e detyrimeve financiare apo kryerjen e një veprimi të caktuar prej institucioneve buxhetore, konstatohet gjithashtu se, Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor nuk ka kryer rregullisht, rast pas rasti, ose nuk ka kryer deri më sot, veprimet përmbarrimore, sikurse parashikohet në nenin 581, 583 dhe 589 të K.Pr.C. Në ato pak raste, kur janë lajmëruar degët e

thesarit në rrethe, për vendosjen e masës së sekuestros prej Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor, në llogarinë e institucionit buxhetor debitor, konstatohet se, degët e thesarit nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore, sikurse sanksionohet në nenin 581 dhe 583 të K.Pr.C. Ndaj personave përgjegjës, pranë degëve të thesarit në rrethe, të cilët kanë shkelur detyrimin për mosdorëzimin e kredisë palës debitore, si dhe dhënies së përgjigjes në përputhje me sanksionimet e kryera në nenin 583 të K.Pr.C., nuk rezulton në asnjë rast të jenë kryer nga Shërbimi i Përmbaramit Gjyqësor ushtrimi i të drejtave për vendosjen e sanksioneve, sikurse parashikohet në nenin 583 dhe 606 të K.Pr.C. Mbajtja e një qëndrimi të tillë hezitues, prej Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor, ka sjellë zvarritje të pajustificueshme në ekzekutimin e titujve ekzekutiv, jashtë çdo afati ligjor dhe të arsyeshëm.

Nisur nga parashikimet e paragrafit të fundit të nenit 589 të K.Pr.C., është Këshilli i Ministrave, organi i cili nxjerr udhëzimin për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit. Mungesa, deri më sot, e nxjerrjes së këtij udhëzimi, nuk mund të justifikojë degët e thesarit në moskryerjen e veprimeve, sikurse është lajmëruar nga Shërbimi i Përmbaramit Gjyqësor në ekzekutimin e titujve ekzekutiv. Avokati i Popullit, nisur nga problematika e konstatuar ka iniciuar fillimin e çështjes për nxjerrjen e këtij akti.

Veç rastit të sipërpërmendur, problematikat e sipërcituara hasen dhe në 20 raste të trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010, si p.sh:

-Në trajtimin e rasteve me **nr.200900135**, dhe **nr.201000401**, i është bërë rekomandim palës debitore I.N.U.K-ut Tiranë, si dhe Ministrisë së Punëve Publike e Transportit, Ministrisë së Financave, për marrjen e masave në përmbushjen e detyrimit financiar ndaj ankuesve, sipas asaj që është vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimet nr.4949, datë 30.05.2008, dhe nr. 2313, datë 20.04.2005

- Në trajtimin e rastit me **nr.2010000431**, i është rekomanduar Ministrisë së Financave të marre masat për caktimin e fondit të nevojshëm financiar ose financim të veçantë nga Buxheti i Shtetit për shlyerjen e detyrimit financiar ndaj ankuesit, në bazë të vendimit të Gjykates së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të vendimit nr.596, datë 21.09.2006 të K.Sh.C, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 80, datë 03.01.2007, si dhe urdhërimin e drejtuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë, të kryejë rikthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës. Ministria e Financave është shprehur vetëm rreth mundësisë për shlyerjen e detyrimit financiar ndaj ankuesit (gjyqfituesit).

-Në trajtimin e rastit me **nr.200901387**, konstatohet se, Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Mat, nuk ka kryer dhe nuk kryen përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në dispozitivin e Vendimit Gjyqësor nr. 305, datë 20.06.2007, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Mat, me objekt :”*Detyrimin e Z.V.RR.P.P. Mat, të kryejë lëshimin e vërtetimit të pronësisë për efekt shitjeje të pasurisë të rregjistruar me nr.105, viti 1993, nr.pasurie 6/78, Z.K.1326, sipas kartelës së pronësisë në favor të kreditorit V.A*”. Në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor në fjalë, Zyra e Përmbartimit, Mat, ka ushtruar vendosjen e sanksionit të gjobitjes ndaj shtetasit Astrit Farruku, Regjistruer i Z.V.RR.P.P. Mat, si dhe ka kryer kallzim penal ndaj tij për konsumimin e figurës së veprës penale “Pengim ekzekutimi të vendimit gjyqësor”, parashikuar e dënueshme në nenin 320 të Kodit Penal. Në kushtet e dhënies së këtij informacioni, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Kryeregjistruerit si dhe Ministrisë së Drejtësisë, dhënien e masës disiplinore për “Largim nga detyra” ndaj Regjistruerit. Pranohet Rekomandimi për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”. Sipas informacionit të marrë rezulton se është kryer përsëri kallzim penal ndaj Rregjistruerit të Z.V.RR.P.P., Mat, për kryerjen e së njëjtës veprë penale.

- Në trajtimin e rastit me **nr.201000052**, konstatohet se, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit nuk ka kryer përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në dispozitivin e Vendimit Gjyqësor nr. 6708, datë 30.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, sipas të cilit është vendosur detyrimi i saj të rikthejë ankuesin (gjyqfituesin) në vendin e mëparshëm të punës si dhe të paguajë pagën për kohën e qëndrimit papunë. Në trajtimin e këtij rasti, palës debitore i është rekomanduar të kryejë marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara. Deri më sot nuk është kthyer përgjigje për rekomandimin e Avokatit të Popullit.

- Përsa i përket trajtimit të ankesave me objekt të ndryshëm nga ato të sipërcituara, konstatohet se Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor, në rastet që trajtohen më poshtë, ka mbajtur qëndrime si dhe ka kryer veprime të paligjshme në ekzekutimin e titujve ekzekutivë, të cilat kompromentojnë këtë organ si dhe çenojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të subjekteve ankues (gjyqfitues).

Mbajtja e qëndrimit refuzues, për kryerjen e veprimeve përmbartimore në ekzekutimin e titujve ekzekutiv, haset në një numër rastesh, qëndrime këto të paragjyqeshme, sidomos kur kryhen pas disa muajve e viteve nga data e depozitimit të kërkesave për ekzekutimin e titujve ekzekutiv.

a) Në trajtimin e rastit me **nr.200900354**, Zyra e Përmbartimit, Tiranë, në mënyrë flagrante nuk ka kryer procedurat për ekzekutimin e

detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv nr. 208, datë 22.01.2007, sipas të cilit është vendosur detyrimi i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, të kryejë nxjerrjen e aktit administrativ, lidhur me kërkesën datë 17.11.2005, të kryer prej gjyqfituesit (ankuesit). Për qëndrimet e paligjshme, të mbajtura prej Zyrës së Përmbaramit, Tiranë, Avokati i Popullit ka kryer rekomandim si për vendosjen e sanksioneve ligjore ndaj palës debitore, ashtu dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj tre përmbaruesve gjyqësorë, të cilët nuk kanë kryer ushtrimin e detyrave të parashikuara në ligj. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor nuk ka kthyer ende përgjigje rreth rekomandimeve të kryera. Gjithashtu, në kundërshtim me nenin 616 të K.Pr.C., Zyra e Përmbaramit, Tiranë ka kryer pushimin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. 208, datë 22.01.2007.

- Në trajtimin e rastit me **nr.200902188**, Zyra e Përmbaramit, Korçë, në mënyrë të pajustificueshme, ka zvarritur kryerjen e procedurave përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor nr. 2508, datë 02.10.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, sipas të cilit është vendosur detyrimi i një subjekti privat të prishë ndërtime të kryera, si dhe ka refuzuar zbatimin e këtij titulli ekzekutiv pas 15 muajve të rivënies së tij në ekzekutim. Vendimi i refuzimit, i mbajtur prej përmbaruesit gjyqësor, është anuluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, me Vendimin nr. 318, datë 05.02.2008. Për qëndrimet e mbajtura nga Zyra e Përmbaramit, Korçë, Avokati i Popullit ka rekomanduar si për vendosjen e sanksioneve ligjore ndaj palës debitore, ashtu dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbaruesit gjyqësor, i cili nuk ka kryer ushtrimin e detyrave të parashikuara në ligj. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor apo Zyra e Përmbaramit Korçë, nuk kanë kthyer ende përgjigje rreth rekomandimeve të kryera.

- Në trajtimin e rastit me **nr.200902235**, konstatohet se, Zyra e Përmbaramit, Tiranë, pa asnjë shkak ligjor, jo vetëm nuk kryen veprimet për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor nr. 1189, datë 03.03.2005, Tiranë, për afro tre vjetë e gjysëm, por kryen dhe veprime, sikurse është thirrja e ekspertit, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e ekzekutimit dhe janë të paparashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Pas afatit të sipërcituar, Zyra e Përmbaramit, Tiranë, kryen veprimin e refuzimit për zbatimin e Vendimit Gjyqësor në fjalë, qëndrim ky aspak i ligjshëm në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

- Në trajtimin e rasteve me **nr.2010000073**, **nr.201000693**, **nr.200902188**, **nr.200902235** dhe **nr.200902325**, haset i njëjti qëndrim refuzues nga Shërbimi i Përmbaramit Gjyqësor në ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 2508, datë 02.10.1995, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë, Vendimit Gjyqësor nr. 1189, datë 03.03.2005 të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë si dhe Vendimit Gjyqësor nr.3819, datë 22.12.1999, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me objekt : “Detyrim për lirim trualli dhe kthim shume në lekë“.

Në rastin e fundit, qëndrimi refuzues i Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, është vlerësuar i paligjshëm nga kjo Gjykatë, e cila me Vendimin nr. 8049, datë 15.11.2007 dhe ajo e Apelit, Tiranë, me Vendimin nr. 121, datë 21.05.2008, kanë vendosur për: *“Detyrimin e Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, të vazhdojë ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit nr.1664, datë 29.12.2006”*.

Tjetër problematikë e hasur në veprimtarinë e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor, e cila ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formë së prerë, është dhe veprimi i thirrjes së ekspertit nga Zyrrat e Përmbarrimit, në mënyrë të paligjshme dhe të panevojshme për llojin e objektit të ekzekutimit. Ky veprim konstatohet të jetë kryer në disa raste të trajtuara nga Avokati i Popullit si ai me nr.doculive 200902497, nr. 200902235 dhe nr.201000087.

Në rastin e çështjes të rregjistruar me **nr.200902497**, ankuesi ka prezantuar shqetësimin e tij për moskryerjen e veprimeve përmbarrimore në ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr.1311/T-52, datë 15.07.2008, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, me objekt: *“Detyrimin e të paditurit D. C. t’i lirojë e dorëzojë paditësit H. Sh. banesën dhe truallin me sipërfaqe 300m2, ndodhur në Fshatin Anë-Vjosë, Tepelenë dhe të mos e përsërisë në të ardhmen”*.

Pasuria objekt ekzekutimi, sipas Çertifikatës “Për vërtetim pronësie” datë 21.05.2008 dhe hartës treguese të rregjistrimit, përcakton vendndodhjen e objektit për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastër, ka vendosur detyrimin për lirim e dorëzim. Pas më shumë se një vit zvarritjeje të kryerjes së procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv në fjalë, përmbarruesi gjyqësor i çështjes me Vendimin nr. 130, datë 03.09.2009, ka vendosur “Për thirrjen e ekspertit”. Ky qëndrim i përmbarruesit gjyqësor, për llojin e objektit të ekzekutimit, nuk ka asnjë bazë ligjore si dhe është i panevojshëm dhe e pajustificueshme kryerja e procedurave të tilla, të cilat rëndojnë palët pjesëmarrëse në ekzekutim, me detyrimin e pagimit të shpenzimeve të panevojshme përmbarrimore.

Në rastin e çështjes të rregjistruar me **nr.200902235**, ankuesi ka prezantuar shqetësimin e tij për moskryerjen e veprimeve përmbarrimore në ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor 1189, datë 03.03.2005, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Në rastin e çështjes të rregjistruar me nr. doculive 201000087, ankuesi ka prezantuar shqetësimin e tij për moskryerjen e veprimeve

përmbardimore në ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor 82, datë 31.03.2004, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tepelenë.

Sikurse në dy çështjet e sipërpërmendura, Zyra e Përmbardimit, Tepelenë, përmbarduesi gjyqësor i çështjes, ka kryer veprimin e thirrjes së ekspertit për të përcaktuar mangësitë, të cilat, sipas tij, ekzistojnë në aktet e ekspertimit që i bashkëlidhen dhe janë pjesë e Vendimit Gjyqësor nr. 82, datë 31.03.2004, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tepelenë.

Edhe në këtë rast, qëndrimi i përmbarduesit gjyqësor të Zyrës së Përmbardimit, Tepelenë, vjen në kundërshtim me sanksionimet e kryera në Kreu VII "Ekzekutimi i detyrimit për dorëzimin e një sendi të caktuar" të K.Pr.C., neni 601 e vijues. Në dispozitat e këtij Kreu nuk përcaktohet e drejta apo detyrimi i përmbarduesit gjyqësor të thërrasë ekspert për kryerje akti ekspertimi në ekzekutimin e Titujve Ekzekutiv, me objekt sikurse është ai i Vendimit Gjyqësor nr. 82, datë 31.03.2004.

Ofrimi i shërbimit për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, kryhet sikurse dihet, edhe prej përmbarduesve gjyqësor privatë, të cilët përzgjidhen mbi bazë kriteresh të vendosura si dhe konkurimi. Prej ditës së fillimit të ofrimit të shërbimit për ekzekutimin e titujve ekzekutiv nga ana e përmbarduesve gjyqësor privatë, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, deri më sot, nuk është depozituar asnjë ankesë, kërkesë apo njoftim për shkelje të të drejtave, lirive apo interesave të ligjshme të shtetasve nga ana e përmbarduesve gjyqësor privatë.

#### **- Ndhimja ligjore falas**

Legjislacioni ynë parashikon dhe rregullon institutin e shërbimit ligjor falas, si një e drejtë e individëve që janë në këto kushte, por ky shërbim verëhet se ka akoma probleme, sidomos në kërkesat e ndryshme për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë për çështje të ndryshme penale. Për shkak të vështirësive ekonomike, shumë qytetarë nuk kanë mundësi financiare për të siguruar një avokat, dhe klinikat ligjore që ofrojnë këtë mundësi janë të pakta për të mos thënë inekzistente.

Ky boshllëk ligjor u plotësua nga Kuvendi i Shqipërisë me daljen e ligjit nr.10039 datë 22.12.2008 "Për Ndhimë juridike", ku parashikohen kushtet, lloji i ndihmës ligjore, mënyra dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit si dhe të interesave të tjera të ligjshme të tij.

Nga përmbajtja e dispozitave ligjore të këtij ligji del se dhënia e ndihmës juridike nga shteti mbështetet në disa parime si, parimi i barazisë së të drejtave për të gjithë individët që përfitojnë nga ndihma juridike, i profesionalizmit të personave që japin ndihmën juridike, i cilësisë,

efiçencës dhe efektivitetit të ndihmës juridike, të ruajtjes së konfidencialitetit dhe të papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

Në këtë ligj parashikohet se ndihma juridike nga shteti jepet nga avokat të autorizuar sipas ligjit dhe në kushtet e parashikuara në ligj.

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët kërkojnë të mbrohen me avokat në procedime penale, në të gjitha fazat e tij, dhe që për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin vet një avokat mbrojtës ose kanë mbetur pa të.

Të drejtën për ndihmën juridike nga shteti e kanë edhe personat që kanë për gjykim në gjykatë një çështje civile ose administrative, por që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar një avokat, ku futen edhe personat që përfshihen në programet e mbrojtjes sociale.

Ndihmë juridike nga shteti përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja është e detyrueshme me ligj dhe ajo mund të kërkohet para, gjatë, ose pas procesit gjyqësor.

Në lidhje me zbatimin në praktike të këtij ligji, jemi informuar për krijimin e Komisionit Shtetëror pranë Ministrisë së Drejtësisë, dhe konkretisht, të kryetarit dhe të anetareve të tij. Nga informacioni që ne kemi, ky komision, deri tani, nuk ka bërë asnjë mbledhje, pasi, në bazë të ligjit, për funksionimin e tij, duhet që më parë të dalin aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **6. E drejta e Pronës**

E drejta e pronës, si një e drejtë themelore, garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 41 dhe nenin 42 të saj, në të cilët thuhet shprehimisht se;

“1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë”,

”1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.



Gjate vitit 2010, llogariten rreth 117 ankesa, ne të cilat është pretenduar shkelje e të drejtës se pronës nga veprimet dhe mosveprimet e organeve të administratës publike.

E drejta për të gëzuar lirisht pronën garantohet dhe kërkon respektimin e saj se pari nga ligjvenesit, i cili ne hartimin e ligjeve duhet të garantojë respektimin e kesaj të drejtë, por ne të njejten kohe, kjo e drejtë ka të ngjarë të cenohet dhe nga organet e administratës publike gjatë vendimmarrjes se tyre, qofte normative apo individuale, vendimmarrje e cila prek dhe pengon subjektet ne përdorimin lirisht të prone se tyre.

E pare ne këtë prizem, ndërhyrjet e Institucionit të Avokatit të Popullit kane qenë si ne drejtim të përmbajtjes, se përcaktimeve ne ligje të caktuara lidhur me predispoziten e tyre për të cenuar të drejtën e gezimit lirisht të pronës ( kujtojmë ketu ndërhyrjen tone ne vitn 2009 ne Gjykatën Kushtetuese, të cilën e kemi prezantuar ne raportin e kaluar), por dhe ne drejtim të vendimmarrjes individuale të organeve të administratës, pra të shqyrtimit të ankesave individuale, të cilet, ne përmbushje të interesit publik të ngarkuar nga ligji, duke ushtruar kompetencat e tyre, duhet të garantojnë mbrojtjen e të drejtës se pronës.

Konkretisht, kemi konstatuar shkelje të të drejtës së pronës, nëpërmjet mosrespektimit të dispozitave të Ligjit 9235 datë 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompesimin e pronave”, i ndryshuar, si dhe Ligjit 10207 dt. 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin 9235 dt. 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”, lidhur me afatet ligjore për dhënien e një vendimi.

Proçesi i kthimit dhe kompesimit të pronës, si një nga mënyrat e ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë, ka sjellë domosdoshmërinë e ngritjes së mekanizmave institucionalë, që kanë tagër dhe kompetencë për marrjen e vendimeve përkatëse për fitimin e titullit të pronësisë. Në një këndvështrim të detajuar, sa i përket pozicionit të institucionit në lidhje me veprimtarinë e Agjensisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, mund të thuhet se në vazhdimësi kemi ndërhyrë në respektimin e afateve procedurale, sa i përket marrjes së vendimeve konkrete për kthimin e kompesimin e pronës nga Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave Tiranë, duke mbajtur në vëmendje se, me ndryshimet e fundit ligjore, Zyrrat Rajonale e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave në qarqe janë suprimuar.

Konkretisht, afati për marrjen e një vendimi nga institucioni i sipërcituar, referuar Ligjit 10207 dt. 23.12.2009 “Për disa ndryshime në ligjin 9235 dt. 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”, neni 2, pika 1, gërma “b”, është tre muaj, ku rëndom konstatohet i pazbatuar në pjesën më të madhe të praktikave të trajtuara. Një pjesë e konsiderueshme e shtetasve që kanë aplikuar për njohjen e së drejtës për

kthimin dhe kompesimin e pronës, pas kalimit të këtij afati, i drejtohen Avokatit të Popullit, me qëllim ndërhyrjen pranë A.K.K.P.-së, për marrjen e një vendimi, në kushtet pra të shkeljes evidente të parimit të njohur në Kodin e Procedurës Administrative, për marrjen e vendimeve nga administrata publike brenda afateve.

Në këtë kontekst roli i Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të lirive të njeriut, nga mosveprimi i administratës publike, merr një rëndësi të veçantë, e pse jo edhe përcaktues, në procesin e ndërlikuar të kthimit dhe kompesimit të pronës.

Në trajtimin e ankesave të kesaj natyre, zyrës përkatëse, pasi i qartësohet legjitimitimi i ndërhyrjes së Avokatit të Popullit në këtë procedurë, i është kërkuar të japë shpjegime mbi argumentet ligjorë, për mosmarrjen e një vendimi brenda afateve të parashikuara. Gjithashtu, në mjaft raste nuk ka munguar dhe shprehja me rekomandim, në të cilin evidentohet detyrimi i organit përkatës për marrjen e një vendimi.

Institucioni yne ka konstatuar cenim të së drejtës se pronës edhe nëpërmjet moszbatimit të dispozitave të Ligjit nr. 9780 dt. 16.07.2007, "Për inspektimin e ndërtimit", i ndryshuar, nga ana e organeve përkatësisht i Inspektoriatit Ndertimor Urbanistik Kombëtar.

Cënimi i së drejtës për të gëzuar lirisht pronën, nëpërmjet ndërtimit të objekteve pa leje ndërtimi, gati në të gjitha rastet, shoqëruar me mosrespektim të distancave urbane ndërmjet objekteve ekzistuese dhe atyre në ndërtim, përbën një shqetësim serioz, të cilin Avokati i Popullit, nëpërmjet trajtimit të ankesave individuale, ka tentuar ta minimizojë sadopak.

Sigurisht që shkelja e kësaj të drejtë nuk do të ishte e mundur, nëse organet shtetërore të ngarkuara për kontrollin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, do të tregonin efikasitet në zbatimin e ligjit. Pothuajse në të gjitha rastet e paraqitura, ku evidentohet shkelje e së drejtës për të gëzuar lirisht pronën, e shprehur me mosekzekutim të ndërimeve pa leje nga ana e I.N.U.V.-ve në Bashki/Komuna, konstatohet mosrespektimi i afateve ligjore të parashikuara për ekzekutimin e vendimeve të kësaj natyre, parashikuar në Ligjin nr. 8408 datë 25.09.1998 "*Për inspektimin e ndërtimit*", neni 14, "*Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet*", paragrafi "3", ku përcaktohet se: "*Vendimet e I.N.U. të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë. Përyjashtimisht vendimet për prishjen e ndërtimit të kundraligjshëm kanë afat deri në 30 ditë*". Pra, ligji parashikon një afat 30 ditor për ekzekutimin e vendimit për prishje, e për raste të veçanta deri në 60 ditë, që do të thotë se janë afate të panegociueshme, e si rrjedhim janë të detyrueshme për t'u respektuar.

Gjithashtu, është konstatuar shkelje e së drejtës mbi pronën, nëpërmjet mosrespektimit të neneve 1 dhe 2 të Ligjit nr. 8651, dt.

22.12.2009 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”. Konkretisht, shkelja vërehet në trajtimin e rasteve të ndryshme në lidhje me moskryerjen e procedurave të shpronësimit, përkundër përdorimit të pronës për interes publik. Siç konstatohet më lart, në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, kufizimet e së drejtës mbi pronën mund të realizohen vetëm në rastet, kur ajo përdoret për interes publik dhe gjithmonë përkundrejt një shpërblimi të drejtë. Ndryshe nga vite të mëparshme, kur ankesat kishin objekt çmimin, përkundër përdorimit të pronës për interes publik, gjatë këtij viti, pranë Avokatit të Popullit janë paraqitur ankesa me objekt përdorim të pronës për interes publik, pa inicuar aspak procedura shpronësimi. Në të gjitha rastet e paraqitura kemi të bëjmë me rrugë lokale, ku bashkia apo komuna, në pozicionin e organit të interesuar, nuk ka filluar procedura shpronësimi, nisur nga interesi, sipas tyre, i komunitetit të territorit në administrim të saj, si dhe nga sipërfaqja relativisht e vogël e pronës private përdorur për interes publik.

Shkelje e së drejtës për të gëzuar lirisht pronën është shkaktuar në të njëjten kohë dhe nëpërmjet mosrespektimit të dispozitave të Ligjit 9482 dt. 03.04.2006 “Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Cënimi i së drejtës mbi pronën, nëpërmjet mosrespektimit të kësaj dispozite, që shkaktohet si rrjedhojë e moszbatimit të neneve 26 dhe 40 të Ligjit 9482 dt. 03.04.2006 “Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ka si efekt mospezullimin e procedurave të legalizimit edhe kur jemi në kushtet e parashikuara në nenet e sipërpërmendura. Ka disa ankesa të shqyrtura, kur pronari i truallit mbi të cilin janë ndërtuar objekte pa leje ka inicuar një proces gjyqësor, ku dhe me vendim të ndërmjetëm është vendosur pezullim i procedurave të legalizimit deri në përfundim të këtij procesi. Pas marrjes së këtij vendimi dhe paraqitjes së tij nga ankuesit pranë A.L.U.I.Z.N.I.-it rajonal, është konstatuar se procedura për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje nuk është pezulluar. Në këto kushte, në referim të akteve kushtetuese dhe ligjore të sipërcitura, kemi rekomanduar pezullimin e kësaj procedure.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2010, ka konstatuar se një numër i konsiderueshëm i ankesave u drejtohen kryesisht Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të cilat me veprimet dhe mosveprimet e tyre janë bërë premise për shkeljen e të drejtës së pronës. Këto organe nuk janë veçse një pengesë burokratike artificiale ndaj qytetarëve të thjeshtë për kryerjen e veprimeve të ndryshme të parashikuara nga Ligji. Konkretisht, detyrimet ligjore anashkalohen nga nëpunësit e Zyrave, duke shkaktuar sorollatje të individëve, mohim të të drejtave të tyre të njohura dhe garantuara në aktet normative në fuqi.

Gjatë trajtimit të ankesave lidhur me veprimet e ZRPP-se është konstatuar tejkallim i afateve administrative dhe ligjore për shqyrtimin dhe përpunimin e tyre në regjistrimin e kërkesave të parashtruara. Shkeljet kane shkuar deri edhe ne shuarjen e të drejtës së pronësisë përmes interpretimit që ZVRPP u bëjnë akteve të vjetra, vendimeve gjyqësore apo titujve të tjerë të pronësisë, duke i konsideruar ato si të paqëna apo të pavërteta, si edhe duke kërkuar në çdo rast konfirmimin e tyre nga organe të ndryshme të administratës apo ato organe që i kanë lëshuar këto akte apo vendime, gje qe shpesh është absolutisht e pamundur, për shkak se këto organe apo akte nuk mund të gjenden më për shkaqe objektive. Qëndrime të tilla negative dhe adresim i individëve në procese të gjata gjyqësore për të vërtetuar një fakt apo të drejtë që ato e kanë ushtruar prej vitesh, janë absolutisht të padrejta dhe është e domosdoshme, ashtu siç e kemi theksuar edhe në raportin vjetor të vitit të kaluar, të ndërmerren iniciativa ligjore për ndryshimin e Ligjit nr.7843 datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe përshtatjen e tij dhe të sistemit aktual të regjistrimit të pasurive të paluajtshme me kërkesat dhe ndryshimet aktuale që kanë ndodhur në Shqipëri, si dhe përputhjen e tij me aktet e tjera ligjore të brendshme. Konkretisht gjykojmë se është e padrejtë dhe diskriminuese ndaj individëve të thjeshtë apo asaj shtrese popullore që disponon pasuri të vjetra, mbi të cilat ushtron të gjitha tagrat e pronësisë, t’u mohohet pajisja e tyre me dokumentacionin aktual të pronësisë, për shkak të faktit të sipërcituar dhe mungesës së shkaqeve objektive për konfirmimin apo vërtetimin e dokumentacionit të vjetër me të cilin ato janë bërë pronar të asaj pasurie të paluajtshme.

Gjatë vitit 2010 ka një rritje të vogël të ankesave, lidhur me problemet që kanë shoqëruar në vite ndarjen dhe dhënien në pronësi dhe përdorim të tokave bujqësore subjekteve përfitues, sipas Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë në dhe për zbatim në terren të tij. Konkretisht numri i ankesave drejtuar Avokatit të Popullit për vitin 2010 ka qenë 38.

Përfundimi i procesit të ndarjes dhe rindarjes së tokës bujqësore, të krijimit të titujve të rinj të pronësisë mbi të dhe mbarimit të funksionimit të veprimtarisë së komisioneve të ndarjes së tokës me Ligjin nr.9948, dt.07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, ka sjellë rritjen e ndjeshmërisë së shumë familjeve bujqësore që nuk kanë gjetur zgjidhje përfundimtare, duke patur parasysh vendimet dhe veprimet administrative në mbylljen e ciklit, që fillon nga marrja e aktit përkatës të fitimit të pronës, deri tek regjistrimi e pajisja me çertifikatën nga Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Objekti i tyre fillon nga kërkesat për këshilla ligjore, për mosdhënie të tokës bujqësore në pronësi, moskalimi i tyre nga përdorimi në pronësi, mosregjistrimi në ZRPP-të e rretheve, për ndërhyrje në zgjidhjen e konflikteve kufitare që kanë lindur midis ankuesve dhe personave të tjerë fizike apo juridikë privatë, mes tyre dhe ish komisioneve të tokave, për pasaktësi të hartografisë, për mos plotësim sipas ligjit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi apo të dokumentacionit tjetër nga komunat dhe bashkitë, mosdërgimin e tyre në ZRPP-të, për mbivendosje parcelash, pajisje me Aktin e Pronësisë për troje brënda vijave të verdha, për dhenien e të njëjtës sipërfaqe dy ose më shumë subjekteve, për mosmarrje të tokës sipas frymëve, për zvarritje në shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut apo ankesa ndaj vendimeve për fshirje të pasurive të subjekteve përfitues dhe regjistrimin në emër të të tjereve pa argumentim, problemet që priten të lindin nga përfundimi i gjykimeve për shqetesimet dhe konfliktet e lartpërmendura, etj.

Përsa u takon zvarritjeve në shqyrtimin e ankesave nga Komisionet e lartpërmendura, kemi ndërhyrë dhe, në të gjitha rastet, na ka ardhur informacioni i kërkuar dhe i detajuar nga vetë Prefektët e qarqeve. Gjatë trajtimit të rasteve kemi konstatuar mungesë bashkëpunimi dhe bashkëveprimi ndërmjet institucioneve, si ato midis organeve bazë të administratës vendore dhe këshillave të qarqeve, apo midis këtyre dhe Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë. Një problem tjetër që konstatohet, ka të bëjë me pasaktësitë e kufijve midis fshatrave fqinje, apo midis këtyre dhe tokave të ish NB-ve dhe konflikte të shumta midis zbatimit në terren të Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për Tokën", i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij, si VKM nr.161, datë 08.04.1993 "Për një ndryshim në VKM 452, datë 17.10.1992, "Për ristrukturimin e NB-ve".

Pra, pavarësisht përfundimit të ndarjes të tokës bujqësore, mbeten ende probleme që kërkojnë zgjidhje imediate.

Gjate trajtimit të ankesave si dhe analizes se kuadrit ligjor e kushtetues, u pa me vend që ne, si Institucion, t'i drejtoheshim Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009, në kërkesën me objekt deklarinë dhe shfuqizimin si antikushtetues të Ligjit nr.9948, datë 7.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore". Ky i fundit u rrëzua me vendimin nr.29, dt.31.05.2010, të kesaj gjykate. Kjo gjykate përfundimisht arsyetoi se, Ligji nr.9948, datë

07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, është në pajtim me Kushtetutën vetëm, nëse ai interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e theksuara prej kësaj Gjykate, pra ai nuk prek titujt e pronësisë të dhënë në përputhje me kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi në kohën e krijimit të tyre. Komisionet vendore janë vetëm konstatuese të pavlefshmërisë, dhe nuk mund të anulojnë apo shfuqizojnë tituj të pronësisë, apo të urdhërojnë çregjistrimin e këtyre titujve nga regjistri i pasurive të paluajtshme. Është vetëm gjykata, e cila mbi padinë e të interesuarve apo autoriteteve publike përkatëse, vendos përfundimisht në lidhje me të drejtën e pronësisë së subjekteve të interesuara.

Gjykata theksoi gjithashtu se, argumentet e mësipërme në lidhje me Ligjin 9948, vlejnë edhe për pretendimet për shfuqizimin e VKM nr.1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

Ne përfundim, pas analizes se problematikes se mesipërme jemi të mendimit dhe kerkojme ndërhyrje si ne nivel politik, dhe administrativ. Sa me sipër mendojme se duhet realizuar:

1- Futja në sistem të regjistrimit të tokave të ndara në pronësi familjeve bujqësore në shumë zona të vendit, nëpërmjet sigurimit të fondeve financiare dhe burimeve njerëzore për Zyrën Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2- Ngritja e komisioneve të veçanta dhe nxjerrja e akteve ligjore dhe nënligjore për zgjidhjen përfundimtare të pronësisë se tokës bujqësore, të marrë në përdorim nga subjektet përfituese, si ish punonjës apo banorë të ish Kooperativave dhe Ndëmmarrjeve Bujqësore.

Ne raportin e vitit të kaluar kemi dhene informacion lidhur me kerkesat qe institucioni i Avokatit të Popullit i ka drejtuar Gjykates Kushtetuese për shfuqizime të dispozitave ligjore qe binin ndesh me Kushtetuten.

Konkretisht me Vendimin Nr.17, dt.23.04.2010, kjo Gjykatë, pasi gjykoi kërkesën për shfuqizimin si antikushtetues të paragrafit të dytë dhe të tretë, të Nenit 10 të Ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", ndryshuar me Ligjin nr. 9701, datë 02.07.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 21.11.2007 "Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme" dhe të neneve 2 dhe 6 të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 31.01.2007 "Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të

pasurive të paluajtshme", vendosi: "Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 10 dhe të paragrafit të dytë të nenit 39/a të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të shtuar me ligjin nr. 9701, datë 2.07.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme"

*Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 21.11.2007 "Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme"*

*Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e neneve 2 dhe 6 të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 31.01.2007 "Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme"*

Nderkohe, me Vendimin nr.27, dt.26.05.2010 Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën për shfuqizim si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 16 dhe 18 të Ligjit 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar me Ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar", vendosi :

*"Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të Neneve 15 pika 1, geramat c, ç, d, dh dhe 16 të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar me ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" i ndryshuar".*

**Për një informacion me të detajuar të problematikes se prezantuar me lart, parashtrojme disa raste dhe rekomandime:**

Ne ankesën me **nr.201000255**, ankuesi kërkoi ndërhyrjen e Avokatit të Popullit pranë I.N.U.V. Tiranë, me qëllim respektimin e afateve ligjore në ekzekutimin e vendimit për prishje ndaj objektit të ndërtuar nga fqinji. Duhet theksuar se bashkëngjitur formularit të ankesës rezultonte se, mëse një herë, I.N.U.V. Tiranë i drejtohej ankuesit me përgjigjen "vendimi do të ekzekutohet brenda afateve ligjore", në një kohë që tashmë këto afate ishin shkelur. Por, ajo që e bënte të veçantë këtë rast, ishte se, pas një periudhe gati një vjeçare nga marrja e vendimit të parë për prishje, sigurisht i paekzekutuar, për të njëjtin objekt, u mor një vendim i dytë, që si dhe tek i pari afatet për ekzekutim u tejkaluan. Në disponim të këtij dokumentacioni, i kemi rekomanduar I.N.U.V Tiranë ekzekutimin e vendimit për prishje në një kohë sa më të shpejtë. Më tej, në mungesë të një përgjigje nga I.N.U.V. Tiranë, i kemi rekomanduar

I.N.U.K. ushtrimin e kompetencave ligjore për ekzekutimin e vendimeve për prishje.

Ne ankesen e rregjistruar me **nr.201001198**, një qytetar shprehte shqetësimin e tij ndaj A.K.K.P. Tiranë, sa i përket zvarritjes së procedurës së parashikuar për dhënien e një vendimi, ashtu dhe siç parashikohet në dispozita të Ligjin 9235 datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompesimin e pronave*”, i ndryshuar.

Nga shqyrtimi dokumentacionit shoqërues, evidentohet qartë shkelja e afateve ligjore në dhënien e një vendimi, referuar dispozitave të Ligjit 10207 dt. 23.12.2009 “*Për disa ndryshime në ligjin 9235 dt. 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës*”, ku në nenin 2, pika 1, gërma “b”, përcaktohet “*Përfundon shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të njohjes, kthimit dhe kompesimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të ish zyrave rajonale të A.K.K.P. në qarqe, të depozituara në A.K.K.P. , brenda afatit për ushtrimin e së drejtës së ankimimit. Pas shqyrtimit të ankimit, Drejtori i Përgjithshëm i A.K.K.P.-së, brenda tre muajve nga nisja e procedimit të ankesës vendos:*

- *rrëzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të vendimit*
- *shfuqizimin e vendimit dhe zgjidhjen në themel të çështjes”*

Në këto kushte, në mbrojtje të të drejtës kushtetuese të shtetasve mbi pronën. i kemi rekomanduar A.K.K.P. Tiranë, marrjen në një kohë sa më të shpejtë të një vendimi.

Ne ankesen me **nr.201001294**, ankuesi shprehej se pa asnjë paralajmërim, komuna i kishte zaptuar një sipërfaqe trualli prej 6 m2 brenda murit rrethues me avlli, deri fare afër themeleve të shtëpisë së tij, për shkak të zgjerimit dhe rikonstruksionit të rrugës rurale ekzistuese.

Përkundër dhënies së shpjegimeve të kërkuara nga Avokati i Popullit, kryetari i komunës përligjite mosfillimin e procedurave të shpronësimit me argumentin se sipërfaqja e truallit të përdorur për interes publik ishte modeste, pra e sakrifikueshme për shkak të interesit të komunitetit ku ndërtohet rruga.

Pra në kushtet e kryerjes së procedurave për ndërtimin e rrugës në kundërshtim me nenet 1 dhe 2 të Ligjit Nr.8561 datë 22.12.1999 “*Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”, në raport me të drejtat legjitime të ankuesit në cilësinë e pronarit, kemi rekomanduar fillimin dhe përfundimin e procedurave të shpronësimit në favor të ankuesit, me cilësinë e pronarit të ligjshëm, për shkak të përdorimit të pronës private për interes publik.

Ne ankesen me **nr.201001116**, një shtetas bënte me dije se me cilësinë e një prej bashkëpronarëve të truallit, sigurisht në disponim të certifikatës së pronësie lëshuar së fundi nga Zyra e Vendore e



Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ku ndodhej prona, kishte incicuar një procesi gjyqësor, me objekt “Detyrimin e të paditurve për të prishur ndërtimin pa leje dhe dorëzimin e truallit 238 m<sup>2</sup>”.

Por fakti që detyronte Avokatin e Popullit të shprehej me rekomandim në këtë rast, ishte vendimi i ndërmjetëm i trupit gjykues, për pezullim të procedurave të legalizimit të objektit të ndërtuar pa leje ndërtimi deri në përfundim të procesit gjyqësor, të cilin edhe pse të interesuarit e kishin paraqitur pranë A.L.U.I.Z.N.I.-it, kjo procedurë nuk ishte pezulluar prej këtij të fundit.

Në këtë rast, pra ishte e qartë, se ky organ po vepronte në shkelje të nenit 40 “Pezullimi i procedurave të legalizimit”, të ligjit të sipërcituar, ku përcaktohet *“Në rastet kur si pasojë e shqyrtimit të një mosmarrëveshje në gjykim, ndërmjet subjektit dhe pronarit të truallit privat/kufitar, gjykata ka vendosur masë sigurimi, procedurat për legalizimin e shtesës së objektit pezullohen dhe rifillojnë sipas këtij ligji, kur masa e sigurimit humb fuqinë e saj, me kusht që shtesa pa leje të jetë vetëdeklaruar, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1.1 të nenit 7 të lëtij ligji”*.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, drejtuesi i këtij institucioni na sqaroi se në zbatim të rekomandimit të Avokatit të Popullit kishte urdhëruar pezullimin e procedurës së legalizimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

Ankesa me nr. **201000076**, me të cilën qytetari, banues në Shkodër, kërkon ndërhyrjen institucionale të A.P. për zvarritje për më tepër se 3 muaj në ritrajtimin e dy vendimeve të dt.27.05.2009 nga ish-ZRKKP-ja e Qarkut Shkodër, pas shfuqizimit dhe dërgimin për rishqyrtim nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së Tiranë.

Sipas Nenit 20 të Ligjit nr.10207, dt.23.12.2009 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.9235, dt.29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” veprimtaria e Zyrave Rajonale të AKKP-së në qarqe përfundonte 15 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit, që i korrespondonte datës 22.02.2010. Rasti i sipërpërmendur nuk është trajtuar nga ish-AKKP-ja Shkodër, brenda këtij afati, duke iu shmangur detyrimin për të dhenë një vendim.

Ankesa me nr.**200900569**, i takon një ankuesi nga Korça që kërkonte ndërhyrje institucionale pranë ZVRPP-së së rrethit, pasi nuk po merrte përgjigje për kërkesën për fshirje të mbivendosjes në regjistrat përkatës.

Kërkesat tona të përsëritura dhe rekomandimi i dt.22.10.2009 ndaj Zyrës Vendore dhe asaj Qëndrore në Tiranë, moren përgjigje me shkresën e datës 01.06.2010, pak ditë pasi vendimi nr.17, dt.23.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese, i cili shfuqizoi si të papajtueshëm me Kushtetutën

paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 10 dhe paragrafin e dytë të nenit 39/a të Ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të shtuar me ligjin nr. 9701, datë 2.07.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" si dhe udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 21.11.2007 "Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme", u botua në Fletore Zyrtare.

Qëndrimi i mbajtur, shmangia nga trajtimi i kërkesës dhe mosnjohimi i ankuesit prej mëse 6 muaj, në kushtet kur Gjykata Kushtetuese nuk kishte marrë vendim pezullimi për normat ligjore, për të cilat Avokati i Popullit kishte kërkuar shpalljen e tyre si antikushtetues, nuk tregon impenjim dhe seriozitet nga organi administrativ.

Ankesa me **nr.201000919** e një qytetari nga Tirana, është trajtuar në të njëjtën mënyrë si më lart, por kësaj rradhe nga AKKP-ja Qëndrore. Shqyrtimi i ankimit administrativ, për ndryshimin e pjesshëm të një vendimi të ish-KKKP-së të Bashkisë Tiranë nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, u zvarrit, në kushtet e mospezullimit nga Gjykata Kushtetuese, të neneve 15 dhe 16 të Ligjit nr.9235, dt. 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", i ndryshuar, deri në dhënien e vendimit përfundimtar nr.27, datë 26.05.2010 dhe botimit të tij në Fletortën Zyrtare.

Ankesa me **nr. 200901066** i takon një qytetari nga Tirana, i cili ankohet për mosveprim në bazë të ligjit procedural civil për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës të prerë nr.1747, dt.26.05.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku debitori, një person juridik ne fushen e ndërtimit, detyrohej ta njihte pronar të një apartamenti 2+1. Pëmbaruesi gjyqësor në vazhdimësi mbante qëndrim indiferent, në formën e mosveprimit, ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, pasi kjo e fundit kishte urdhëruar në dt.28.08.2008 bllokimin në ZRPP-në Tiranë të një pallati për mos pagim tatimesh nga subjekti ndërtues, ku përfshihej apartamenti pronë e ankuesit, objekt i procesit gjyqësor. Ky veprim, në kushtet kur ankuesi gjyqfitues apartamentin e kishte të regjistruar dhe marrë Çertifikatën e Pronësisë. Drejtorisë Rajonale Tatimore i drejtuam Rekomandim për lirimin nga pezullimi të apartamentit pranë ZRPP Tiranë. Reagimi i tyre ishte i shpejtë u realizua heqja e pezullimit, pasi shkaku i pezullimit kishte rënë nga dalja e Ligjit nr.9986, dt.30.10.2009 që falte detyrimet e prapambetura doganore dhe tatimore. Ndërhyrja jonë rrëzoi pretendimet justifikuese të Zyrës së Përmbarimit dhe zgjidhi pozitivisht shqetesimin afro 4 vjeçar të kreditorit.

## 7. E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës

E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës garantohet nga neni 49 i Kushtetutes se Republikës se Shqipërisë, si dhe i gjithë kuadri ligjor i brendshëm, i cili specifikisht i garanton i secilit të drejtën për të fituar mjetet e tij të jetesës me punë të ligjshme. Konkretisht në nenin 49 të Kushtetutes thuhet se:

“1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.

2. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës”.

Gjate vitit 2010, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, janë paraqitur rreth 104 ankues, të cilët kanë pretenduar shkelje të marrëdhënies së tyre të punës, nga ana e administratës publike. Konkretisht ata janë ankuar për largime të pamotivuara nga puna, shkelje të procedurave të parashikuara në ligj për largimin nga puna dhe mosarsyetim të vendimeve, gjë e cila i ka penguar realisht ankuesit të infomohen lidhur me arsyet e vendimit dhe, për rrjedhojë, të parashtrijne kundër argumentet e tyre.

Rastet me tipike që janë trajtuar dhe po trajtohen në vazhdim nga zyra jone, janë ato të largimit nga puna nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë të të gjithë ndihmes-stomatologeve në Shqipëri, duke i nxjerre në asistencë, apo ajo e një grupi infermjesh të Spitalit Ushtarak. Largim nga puna duke e legjitimuar atë me reformën strukturore është dhe ajo e një grupi punonjesh të sektorit të naftës. Nga këto raste kemi evidentuar se ka patur mosrespektim të afatëve ligjore paraprake të ndërprerjes së marrëdhënies të punës nga ana e punëdhënësit dhe shkelje të procedurave të parashikuara në ligj për largimin nga puna.

Gjatë këtij viti, punonjës të policisë së shtetit, në detyrë apo në reformë, kanë kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore nga organet e prokurorisë. Këto shkelje kanë patur të bëjnë me largime nga puna, me mosrespektimin e kohës së punës e të pushimit, me moszbatimin e vendimeve gjyqësore për kthim në punë etj.

Problematike për t'u përmendur është dhe ajo e statusit të personelit arsimor parauniversitar. Siç edhe e kemi bërë të ditur në vite, në raportet tona vjetore, marrëdhëniet e punës së personelit arsimor parauniversitar rregullohen me Kontratat Kolektive që Ministria e Arsimit ka lidhur me përfaqësuesit e Sindikatave që aderohet në këtë fushë. Është për t'u përmendur se, aktualisht, modalitetet e kontratës

kolektive janë për t'u vleresuar ne shume aspekte: përmendim ketu, proceduren e marrjes ne pune, ate të transferimit, të ndryshimit të vendit të punes etj. Por ajo qe ne konstatojme është se këto dispozita nuk gjejne zbatim ne vendimmarrjen individuale të Drejtorive Arsimore apo të Zyrave Arsimore. Nga vendimet, të cilat ne kemi shqyrtuar, konstatojme se ato janë të paarsyetuara çka pengon realisht subjektet të informohen lidhur me arsyet e vendimit dhe për rrjedhojë të parashtrojne kundërgargumentet e tyre. Realisht, kjo shkelje ka një pasoje finale qe bie pikerisht mbi buxhetin e shtetit, pasi shumica e ketyre individeve i fitojne proceset gjyqesore.

Për këtë arsye jemi të mendimit se përgjegjësia për nxjerrjen e një vendimi, i cili ka për pasoje shkeljen e të drejtës për pune, nuk duhet të bjere mbi organin e administratës publike qe e ka nxjerre ate, por duhet të jete individuale e titullarit të organit, pasi ky i fundit e ka detyrim ligjor zbatimin e ligjit. Ne kushtet, kur moszbatimi sjell një efekt pasuror kuptohet qe përgjegjësia duhet të jete si pasurore dhe disiplinore për këtë titullar.

#### **Nder ankesat e trajtuara me këtë problematike përmendim disa raste konkrete dhe rekomandime:**

Lidhur më të drejtën për punësim, do të veçonim ankesën e një grupi punonjësish (me **nr.201001357, 201001359, 201001360, 201001361, 201001362, 201001363, 201001364, 201001365**) ish-inspektorë të kontrollit të ushqimit pranë DRUMBK, me anë të së cilës shprehnin pretendimin e tyre për lirim të padrejtë nga puna dhe transferim të disa inspektorëve mbi baza preferenciale pranë AKU të Qarkut Tiranë.

Nga hetimi i deritanishëm i kësaj çështjeje, është konstatuar mungesë transparence lidhur me shpalljen e kriterëve të organizimit të testimit si edhe të njohjes të gjithë pjesëmarrësve me pikët respektive, renditje e cila do të tregonte dhe nivelin e tyre. Natyrisht kjo renditje duhet të ishte baze e vendimmarrjes se metejshme të organit, duke mos cenuar keshtu të drejtën për pune.

Ne ankesen me **nr.201000526**, një punonjës policie, efektiv në Seksionin e Objekteve të Komisarariatit të Policisë Nr. 1 Tiranë ankohej për shkeljen e të drejtave ligjore lidhur me kohën javore të punës dhe të pushimit. Ai pretendonte se ndaj tij dhe kolegëve të vet nuk respektohej java 40 orëshe e punës. Këtë shqetësim ankuesi së bashku me kolegët e kishin ngritur pranë drejtuesve të tyre, por në vend që të respektoheshin të drejtat ligjore dhe të zgjidhej problemi, atyre u thuhej se këto ishin kushtet dhe le të zgjidhnin njërën prej alternativave, qëndrimin në polici ose largimin prej saj.

Në përfundim të verifikimeve të bëra lidhur me këtë ankese, si në Komisariatin e Policisë Nr. 1 dhe në disa Komisariate të tjera në Tiranë, si dhe nga përgjigja e ardhur nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë arritëm në konkluzionin se, pretendimet e ngritura nga ankuesi, se atij dhe punonjësve të policisë të Seksionit të Objekteve në Komisariatin e Policisë Nr. 1 Tiranë u shkelej e drejta ligjore lidhur me kohën e punës e të pushimit ishin të vërteta. Kjo shkelje ligjore u konstatua edhe në disa Komisariate të tjera Policie në Tiranë, të cilët kishin efektiv policie për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve. Punonjësit e policisë të Seksioneve të Objekteve, që ishin disa dhjetra, në dallim nga punonjësit e policisë patrullë, në fakt punonin më shumë 40 orë në javë, nuk bënin dy ditë pushimi javor, nuk përfitonin pushimet në ditët e festave zyrtare dhe nuk paguheshin për mbikohën e punës që bënin.

Qëndrimi i drejtuesve të Komisariateve të Policisë Tiranë dhe i Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë ishte i kundërligjshëm dhe vinte në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, aktet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor në fuqi që garantojnë të drejtën e shtetasve *për të qënë të gjithë të barabartë para ligjit, të drejtën që të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikpamja e dinjitetit dhe e të drejtave dhe të drejtën për një pagë të drejtë dhe një shpërblim të barabartë për një punë të barabartë, pa kurrfarë dallimi.*

Për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij problemi i dërguam rekomandim Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë. Nëpërmjet këtij rekomandimi kërkuam marrjen e menjëhershme të masave të nevojshme organizative për respektimin e kohës ligjore të punës dhe të pushimit për punonjësit e Policisë së Shtetit të Seksioneve të Objekteve në Komisarimatet e Policisë Tiranë.

Gjithashtu, kërkuam edhe marrjen e masave administrativo-financiare për pagimin e menjëhershëm të punonjësve të Policisë së Shtetit të Seksioneve të Objekteve për mbikohën e punës (orët shtesë të punës e shërbimit mbi kohën javore 40 orëshe të punës).

Rekomandimi, i cili iu dërgua për dijeni edhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, u pranua. U informuam se po punohej për përgatitjen e infrastrukturës së nevojshme për marrjen e masave e zbatimin në afat të VKM-së nr. 333, dt. 28.04.2010 “Për Ruajtjen dhe Sigurimin e Objekteve Shtetërore”, i cili do të hynte në fuqi më 01.01.2011. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi do të krijoheshin të gjitha mundësitë për trajtimin me sistemin 40 orësh të të gjitha strukturave policore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë. Mirëpo në përgjigje nuk na u dha asnjë informacion se çfarë do të bëhej me detyrimet financiare të prapambetura ndaj kësaj kategorie punonjësish policie.

Për zgjidhjen edhe të kësaj çështjeje i sugjeruam ankuesit që ai dhe kolegët e tij t’i drejtoheshim me padi organeve gjyqësore.

Ankesa me **nr.201000612**. Si rast konkret mund të përmendim rekomandimin tone drejtuar Drejtorise Arsimore Rajonale të Qytetit (DAR) Tirane lidhur me punesimin si mesuese definitive të edukimit fizik të ankueses, e cila ka qenë një nga kampionet kombetare të gjimnastikes, e diplomuar mesuese e edukimit fizik, e kualifikuar për kategorine e pare, gjyqtare për sportin e gjimnastikes, notit dhe e çertifikuar si fizioterapiste.

Zyra, duke ndjekur këtë çështje si një kerkese të ligjshme, ku behej fjale për një individ qe plotesonte të gjitha kriteret, të cilat nuk i plotesonin edhe ata persona qe janë të punesuar ne të gjitha shkollat e Tiranës, duke ju drejtuar ndër të tjera edhe Ministrise se Arsimit dhe Shkences, beri të mundur pranimin e rekomandimit tone dhe emerimin e ankueses ne një nga shkollat 9 vjeçare të Tiranës.

## **8. E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqerore**

E drejta e per te perfituar nga sistemi i sigurimeve shoqerore ne Shqipëri garantohet nga Kushtetuta e Republikës se Shqipërise, ne piken 1 të nenit 52, ne të cilen thuhet se:

“1. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.

2. Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj”.

Legjislacioni aktual u jep të drejtën e personave për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqerore me Ligjin nr.7703 date 11.05.1993 “Për sigurimet shoqerore ne Republikën e Shqipërise” (indryshuar) si dhe aktet nenligjore të dala për zbatim. Problematika qe lidhet me zbatimin e ketij ligji numeron rreth 49 ankesa të depozituara prane Institucionit tone.

Pavaresisht se sistemi publik i sigurimeve shoqerore ka ardhur duke u reformuar dhe duke iu përshtatur zhvillimeve ekonomiko-sociale, nuk mund të anashkalohen disa ceshtje të konstatuara nga ankesat e trajtuara nga ana jone, të cilat jane:

- Çështja e pensioneve minimale shume të ulta, krejt e pamjaftueshme për një jete normale për të moshuarit. Pensionet e ulta mbeten një çështje e ndjeshme publike.

- Me qellimin qe efektet financiare të shteses ne masen e pensioneve të plota të pleqerise të përfshijne kategorine e personave të përcaktuar ne VKM-ne nr.787 date 21.11.2003 “Për zbatimin e fazes se katert të ngushtimit të diferencave ne masen e pensioneve”, si dhe të tabelës “C.f”, kemi kerkuar ndryshim të te germes “dh”, të pikes 3 të

VKM-se nr.787 date 21.11.2003 “Për zbatimin e fazes se katert të ngushtimit të diferencave ne masen e pensioneve”, si dhe të tabelës “C.f”, problematike e paraqitur edhe ne Raportin Vjetor 2009.

Gjate trajtimit të ankesave, shtetasit kane pretenduar se u janë shkelur të drejtat e tyre të ligjshme, kryesisht për masen e pensionit të pleqerise. Megjithese ne vite Institucioni yne ka bërë një pune jo të vogel me ane të Rekomandimeve të paraqitura për përmiresime ligjore, konstatojme se ende nuk janë zbatuar të gjitha Rekomandimet tona. Sipas përgjigjeve qe ne kemi marre nga prezantimi i problemeve të ngritura, procesi i reformimit të skemes se sigurimeve shoqerore është një proces ne vazhdimesi dhe ndryshimet behen ne varesi të politikave qe ndjek shteti ne fushen e sigurimeve shoqerore. Por, pavaresisht kesaj, mund të themi qe ndryshimet duhet të jene me të shpejta për arsyen e thjeshte se masa e pensionit mund të jete jetike për këtë kategori personash, të cilet mund ta kene ate burimin e vetem të te ardhurave të tyre.

Ne fillim të vitit 2010, nisur nga ankesat e depozituara, kemi rekomanduar marrjen e masave për ngritjen e një grupi pune për realizimin e një studimi për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore për të ndryshuar kushtet e daljes ne pension të grupit të pensionisteve qe kane dale ne pension ne periudhen 01.01.1994 – 31.12.1995. Nga Ministria e Financave na u kthye pergjigje se ky rekomandim i është derguar për kompetence Institutit të Sigurimeve Shoqerore. Nderkohe, jemi ne pritje të pergjigjes nga ana e ISSH-se.

Ankesa të shumta gjatë vitit 2010, janë paraqitur nga ushtarakë apo ish ushtarakë që ndërpresin karrierën apo e kanë ndërprerë atë kohë më parë ne kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura, duke filluar nga viti 1992 e në vazhdim.

Sipas ankuesve, jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegeve të tyre që kanë dalë në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qënë të barazvlefshëm në detyrë, por ata kundërshtojnë edhe iniciativën e Kryeministrit, për të ndryshuar ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh.

Mbi bazën e kërkesës së Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në rezervë të Shqipërisë Avokati i Popullit studjoi projekt ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 ”Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ndodhej për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Me shkresën nr. 160, datë 07.07.2008 Avokati i Popullit mendimet e tij ia parashtroi Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e

Njeriut, Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat si dhe Kryetarit të Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Për zgjidhjen e këtij problemi Kuvendi i Shqipërisë në Muajin Maj miratoi ligjin nr.10142 datë 15.05 2009 “Për Sigurimet Shoqërore të Ushtarakëve “. Pas daljes së ligjit, Avokati i Popullit, duke u mbështetur në Nenet 4, 18 pika 1; 49 pika 2; 52 pika 1; 131 gërma “a”; 134 gërma “dh” dhe 142, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 27-31, 45 dhe 49 pika 2 të ligjit nr. 8577 datë 10.02.2000 “Për

Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 24, gërma “c”, i ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ndryshuar me ligjin nr. 9398 datë 12.05.2005,e ka kundërshtuar atë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, duke kërkuar:

1. Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të ligjit Nr.10142 dt.15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit e të punonjësve, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

2. Shfuqizimin e neneve 3/3; 4/2; 12/1,2,3; 14/1; 22; 27 dhe 29/2 të ligjit nr. 10142, dt. 15.05.2009, si të papajtueshëm me Kushtetutën, sepse çënojnë të drejtat ekonomiko-financiare të punonjësve të Policisë së Shtetit, të përfituara me aktet normative të mëparshme.

Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 33 datë 24.06.2010 ka vendosur : Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 2 të nenit 14 , si dhe të nenit 27 të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “ Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit të gardës së republikës të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”. Në pjesën arsyetuese kjo Gjykatë ka arsyetuar se : Parimi i shtetit të së drejtës përmban në vetvete dhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Siguria juridike nënkupton që në rastet kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht për një çështje vendimet e tyre nuk duhet të vihen në dyshim. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve të formës së prerë dhe askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre pasi ato kanë marrë formën e prerë. Në konsideratë të këtyre përcaktimeve , gjykata ka vlerësuar se qëllimi i dispozitave të nenit 29 të ligjit objekt gjykimi, duke u nisur nga konteksti i saj si dhe konteksti i përgjithshëm i këtij ligji, është që kjo rilogaritje e këtyre të drejtave të fituara në zbatim të ligjeve të mëparshme ose dhe të



vendimeve të gjykatave, do të bëhet vetëm në rast se ndryshon pozitivisht, pra përmirëson situatën e përfituesve. Në asnjë rast nuk lejohet që të kryhet një rilloaritje që do të çonte në përkeqësimin e situatës pozitive ose në cënimin e të drejtave të fituara. Në rast të kundërt, pra nëse do të bëhej një interpretim dhe zbatim ndryshe i kësaj dispozite, atëhere do të ishim para cënimit të sigurisë juridike. Nga subjektet e interesuara nuk u dhanë argumente për të justifikuar parimin e sigurisë juridike për interes të rëndësishëm publik. Qëllimin e mbrojtjes së sigurisë juridike e ka patur parasysh edhe ligjvënësi, duke parashikuar në nenin 24 paragrafi i parë të ligjit objekt gjykimi se përfitimet suplementare, pasi janë llogaritur, nuk janë më objekt i ndonjë ndryshimi, me përjashtim të indeksimit të bërë me Vendim të Këshillit të Ministrave. Gjykata, në këtë interpretim pajtues, arrin në përfundimin se: neni 29 i Ligjit 10142, datë 15.05.2009 është i pajtueshëm me Kushtetutën, me kusht që dispozitat e tij të interpretohen si më sipër. Asnjë interpretim tjetër i këtyre dispozitave nuk është i lejueshëm nga pikpamja kushtetuese dhe se mbrojtja e të drejtave të fituara nuk mund të arrihet, në rast se dispozitave të kundërshtuara u jepet kuptim tjetër. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për një kohë të gjatë, Këshilli i Ministrave nuk zbatoi detyrimin e tij për të nxjerrë një vendim i cili do të përcaktonte kriteret e përllogaritjes së pensionit. Kohët e fundit ky vendim u zëvendësua me një akt normativ të Qeverisë, i cili përkeqëson pozitën e përfituesve. Me anën e disa vendimeve gjyqësore, disa ushtarakë kishin fituar të drejtën për të marrë pensionin suplementar. Ata u ankuan se nga ana e sigurimeve shoqërore nuk po bëhej përllogaritja e pensionit. Për këtë, zyra e Avokatit të Popullit gjeti se veprimtaria e zyrave të sigurimeve shoqërore pengohej nga qeveria, e cila nuk kishte plotësuar detyrimin ligjor për të nxjerrë aktet, të cilat do të përcaktonin kriteret mbi të cilat do të përllogaritej pensioni. Për këtë problem, ende pa marrë jetë vendimi, u nxorr akti normativ, i cili përcaktonte kriteret mbi të cilat do të përllogaritej pensioni i ushtarakëve në lirim apo rezervë, ky akt është shumë i kontestuar nga shoqatat e ushtarakëve.

Kjo çështje vazhdon të mos gjeje ende zgjidhjen e duhur.

### **Raste te tjera dhe rekomandime:**

Gjate shqyrtimit të ankeses me **nr.2010001193**, kemi konstatuar se një të moshuare, azilante ne Shtepine e të Moshuarve ne Kavaje, i ishte shkelur e drejta e perfitimit të pensionit të pleqerise.

Pasi kryem një korrespondence të gjatë me DRSSH-te Tirane, Korce dhe Gjirokaster si dhe me Institutin e Sigurimeve Shoqerore, sepse dosja e pensionit të kesaj të moshuare nuk gjendej, na u kthye pergjigje se dosja ndodhej prane Drejtorise Rajonale të Sigurimeve Shoqerore

Gjirokaster. Ne Rekomanduar transferimin urgjentisht të dosjes se pensionit prane Drejtorise Rajonale të Sigurimeve Shoqerore ne Tirane. Ne këto kushte i kthjem pergjigje ankueses qe të interesohej prane Agjensise Lokale të Sigurimeve Shoqerore ne Kavaje.

Ne Inspektimin e kryer prane Shtepise se të Moshuarve ne Kavaje, u informuam se dosja ishte transferuar ne ALSSH-ne Kavaje dhe ankuesja kishte filluar të terhiqte pensionin e saj të pleqerise.

Ankesa me **nr.201000290**, e një numri arsimitaresh nga qyteti i Korces, ne lidhje me masen e pensionit të pleqerise. Kjo kategori personash ka dale ne pension pleqerie gjatë vitit 1994. Sipas tyre, masa e pensionit qe ata gezonin ishte me e ulet se e kolegeve të tyre qe kishin dale ne pension pleqerie ne periudhen 01.10.1993 – 31.12.1993.

Ky problem është prezantuar nga ana jone edhe ne raportin vjetor 2009, ku një grup arsimitaresh nga qyteti i Lushnjes paraqiten ankesen e tyre për masen e ulet të pensionit të pleqerise dhe kerkonin permiresim të legjislacionit ekzistues, me qellim qe të parafrohen masat e pensioneve të pleqerise të personave qe kane dale ne pension me 60% deri ne vitin 1995 me ato qe dalin sot. gjatë marrjes ne shqyrtim të kesaj ankese, ne vitin 2009, ne proceduam me kerkese për shpjegime prane Ministrise se Financave.

Pas marrjes se pergjigjes, konstatuam se u ishte e shkelur e drejta e rritjes se mases se pensionit të pleqerise, pasi nuk kishin perfituar nga VKM nr.605 date 31.12.1993 “Per rritjen e pensioneve dhe të ardhurave nga papunesia”. Shtesen ne masen e pensionit, sipas kesaj VKM-je, nuk e perfituan ata pensioniste qe, si date fillimi të pensionit, kishin daten 01.01.1994 e ne vazhdim. Kjo, për faktin se si rritja, ashtu dhe granti kane qenë të aplikuara ne page dhe ne masen e pensionit baze. Si pasoje e perfshirjes se pensionit baze të rritjes dhe të shteses (grantit ne një shume prej 494 lekesh), dy persona, me të njejtat kushte, por qe kane data të daljes ne pension, njeri para 31.12.1993 dhe tjetri pas dates 01.01.1994, ne llogaritje rezultojne me masa pensioni të ndryshme, me një diference prej 5.6%. Sa me siper konkluduam ne dergimin e një Rekomandimi institucioneve pergjegjese.

## **9. E drejta për arsimim**

E drejta per arsimim eshte e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe nga nje kuader i plote ligjor. Avokati i Popullit ka treguar sensibilitet në trajtimin e rasteve të ndryshme, të paraqitura nga shtetas të ndryshëm, ku janë konstatuar veprime në kundërshtim me dispozita ligjore në fuqi, të cilat çënojnë deri dhe dëshirën e nxenesit për të ndjekur shkollën.

Realisht rastet kane qenë të shkeputura, pra kjo do të thote se e drejta për arsim garantohet nga organet e administratës publike. Megjithetë, nuk mund të leme pa permendur ketu të drejtën për arsim të komunitetit rom, çështje kjo e trajtuar dhe me siper pikerisht ne Rekomandimet e seminarit Kombetar të organizuar vitin e kaluar nga zyra jone.

Po keshtu, është për tu vleresuar fakti se tashme është pergatitur nga Ministria e Arsimit dhe e Shkences draft ligji “Per Sistemin Arsimor Parauniversitar”, qellimi i të cilit është ndër të tjera rregullimi i aspekteve të ngritjes, organizimit, financimit e sigurimit të cilesise se institucioneve të arsimit parauniversitar, si dhe të rolit të shoqerise ne funksionimin e arsimit parauniversitar. Ai është lançuar nga MASH ne Dhjetor 2010, dhe ne procesin e konsultimit me grupet e interesit, do të këtë vend për tu konsultuar dhe me Zyren e Avokatit të Popullit, për problematika të veçanta.

### **Nder ankesat e trajtuara permendim:**

Ankesën me **nr.201001276**, ku ankuesi parashtronte pretendimin e tij ndaj drejtorisë së shkollës së mesme ku djali i tij, përsëritës i vitit të parë, nuk lejohej të vijonte me studimet e vitit shkollor.

Me marjen në shqyrtim të kësaj ankese, eksperti i ngarkuar me trajtimin e saj, është paraqitur personalisht pranë drejtorisë së shkollës ku dhe ka zhvilluar një takim me drejtorin e shkollës.

Gjatë këtij takimi, pas shpjegimeve të kërkuara, e më tej absurditetit të argumentave të përdorura për krijimin e një shtete të tillë, ku nxënësi nuk lejohet të fillojë shkollën se është përsëritës viti, funksionarit në fjalë i është kërkuar pranimi i menjehershemi nxënësit, duke i bërë të ditur se qendrimi i shkolles ishte i pabazuar ne ligj dhe i paargumentuar.

Nga informacionet e marra pas takimit të sipërpërmendur, sigurisht në funksion të ndjekjes deri në zgjidhje të kësaj çështje, ka rezultuar se djali është lejuar të ndjekë vitin shkollor 2010.

## **10. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim**

Çështja e strehimit perseri prezantohet si një problem madhor dhe jetik. Numri i familjeve të pastreha dhe kërkesat e tyre vijojnë të rriten, duke sjellë zgjidhje të pa mjaftueshme e krahasimisht të këtyre kërkesave në drejtim të projekteve minimale të realizuara nga pushteti vendor. Gjatë vitit 2010 janë rregjistruar rreth 29 ankesa, të cilat kane këtë problematike. Duke shpresuar se aktet ligjore dhe nënligjore që kanë dalë

nga Qeveria për zgjidhjen e strehimit, do të zgjidhin hap pas hapi këtë problem kombëtar dhe madhor, besojmë se dhe kategoritë e tjera të pastreha do të përfitojnë nga këto politika sociale të shtetit. Megjithatë gjatë trajtimit të këtyre ankesave, kemi konstatuar se qytetaret vijnë të pretendojnë, që mungon transparenca në përzgjedhjen e kategorive apo në vendimarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese e radha e trajtimit të shtetasve, probleme të cilat janë prezantuar dhe në raportet e mëparshme.

Për këtë problem, zyra jonë rithekson mangësinë e informimit publik për ditën e mbledhjeve, apo dhe rendin e ditës të mbledhjeve të këshillave bashkiake, të cilat duhet të jenë publike dhe të njohura, me qëllim që personat e interesuar të jenë pjesë e kësaj procedure, për të cilët janë direkt të interesuar dhe për të cilat duhet të vihen në dijeni, qoftë dhe se kur praktikisht mund të zgjidhen shqetësimet e tyre.

Konstatohet zvarritje e procedurave për trajtimin me strehim të individeve që, megjithëse gëzojnë statusin e të pastrehut, perseri nuk kanë gjetur asnjë mundësi të trajtohen me strehim nga ana e organeve të pushtetit vendor.

Nga korrespondenca e mbajtur me Bashkitë si në Tiranë, apo edhe në rrethe të tjera, ka rezultuar se emrat e individeve ankues që i janë drejtuar Avokatit të Popullit, janë në listat perkatese për t'u trajtuar me strehim, por zvarritja e procedurave ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve që kanë Bashkitë për trajtimin me strehim, për t'u ardhur në ndihmë të qytetarëve.

Mbetet gjithashtu problematike çështja e trajtimit me strehim apo shtesë sipërfaqe banimi për ushtarakët. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes ky problem duhet të zgjidhet nëpërmjet:

a) *Rritjes së fondit të dhënies së kredive për strehim nga buxheti i shtetit, i cili deri tani ka qënë i kufizuar.* Për vitin 2010, shumta e fondit të parashikuar është zvogëluar akoma më shumë. Kjo shumë është e pamjaftueshme për plotësimin e nevojave të ushtarakëve në krahasim me numrin e shumë të kërkesave për strehim. Për këtë u sugjerua rritja e fondit të kredisë për strehim për ushtarakët e Forcave të Armatosura, si dhe gjetja e formave të tjera, duke bashkëpunuar me organet lokale të pushtetit për të bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të strehimit.

b) *Strehimit të ushtarakëve në ambiente të cilat dalin të lira nga ristrukturimi i Forcave të Armatosura.*

c) *Nëpërmjet kompensimit të qerave të banesave dhe të ushqimit të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.524, datë 30.07.2004, i cili është në proces rishikimi. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 28.01.2008 u rritën normat e ushqimit të efektivave ushtarakë të ushtrisë.*

Për një pjesë të ushtarakëve aktiv, Ministri i Mbrojtjes, në pikën 8, të urdhërit të tij nr. 388, datë 13.03.2008, ka përcaktuar që një pjesë e efektivave, këtë ushqim ta marrin duke iu kompesuar në vlerë monetare. Theksojmë se, pavarësisht vonesave për vitin 2010, në muajin Qershor 2010, nga ana e Ministrit të Mbrojtjes ka dalë urdhëri për dhënien e qirasë së banesave, mbasi është përcaktuar çmimi mesatar i qirasë së banesave, i cili sipas gërmës “c”, të pikës 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524 datë 30.07.2004, përcaktohet çdo vit.

### **Raste te tjera dhe rekomandime:**

Ankesa me **nr.201000893**. Ankuesi, një banor në Komunën Paskuqan Tiranë, ankohej se nuk ishte trajtuar me strehim nga kjo komunë, pavarësisht faktit se gezonte statusin e të pastrehut. Në përgjigjen dërguar institucionit tonë nga ana e këtij organi të administratës publike rezulton se, kjo komunë i ka marrë të gjitha masat për të trajtuar kërkesën e tij brenda mundësive ligjore dhe financiare, por kjo e fundit nuk disponon të ardhura të mjaftueshme që të trajtonte rastet e të pastrehëve që ishin në territorin e saj.

Ankesa **nr.201000315**, e paraqitur nga disa ushtarakë, të cilët pretendonin se Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes për kompesimin e qerasë së banesës për ushtarakët nuk ishte në përputhje me V.K.M Nr.524, datë 30.04.2004 "Për masën dhe mënyrën e kompesimit të qerasë së banesës për ushtarakët e Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë ", në bazë dhe për zbatim të së cilës ky urdhër kishte dalë. Në bazë të ndryshimeve që ishin bërë në V.K.M, ishte zgjeruar rrethi i ushtarakëve të cilët mund të përfitonin kompesim qeraje banese, duke përfshirë përveç oficerëve edhe nënoficerët dhe ushtarët profesionist. Pas shqyrtimit të ankesës, rezultoi se pretendimet e ankuesve ishin të bazuar në ligj dhe Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi ndryshimin e Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes për vitin 2009 si dhe përfshirjen e nënoficerëve dhe ushtarëve profesionist në urdhërin respektiv të vitit 2010. Nga përgjigja e paraqitur për këtë rekomandim, jemi njohur se përfshirja e kategorive të ushtarakëve ishte bërë në mënyrë të pjesshme për shkak të fondeve financiare të limituara.

Me rekomandimin e datës 15.04.2010, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrit të Mbrojtjes Z. Imami ndryshimin e urdhërit Nr 953 datë 06.07.2009 “Për kompesimin e qirasë së banesës për ushtarakët e F.A/, në Republikën e Shqipërisë në përputhje me V.K.M nr. 524, datë 30.04.2004 “Për masën dhe mënyrën e kompesimit të qirasë së banesës për ushtarakët e F.A. në Republikën e Shqipërisë. Neni 21 i Ligjit nr. 9210 “Për Statusin e Ushtarakut të F.A. i njeh të drejtën e Kompesimit të

Qirasë së Banesës tre kategorive ushtarakësh. (oficer, nënoficer, ushtar me pagesë Profesionist). Në urdhërin e Ministrisë kjo e drejtë ju mohohet nënoficerëve dhe ushtarëve profesionist. Pas rekomandimit tonë, për të përfshirë në urdhër edhe nënoficerët dhe ushtarët profesionist, ky urdhër u korrigjua.

Me shkresën e datës 22.06 2010 Avokati i Popullit i ka propozuar Kryeministrin për mirësimin e V.K.M. nr. 864, datë 29.07.2009 sipas pikës 8 të të cilit përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit studentet që vijnë nga këto shtresa sociale: të verbër, të shurdhër, invalidë paraplegjikë, tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuar, fëmijë rom, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve të rënë apo plagosur për shkak të detyrës, ish të përndjekurit politikë. Nga kjo tarifë vjetore përjashtohen edhe studentet e viteve të larta. Siç dukej qartë, sipas këtij vendimi, nuk përfitonin fëmijët e ushtarakëve të rënë në krye të detyrës. Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministri i Mbrojtjes z. Imami, me shkresën Nr. 8621, datë 25.10.2010, shkruan: Në zbatim të rekomandimit të bërë nga Avokati i Popullit dëshirojmë t'ju vëmë në dijeni se Ministri i Mbrojtjes, duke vlerësuar shqetësimet e shprehura në këtë rekomandim, ndër mori inisiativën për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 9 të të cilit u përjashtuan nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2010-2011 edhe fëmijët e ushtarakëve të F.A. të rënë apo plagosur në krye të detyrës.

## **11. Ndihma ekonomike**

Ankesat e paraqitura pranë institucionit tone kanë të bëjnë me masën e përfitimit të ndihmes ekonomike, e cila sipas ankuesve është shumë e ulët dhe nuk i plotëson nevojat e tyre baze jetësore.

Po në këtë fushë konstatojmë ankesa për ndërpreje të ndihmës ekonomike në menyrë të padrejtë si dhe ankesa për mundësim të përfitimit të pagesës së ndihmes ekonomike, për ata persona që nuk e përfitojnë atë.

## **12. Mbrojtja e konsumatorit**

Në mbrojtje të interesave të konsumatorëve, zyra e Avokatit Popullit i është referuar kryesisht Ligjit Nr.9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit". Ky ligj që përfshin të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, rregullon detyrimet dhe të drejtat e palëve në kuptim të ushtrimit brenda rregullave të tregut, për shërbimet e ofruara nga subjektet juridike në funksion të përgjegjësive operatore-konsumatore. Ankesat e depozituara, në të cilat

është pretenduar shkelje e të drejtës së konsumatorit gjatë ofrimit të shërbimeve publike, rezultojnë rreth 86 .

Ne këtë aspekt, objekt i punës së zyrës së Avokatit të Popullit ka qenë dhe veprimtaria e ndjekur nga subjektet juridike private, të cilët ofrojnë de facto shërbime monopoliste dhe mbulojnë me rrjetin e furnizimeve të ndryshme që kanë si objekt pjesën më të madhe të konsumatoreve.

Gjatë vitit 2010, u vuri re se kompanitë tilla si shoqëria ALBTELECOM sh.a, shoqëria OSSH sh.a. CEZ, Ndermarrja e Ujesjellës Kanalizimeve nuk respektonin të drejtën për informim të qytetarëve të percaktuara në kontratat respektive ndërmjet paleve në fuqi, si dhe të drejtat e ndryshme që burojnë nga legjislacioni përkatës për konsumatorin. Duke anashkaluar qëllimisht këto të drejta, shoqëritë e mesipërme realizonin veprimtaritë e tyre duke sjellë shpesh herë një kosto të madhe për jetën e qytetarëve.

Ne këtë aspekt, duke u nisur dhe nga ankesa të qytetarëve që pretendonin për mungesë të theksuar informacioni nga shoqëria ALBtelekom sh.a, Zyra e Avokatit të Popullit trajtoi gjatë vitit 2010 me inisiativë rastin e mospublikimit në fushën e telekomunikacionit nga ana e shoqërisë ALBtelekom sh.a, rritjen e tarifave të telefonisë fikse, si dhe përmirësimit të shërbimeve për konsumatorët shqiptarë. Kështu, mospublikimi në mënyrat e percaktuara me ligj, i rritjes së tarifës mujore për telefoninë fikse të miratuar nga Enti Rregullator të Telekomunikacionit për shoqërinë ALBtelekom sh.a., ishte vënë re se sillte shqetësim të abonenteve, të cilët pretendonin se nuk njoftoheshin në kohë nga ana e operatorit.

Ky problem përmbante shkelje të dispozitës 54 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit Sipermarresi që ofron shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun kishte detyrimin të njoftonte nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifën e shërbimeve jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi ose ndryshimeve, dhe ky njoftim duhej bërë jo më pak se 3 ditë rrjesht.

Se dyti, prej kohësh Zyra e Avokatit të Popullit ishte bërë me dije nga ankesat e qytetarëve, për mosofrimin e faturave të abonenteve në adresat e tyre. Në këtë kuptim, zyra jone iu referua përmbajtjes së pikës 3 dhe 6 të nenit 40 të Ligjit Nr.9902 datë 17.04.2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorit”, që parashikonte midis të tjerash se: “Fatura për shërbimet e telekomunikacionit, që i shpërndahet konsumatorit, duhet të përmbajë informacion të plotë për listën e numrave të telefonave të thirrur, kohën dhe zgjatjen e telefonatave të bera, numrin e impulseve dhe çmimin total për periudhën e caktuar. Faturat e paraqitura konsumatorit duhet t'i japin

atij mundesine për të verifikuar me perpikmeri llogaritjen e shitjes ose shërbimit të siguruar në një periudhë të caktuar.

Te gjitha shërbimet ndaj konsumatorit për hartimin dhe dorëzimin e faturave janë pa pagesë”.

Per sa me sipër, pjesa më e madhe e abonentëve shqiptarë, jo vetëm që nuk marrin ndonjëherë informacion për fakturën analitike (me elemente të tilla si lista e thirrjeve dhe kohegjatja e telefonatave) të printuar nga kjo kompani, e cila duhet ofruar në adresat e deklaruara prej tyre, por për më tepër nuk u ofrohet as faktura e përmbledhur me formën më të thjeshtë të detyrimit. Zyra jone, dhe me përpari, ishte investuar në bërjen të ditur të detyrimit të kompanisë ALBtelekom, për aplikimin e formës së fakturës, në zbatim të dispozitës së mesipërme, që duhet të kishte gjetur zbatim të plotë ligjor dhe pa pagesë nga ana e Albtelekom sh.a. që në vitin 2005, me qëllim ofrimin e saj, kundrejt abonentëve, pa një kërkesë paraprake. Kjo, pasi kishim qenë në dijeni të faktit se faktura analitike nuk i ofrohet ende konsumatorit, por i vihet në dispozicion atij, vetëm kur e kërkonte me anë të një procedure formale.

Nisur nga këto shqetesime, jo vetëm për mosplotësimin e shërbimeve nga shoqëria ALBtelekom sh.a, por dhe të së drejtës për informim të konsumatorëve tane, Zyra e Avokatit të Popullit gjykoi të nevojshme t'i parashtronte argumentet e mesipërme, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me anë të të cilëve kërkonim jo vetëm vëmendjen e tij si organ publik dhe kontrollues ndaj një shoqërie private në këtë fushë, por dhe imponimin e shtrengësive administrative ndaj mos plotësimit të detyrimeve nga kjo kompani kundrejt abonentëve të saj, në bazë të nenit 137 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Per sa me sipër, arsye ishte se Institucioni i Avokatit të Popullit kishte konstatuar në mënyrë të perseritur se kompania Albtelekom sh.a., pavaresisht statusit të ri si subjekt privat që gezonte, jo vetëm që nuk reflektonte ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, por vazhdonte të vepronte në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe në dëm të interesave ekonomike të konsumatorit. Në këto kushte, iu kërkuua Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të merrte masat e nevojshme qoftë edhe me vendimmarrje konkrete, që kjo gjendje paligjshmerie të merrte fund menjëherë, për të krijuar të gjitha kushtet në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit.

Si rezultat i këtyre përpjekjeve, nga ana e Shoqërisë ALBTELECOM sh.a. u bënë publike në media sipas legjisllacionit përkatës, tarifatat e miratuara nga Enti Rregullator të Telekomunikacionit, si dhe u përmirësua dorëzimi i faturave në banesat. Megjithatë, për këtë të fundit, zyra jone vijon të shprehë me rezervë, pasi dorëzimi i faturave, kohë pas kohe, paraqet probleme për konsumatorët, shoqëria në fjalë



ofron shërbime të shpërndara për klientin për printimin e faturave që nuk i kanë shkuar konsumatorit në banesë, si dhe faturat elektronike on line për informim të të interesuarve.

Legjislacioni aktual garanton mbrojtjen e konsumatorit si dhe përcaktimin e rregullave dhe ngritjen e institucioneve përkatëse për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Detyrat që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit, që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet konsumatorit Shqiptar dhe Kompanisë së Furnizimit me energji elektrike CEZ shpërndarja sh.a si dhe përcaktojnë detyrimet e kësaj të fundit për cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë garantohen dhe në legjislacionin mbështetës në këtë fushë, i cili ka qenë kryesisht Ligji Nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, Ligji Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, si dhe Kontrata Tip “Për furnizimin me energji elektrike për klientët familjarë”, të miratuar me Vendimin Nr. 40 datë 31.08.2005 nga Enti Rregullator i Energjisë.

Gjatë trajtimit të ankesave të shumta nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit është konstatuar se nga Ndërmarrja e CEZ Shpërndarja sh.a gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj për sigurimin ndaj klientit të një shërbimi sa më efikas dhe cilësor, nuk është parashikuar një procedurë transparente në trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve për pretendimet e tyre lidhur me mbifaturim e energjisë elektrike.

Gjatë shqyrtimit të rasteve u konstatua se ishte shkelur pika 6.4 (6.4.1, 6.4.2, 6.4.3) e kontratës së furnizimit me energji elektrike, ku përcaktohet se:

*6.4.1 Kur klienti dyshon në saktësinë e një matësi, ose kur ka vënë re pasaktësi në matës, ai ka të drejtë të paraqesë në ERE një ankesë ndaj furnizuesit (me shkrim, me gojë, me telefon ose në rrugë elektronike) në përputhje me Ligjin Nr. 9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, por kjo nuk përjashton të drejtën e klientit në çdo rast për paraqitjen e një ankesë kundrejt furnizuesit.*

6.4.2. Kur klienti i drejtohet furnizuesit për ankesën që ka lidhje me sasinë e energjisë elektrike të faturuar, ai paraqet kërkesë me shkrim në zyrat e furnizuesit, deri në pesë ditë përpara përfundimit të muajit të faturuar. Kur ankesa bëhet, pasi veprimet në faturën kanë kaluar në arkë ose në bankë, ajo zgjidhet pasi është kryer pagesa e saj, brenda 30 ditëve nga data e bërjes së ankesës.

6.4.3 Mënyra e zgjidhjes së ankesës bëhet sipas rregullave të aplikueshme nga furnizuesi, por që janë të bëra publike nga faturuesi në të gjithë pikat ku furnizuesi pranon pagesat e faturave të energjisë elektrike apo ku janë sportelet dhe zyrat e tij. Për sasinë e faturuar tepër

dhe që është paguar nga klienti, bëhet zbritja në vlerën e faturës së muajve pasardhës, deri në shlyerjen e plotë të vlerës.

Edhe pas ndërhyrjes së Institucionit të Avokatit të Popullit situata vazhdon të ngelet e njëjtë, duke mos ofruar asnjë zgjidhje për verifikimin e ankesave të këtyre qytetarëve nga ana e kompanisë CEZ Shpërndarja sh.a si dhe mosdhënien e shpjegimeve të argumentuara institucionit tonë lidhur me objektin e këtyre ankesave sipas neneve të përcaktuara në Kushtetutë e në Ligjin Nr. 8485 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Mekanizmat kryesore të perdorur nga zyra jone ne drejtim të trajtimit të problemeve të konstatuara ndërmjet paleve klient-furnizues, kane qenë kerkesat tona zyrtare, por dhe rekomandimet ne disa raste, për verifikimin e aparateve mates dhe ballafaqimit me klientin për sasine mujore të faturuar, mungesen e informimit zyrtar nepermjet procesverbalit ne rastet e konstatimit të sahatit të demtuar, mosdorezimit ne kohe të faturave mujore ne banesa, masat e ndryshme administrative të gjobvenies etj.

Per sa me siper, na duhet të veme ne dukje mungesen e theksuar të ketij operatori ne drejtim të një komunikimi dhe sqarimi të drejtperdrejte me klientin, dhe mosfunktionimin e zyres se ankesave të operatorit, pasi qytetaret qe janë drejtuar prane zyres tone kane pretenduar se ankesat e tyre, ne asnje rast, nuk merreshin seriozisht nga perfaqesuesit e shoqerise furnizuese. këto mangesi sillnin jo vetem mungesen e informimit të qytetareve për problemet konkrete, por perbenin shkelje e të te drejtave kontraktuale të klientit, sipas kushteve të percaktuara ne kontrate.

Nje aspekt tjeter ne këtë fushë ka perbere rasti i mbifaturimeve të vertetuara mujore nga ana e faturisteve të furnizuesit. Konkretisht, ankesa me **nr.201000651**, e trajtuar nga ana jone gjatë vitit 2010, pasi u vertetua se qytetari qe pretendonte mbifaturim abuziv, kishte pasur të drejtë, nga ana e OSSH-se zonale i`u ofrua mundesia e zbritjes se vleres se mbifaturuar ne muajt paasardhes.

Megjithese ky korrigjim ishte një mënyrë lehtesimi dhe drejtësie për klientin familjar ne këtë rast, nga ana jone theksohet se fenomeni i shpeshte i mbifaturimit vijon të mos gjeje zgjidhje vetem nepermjet ketij opsioni të ofruar nga furnizuesi.

Si rezultat i trajtimit dhe eksperiencës 10 vjecare pergjate punes tone për ankesat e ketij lloji, zyra e Avokatit të Popullit i vuri ne dukje entit publik rregullues ERE, ne seancen degjimore të zhvilluar prej tij ne daten 18.11.2010 “Per shqyrtimin e kerkesave të rritjes se cmimit të energjise elektrike nga operatoret perkates”, nevojen e hartimit të një kontrate të re juridike ndërmjet paleve, e cila do të ishte pergjegjese si për ndërgegjesimin e detyrimeve qe lindnin nga kjo marredhenie ndërmjet

paleve, por kryesisht për të drejtat e munguara dhe anashkaluara të konsumatoreve që jo pak here gjendeshin të detyruar të paguanin për faj të te treteve.

Si rezultat, u pergatit nga ana e ERE-s draft kontrata e re për këtë qellim, për të cilën zyra jone u ftua të ofroje verejtjet dhe sugjerimet perkatese. Këto të fundit u hartuan dhe u derguan pas një studimi të kujdesshem të ketij drafti nga ekspertet e zyres, si dhe duke u mbeshtetur ne trajtimet e ankesave të shumta që na drejtohen cdo vit për këtë problem.

Nje pershkrim me i detajuar mbi këto zhvillime dhe sugjerime të dhena nga zyra e Avokatit të Popullit, do të ofrohen ne raportin pasardhes, pasi verejtet tona pritet të shqyrtohen apo të debatohen ne seancen perkatese që do të zhvillohet nga ERE për këtë qellim.

Nje operator tjeter problematik, ne këtë aspekt, ka qenë dhe Ndermarja e Ujesjelles Kanalizimit, e cila shpesh është referuar se ka treguar mungese informimi të klienteve për sa u perket ardhjes se faturave ne banesa, mbifaturim abuziv nga ana e faturisteve dhe moskthim pergjigje nga operatori, etj.

Duke qenë se për këtë problem u paraqiten disa qytetare prane zyres tone, ne kerkuam që, duke marre parasysh gjendjen ekonomike të çdo familjari, të behej një marreveshje rast pas rasti dhe kjo sasi uji të mos paguhej brenda një muaji, sikunder u kerkohej, por me keste. Nga ana e strukturave të Ujesjellesit Tirane u pranua se për situaten e krijuar për faj të faturisteve, do ishte një zgjidhje ajo që qytetaret e interesuar të paraqiteshin prane Drejtorise perkatese me kerkese personale, për një marreveshje lidhur me ndarjen ne keste të shumes se faturuar, pa perdorur kamatvonesen për këtë gje.

Per sa me siper, zyra jone orientoi qytetaret që të paraqiteshin sa me pare personalisht prane Drejtorisë zonale të Ndermarrjes se Ujesjellesit, për të bërë një kerkese të tille me qellim evitimin e pagimit të te gjithë shumes ne një muaj të vetem.

Nje kontribut tjeter të rendesishem që zyra jone ka dhene ne kuader të mbrojtjes se të drejtës se konsumatorit ka qenë dhe studimi dhe verejtjet e parashtruara për hartimin e kontrates se re, ndërmjet Sherbimit të Ujesjelles Kanalizimit dhe konsumatorit. Disa nga këto sugjerime ishin:

- Percaktimi i një afati të shkurter 28-29-30 ditor për leximin dhe faturimin mujor të ujit ne drejtim të klienteve familjare.
- Percaktimi ne kontrate i mundesise se pageses me keste të faturave të prapambetura si debitore.
- Marrja dhe ofrimi me shkrim i vendimit të operatorit, kundrejt klientit, pas çdo ankese të parashtruar prej tij.

- Percaktimi i procedurave të sakta të rasteve të mbifaturimit të klientit dhe menyres së kompesimit nga operatori.
- Lehtësimi i procedurave të kompesimit të klientit, me qëllim evitimin e shqyrtimit të ankesave në rrugë gjyqësore.

Për sa më sipër, mund të themi se shumë nga sugjerimet u pranuan nga ana e Entit Rregullator të Ujit, dhe në takimin konsultues na u premtua se do të shikohej mundësia e pasqyrimeve të tyre në draftin final.

Një pasqyre më e detajuar e këtyre sugjerimeve gjendet në webside-in tone zyrtar, si dhe do të parashtrahet në raportin tone pasardhës, kur do të jete finalizuar dhe kontrata juridike ndërmjet paleve për ujin.

Gjatë shqyrtimit të rasteve të ndryshme vihet re se disa pika të rregullores “Për furnizimin me Ujë dhe për Kanalizime në zonën e Shërbimit të Ujës-Kanalizime sh.a” nuk janë zbatuar ose janë hasur vonesa në përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e këtyre ndërmarrjeve. Bazuar në rregulloren e sipërcituar, pjesa e dytë, pika 2.4 përcakton shprehimisht detyrimin e UK sh.a për ndërtimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe rinovimet e rrjetit lidhës. Pikërisht, mosveprimi në kohë i U.K sh.a për rehabilitimin e rrjetit të furnizimit me ujë, edhe pse dëmtimi i tij është shkaktuar pa faj të konsumatorëve, ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për zgjidhjen e problemit.

Problematika e prezantuar e lart, behet prezente në rastet e mëposhtme:

Ankesat me **nr.201001763** dhe **nr.201001775**, të dy shtetasve me banim në Tiranë, të cilët ankohen ndaj Ndërmarrjes CEZ Shpërndarja sh.a lidhur me mbifaturimin e sasisë së energjisë elektrike për muajin Nëntor. Për këto raste ankuesit pretendojnë se kanë ndjekur rrugën administrative të ankimimit, duke ju drejtuar zyrave të kujdesit ndaj klientit (me ankesa me shkrim) pranë Kompanisë CEZ Shpërndarja sh.a. dhe jo vetëm që nga ana e kësaj kompanie nuk është ndjekur ndonjë procedurë për verifikimin e ankesave të tyre, por nuk i është dhënë asnjë informacion i nevojshëm, duke tejkalluar kështu të gjitha afatet e përcaktuara sipas ligjit e akteve nënligjore, për trajtimin dhe verifikimin e ankesave të tyre.

Për këto çështje, në si institucioni proceduam me kërkesë për shpjegime, duke qënë se konstatoam se ishte shkelur e drejta e tyre, në respektimin e afateve për verifikimin e ankesave dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre si konsumatorë.

Për rastet e të dy këtyre shtetasve ende nuk është dhënë një zgjidhje ligjore për problematikën e paraqitur.

Ankesa me **nr.201001003** e paraqitur prane Institucionit të Avokatit të Popullit, pretendohet nga qytetari se faturimi i bërë ishte abuziv, kundërsht konsumit familjar për ujin, nga ana e Ndermarrjes së Ujesjellesit Tirane. Konkretisht sqarohet se atij i kishte ardhur një fature nga kjo ndërmarrje në shumën e 140 mijë lekëve, të cilat ai pretendonte se nuk mund t'i kishte konsumuar kurrë për një muaj, duke qenë se ishte pagues i rregullt i faturave për ujin.

Në këto kushte, zyra e Avokatit të Popullit kerkoi menjëherë sqarime nga autoritetet e Ndermarrjes së Ujesjelles Kanalizimeve Tirane, dhe konkretisht komunikoi me Drejtorin e Departamentit të Shitjeve. Nga ana e këtij të fundit u informuam se qytetari perkates kishte konsumuar sasinë e konstatuar realisht, por kjo situatë ishte krijuar për faj të faturistëve, të cilët nuk kishin faturuar muaj pas muaji sasinë konkrete të sahatit mates, por kishin faturuar me pak. Prandaj, kjo sasi uji e konstatuar se fundmi, i ishte faturuar në total klientit me çmimin e vjetër dhe jo me atë të ri që ishte dyfishi tashmë.

Ankesa me **nr.201001728**. Ankuesit, me cilësinë e përfaqësuesve të lagjes ku banonin, paraqitën një ankesë me objekt mosveprimin e “Ndermarrjes Ujesjellës Kanalizime” Durrës, për riparimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit të pijshëm. Me qëllim të shqyrtimit në një kohë sa më të shpejtë të pretendimeve të ankuesve, pra për të pasur efektivitetin në hetimin administrativ të ndërmarrë nga Avokati i Popullit, ekspertët e ngarkuar me shqyrtimin e ankesës, në prezencë edhe të banorëve të kësaj lagjeje, zhvilluan një takim me drejtorin e Ndermarrjes U.K. Durrës, për zgjidhjen sa më të shpejtë të kësaj çështje. Gjatë këtij takimi u bëmë me dije se tubacioni kryesor që furnizonte këtë zonë me ujë të pijshëm, kishte pësuar çarje, për riparimin e të cilit, funksionari në fjalë dha garanci të plota se do të sistemohej brenda një kohe shumë të shkurtër. Gjithashtu, nga interesimi i mëtejshëm lidhur me ecurinë e kësaj çështje, morëm informacion për fillimin e punimeve për riparimin e defektit, që në fakt konfirmoi dhe një herë angazhimin e shprehur gjatë takimit të sipërpërmendur të strukturave përgjegjëse për furnizim sistematik dhe pa ndërprerje me ujë të pijshëm.

### **13. E drejta për kujdes shëndetësor**

E drejta për trajtim të barabartë të individëve, në kuadër të kujdesit shëndetësor, është një nga të drejtat themelore të individit, e afirmuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Pikerisht në nenin 55 të Kushtetutës, thuhet se:

“Shtetasit gezojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

Kushdo ka të drejtë për sigurim shendetesor sipas procedurës të percaktuar me ligj”.

Kuadri ligjor, mbi bazën e të cilit Avokati i Popullit ka ushtruar veprimtarinë e tij në këtë fushë të drejtave të njeriut, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e saj, ka të bëjë me; Ligjin Nr.8092, datë 21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor”, Ligjin Nr.3766, datë 17.12.1963 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, Ligjin Nr.9888 datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Duke vlerësuar këtë të drejtë, si një tregues real dhe domethenës të një shteti social, si dhe element të rëndësishëm të së ashtuquajturës “Cilesi e jetes”, veprimtaria e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010 është fokusuar në vizita dhe kontrole tematike në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor, të shërbimit paresor të kujdesit shendetesor si dhe në spitale të burgjeve, në të gjithë vendin.

Inspektimet dhe vizitat e kryera në këto institucione, kanë patur një rol të madh në evidentimin e problematikave që ekzistojnë në këto institucione, lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse.

Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në evidentimin e gjendjes së respektimit dhe zbatimit të ligjit, i cili reflekton respektimin e të drejtave dhe lirive të individit në këto institucione, por dhe për vlerësimin e funksionimit të strukturës institucionale, të përshtatur me profesionalizëm, sipas standarteve të kërkuara konform ligjit, si dhe vlerësimin të kushteve infrastrukturore ekzistuese në ambientet e këtyre institucioneve.

Nga inspektimet e kryera si dhe nga rastet e trajtuara që lidhen me të drejtën për kujdesin shendetesor, është arritur në konkluzionin se, në përgjithësi, shërbimet shëndetësore dhe sociale që u ofrohen individëve në këto qendra kanë nevojë për më shumë fonde investimi, plotësim organik, shpejtësi në realizimin e projekteve, përqëndrim dhe vëmendje më të madhe në trajtimin human të të sëmurëve, si dhe në shtimin e projekteve të reja, që do të mundësonin një përmirësim të dukshëm të shumë zërave problematikë.

Avokati i Popullit vlerëson si të pamjaftueshëm angazhimin institucional, fondet e vëna në dispozicion dhe masat e marra për përmirësimin e situatës në shërbimet spitalore. Krahas kësaj, Ministria e Shëndetësisë është treguar shpesh inaktive për të lëvizur në kohë dhe për të informuar në çdo rast përmirësimet e kryera nga ana e saj për gjendjen.

Vihet re një bashkëpunim më i mirë dhe korrekt nga ana e Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për të

realizuar me shpejtësi propozimet për ndryshimin e gjendjes në disa institucione në varësi të saj.

### **Raste të evidentuara gjatë vizitave dhe inspektimeve dhe të trajtuara nga ana jone:**

1. Në Spitalin Psikiatrik Shkodër është konstatuar se godina aktuale është pjesërisht e amortizuar dhe nuk ishin marrë masa për kalimin e pacientëve të këtij spitali në ambientet e godinës së re, e cila ishte në përfundim të rikonstruksionit. Konstatohet se skema e sigurisë nuk krijonte siguri për personelin dhe pacientët, pasi familjarët lejoheshin të futeshin në ndërtesë në çdo kohë. Cilësia e detergjentëve sanitarë, si produkte të domosdoshme për një higjenë brenda standarteve të kërkuara në këto institucione, linte shumë për të dëshiruar.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me **nr.201001135**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar ;

Marrja e masave urgjente për kalimin e pacientëve të këtij spitali në ambientet e godinës së re që po ndërtohet, pasi godina aktuale është pjesërisht e amortizuar.

Rishikimi i skemës së sigurisë, pasi shpesh herë personeli dhe pacientët ndihen të pasigurt nga lejimi i familjarëve në çdo kohë.

Përmirësimin e cilësisë së detergjentëve sanitarë si produkte të domosdoshme për një higjenë brenda standarteve të kërkuara në këto institucione.

Ne pergjigje të rekomandimit tone, Drejtoria e Politikave të Planifikimit Shëndetësor pranë Ministrisë së Shëndetësisë është shprehur se gjendja aktuale e godinës së re është në fazën fillestare, ku për vitin 2010 është bërë lidhja e kontratës, kishin filluar punimet si dhe fondet ishin vënë në dispozicion. Ndërsa për vitin 2011 ishte planifikuar fondi prej 70.000.000 lekë të reja për përfundimin total të spitalit akut me 35 shtretër si dhe ishte planifikuar që kjo godinë të përfundonte në fund të vitit 2011, ku do të mund të bëhej dhe akomodimi i pacientëve që aktualisht ndodheshin në Shërbimin Psikiatrik Shkodër. Gjithashtu, konfirmohet se do të bëhej i mundur rishikimi i skemës së sigurisë, si dhe përmirësimi në cilësinë e detergjentëve sanitarë në mënyrë të vazhdueshme nga drejtoria përkatëse.

2. Në Spitalin Psikiatrik Tiranë është konstatuar se, nuk ka shërbim të veçantë me personel kujdestar dhe socialo-edukativ të profilizuar. Xhamat e dritareve në repartet e femrave dhe meshkujve nuk janë me rrjete mbrojtëse për pasojë kjo situatë përbën një rrezik për jetën e pacientëve dhe personelit. Dyert janë pothuajse jashtë funksionit, gjë e cila krijon një situatë të padëshiruar gjatë hyrjes ose daljes së pacientëve në pavione. Dhoma e rekreacionit të fëmijëve, e cila përdoret për

qetësimin dhe rehabilitimin e gjendjes së tyre të shëndetit mendor, është jashtë të gjitha standarteve të përcaktuara në ligj. Oborri i repartit të pacientëve kronik, i cili është favorizues për ajrosjen e tyre si dhe për kryerjen e aktivitete sociale-edukative, është i parikonstruktuar dhe pa asnjë pajisje për qëllimin që ka.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me **nr.201000624**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar ;

Krijimi i shërbimit të veçantë me personel kujdestar dhe socialo-edukativ të profilizuar, pasi personeli task-forcë nuk kishte si specifike këto funksione.

Marrja e masave për ndërrimin e xhamave të dritareve në repartet e femrave dhe meshkujve dhe zëvendësimi i tyre me xhama me rrjete mbrojtëse, pasi kjo përbënte rrezik për jetën e pacientëve dhe personelit. Gjithashtu, ndërrimi i dymëve, pasi mosfunksionimi i plotë i tyre mund të krijonte situata të padëshiruara gjatë hyrjes ose daljes së pacientëve në pavione.

Përmirësimi i kushteve në dhomën e rekreacionit të fëmijëve, pasi ky ambient përdorej për qetësimin dhe rehabilitimin e gjendjes së tyre të shëndetit mendor, si dhe mundësimi i mjeteve të duhura për shfrytëzimin e oborrit në repartin e pacientëve kronikë, pasi ky ambient ishte favorizues për ajrosjen e tyre dhe aktivitete sociale-edukative. Sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se është miratuar një plan masash për këtë spital ku janë përfshirë edhe masat e propozuara nga ana jonë, por deri më sot nuk është konfirmuar zyrtarisht një veprim i tillë.

**3.** Në Spitalin Psikiatrik Vlorë është konstatuar se nuk është bërë lëvrimi i fondeve për ndërtimin e godinës së re, pasi kushtet aktuale në godinën e vjetër, ku strehohet pjesa më e madhe e pacientëve të këtij spitali, janë jashtë standartit. Nuk është shtuar numri i mjekëve dhe personelit ndihmës në këtë institucion, për të ofruar një shërbim dhe përkujdesje ndaj pacientëve, sipas kërkesave të përcaktuara në ligj.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me **nr.201000687**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar ;

Lëvrimi i fondeve për ndërtimin e godinës së re; Shtimi i numrit të mjekëve dhe personelit ndihmës në këtë institucion; Sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se është në përfundim faza e kalimit të të gjitha aseteve spitalore në godinën e re të Spitalit Psikiatrik.

**4.** Në Qendrën Spitalore të Burgjeve është konstatuar prezenca e lagështirës në sektorin e meshkujve dhe femrave si dhe mungesa e mjeteve akomoduese nëpër dhoma. Nuk ka një dhomë të veçantë për rastet e diagnostikuara me probleme të shëndetit mendor me masa izolimi si dhe nuk ka një strehë në ambientet e ajrimit, për rastet e një



moti me shi apo kur ka temperatura të larta. Ambienti ekzistues, ku zhvillohen aktivitete edukativo-kulturor, është shumë i vogël në raport me numrin e të shtruarve dhe, numri i stafit kujdestar për këtë kategori, në raport me kërkesat që ka ky institucion, është i papërfillshëm. Nuk merren masa mbrojtëse për stafin mjekësor kundrejt rasteve me sëmundje infektive dhe raporti i infermierëve meshkuj me infermieret femra nuk është i ballancuar sipas rasteve që trajton kjo qendër për të dënuarit dhe të paraburgosurit me mjekim të detyruar.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me **nr.201000448**. Pas konstatimeve të bëra, nga ana jone është rekomanduar;

Rikonstruksioni sa më parë i dhomave për evitimin e lagështires në sektorit e meshkujve dhe femrave pasi prezenca e lagështires në këto ambiente përbën rrezik serioz për shëndetin e tyre. Krijimi i menjëhershëm i një dhomë të veçantë për rastet e diagnostikuara me probleme të shëndetit mendor me masa izolimi, pasi mungesa e një të tillë përbën problem serioz për stafin mjekësor i cili nuk disponon mjetet e duhura të shtrëngimit sipas standarteve të kërkuara. Kjo dhomë duhej të ishte e veshur sipas kriterëve mjekësore që dhe i dënuari ose i paraburgosuri të mos mund të dëmtonte vetveten. Vendosja e një strehe në ambientet e ajrimit me qëllim që koha e ajrimit të bëhet e plotë edhe në rastet kur bie shi apo kur janë temperatura të larta, pasi të dënuarit dhe të paraburgosurit janë nën trajtimin mjekësor dhe se ajrimi i tyre është i domosdoshëm për përmirësimin e gjendjes së tyre shëndetësore. Akomodimi i dhomave të kësaj qendre sipas standarteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj. Vendosja e tavolinave dhe komodinave në ato dhoma që nuk ka të tilla. Plotësimi i këtyre standarteve do të krijonte hapësira të përshtatëshme për ajrim. T’u vihej kapak koshave të plehrave në dhoma ose të vendosen kosha të rinj, pasi me afrimin e stinës së verës mbajtja e këtyre koshave në dhomë ndikonte në ndotjen e ambientit.

Zgjerimi i ambientit, ku zhvilloheshin aktivitete edukativo-kulturor, pasi ambienti ekzistues ishte shumë i vogël në raport me numrin e të shtruarve, si dhe shtimi i një kujdestari në organike, pasi në raport me shifrën aktuale 91 persona, me vetëm një kujdestar, ishte i pamjaftueshëm. Të merreshin masat mbrojtëse për stafin mjekësor, kundrejt rasteve me sëmundje infektive dhe të ballancohej raporti i infermierëve meshkuj me infermieret femra, pasi në këtë qendër kishte të dënuar dhe të paraburgosur me mjekim të detyruar dhe se infermierët meshkuj duhet të ishin më prezent në këto raste.

Lidhur me konstatimet e paraqitura më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresë, shprehet se po punohej për hartimin e projektit të preventivave përkatëse nga sektori i investimeve për;

- Krijimin e strehës tek sheshet e ajrimit
- Përmirësimin e ndriçimit natyral nëpër dhoma
- Veshjen e një ambienti të veçantë me elementë sigurie, për të sëmurët me rrezikshmëri.

Gjithashtu, kjo drejtori konfirmonte se u morën masat e menjëhershme për të siguruar këmishat e forcës dhe se u krye plotësimi me materiale gazermimi si (peshqira, çarçafe, këllef, dysheke, stola plastike, tavolina plastike, pandofla etj).

5. Në Spitalin Psikiatrik Elbasan është konstatuar se, kishte mbipopullim në raport me kapacitetin e shtrimit dhe se organika e stafit mjekesor, infermier dhe kujdestar, në raport me numrin e pacientëve të shtruar në këtë institucion, nuk ishte në përputhje me ligjin. Aktualisht, ky spital mban 70 pacientë, që i përkasin strehimit në Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor, dhe qëndrimi i tyre në këtë spital është në kundërshtim me ligjin “Për Shëndetin Mendor”. Pacientët e këtij spitali vuajnë ndjeshëm mungesën e veshmbathjeve si (këpucë, bizhame, trikotazhe, veshje dimërore etj) të drejta ligjore këto të parashikuara në nenin 7 të ligjit Nr.8092 dt.21.03.1996, “Për Shëndetin Mendor”, dhe se tenderimi për plotësimin dhe realizimin e nevojave për pacientët nuk është kryer prej 2 vjetësh. Nuk ishte kryer hidroizolimi i tarracës së këtij spitali për evitimin e lagështirës nëpër pavione, si dhe sistemi i ngrohjes ishte i amortizuar dhe jofunksional, në të gjitha ambientet e këtij institucioni. Në të njëjtën gjendje ndodhej edhe rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm. Në lavanterinë e këtij spitali u konstatua se kishte mungesa të pajisjeve larës e profesional dhe se guzhina e këtij spitali nuk kishte sistem aspirator. Shërbimi dentar nuk ushtronte mjekime dhe trajtime stomatologjike, por vazhdonte të ushtronte vetëm “*extripime*”.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me **nr.201001772**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar;

Marrja e masave urgjente për plotësimin dhe shtimin e mjekëve në organikën e Spitalit Psikiatrik Elbasan, si dhe shtimi me personel kujdestar dhe socialo-edukativ në shërbimin e veçantë, si specifik për këto funksione.

Marrja e masave urgjente për paisjen sa më parë të pacientëve të këtij spitali me të gjitha paisjet e munguara (veshmbathje dhe hoteleri), si dhe përfundimi sa më parë i procedimit të tenderimit për plotësimin dhe realizimin e nevojave të pacientëve si e drejtë e mohuar prej 2 vjetësh.

Kryerja e hidroizolimit të tarracës së këtij spitali për evitimin e lagështirës nëpër pavione, si dhe marrja e masave urgjente për rikonstrukcionin e sistemit të ngrohjes për të gjitha ambientet e këtij institucioni. Përmirësimi i kushteve të rrjetit të furnizimit me ujë të

pijshëm, përshtatja e tij sipas nevojave të paisjeve në lavanteri, guzhinë etj.

6. Në Spitalin Infektiv pranë QSUT-së është konstatuar se me ndarjen e reparteve (reumatologji dhe alergologji), kapaciteti i shtrimit në këtë spital është i pamjaftueshëm dhe forma e shtrimit të pacientëve nuk është respektuar sipas diagnozave mjekësore nëpër dhoma të kategorizuara për rastet e sëmundjeve infektive, me pasojë rikontaminimin e pacientëve të tjerë. Gjendja e ashensorit të këtij spitali ishte jofunksionale dhe dhomat e pavionit 2 kishin nevojë për ndrimin e shtrojeve dhe shtretërve, pasi këto paisje ishin tepër të vjetëruara dhe jashtë standartit. Në pavionin 1 dhe në 6 dhomat, për raste epidemish masive dhe, kryesisht, në ambientin e magazinës së medikamenteve dhe materialeve profesionale, ka prezencë të lagështirës.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ana jone me **nr.201000773**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar ;

Marrja e masave urgjente për transferimin e dy reparteve që ndodhen në të njëjtën godinë (reumatologjia dhe alergologjisë), për zgjerimin e spitalit infektiv, pasi kapaciteti aktual i shtrimit në të 3 pavionet ishte i pamjaftueshëm dhe me afrimin e stinës së verës, ky spital mund të përballej me situata të padëshiruara, si rrjedhojë e pamjaftueshmërisë së kapacitetit të shtrimit.

Respektimin e formës së shtrimit të pacientëve me sëmundje infektive të përcaktuar, nëpër dhoma të kategorizuara në bazë të diagnozave mjekësore, për të evituar çdo lloj risku në rikontaminimin e tyre përgjatë rehabilitimit në këtë spital, si dhe evitimin e shtrimit të pacientëve nga 3 persona në dhoma me hapësirë të pamjaftueshme për këtë shifër. Rivendosjen në gjendje funksionale të ashensorit të këtij spitali, pasi shfrytëzimi i tij është i një rëndësie të dyfishtë për raportin pacient-personel, kundrejt nevojave të përditshme dhe lehtësimin e situatave emergjente në këtë institucion. Përmirësimin e kushteve në dhomat e pavionit 2, kryesisht zëvendësimi i shtretërve dhe i shtrojeve, si dhe mundësimi i pajisjeve të reja, të kërkuara sipas standartit për infermierit e çdo pavioni. Eliminimi sa më parë i lagështirës në pavionin 1, pasi ky pavion është në funksion të plotë për pacientët e rehabilituar, si dhe eliminim e lagështirës në 6 dhomat e krijuara për raste epidemish masive dhe kryesisht në ambientin e magazinës së medikamenteve dhe materialeve profesionale. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se po vijon puna për kalimin e pavionëve në dy ambiente të tjera dhe po përmirësohen kushtet në shërbimet ekzistuese.

7. Një nga çështjet e filluara me inisiativë, ka qenë edhe inspektimi i kryer ne Repartin Infektiv të Spitalit Ushtarak (**nr.201000860**). Objekti i këtij inspektimi ka qenë verifikimi i kushteve, ne të cilat sigurohet kujdesi

shendetesor për pacientet, bazuar në percaktimet e dhëna në ligjin Nr.3766, datë 17.12.1963 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone, është rekomanduar;

Mbështetja financiare e punonjësve të stafit mjekësor, të cilët punojnë në repartin infektiv (mjek dhe infermier) dhe konkretisht, dhënia e shtesës për kushte pune të diferencuar nga kategoritë e tjera, si dhe pagesa e shtesës financiare për masterat dhe doktoraturat e mjekëve.

Për sa më sipër, Ministria e Mbrojtjes, lidhur me dhënien e shtesës financiare për kushte pune të diferencuar të stafit mjekësor në Repartin Infektiv të Spitalit Qëndror Ushtarak në Tiranë, është shprehur se, pagesat për shtesën financiare për masterat dhe doktoraturat e mjekëve janë bërë me vonesë për mungesë të fondeve.

#### 14. Synimi për një mjedis të shëndetshëm

Istitucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar ankesa të paraqitura ndaj organeve të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, kryesisht që kanë lidhje me ndotjen apo vibrimet akustike, në dëmtim të cilësisë së jetës.

Në shumë raste të trajtura përgjatë veprimtarisë së Avokatit të Popullit, me iniciativë por dhe nga ankesa të paraqitura nga individë, të cilat gjatë vitit 2010 kanë qenë 8 të tilla, vihet re një tendencë në rritje sa i përket ndotjes së mjedisit në qendra të mëdha urbane nëpërmjet ndotjes akustike, shkaktuar nga subjekte shërbimi përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre. Paraqitja e ankesave ka qenë e shpeshtë edhe për shkak të kapaciteteve të limituar në personel dhe teknikë të Agjencive Rajonale të Mjedisit (A.R.M.) në qarqe, të cilat sidomos në qendra të mëdha urbane, nuk arrijnë të monitorojnë plotësisht tejkalimin e nivelit të zhurmave të lejuara nga mijëra subjekte shërbimi. Gjithsesi, duke e konsideruar këtë ndërhyrje të Avokatit të Popullit edhe si një ndërmjetësim midis qytetarit dhe organit të administratës publike të ngarkuar për zgjidhjen e çështjeve të kësaj natyre, kemi zhvilluar takime direkte, apo biseda telefonike me drejtues të A.R.M.-ve në qarqe, me qëllim vënien në vëmendje të çështjeve të paraqitura, e sigurisht ndërhyrjes ligjore nëse ka vend për një të tillë. Ndjekja e kësaj procedure, pra ndërmjetësuese, është realizuar për faktin se shumë qytetarë, në padijeni të ekzistencës apo kompetencave të këtij organi shpesh herë i drejtohen institucioneve që nuk kanë kompetencë të trajtojnë çështje të kësaj natyre.

Problematika e prezantuar behet prezente me ankesat e meposhtme:

Në ankesën me **nr.201000707**, ankuesi me cilësinë e përfaqësuesit të banorëve të pallatit ku banon, paraqiti ankesë me objekt mosveprim i

Agjencisë Rajonale të Mjedisit të qarkut, sa i përket ndotjes akustike shkaktuar nga një subjekt shërbimi në katin e parë.

Në kërkesën e paraqitur jemi drejtuar me një kërkesë për shpjegime Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, ku kërkohej të na përcillej një informacion i hollësishëm, në lidhje me veprimet e ndërmarra për normalizimin e situatës së rëndë shkaktuar nga ushtrimi i aktivitetit të këtij lokali në këtë zonë. Në përgjigjen e dhënë nga drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit, sqarohemi se mbi bazën e indiceve të përcjella zyrtarisht nga Avokati i Popullit, është ushtruar kontroll në subjektin e shërbimit objekt i ankesës, ku dhe inspektorët e këtij organi kanë konstatuar zhurmë jashtë normës së lejuar, duke lëshuar akt kontrolli në të cilën i është lënë detyrë subjektit të kontrolluar të pezullojë aktivitetin pas orës 23 oo dhe të kryejë matjen e nivelit të zhurmave.

Një ankese tjetër është depozituar ne institucionin tone nga Bashkia Poliçan, lidhur me pretendimin për domodoshmerine e ngritjes se strukturave Mbrojtjes Ndaj Zjarrit dhe Shendetit (MNZSH), e cila ka të beje me mbrojtjen e nevojshme të jetes dhe pasurise se qytetareve nga zjarri, për arsye të largesise se ketij qyteti nga qytetet e tjera dhe sidomos të ndihmes qe duhet dhene nga kjo strukture ne raste nevojje për Kombinatin Mekanik Poliçan ( ku çmontohen municione).

Për të ngritur këtë strukture, krahas investimeve të cilat janë të kufizuar dhe qe i ka bërë vete Bashkia, është kerkuar mbeshtetje me ndihme financiare nga Ministria e Brendshme, të cilat kane të bëjnë me mjetet teknike, financiare dhe trajtimin e vazhdueshem të personelit etj.

Lidhur me këtë ankese të rëndësishme, institucioni yne i është drejtuar Ministrise se Brendshme, e cila është treguar e gatshme për të ndihmuar Bashkinë Poliçan, duke i kerkuar dokumentacionin perkates të ketij sherbimi për t'i dhene udhezimet perkatese për personelin si dhe dergimin e mjeteve teknike.

Ne këtë ankese është shprehur edhe shqetesimi i Bashkise, lidhur me problemet për mbrojtjen e mjedisit të qytetit nga ndotja qe behet nga Kombinati Mekanik i Poliçanit, meqenese atje çmontohen municione. Perveç aneve pozitive ne uljen e shifrave të papunesise dhe ndikimit ne ngritjen e nivelit social-ekonomik, zyra jone i ka kerkuar Ministrise se Mbrojtjes permiresimin e teknologjise, për arsye të tymit qe del nga oxhaku i ketij kombinati, i cili shkakton prishjen e ajrit të mjedisit, duke ndikuar ne gjendjen shendetesore të qytetareve. Ne pergjigjen derguar institucionit tone, Ministria e Mbrojtjes ka sqaruar, se kane filluar të merren të gjitha masat e menjehershme për zhdukjen e pasojave të lartpermendura.

## 15. Çështje të mirëadministrimit

Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian e shpallur në samitin e Nises, në Dhjetor 2000, përmbledh të drejta të tilla themelore të qytetarise, si e drejta për administrim të mire dhe e drejta për t'u ankuar tek Ombudsmeni Europian ndaj keqadministrimit. Kemi të bëjmë me keqadministrim, kur një organ publik nuk vepron në përputhje me rregullin apo parimin, i cili është i detyrueshem për te. Ky perkufizim është aprovuar edhe nga Parlamenti Europian.

Pavaresisht se sa i detyrueshem është ky akt me parashikimet e tij, aktualisht në vendin tonë, në një të ardhme të afert secili prej nesh do të ballafaqohet me standarte të tilla, të cilët kushtezojnë veprimtarine e organeve të administratës publike dhe të treteve që veprojnë për llogari të saj. Megjithatë, mund të themi se këto parime janë tashme dhe të sanksionuara në legjislacionin tonë nepermjet dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, dhe në njëfarë mënyrë në këtë analize kemi bërë një grupim të tyre, duke i konceptuar si rregulla të cilët garantojnë mirëadministrimin.

Gjatë shqyrtimit të ankesave që janë depozituar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, kemi konstatuar se, jo pak prej tyre kanë patur të bëjnë me shkelje të elementëve të ndryshëm që garantojnë parimin e mirëadministrimit, me qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, me ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimin e detyrave, realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, të shpejta, etj. Konkretisht vetëm numri i ankesave që ka të bëjë me zvarritjen e procedurave administrative nga ana e organeve perkatese të administratës publike, rezulton të jete rreth 119.

Duhet kuptuar se ky numer nuk perfaqeson numrin total të të gjithë çështjeve që janë shqyrtuar nga ana e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010 në lidhje me shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative gjatë ushtrimit të veprimtarise së organeve të administrates publike. Megjithatë ky numer jep një evidence reale të faktit se, e drejta për mirëadministrim ka marrë një karakter sensitiv.

### *a. E drejta për informim gjatë procedimit administrativ*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 23 parashikon se: “E drejta e informimit është e garantuar”.

Kodi i Procedurave Administrative, parashikon të drejtën e informimit si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike. Ai bën një rregullim specifik të së drejtës për informim, duke filluar nga neni 20 i tij ku behet fjale shprehimisht për të drejtën për

informim si një parim baze i funksionimit të administratës publike, e duke vazhduar me nenet 51-55, duke ia njohur këtë të drejtë subjekteve që janë palë në një procedim administrativ, ose atyre që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me këtë proces.

Në parim, të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.

Mosrespektimi i dispozitave ligjore të sipërpërmendura, përkundër kërkesave të paraqitura nga individë, sigurisht me pasojë shkeljen e së drejtës kushtetuese të shtetasve për informim, tashmë përbën një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë së Avokatit të Popullit.

Lidhur me rregullimin që i bën Kodi i Procedurave Administrative të drejtës për informim, nga çështjet e marra në shqyrtim rezulton se nga ana e Administratës Publike nuk respektohet dhe nuk zbatohet e drejta për informim gjatë zhvillimit të një procedimi administrativ, ndaj atyre subjekteve të së drejtës administrative që kanë një interes të drejtëpërdrejtë ose të ligjshëm në këtë procedim.

Problem shqetësues vijon të jetë mosrespektimi i së drejtës për informim të shtetasve, palë në procedimin administrativ në zhvillim e sipër.

Një problematikë e tillë është konstatuar në tre drejtime.

*-Shkelje e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ nga A.L.U.I.Z.N.I. në qarqe.*

Një pjesë e konsiderueshme shtetasish kërkojnë të informohen zyrtarisht, për ecurinë e procedurës së legalizimit të objekteve të ndërtuara prej tyre pa leje ndërtimi, por që kanë paraqitur brenda afateve ligjore formularin e vetëdeklarimit. Duke pasur parasysh që është një proces në përfundim e sipër, të shqetësuar nga p.sh. mospublikimi i emrave në listat e subjekteve prona e të cilave po legalizohet, e më tej, pasi nuk kanë marrë përgjigje për kërkesën e paraqitur, i drejtohen Avokatit të Popullit. Sigurisht kjo situatë, për rastet që na janë prezantuar, është krijuar për shkak të mosadministrimit si duhet të këtij organi, nëpërmjet mosrespektimit të së drejtës për informim, për çështje kaq sensibil siç është prona private, duke sjellë mungesë transparence gjatë veprimtarisë së tij në përmbushje të misionit funksional, me pasojën e pashmangshme të paragjykitimit të palës së interesuar për drejtësi në vendimarrje.

*-Shkelje e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ nga A.K.K.P. Tiranë.*

Ndryshimet e fundit të ligjit për kthimin dhe kompesimin e pronave, kanë bërë që një masë e gjerë shtetasish, të mos kene asnjë informacion për ecurinë e procedimit administrativ të kthimit dhe

kompesimit të pronës në favor të tyre. Në fakt, si dhe në organe të tjera, arsyetja e paraqitjes së kërkesave për informim në lidhje me ecurinë e procedimit administrativ, vjen si rrjedhojë e mosrespektimit të afateve ligjore për përfundimin e këtyre procedurave, të cilat ashtu dhe siç jemi shprehur më lart, përbëjnë një numër të konsiderueshëm.

Në këto kushte, përveçse mohimit të së drejtës për informim, kërkuesi përballet me mungesë të plotë të transparencës së veprimtarisë së këtij organi të administratës publike, e ç'është më e rëndësishmja mosrespektim evident të afateve ligjore për përfundim të procedurës administrative në dhënien e vendimit përkatës, dukuri të cilat gjithmonë e më shumë në tërësinë e tyre faktojnë mosadministrimin si duhet në funksion të përmbushjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore të shtetasve.

*-Shkelje e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ nga I.N.U. vendor apo kombëtar, në funksion të mungesës së transparencës.*

Në fakt, shkelja e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ zhvilluar nga ky organ, në kuptimin klasik përgjithësisht konstatohet në bashki apo komuna të vogla, ku subjekti i konsideruar si kundravajtës nuk vihet në dijeni paraprakisht për fillimin e procedurës administrative të parashikuar, por vetëm gjatë ekzekutimit të vendimit për prishje, duke mos i mundur ndjekjen e rrugës së apelimit ndaj aktit administrativ në gjykatë.

Në një vështrim të përgjithshëm, sa i përket tre pikave të trajtuara më sipër, mund të konkludohet se kërkesa për ushtrimin e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ, është një pasojë logjike e mosrespektimit të afateve ligjore gjatë procedimit administrativ. Akumulimi i të tilla kërkesave sjell pashmangshmërisht mungesë transparencë dhe vështirësi në menaxhimin e veprimtarisë institucionale, trajtim me dy standarte të çështjeve konkrete, paragjykim të palës së interesuar për drejtësi në vendimarrje, e përfundimisht, duke krijuar një situatë keqadministrimi me pasojë shkeljen e një sërë të drejtave kushtetuese ndaj shtetasve.

Ka mjaft raste të tjerë, kur shtetas të ndryshëm, palë në procedurat administrative, të zhvilluara nga organe të ndryshme, kërkojnë të informohen për ecurinë e procedurës, në ushtrim të së drejtës për informim, por dhe të drejtës për transparencë në veprimtarinë e organeve publike.

**Problematika e prezantuar me lart paraqitet nepemjet këtyre rasteve:**

Ankesa e rregjistruar me **nr.201001281**, ku ankuesi parashtronte shqetësimin e tij, ndaj ALUIZNI-it të Qarkut Tiranë, për shkelje të së



drejtës për informim, përkundër kërkesës së paraqitur prej tij pranë këtij organi. Me qëllim të shqyrtimit në një kohë sa më të shpejtë të pretendimeve të parashtruara, si dhe për të pasur efektivitet në hetimin administrativ të ndërmarrë nga Avokati i Popullit, eksperti i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës është paraqitur pranë ALUIZNI-it të Qarkut, ku edhe ka marrë e më tej përcjellë tek ankuesi informacionin e kërkuar nëpërmjet ankesës së paraqitur.

Disa ankues kane patur pretendime lidhur me informimin gjatë një procesi administrativ. Permendim ketu ankesa lidhur botimin e teksteve të Universitetit të AEFS “Vojo Kushi”, për t’u njohur dhe informuar lidhur me botimin e ketyre teksteve, ne të cilat ankuesi ka qenë bashkeautor. Shkreses tone i është kthyer një pergjigje, se ky dokumentacion i perket një periudhe qe drejtohej nga një staf tjetër dhe për këtë qëllim është riperseritur urdheri dhe zyres tone i janë vene ne dispozicion dokumentet perkatese. Ky informacion i është bërë i ditur pales se interesuar, duke permbushur keshtu kerkesen për marrjen e informacionit të kerkuar.

Në ankesën e regjistruar me nr.201001281, ankuesi parashtronte shqetësimin e tij, ndaj ALUIZNI-it të Qarkut Tiranë, për shkelje të së drejtës për informim, përkundër kërkesës së paraqitur prej tij pranë këtij organi.

Me qëllim të shqyrtimit në një kohë sa më të shpejtë të pretendimeve të parashtruara, si dhe për të pasur efektivitet në hetimin administrativ të ndërmarrë nga ana jone, eksperti i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës është paraqitur pranë ALUIZNI-it të Qarkut, ku edhe ka marrë e më tej përcjellë tek ankuesi informacionin e kërkuar nëpërmjet ankesës së paraqitur.

### **Përmirësim i legjislacionit që garanton të drejtën për informim gjatë procedimit administrativ**

Në lidhje sa me siper kemi pasur si indicie shumë ankesa të shqyrtuara nga Avokati i Popullit, ku nëpërmjet përgjigjeve zyrtare të I.N.U.V.-ve në Bashki të ndryshme të vendit, ka rezultuar mundësia për të shmangur marrjen e më tej ekzekutimin e vendimeve për prishje, të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi tashmë të përfunduara.

Në këto kushte, Avokati i Popullit, referuar nenit 24/a, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ka ushtruar të drejtën për ndryshime legjislative në nenin 12, të Ligjit nr. 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” si dhe në nenin 1, pika “2”, të Ligjit nr. 10240 dt.25.02.2010, “Për disa shtesa në Ligjin nr. 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”.

Nga përmbajtja e të dy dispozitave ligjore, në rastin e ushtrimit të kontrolleve për zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit apo

urbanistikës, ligji i jep diskrecion organit të inspektoriatit ndërtimor e urbanistik, që të veprojë vetëm në rastet kur punimet për ndërtimin e objektit, eventualisht pa leje ndërtimi, janë në vijim.

Në fakt, rekomandimi i Avokatit të Popullit ka si qëllim kryesor mbrojtjen e të drejtave të shtetasve, të cilët për arsye të ndryshme kërkojnë ndërhyrjen e organeve të administratës publike, në ushtrim të përgjegjësive ligjore mbi objekte të përfunduara pa leje ndërtimi, të cilat shkaktojnë cenim të të drejtave themelore të njeriut.

Në lidhje me opinionet apo me idetë e krijuara për përmirësim të legjislacionit në fuqi, një problem tjetër shqetësues i vërejtur gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve të paraqitura pranë institucionit, vazhdon të jetë afati i parashikuar në neni 13 të Ligjit nr. 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”. Në këtë dispozitë parashikohet shprehimisht se afati për zbatimin e vendimit të I.N.U.V.-ve apo Kombëtar, maksimalisht është deri 60 ditë. Pra realisht ndërhyrja mund të realizohet që të nesërmen e marrjes së vendimit për prishje, duke mos i lënë kohën e nevojshme shtetasit, të ushtrojë të drejtën e tij të ankimimit në rrugë administrative apo gjyqësore. Gjithashtu kjo dispozitë shkel të drejtën e individit për një proces të rregullt ligjor të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, që në fakt kërkon nga Avokati i Popullit ushtrimin e së drejtës për ndryshime legjislative, sigurisht në funksion të parandalimit të shkeljes të drejtave të njeriut.

#### **- Respektimi i afateve ligjore. Mosveprime të organit të administratës publike apo të treteve qe veprojnë për llogari të tyre**

Mosrespektimi i afateve ligjore, si në trajtimin e ankesave apo kërkesave të personave fizikë dhe juridikë privatë nga organet e administratës publike, ka qenë dhe mbetet një problem mjaft i mprehtë. I njëjti konstatim qëndron edhe në bashkëpunimin e Institucionit të Avokatit të Popullit; kërkesat për shpjegime, sqarime apo rekomandimet e bëra, në raste të rralla qëllon që na dërgohen brënda afateve ligjore.

Në marrëdhënie me Avokatin e Popullit, për vitin 2010, konstatohet se Zyrat e Përmbartimit nuk kanë dhënë informacion dhe shpjegime brenda afateve të kërkuara si dhe nuk kanë lëshuar kopjet e akteve për veprimet proceduriale përmbartimore të kryera. Po kështu ka rezultuar shkelje e kesaj të drejtë nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Tirane. Gjatë trajtimit të problematikes, organi i administratës publike, në disa raste ka shkelur këtë të drejtë, duke mos i dhene pergjigje ne kohe personave për të proceduar me tej.

Gjatë shqyrtimit të ankesave që janë derguar pranë institucionit tonë kemi konstatuar se jo pak prej tyre kanë patur të bëjnë me shkelje të elementëve të ndryshëm që garantojnë parimin e mirëadministrimit, me

qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, me ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave, realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, të shpejta, etj.

### **Me poshte po paraqesim disa nga ankesat e trajtuara:**

Ankesa me **nr.201000076**, me të cilën qytetari, banues në Shkodër, kërkon ndërhyrjen institucionale të A.P. *për zvarritje për më tepër se 3 muaj* në ritrajtimin e dy vendimeve të dt.27.05.2009 nga ish-ZRKKP-ja e Qarkut Shkodër, pas shfuqizimit dhe dërgimin për rishqyrtim nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së Tiranë.

Sipas Nenit 20 të Ligjit nr.10207, dt.23.12.2009 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.9235, dt.29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës" veprimtaria e Zyrave Rajonale të AKKP-së në qarqe, përfundonte 15 ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit, që i korrespondonte datës 22.02.2010. Rasti i sipërpermëndur nuk është trajtuar nga ish-AKKP-ja Shkodër brënda këtij afati, duke iu shmangur detyrimit për të dhenë një vendim.

Ankesa me **nr.200900569** i takon një ankuesi nga Korça që kërkonte ndërhyrje institucionale pranë ZVRPP-së së rrethit, pasi nuk po merrte përgjigje për kërkesën për fshirje të mbivendosjes në regjistrat përkatës. Kërkesat tona të përsëritura dhe rekomandimi i dt.22.10.2010 ndaj Zyrës Vendore dhe asaj Qëndrore në Tiranë, morën përgjigje me shkresën e datës 01.06.2010, pak ditë pasi vendimi nr.17, dt.23.04.2010 i Gjykatës Kushtetuese, i cili shfuqizoi si të papajtueshëm me Kushtetutën paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 10 dhe paragrafin e dytë të nenit 39/a të Ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të shtuar me ligjin nr. 9701, datë 2.07.2007 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" si dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.4, datë 21.11.2007 "Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre, që krijojnë mbivendosje, në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme", u botua në Fletore Zyrtare.

Qëndrimi i mbajtur, shmangia nga trajtimi i kërkesës dhe mosnjoftimi i ankuesit prej mëse 6 muaj, në kushtet kur Gjykata Kushtetuese nuk kishte marrë vendim pezullimi për normat ligjore, për të cilat Avokati i Popullit kishte kërkuar shpalljen e tyre si antikushtetues, nuk tregon impenjim dhe seriozitet nga organi administrativ.

Ankesa **nr.201000919**, e një qytetari nga Tirana, është trajtuar në të njëjtën mënyrë si më lart, por kësaj rradhe nga AKKP-ja Qëndrore. Shqyrtimi i ankimit administrativ, për ndryshimin e pjesshëm të një

vendimi të ish-KKKP-së të Bashkisë Tiranë nga Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, u zvarrit, në kushtet e mospezullimit nga Gjykata Kushtetuese, të neneve 15 dhe 16 të Ligjit nr.9235, dt. 29.07 2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, deri në dhënien e vendimit perfundimtar nr.27, datë 26.05.2010 dhe botimit të tij në Fletorten Zyrtare.

Ankesa me **nr.201001800**, ku konstatohet se, Z.V.RR.P.P. Gjirokastrë, pa asnjë shkak të ligjshëm ka cënuar të drejtën e pronësisë së shtetasit V. K. mbi një pasuri të paluajtshme (truall 1490m<sup>2</sup> ) të ndodhur në Fshatin Vanistër, Gjirokastrë, e rregjistruar në pronësi të tij me datë 26.03.2001 të rregjistrimit hipotekor, pas hedhjes së pasurisë në sistem.

Në kushtet kur Regjistruesi i Z.V.RR.P.P., Gjirokastrë, mori Vendimin ne datën 09.10.2009, për fshirjen e rregjistrimit të kundërligjshëm, Kryeregjistruesi me Vendimin nr. 85, datë 23.04.2010 ka vendosur për miratimin e vendimit ne date 09.10.2009 të Regjistruesit të Z.V.RR.P.P., Gjirokastrë.

Në trajtimin e rasteve me **nr.200900487** dhe **nr.200900414** konstatohet se, Ish-Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Tiranë, apo sot Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Tiranë, nuk kanë përmbushur dhe nuk përmbushin detyrimin ligjor të nxjerrjes së aktit administrativ, lidhur me kërkesën e kryer prej dy familjeve për njohjen dhe kthimin e pasurisë së paluajtshme. Për këtë rast, konstatohet se, jo vetëm jashtë afatit ligjor por dhe jashtë çdo afati të arsyeshëm subjektet e mësipërme nuk kanë kryer shqyrtimin e kërkesave të dy familjeve, kryer prej tyre respektivisht në vitin 1996, 2006. I është rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të A.K.K.P., Tiranë, fillimi i procesit disiplinor si dhe marrja e masave të menjëhershme për shqyrtimin dhe dhënien e vendimeve lidhur me kërkesat për njohjen dhe kthimin e pasurisë së paluajtshme të dy familjeve. Megjithëse kanë kaluar më shumë se 9 muaj nga koha e kryerjes së rekomandimeve, ende nuk është përfunduar procedimi administrativ prej Agjensisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Tiranë.

Ankesa me **nr.201000966** ben fjale për një shtetas nga qyteti i Shkodres, i cili ankohej për zvarritje të shqyrtimit të kerkeses se tij nga Ministria e Drejtësisë për të perfituar demshperblim si ish i denuar politik. Për bllokimin e dhenies të demshperblimit kishte bërë disa here kerkesë, por nga ana e atij Institucioni nuk kishte marre pergjigje zyrtare.

Pas ndërhyrjes sone, me kerkesë për shpjegime, morem informacionin e kerkuar dhe i kthjem pergjigje ankuesit, duke e njoftuar se nga ana e Institucionit perkates i ishte njohur e drejta për të perfituar demshperblimin financiar.

Ankesa me nr.201000909, ben fjale për mosmarrje të pergjigjes nga Komisioni Qendror i Ankimit pranë ISSH-së për kerkesen ankimore të bërë nga një shtetas me banim ne Durres. Kishin kaluar mbi tre muaj nga paraqitja e kerkeses se tij dhe nuk kishte asnje pergjigje.

Proceduam me kerkesë për shpjegime ne Komisionin Qendror të Ankimit prane Institutit të Sigurimeve Shoqerore dhe ne pergjigje të kerkeses sone na informuan se kerkesa e ankuesit ishte shqyrtuar dhe dhene vendimi perkates brenda afateve të percaktuar ne Kodin e Procedures Administrative, duke na derguar një kopje të atij vendimi.

Por shkelja e kesaj të drejte ishte bërë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore ne Durres, pasi njoftimi mbi perfundimin e procedimit të aktit administrativ jepet nga Drejtorite Rajonale të Sigurimeve Shoqerore, atje ku dhe depozitohet kerkesa ankimore për vendimin e dhene nga Komisioni i Ankimit të asaj drejtorie.

Per të gjitha rastet e konstatuara nga ana jone është marre takim me personat pergjegjes dhe nga ana e tyre na është thene qe vonesat e kthimit të pergjigjeve qytetareve vijne nga transferimet e dosjeve nga një Institucion ne tjetrin.

*Konstatohen zvarritje për një kohe të gjatë në shqyrtimin nga ana e Komisionit Qëndror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut, të kërkesave të individëve për dhënien e statusit të Dëshmorit të Atdheut.*

Nga viti në vit pranë stafit teknik të Komisionit ishin grumbulluar gjithsej 491 dosje me kërkesa për dhënien e Statusit të Dëshmorit të Atdheut, të cilat prisnin mbledhjen e Komisionit përkatës për të shqyrtuar kërkesat, por ende edhe sot një pjesë e mirë e këtyre ankesave kanë ngelur pa u shqyrtuar nga Komisioni.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 31.01.2007, caktonte afatin prej 45 ditësh për shqyrtimin në kohë të kërkesave të shtetasve shqiptar për shpalljen dëshmor të të afërmëve të tyre, të rënë gjatë luftës apo në krye të detyrës. Për mosfunksionimin e Komisionit Qëndror të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut, Zyra jonë i dërgoi Zv/Kryeministrit, Z.Gazmend Oketa, si kryetar i këtij Komisioni, rekomandimin për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura të Komisionit Qëndror të Dëshmorëve të Atdheut, sipas Vendimit të mësipërm, duke e ndjekur problemin në vazhdimësi. Më datë 14.12.2007 verifikuam pranë stafit teknik në Ministrinë e Mbrojtjes se, nga 491 dosje të prapambetura, janë marrë në shqyrtim 40 prej tyre dhe janë pergatitur për shqyrtim edhe 70 dosje të tjera për t'i shqyrtuar brenda vitit 2007". Siç shihet angazhimet e marra kishin ngelur vetëm fjalë. Për këtë, më 18 dhjetor 2007 i dërguam Zv. Kryeministrit rekomandimin tjetër për marrjen e masave për përsheptimin e procedurave të shqyrtimit të kërkesave për Statusin e Dëshmorit të Atdheut. Në përgjigje të rekomandimit tonë,

kabineti i Zv. Kryeministrit na informoi për masat e marra për të përfunduar në një kohë sa më të shpejtë shqyrtimin e rasteve të paraqitura. Me shkresën nr. 114 datë 11.01.2008, kabineti i Zv/Kryeministrit na njoftoi se: “Komisioni Qëndror i Statusit të Dëshmorëve të Atdheut” mbledhet në mënyrë periodike për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura. Mbledhja e fundit e këtij Komisioni u zhvillua në muajin dhjetor 2007, në të cilën u shqyrtuan rreth 70 dosje, gjë e cila e çoi numrin e dosjeve të shqyrtuara në 120 nga 491 dosjet e prapambetura. procesi i diskutimit të kërkesave, interpretimit të ligjit për çdo kërkesë është një proces delikat, jo i lehtë, për të cilin çdo anetar i Komisionit angazhohet maksimalisht. Komisioni Qëndror ka vendosur organizimin e mbledhjeve çdo 2-3 javë me qëllim përfundimin e shqyrtimit të dosjeve të prapambetura. Faktikisht angazhimi i Qeverisë për të zgjidhur përfundimisht këtë problem brenda vitit 2007 nuk gjeti zbatim. Duke parë se mosplotësimi i këtij detyrimi ligjor vazhdoi edhe për vitin 2008, dhe krijoi premisa për shkeljen e të drejtave për shtetasit që kërkojnë shpalljen dëshmorë të të afërmeve të tyre në 02.10.2008 kemi përsëritur rekomandimin tonë, për shpejtimin e procedurave “Për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura të Komisionit Qëndror të Statusit të Dëshmorëve të Atdheut”, sipas Vendimit Nr. 54 datë 31.01.2007 të Këshillit të Ministrave, duke ja dërguar këtë rekomandim Zv/kryeministrit Z. Genc Pollo. Një kopje të këtij rekomandimi ja kemi dërguar Sekretariatit Teknik të Komisionit të Statusit të Dëshmorit të Atdheut. Nga verifikimet tona të bëra kohët e fundit rezulton se, kanë mbetur ende shumë dosje pa u shqyrtuar, në këtë numër janë përfshirë edhe dosjet që kanë ardhur për shqyrtim gjatë viteve 2007, 2008 e 2009. Gjatë verifikimit rezultoi se Komisioni i Qëndror i Statusit të Dëshmorit të Atdheut ka shqyrtuar 72 dosje në mbledhjen e muajit shkurt të vitit 2009 dhe për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura, nuk është mbledhur më gjatë vitit 2009. Nga ana jonë u kërkuar përsëri që të përshpejtohet puna për shqyrtimin e këtyre dosjeve në një kohë sa më të shkurtër, duke bërë mbledhje më të shpeshta të Komisionit. Me ndryshimet e bëra V.K.M. duke caktuar si Kryetar Komisioni Ministrin e Shtetit shpresuam që ky problem të merrte zgjidhje gjatë vitit 2010, por ende vazhdon që ky problem të mos marrë zgjidhjen e duhur.

**- Respektimi i të drejtave procedurale, e drejta e degjimit, e marrjes se eksperteve, e drejta për të paraqitur dokumentacion etj.**

Ankesa me nr.20100242, ben fjale për zvarritje të dhenies se dokumentacionit nga ana e Zyres se Personelit prane KPTHN-se Ballsh për një shtetas me banim ne Fier, i cili kishte plotesuar kriteret për të perfitimin e pensionit të parakohshem. Kishte kerkuar disa here qe të terhiqte dokumentat, por nga ana e tyre kishte marre pergjigje verbale se,

dokumentacioni nuk ndodhej prane atij Institucioni. Pas ndërhyrjes sone u be e mundur qe ankuesit të njihej e drejta e tij e shkelur dhe njoftuam ankuesin qe të shkonte dhe të terhiqte dokumentacion.

**- Mosnjoftimi i permbajtjes se aktit administrativ, subjekteve qe cenohen**

Ankesa me **nr.201000047**, ben fjale për mosvenie ne dijeni të permbajtjes se aktit administrativ, konkretisht të ndërprerjes se pensionit të pleqerise për t'u verifikuar vjetersia ne pune e një shtetasi me banim ne Tirane nga ana e Drejtorise Rajonale të Sigurimeve Shoqerore ne Tirane. Megjithese kishte kaluar një kohe relativisht e gjatë prej një viti, ankuesi nuk kishte marre asnje njoftim se çfare ishte vendosur pas verifikimit të dosjes se tij të pensionit. Pas marrjes ne shqyrtim të rastit, proceduam me kerkese për shpjegime dhe ne pergjigje të kerkeses sone, u informuam se dokumentat e dosjes ishin verifikuar ne regjistrat themeltare dhe kishin rezultuar mosperputhje të te dhenave qe dispononte dosja e pensionit me të dhenat qe figuronin ne regjister. Ankuesit i kthjem pergjigjen perkatese, duke e sqaruar për rrugen ligjore qe duhet të ndiqte.

**- E drejta për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moskryerjes së procedurës administrative në shqyrtimin e kërkesës.**

Kjo e drejtë është e garantuar në nenin 42, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ne Ligjin nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”; ne nenin 5 i Ligjit nr. 9701, datë 02.04.2007, “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme”

Në trajtimin e rastit me **nr.201000044**, konstatohet se, Kryeregjistruesi i Z.Q.RR.P.P., Tiranë, nuk ka kryer procedurën e shqyrtimit brenda afatit ligjor të aktit nr. 13, datë 10.12.2008, të nxjerre prej Regjistruesit të Z.V.RR.P.P., Tiranë. Avokati i Popullit i ka rekomanduar Kryerregjistruesit të Z.Q.RR.P.P., nxjerrjen e aktit administrativ lidhur me miratimin ose jo të Vendimit nr.13, datë 10.12.2008 të Regjistruesit të Z.V.RR.P.P., Tiranë. Për rekomandimin tone, Kryerregjistruesi, është shprehur se nuk mund ta pranojë për shkak se Gjykata ka filluar shqyrtimin e Vendimit të tij nr. 122, datë 08.12.2009, sipas të cilit është vendosur për: “Për pezullimin e shqyrtimit të Vendimit nr.13, datë 10.12.2008 të Regjistruesit të Z.V.RR.P.P., Tiranë”.

## **16. Veprimtaria e Zyrës Rajonale Shkoder**

Nenseksioni i të Drejtave të Fëmijëve prane Zyres Rajonale të Avokatit të Popullit, Shkoder, është ngritur si një mekanizem i mbrojtjes

se të drejtave të fëmijëve, qe ne Nentor të vitit 2006, ne baze të marreveshjes tripaleshe ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit, Save the Children Albania dhe SIDA.

Nëpërmjet sqarimeve apo ndryshe konsulencave dhe orientimeve ligjore Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Shkoder ka mundur t'u vije në ndihmë qytetarëve, me synimin për të eliminuar sa më shumë sorollatjet e tyre në dyert e Administratës Publike, ku shpesh hasin mjaft pengesa burokratike. E gjithë kjo procedurë, pergjate viteve të funksionimit të Sektorit të Pritjes se Popullit prane Zyres Rajonale të Avokatit të Popullit Shkoder, lidhet direkt me kujdesin e kesaj Zyre Rajonale dhe ka rritur besimin të qytetarët qe ata t'i drejtohen institucionit të Avokatit të Popullit, ne parashtrimin e ankesave individuale apo kolektive, si dhe të kerkojne keshillime apo orientime ligjore për zgjidhjen e duhur ligjore të problemeve të tyre.

Ndryshe nga raportet e tjera, Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Shkoder, vjen me një risi këtë vit ne permbushjen e disa aktiviteteve kryesore e kryesisht me institucionet lokale dhe shoqerise civile, fokusuar ne promovimin dhe mbeshtetjen institucionale të disa strukturave monitoruese dhe të ofrimit të sherbimeve sociale. Kjo zyre ka organizuar dhe koordinuar aktivitete dhe tryeza të rumbullaketa ne kuadrin e bashkepunimit ndërinstitutional, me qellim permiresimin e sherbimeve qe ofrohen nga ana e organeve të administratës publike, si dhe permiresimin e gjendjes se respektimit të te drejtave të fëmijëve ne Qarkun Shkoder.

Ne këtë kontekst janë vleresuar si shume të rendesishme aktivitetet qe Zyra e Avokatit të Popullit, Shkoder, ka koordinuar me partnere të ndryshem gjatë vitit 2010.

Keto aktivitete janë fokusuar ne:

- Promovimin dhe ndërgjegjesimin për mbrojtjen e respektimin e të drejtave të fëmijëve, sipas standarteve ligjore.

- Bashkepunimin ndërinstitutional ne zbatimin rigoroz të te drejtave të fëmijëve.

- Promovimin dhe mbeshtetjen institucionale për projektin e perbashket ndërmjet UNICEF dhe Ministrise se Punes dhe Çeshtjeve Sociale; “Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve” ne nivel Qarku, si dhe për “Zyren e trajtimit të rasteve dhe ankesave të dhunes ne familje”, ne nivel Bashkie.

- Monitorimin e të drejtave të fëmijëve ne nivel Qarku, dhe mbrojtjes e respektimit të te drejtave të fëmijëve, sipas Konventes se Drejtave të Fëmijëve dhe Strategjise Kombetare të Fëmijëve.

- Funksionimit të Zyres se Pritjes se Popullit, ne Zyren Rajonale të Avokatit të Popullit, Shkoder, e hapur qe ne fillimet e punes se kesaj zyre rajonale.



## Problematikat e evidentuara

Vlen të theksohet se, ne ankesat që janë paraqitur nga qytetaret në Zyren Rajonale të Avokatit të Popullit, Shkoder, gjatë vitit 2010, pretendohet për shkelje të të drejtave të individëve të fokusuar në veprimtarinë e këtyre organeve të administratës publike: Inspektoriat Ndertimor dhe Urbanistik, Zyra e Strehimit në Bashkinë Shkoder, Zyra e Ndhimes Ekonomike në Rajon, Zyra e Gjendjes Civile, Zyra e sherbimit përmbartimor. Problematike kanë qenë ankesat në lidhje me përfitimin e pagesës së aftesise së kufizuar, kërkesën për rivlerësim të masës së pensionit të pleqerisë, konfliktet dhe dhunen e ushtruar nga punonjësit e Policisë së Shtetit, problemet me të drejtën e pronësisë, etj.

### **- Veprimtaria e Nenseksionit të Drejtave të Fëmijëve**

Veprimtaria e zhvilluar nga Nenseksioni i të Drejtave të Fëmijëve, pranë Zyres Rajonale të Avokatit të Popullit, Shkoder, gjatë vitit 2010, ka qenë fokusuar në aktivitete lobuese dhe advokuese në bashkëpunim me institucionet e qeverisjes vendore dhe shoqërië civile, për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve.

Konkretisht, kjo zyre ka marrë pjesë dhe ka luajtur një rol aktiv në këto aktivitete kryesore;

-Inspektimi i kushteve të jetesës për komunitetin rom gjatë fazës së përmbytjeve. Ky Komunitet ishte instaluar pranë Repartit Ushtarak në Rrenc të Shkodrës. Inspektimi u krye me qëllim monitorimin e kushteve aktuale të jetesës së këtij komuniteti dhe rekomandimeve përkatëse. (Janar 2010).

-Takim i zhvilluar me Reporterin Special të OKB-së, lidhur me fenomenin e Gjakmarrjes në Rajonin Shkoder. Në pozicionin e monitoruesit të të drejtave të fëmijëve për Qarkun Shkoder, Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit, vlerësoi takimin, duke dhënë edhe mesazhin për gjithë institucionet publike dhe shoqërië civile pjesëmarrëse në këtë takim, me qëllim realizimin e bashkëpunimit reciprok në luftën kundër këtij fenomeni, që mohon edhe të drejtat e fëmijëve. (Shkurt 2010)

-Takim me shefin e OSBE-Shkoder, lidhur me situatën e zbatueshmërisë së të drejtave të fëmijëve në Qarkun Shkoder. Duke qenë se Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit ka qenë iniciatore e krijimit të një sistemi të monitorimit të të drejtave të Fëmijëve, gjatë viteve të konsolidimit të këtij institucioni, kjo strukturë e re monitoruese rajonale shihet si partnere serioze e OSBE-së, me shumë vlerë në procesin e raportimit të të drejtave të fëmijëve. gjatë këtij takimi u shkëmbyen

aspekte të situates se zbatueshmerise se të drejtave të fëmijëve, apo shkeljeve bazuar edhe ne ankesat insdividuale të fëmijëve. (Mars 2010)

- “Promovimi i Zyres se trajtimit të rasteve dhe ankesave të dhunes ne familje” prane Bashkise Shkoder dhe pjesemarrja ne rolin e moderatorit ne “Konferencen e Cooperazione Italiana dhe VIS”. Zyra Rajonale prezantoi modelin e monitorimit të te drejtave të fëmijëve ne Qarkun Shkoder, nevojen për fuqizimin e “Rrjetit të Monitorimit dhe Mbrojtjes se Fëmijëve”, si një model pozitiv rajonal ne fushen e monitorimit të drejtave të fëmijëve. (Prill 2010)

-Pjesemarrje ne Tryezen e Rrumbullaket me teme: “Minimizimi i fenomenit të kequshqyerjes se fëmijëve”, organizuar nga Ministria e Shendetesise, D.SH.P Shkoder dhe UNICEF.( Maj 2010)

-Pjesemarrje ne Tryezen e rrumbullaket “Te gjithë se bashku kunder Punes se Fëmijëve”. një Tryeze e tille u realizua ne bashkepunim të ngushte me institucionet publike si Bashkia Shkoder, Inspektoriat Rajonal i Punesimit dhe Shoqeria Civile, si “Observatori për të Drejtat e Fëmijëve”, World Vision, SOS Fshatrat e Fëmijëve etj. (Qershor 2010)

-Pjesemarrje ne takimin “Fuqizimi i roleve gjinore ne shoqerine shqiptare”. Takimi u zhvillua nga OSBE dhe Aleanca Gjinore për Zhvillim. Ne baze të dhenave qe Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit , Shkoder, dispononte lidhur me gjendjen e të drejtave të fëmijëve, u mor pjese ne diskutimet mbi faktin se, si ndikon pabarazia gjinore ne respektimin e të drejtave të fëmijëve, vajza apo djem. (Korrik 2010)

-Ofrimi i të dhenave qe i perkasin të drejtave të fëmijëve për Keshillin e Qarkut Shkoder, ne funksion të procesit të hartimit të Strategjise Rajonale të Fëmijëve. (Shtator, Tetor, Nentor 2010)

-Pjesemarrja ne Konferencen “Aventura e Edukimit”, organizuar nga SHIS-Shoqata Internacionale për Solidaritet dhe pjesemarrja ne trajnimit me teme : “E drejta për kompensim dhe të drejta të tjera themelore të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në ligj dhe praktikë”, organizuar nga Qendra Shqiptare për Nisma Ligjore. (Dhjetor 2010)

“Observatori i të drejtave të Fëmijëve”, është një projekt i Aleances Shqiptare për Fëmijë, mbeshtetur financiarisht nga Zyra e UNICEF ne Shqiperi, e ngritur tashme si strukture edhe ne Qarkun Shkoder, duke filluar qe nga Maji i vitit 2009. Observatori është një strukturë e shoqërisë civile, i cili shërben për ndërgjegjësimin e aktorëve qeveritarë dhe jo qeveritarë, si edhe të vetë shoqërisë civile, për detyrimet dhe përgjegjësitë qe ata kane në raport me të drejtat e fëmijëve. Duke konsideruar të rëndësishëm faktin se, *të drejtat e fëmijës duhen respektuar dhe përmbushur, pavarësisht qytetit apo fshatit ku ai/ ajo jeton*, observatorët mbledhin dhe shpërndajnë informacion, analizojnë problemet kritike dhe

hartojnë raporte mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve, në çdo bashki e komunë të qarkut.

Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit, Shkoder, dhe “Observatori i të drejtave të Fëmijëve”, kane bashkevepruar ne procesin e monitorimit të drejtave të fëmijëve ne Qarkun Shkoder, të evidentimit dhe referimit të çeshtjeve problematike, si dhe kane promovuar praktikat me të mira të mbrojtjes dhe respektimit të te drejtave të fëmijëve.

Problematikat e dala gjatë procesit të mbrojtjes dhe respektimit të te drejtave të fëmijëve, janë referuar ne institucionin e Avokatit të Popullit, me qellim pergatitjen e rekomandimeve perkatese apo ndjekjen me iniciative të rasteve konkrete të moszbatimit të drejtave të fëmijëve. Aktualisht ne Institucionin e Avokatit të Popullit, me iniciativen e Zyres Rajonale Shkoder, është depozituar një grup ankesash të paraqitura nga disa familje rome, të cilat jetojne ne çadra ne një zone periferike të qytetit të Shkodres. Ato janë gjithsej 9 ankesa dhe objekti kryesor i tyre eshte, mungesa e rregjistrimit të ketyre familjeve ne rregjistrin zyrtar të gjendjes civile.

Duke mos patur një rregjistrim zyrtar, këto familje privohen edhe nga shume të drejta të tjera si, mundesia për perfitim të pageses se ndihmes ekonomike, apo pagesave të tjera të parashikuara ne ligj. Fëmijët e ketyre familjeve nuk frekuentojne sistemin e arsimit parashkollor, apo shkollor, gje e cila perben një shkelje të te drejtave qe afirmohen ne Konventen e Drejtave të Fëmijëve, apo dokumente të tjera të gjithëpranuara, lidhur me respektimin e se drejtës për Arsim.

### **Raportime rreth situates se zbatimit të drejtave të fëmijëve ne Qarkun Shkoder**

Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit, Shkoder, duke qenë promotore e iniciativave të reja edhe të shoqerise civile ne fushen e mbrojtjes dhe monitorimit të drejtave të fëmijëve, ka dhene ndihmesen e saj ne aksesimin e të dhenave dhe treguesve qe, lidhen me të drejtat e fëmijëve. është hera e pare qe ne nivel Qarku Shkoder, mblidhen të dhena statistikore dhe kjo fale edhe bashkepunimit reciprok me ”Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve”, lidhur me tregues monitorimi, të cilet janë të bazur ne ”Strategjine Kombetare për Fëmijë” dhe ne ”Planin e Veprimit”, sipas standarteve ndërkombetare.

Fushat e monitorimit kane qenë respektivisht: e Drejta për Kujdes Shendetesor; e drejta për Arsim; e drejta për Mbrojtje Shoqerore dhe e Drejta për Pjesemarrje. gjatë periudhes pervec mbledhjes se të dhenave, lidhur me treguesit qe perfshihen ne çdo fushe, është analizuar situata e të drejtave të fëmijëve dhe janë dhene rekomandimet perkatese.

### **- E drejta për Kujdes Shendetesor:**

- Shërbimi i stomatologut vlerësohet si i pamjaftueshëm në zonat urbane, por veçanërisht në zonat rurale, ku ky shërbim pothuajse është inekzistent. Në këtë menyrë, fëmijët nuk arrijnë që të kenë akses të mjaftueshëm, lidhur me shërbimin publik të stomatologut.
- Distancat e largëta të qendrave shëndetësore me qendrat e banimit sidomos në zonat rurale, vështirësojnë aksesin e nevojshëm për kujdes shëndetësor.
- Lidhur me semundjen HIV/AIDS, nuk raportohen raste të identifikuar nga asnjë nga Drejtorite e Shendetit Paresor në Qarkun Shkodër, por dihet se ky fenomen ekziston tashmë në shoqërinë shqiptare. Më shumë vëmendje duhet të kushtohet në drejtim të identifikimit të rasteve, trajtimit të tyre dhe shpërndarjes të shërbimeve parandaluese.

### **- E drejta për Arsim:**

- Vështirësitë në arsimimin e fëmijëve lidhen me shumë faktorë. të tilla janë, niveli ekonomik i familjes, çështjet e mentalitet, çështjet infrastrukturore, largësia e madhe e shkollës nga vendbanimi, puna e fëmijëve etj.
- Braktisja e shkollës rezulton të jetë në shifra me të larta në zonat rurale, se në ato urbane dhe kjo është e lidhur me faktorët e parashtruar më lart.
- Të dhënat që, i përkasin numrit të fëmijëve me Aftesi të Kufizuara, që frekuentojnë kopshte apo shkolla të integruara, mungojnë si rekorde administrative nga të gjithë Drejtorite e Arsimit Rajonal në Rrethe. Kjo përbën një shmangie nga detyrimet kushtetuese-ligjore të sanksionuara në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, apo edhe të akteve të tjera nënligjore.
- Fëmijët me Aftesi të Kufizuara, janë një kategori e fëmijëve që përballen me vështirësi të ndryshme, duke filluar nga varfëria dhe deri tek përjashtimi social. Më shumë vëmendje duhet kushtuar në drejtim të identifikimit të tyre dhe zbatimit të politikave favorizuese, lidhur me arsimin gjithëpërfshirës të tyre.

### **- E drejta për Mbrojtje Sociale:**

- Nuk ka një alternativë ndërmjet pagesës së ndihmës ekonomike me shërbimet sociale, në mënyrë që fëmijët e përfshirë në skemën e

pagesës së ndihmës ekonomike, të jenë përfitues të shërbimeve të caktuara të nevojshme për to.

- Mungon denoncimi i rasteve të dhunës në familje ndaj të miturve, nga ana e institucioneve përgjegjëse. Në këtë fazë denoncimi bëhet vetëm nga ana e prindërve, ose familjarëve të tyre. Nëse rastet do raportoheshin në Policinë e Shtetit, në mënyrë të koordinuar nga institucionet përgjegjëse, do kishte një rritje të forces identifikuese të këtij fenomeni dhe të referimit të rasteve të dhunës në familje.
- Sistemimi i viktimave të dhunës, nuk behet në një strehez në nivel Qarku dhe kjo vështirëson shumë procesin e denoncimit dhe marrjes së shërbimeve adekuate.
- Pavarësisht identifikimit të fëmijëve në nivel bashkiak dhe trajtimit të rasteve që përbën një aspekt për t'u cilësuar, vlerësohet se në nivel Qarku/Komune rastet e fëmijëve që punojnë në blegtori, bujqësi apo sektorë, të jenë më të larta se në zonat urbane. Me shumë vëmendje duhet kushtuar në identifikimin e këtyre rasteve dhe përfshirjes në shërbime të ndryshme, me qëllim eliminimin e formave të punës së fëmijëve dhe kjo në mënyrë konstante.
- Më shumë vëmendje duhet kushtuar nga të gjithë institucionet përgjegjëse dhe aktorët e shoqërisë civile, në identifikimin e fëmijëve të ngujuar, që janë jashtë sistemit arsimor dhe koordinimit me shërbime për t'ju garantuar atyre të drejtat që i mohohen me qëllim që të minimizohet ky fenomen.

#### **- E drejta e Pjesëmarrjes:**

- Kompetencat e “Qeverive të Nxënësve”, nuk njihen nga vetë nxënësit e shkollave.
- Më shumë vëmendje duhet kushtuar në të ardhmen drejt njohjes së kompetencave dhe të drejtave të “Qeverisë së Nxënësve”; nxitjes së iniciativës së këtyre strukturave dhe pavarësisë së këtyre strukturave nga drejtoria e shkollës, apo autoritetet lokale.

#### **- Te drejtat e komunitetit Rom ne Qarkun Shkoder**

Viti 2010 ishte konsideruar ne objektivat e Institucionit të Avokatit të Popullit, si viti i një pune të fokusuar ne të drejtat e këtij komuniteti. Nisur nga ky objektivi, Zyra Rajonale Shkoder, i kushtoi një vëmendje të veçantë këtij komuniteti, duke bërë vizita të shpeshta, duke intervistuar dhe mbledhur të dhena lidhur me nevojat dhe gjendjen e këtij komuniteti. Zyra Rajonale ka patur për objekt të punës së saj, komunitetin Rom të vendosur ne lagjen Livade, prane Liqenit Shkoder, pasi është i vetmi

komunitet etnik i ri praktikisht jashte sistemit, ne realitetin e Qarkut Shkoder.

Ky komunitet u prek rende nga permbytjet e Janarit 2011 dhe u zhvendos me ndërhyrjen e organizmave shteterore prane një reparti ushtarak ne Rrenc të Shkodres. Nga ana e zyres sone u kryen inspektive të shpeshta, lidhur me kushtet e jeteses dhe trajtimin e fëmijëve të komunitetit rom gjatë fazes se permbytjeve. Zyra Rajonale shfrytezoj këtë moment të grupimit të ketij komuniteti, për të nxjerre statistika të sakta lidhur me identitetin, gjendjen arsimore, shendetesore të tij.

Keto familje dhe individe, se bashku me fëmijët e tyre të shumte, nuk gezojne asnje të drejtë civile. Ato nuk figurojne të regjistruar ne gjendjen civile etj. Ky rast i është referuar me inisiative Avokatit të Popullit dhe çeshtja është ende ne shqyrtim, me qellim pergatitjen e rekomandimeve të nevojshme.

### **Promovimi dhe mbeshtetja infrastrukturore për "Zyren e trajtimit të ankesave dhe rasteve të dhunes ne familje" ne nivel Bashkie.**

Zyra e ideuar për pritjen e ankesave të fëmijëve, ne Zyren Rajonale të Avokatit të Popullit, Shkoder, qe ne fillimin u konceptua si një ambient i kendshem për fëmijët, ne mënyrë qe të ofronte konfidencialitet gjatë procesit të marrjes se ankesave. Ne vitin 2010 ne kuader të marreveshjes me Bashkine Shkoder, me qellim fuqizimin e strukturave mbrojtese ne nivel Bashkie u be i mundur fuqizimi i Zyres Kunder Dhunes ne Familje, duke i ofruar kesaj të fundit zyren e arreduar dhe miqesore për fëmijët. Bashkepunime të tilla ne fuqizimin dhe promovimin e strukturave mbrojtese për viktimat e dhunes ne familje, sjellin një karakteristike të Zyres Rajonale të Avokatit të Popullit, Shkoder, drejt një perqasjeje ndërinstucionale me qellim krijimin e kushteve të favorshme për respektimin e të drejtave të fëmijëve ne Qarkun e Shkodres. Kjo Zyre vazhdon të sherbeje edhe për rastet e intervistave konfidenciale të ankesave të marra drejtperdrejte nga fëmijët, nga ekspertet e Zyres Rajonale të Avokatit të Popullit, bazuar ne standartet e Konventes se Drejtave të Fëmijëve.

Konsulenca ne shkembimin e të dhenave, qe u perkasin të drejtave të fëmijëve, lidhur me Strategjine Rajonale të Fëmijëve ne Qarkun Shkoder.

Keshilli i Qarkut Shkoder për here të pare, është perfshire ne hartimin e Strategjise Rajonale të Fëmijëve, si një projekt i mbeshtetur nga UNICEF dhe iniciuar fale lobimit të "Observatorit të Drejtave të Fëmijëve", ne nivel Qarku. Hartimi i një dokumenti të tille strategjik qe perfshihet ne politikat sociale dhe angazhimi serioz qe Qarku Shkoder

vazhdon të ndërmarre ne fushen e të drejtave të fëmijëve, vjen si një risi për Rajonin e Shkodres.

Ne këtë kuader Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit, Shkoder/Nenseksioni për të Drejtat e Fëmijëve, ne rolin e mediatorit dhe mbeshtetesit institucional, ka qenë shume bashkepunuese dhe ne të njejtën kohe, ka shkëmbyer të dhenat qe lidhen me të drejtat e fëmijëve, kryesisht për ato të dhena, të cilat janë marre ne bashkepunim të ngushte me "Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve", Shkoder. një procedure e tille ka ndihmuar ekspertet e hartimit të strategjise, jo vetem me të dhena sasiore, por edhe cilesore, duke qenë i vetmja strukture rajonale, e cila ka tagrin e monitoruesit të te drejtave të Fëmijëve ne Qarkun Shkoder, ne nivel perfaqesimi të një institucioni të pavarur kushtetues. të dhenat e ofruara janë kryesisht lidhur me të drejtën për arsim, të drejtën për kujdes shendetesor, të drejtën për mbrojtje shoqerore, sipas kerkesave të ardhura nga ekspertet e hartimit të kesaj Strategjie.

### **Analiza, konstatime dhe rekomandime mbi vazhdimesine e Nenseksionit të Drejtave të fëmijëve prane Zyres Rajonale të Avokatit të Popullit Shkoder.**

Veprimtaria për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ka vijuar si me anë të trajtimit të ankesave individuale, ashtu dhe me ane të hetimit me iniciativë të rasteve të bëra publike, si dhe të shqyrtimit të legjislacionit dhe dhënies së rekomandimeve për ndryshime, apo përmirësime të nevojshme.

Gjatë këtij viti, pa permendur rastet e shqyrtuara dhe rekomandimet e Mekanizmit të Parandalimit të Tortures, janë trajtuar 37 ankesa, kërkesa apo çështje të filluara me iniciativen tonë, të cilat kanë patur si objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve. Disa prej ankesave, kërkesave apo dhe rasteve të shqyrtuara me iniciativë, preknin të drejtat e një numri të konsiderueshëm fëmijësh. Rekomandimet janë pergatitur kryesisht pas kryerjes se inspektimeve të bëra ne Shtepite e Fëmijës, Qendrat Komunitare e Qendrat e Zhvillimit, të cilat janë permendur ne pjese të mëparshme të ketij raporti.

Specialistet e të drejtave të fëmijës, pjese e nenseksionit të Zyres Rajonale Shkoder, janë perfshire ne diskutimet paraprake me specialiste të fushes, pjese e hartimit të ketij projekt ligji dhe kane pranuar ne parim inisiativen ligjore (maksimaliste) të UNICEF, për të propozuar një Komisioner të veçante të te drejtave për fëmijët, ne dispozitat e ligjit ne fjale. Me kalimin e projektligjit integral dhe me konsensus të gjere nga gjitha grupet e interesit ne Keshillin e Ministrave, u prit miratimi i tij ne teresi. Realisht ky ligj u miratua nga Keshilli i Ministrave teresisht, me perjashtim të Kreut V, i cili parashikonte krijimin e Komisionerit. Ne komentarin e ligjit thuhej shprehimisht se, këtë rol do e ushtrojne

Institucionet e Mbrojtjes se Drejtave të Njeriut të konsoliduara. Ne këtë moment të ri institucional, sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit ne detyre, u pergatit një oponence për ligjin, bazuar ne një Raport të Veçante, i cili do kalonte për diskutim ne komisionet perkatese ne Parlament. Linja kryesore e oponences sone kishte të bente me standartet e ligjit, të cilet me mosperfshirjen e Kreut V, vinin ne diskutim standartet e njohura tashme dhe të afirmuara tek: « Parimet e Parisit ».

Qëllimi yne ishte të sqaronim edhe rolin e Nen/Seksionit të te Drejtave të Fëmijëve, pjese e strukturave të Avokatit të Popullit, ne raport me situaten e re institucionale qe ky ligj sjell ne fushen e të drejtave të fëmijës. Oponenca dhe sugjerimet tona u bene pjese e debatit dhe u moren parasysh. Pavaresisht faktit se ato nuk u perfshine ne ligjin e ri, ne debatin perfundimtar ne komisionin e ligjeve doli e qarte se, ne frymen e ketij ligji, si nga ana e Ekzekutivit, ashtu dhe Legjislativit roli i institucionit të pavarur për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, i perket institucionit të Avokatit të Popullit.

Miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë, i Ligjit nr.10347 date 4.11.2010, shenon një hap perpara për mbrojtjen efektive e perkujdesin e posaçem lidhur me të drejtat e fëmijëve ne vendin tone. Me hartimin dhe miratimin e këtij ligji, vendi yne ka përmbushur një detyrim në kuadrin e integritimit të vendit në BE, duke bërë qe institucionet perkatese të marrin përgjegjësi konkrete për mbrojtjen reale të drejtave të fëmijëve. Ne këtë mënyrë është realizuar dhe percaktimi i “Strategjise Kombëtare për Fëmijët” dhe “Plani i Veprimit” të saj, qe parashikojnë si masë legjislative edhe hartimin e një ligji për të drejtat e fëmijëve.

Disa konkluzione lidhur me të drejtat e fëmijëve:

-Miratimi i projektligjit “Per Sistemin Arsimor Parauniversitar”, si dhe hartimi dhe miratimi i Projektligjit “Per mbrojtjen e të drejtave të personave me aftesi të kufizuar”, sigurisht qe do të synojne garantimin sa me efektiv të interesit me të larte të fëmijëve dhe të drejtave të tyre. Avokati i Popullit do të vijojë bashkepunimin për konsultimet perkatese, për një qasje sa me të mire me instrumentet ndërkombetare të ratifikuara nga vendi yne, lidhur me të drejtat e fëmijëve.

-Nevojitet bashkepunim i metejshem me Institucionet e tjera të pavarura ne fushen e mbrojtjes se të drejtave të njeriut, si me Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneren për Mbrojtjen e të Dhenave Personale, etj, jo vetem ne aktivitete të perbashketa për të drejtat e njeriut e kryesisht të fëmijëve, por dhe ne shkembim e referim rastesh konkrete, për zgjidhjen me të mire të ankese-kerkesave.

- Kontrolli i ushtruar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës mbi programet, cilësinë e mësimdhënies dhe kushtet e jetesës dhe të shkollës, të jetë më efektiv dhe më i shpeshtë.



-Nevojitet një performance me cilesore dhe profesionale nga gjyqesori, ne lidhje me çështjet ne të cilat duhet vene ne qender interesi me i larte i fëmijës. Ky parim duhet të gjeje shprehje jo vetem si frazeologji në vendimet gjyqesore, por është e nevojshme të theksohet se ai duhet të jetë konsideratë parësore në veprimtarine e tyre. Në këtë kontekst, respektimi i mendimit të femijës, garantimi i alternativës më të mirë të mirërritjes dhe mirëqenies për të, si dhe e mosdiskriminimit, duhet të jenë qartësisht të shqyrtuara dhe të pasqyruara në vendimet gjyqësore.

-E drejta e fëmijës për të mbajtur rregullisht marrëdhënie dhe takime të drejtperdrejta me të dy prinderit, reflektohet ne nenin 18 të Konventes si dhe ne nenin 215 të Kodit të Familjes, sipas të cilit të dy prinderit kane pergjegjesi të perbashket për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës. Gjithesesi, ka mjaft raste ku zbatimi ne praktike i vendimeve gjyqesore le për të dëshiruar, sidomos kur mungon vullneti i njerit prind për t'a zbatuar ate.

-Ne realitet ka mjaft fëmijë qe jetojne ne një gjendje të veshtire ekonomike dhe me të ardhura të pakta. Skema e sigurimeve shoqerore, por edhe asistenca qe ofron shteti për familjet e varfra, nuk siguron shpesh here as minimumin jetik për këto familje dhe për pasoje, as për fëmijët e tyre. Kjo gje ka çuar shpesh here ne punesimin e fëmijëve ne kundërshtim me ligjin.

-Privimi i lirisë së një të mituri duhet të jetë masa e fundit që mund të merret dhe të zbatohet për periudhën më të shkurtër të mundshme. Duhet bërë përpjekje të veçanta për të shmangur paraburgimin. Sanksionet, ose masat, duhet të jepen dhe zbatohen pa asnjë lloj diskriminimi.

-Ndërmjetësimi, ose masat e tjera restauruese duhet të inkurajohen në çdo fazë të trajtimit të një mituri. Të miturit nuk duhet të kenë më pak të drejta apo mbrojtje ligjore, sesa ato që u ofrohen të rriturve nga rregullat e përgjithshme të procedurës penale. Çdo sistem drejtësie për të mitur duhet të marrë parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve dhe kujdestarëve ligjorë, si dhe duhet t'i përfshijë ata sa më shumë gjatë procedimit penal dhe në ekzekutimin e sanksioneve, përveç kur kjo gjë nuk është në interesin më të larte të të miturve.

## **17. Trajtimi i ankesave te të përndjekurve politikë**

Gjatë vitit 2010 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesa Shoqatat e ish të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, në të cilat pretendojnë se; Ligji Nr. 9831 datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist” bie në

kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut si dhe me Rezolutën e Këshillit të Europës për Dënimin e Krimeve të Komunizmit, në të cilat përcaktohet e drejta e viktimave të regjimit komunist për rivendosjen e drejtësisë, rehabilitimin moral e politik, dëmshpërblimin ekonomik si dhe riintegrimin real në shoqëri. Gjithashtu ata pretendojnë se Ministria e Drejtësisë ka miratuar disa procedura tepër të ndërlikuara dhe të vështira për t'u plotësuar dokumentacioni që u kërkohet të dënuarve politikë për të përfituar dëmshpërblimin që ju takon sipas ligjit përkatës.

Sipas tyre procedurat e miratuara nga Ministria e Drejtësisë janë në kundërshtim jo vetëm me ligjet dhe VKM-të e miratuara për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist, por ato janë edhe në kundërshtim të hapur me Ligjin Nr.9831 datë 12.11.2007.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur gjithësej 2 ankesa individuale nga ish të burgosur dhe të perndjekur politikë nga regjimi komunist, me të njëjtat kërkesa dhe pretendime. Rasti (2010001756) dhe rasti (201001609).

Aktualisht nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë shqyrtuar me përparësi dy ankesa të rëndësishme të paraqitura nga shoqatat e të persekutuarve politikë të Shqipërisë. Rasti (201001609).

Më konkretisht është paraqitur një ankese në lidhje me mosplotësimin e kërkesave të Shoqatës të Përndjekurve Politike Dega Durres, dërguar Kryeministrit të Shqipërisë dhe se ende nuk kishin marrë një përgjigje nga institucioni i tij, lidhur me përshpejtimin e përfundimit të kështit të parë dhe të fillimit të kështit i dytë para vitit të ri për të gjithë personat që i përkasin kësaj kategorie, përcaktimin e moshës së pensionit deri në 55 vjeç për të gjithë të dënuarit ashtu si është për Minatorët, zbatimin e një neni të veçantë nga shteti për punësimin dhe trajtimin e veçantë me strehim falas dhe të gjithë atyre që po enden rrugëve, për të gjithë të dënuarit duhet t'i jepet një status i veçantë ku ata të ndihen të përkrahur në çdo derë që të trokasin për hallet e tyre, trajtimin me vizita mjekesore falas në bazë të të dhënave që shteti disponon, kryerjen e perllogaritjes së dëmshpërblimit për periudhën e qëndrimit në hetuesi sipas ligjit në fuqi 5000 leke dita, për ditët e fituara me punë të llogariten burg sipas vendimit të formës së prerë, si dhe mos zbritjen e letrave me vlerë në shumën e dëmshpërblimit.

Jane paraqitur ankesa nga të persekutuar politike, të cilët perfitojnë dëmshpërblimin, por që nuk kishin dijeni se ku ndodhej dosja e tyre.

Zyra jonë, pasi ka ndjekur rrugën ligjore me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave, i ka informuar këta persona për procedurat administrative që po ndiqen.

## 18. Të tjera

1. Ndër çeshtjet e paraqitura ne institucionin tone gjatë ketij viti, kane qenë edhe ankesat qe kane të bëjnë me mënyrën dhe masën e kompesimit me ushqim të ushtarakëve të F.A të R.Sh. Konkretisht, ne ankesat e paraqitura nga ana e individeve ankues është ngritur pretendimi për mospërfitimin padrejtësisht të trajtimit me ushqim, si dhe të trajtimit me ushqim të një cilësie të dobet.

Kjo është një e drejtë që u është njohur atyre me ane të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.524 datë 30.07.2004. Për problemin e trajtimit me ushqim, nga ana e Drejtorisë së Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm, grupi i punës përgatiti projekt-vendim për përmirësimin e normave të ushqimit. Në mbledhjen e datës 28.01.2008 Këshilli i Ministrave vendosi rritjen e normave të ushqimit, duke i lënë detyrë Ministrisë së Mbrojtjes të përcaktojë një sërë normash të tjera për ushtarakët në varësi të gradës dhe pozicionit që kanë. Ministrit të Mbrojtjes i është lënë detyrë të nxjerrë udhëzim për të përcaktuar trajtimin me ushqim të gatuar pa pagesë për oficerët, nënoficerët dhe ushtarët profesionistë, në rast të qëndrimit në repart mbi 8 orë për arsye gadishmërie, apo trajnime dhe stërvitje në terren, në lloje të ndryshme operacionesh brenda dhe jashtë vëndit. Me VKM nr. 88 datë 28.01.2008 “Për Miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, u përcaktua rritja e normave të ushqimit të efektivave ushtarakë. Në zbatim të këtij vendimi kanë dalë edhe aktet nënligjore zbatuese siç është Urdhëri nr. 388, datë 134.03.2008 i Ministrit të Mbrojtjes “Për trajtimin me ushqim të efektivave ushtarak të F.A të Republikës së Shqipërisë” si dhe Urdhëri nr. 324, datë 27.03.2008 i Komandës së Forcës së Bashkuar ,”Për trajtimin me ushqim të efektivave ushtarakë të Forcës së Bashkuar”. Për vitin 2010 disa ushtarakë u ankuan se nuk përfitonin padrejtësisht trajtimin me ushqim, ndërsa disa të tjerë u ankuan se trajtimi me ushqim ishte i një cilësie të keqe. Ndonëse është i plotë kuadri ligjor që i njeh këtë të drejtë ushtarakut, nga verifikimi i ankesave të kësaj natyre ka rezultuar se jo gjithmonë, përfitohet kjo e drejtë sipas ligjit, dhe akteve të dala në zbatim të tij. Për këtë Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Mbrojtjes plotësimin një për një të detyrimeve ligjore të përmenduar më sipër. Rekomandimet tona janë konsideruar të drejta dhe në përgjithësi janë marrë masat e duhura për zbatimin korrekt të ligjit.

Konkretisht, ne ankesen **nr.201000325**, të paraqitur nga një grup pilotësh të Forcave të Armatosura, pretendohej se norma ushqimore me të cilën ata trajtoheshin, nuk i përgjigjej normativave bashkëkohore dhe kërkesave kalorike për të cilat ka nevojë një pilot. Për këtë rast, Avokati i Popullit kreu një studim krahasues të trajtimit të pilotëve që janë në varësi

nga institucione të tjera si Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë, nga ku rezultuan disa diferenca në normativat që zbatohen për trajtim. për këtë arsye iu dergua një rekomandim Ministrise se Mbrojtjes për rishikimin e ketyre normativave ushqimore. Ky rekomandim është ende në shqyrtim nga Ministria e Mbrojtjes dhe pritet një vendimmarrje për zgjidhjen përfundimtare të ankesave.

**2.** Eshtë konstatuar se nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes nuk respektohet e drejta e ushtarakëve për marrjen e normave të veshmbathjes. Trajtimi me uniformë i ushtarakut është një nga të drejtat që i është njohur atij nga neni 27, i Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe V.K.M. nr. 464, datë 02.07.2004.

Për problemin e normave të veshmbathjes nga Drejtoria e Logjistikës çdo vit rinovohet urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes për përmirësimin e normave të veshmbathjes. Në tabelat e reja për oficerët e trupës e të shtabeve janë përmirësuar normat e veshmbathjes, veçanërisht në drejtim të cilësisë së saj. Ministria e Mbrojtjes, shtetasve që kanë bërë betimin dhe shërbejnë në Forcat e Armatosura, u ka mohuar të drejtën të mbajnë uniforma sipas ligjit bashkë me simbolet përkatëse. Gjatë vitit 2010, në disa raste u konstatua se nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes nuk respektohej e drejta e ushtarakëve për marrjen e normave të veshmbathjes. Për këtë, nga ana jonë ju rekomandua Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të F.A, pajisja sa më parë me uniforma sipas ligjit. Pas rekomandimit tonë, mësuam se u bë pajisja me uniforma por vetëm për stërvitje. Siç shihet, qëndrimet burokratike të Ministrisë së Mbrojtjes kanë bërë që kjo e drejtë e njohur nga ligji të mos gëzohet prej ushtarakëve plotësisht.

Nga verifikimi i rekomandimeve të mëparshme është konstatuar e njëjta gjëndje, për të cilën kemi reaguar nëpërmjet rekomandimit, me anën e të cilit kemi kërkuar trajtimin e ushtarakëve me uniforma në një kohë sa më të shpejtë. Për këtë, nëpërmjet një rekomandimi tjetër ju kërkuam Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura vendosja në vënd e të drejtës së shkelur të ushtarakëve aktiv. Në përgjigje të këtij rekomandimi, me shkresën nr. 9196, datë 03.11.2010 të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm njoftohemi se, nga ana e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura janë marrë masa për kompletimin e gjithë strukturave ushtarake me uniforma stërvitje dhe materiale të tjera

**3.** Kreu i katërt i Ligjit Nr. 9210 datë 23.04.2004, “Të Drejtat Sociale të Ushtarakut dhe familjes së tij” i ka parashikuar në një sërë dispozitash nga neni 31 deri në nenin 45, këto të drejta.

Duke ballafaqur këto dispozita me ankesat e prezantuara në vitin 2010. pranë zyrës së Avokatit të Popullit. gjejmë se ka mospërputhje të

mëdha. Mosmarrja e masave efektive për kalimin e Forcave të Armatosura nga sistemi i shërbimit të detyrueshëm ushtarak në atë të ushtarëve profesionistë me pagesë, ka bërë të ketë shkelje të drejtave të ushtarakëve lidhur me kohën e punës dhe të pushimit. Kjo ka ndodhur, për shkak se nuk janë plotësuar nevojat e F.A me ushtarë profesionistë e për rrjedhojë ngarkohen me shërbim personeli tjetër, ndonjë herë edhe ata që nuk e kanë për detyrë, ndonëse Drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm, për të realizuar pushimet në ditët e shtuna, ka bërë ndryshimin e programit stërvitor edhe për vitin 2010, duke kaluar nga katër cikle stërvitore në tre cikle stërvitore, me qëllim që të garantohet pushimi i ushtarakëve. Mbas çdo cikli stërvitor kryhen 15 ditë pushim.

Konkretisht, ankesa **nr.201001171**, kishte të bënte me kërkesën e disa ushtarakëve për t'u paguar orët e angazhimit në detyrë jashtë orarit normal të punës. Pas analizës që iu bë kësaj ankese, rezultoi se zgjidhja e saj lidhej me interpretimin dhe zbatimin në praktikë të nenit 17 dhe të nenit 31, pika 2, të Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Avokati i Popullit ka paraqitur një rekomandim pranë Ministrisë së Mbrojtjes për trajtimin e kësaj kategorie ushtarakësh, por deri më sot reagimi pozitiv ndaj kësaj kërkesë ka qenë i kushtëzuar nga mungesa e fondeve financiare.

**4.** E drejta për kushte banimi dhe jetese të pershtateshme për ushtarakët në përputhje me parashikimin e bërë në nenin 31, të ligjit "Për statusin e ushtarakut të forcave të armatosura".

Një numër ankesash për vitin 2010 kanë qënë ato që lidhen me kushtet e banimit dhe të jetesës së ushtarakëve si ato të konstatuara gjatë inspektimeve në Akademinë e nënoficerave dhe në Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Mojsiu". Avokati i Popullit nëpërmjet rekomandimeve ka kërkuar miratimin e fondeve të domosdoshme për përmirësimin e kushteve të jetesës. Në përgjigje të këtyre rekomandimeve nga ana e titullareve të Ministrisë së Mbrojtjes, na është bërë me dije se kanë përfunduar projektet për rikonstruksion të godinave të banimit dhe janë me prioritet në planin e investimeve për vitin 2011.

Verifikimi i respektimit të drejtave dhe lirive të ushtarakëve është organizuar edhe sipas një plan inspektimi i miratuar nga Avokati i Popullit, i cili parashikon vizita në disa reparte ushtarake nga ana e një ekipi ekspertësh të zyrës së Avokatit të Popullit. Këto vizita organizohen për të parë si respektohen të drejtat dhe liritë e ushtarakëve si dhe kushtet e ruajtjes dhe trajtimit të ushtarakëve të dënuar me ndalim disiplinor.

Ankesa e regjistruar me nr. **201000433**.

Nje grup ankuesish na shkruanin se, kishin qenë të punesuar ne repartin nr. 1200 Regjimenti Komando Zall-Herr, sipas kontratave perkatese. Ne periudhen kohore gusht 2009 deri ne muajin janar 2010 ata kishin qenë pjese e kontigjentit të derguar ne misionin paqeruajtjes ne Afganistan. Para se të niseshin ne këtë mision, ishin nenshkruar kontratat perkatese individuale për pjesmarrje ne mision, të cilat kane patur disa mangesi ne permbajtjen e tyre, sidomos pasqyrim të bazes ligjore rregulluese, si dhe masen e shperblimit ditor qe do të merrnin gjatë kesaj kohe. Megjithatë, atyre verbalisht, para nisjes ne mision, u është thene se dieta ditore do të ishte 60 USD ne dite dhe se kjo nuk do të tatohej. Ne muajin dhjetor 2009, kur ndodheshin ne Afganistan ata janë informuar se shperblimi ditor apo dieta ditore, sikurse është pasqyruar ne kontratat tip të lidhura me ta, ishte tatuar ne masen 10 % dhe për rrjedhoje ne vend qe ata të paguheshin 60 USD ne dite, janë paguar me 54 USD ne dite.

Duke e konsideruar këtë veprim si cenim të te drejtave të tyre ligjore, një pjese e konsiderueshme e kontigjentit të misionit prej 86 personash, me daten 07.12.2009, bene një kerkese drejtuar Kryeministrit, Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Pergjithshem dhe Komandantit të Forces se Bashkuar. Ne këtë kerkese ata kerkonin trajtim financiar të barabarte me koleget e tyre të vendeve të NATO-s, trajtimi të behej me euro dhe jo me dollare, të mos tatohej shperblimi ditor, si dhe t'u kthehej pergjigje për këto kerkesa. Gjithashtu, ata kerkonin qe, nese nuk do të realizoheshin kerkesat e tyre, të ndërpritej menjehere misioni brenda dt. 20.12.2009. Këtë kerkese ata ia dorezuan Komandantit të Misionit Paqeruajtjes, i cili informoi eproret e tij ne Shqiperi.

Pas berjes se kesaj kerkese, ata janë njoftuar nga komandanti i tyre, i cili ishte informuar nga eproret e tij dhe drejtperdrejte edhe nga Ministri i Mbrojtjes ne telefon, se do të behej rritja e shperblimit ditor ne mision dhe rritja e rroges se ushtarakeve. Këtë informacion ata e kane mirepritur dhe kane vazhduar kryerjen e detyres se ngarkuar.

Kur keta ushtarake janë kthyer ne Shqiperi, atyre u është dhene leja 10 ditore dhe pas kesaj janë njoftuar qe të paraqiten ne repart. Nga strukturat drejtuese të repartit, ky veprim i tyre është konsideruar si shkelje e rende e disiplines dhe, për këto arsye, pasi u bene edhe analizat perkatese është vendosur ndeshkimi i tyre, duke i liruar nga detyra dhe nxjerre ne lirim nga F.A të R.SH. Ne këtë kuader ata janë liruar nga detyra me motivacionin “per ulje të figures se ushtarakut”.

Ankuesit pretendojne se lirimi i tyre është ne kundersizim me aktet normative ne fuqi, sepse ankesa është një e drejtë e ligjshme dhe se ate e bene për cenimin e të drejtave të tyre ligjore. Perveç kesaj ata pretendojne se ne fund të fundit nuk e ndërprene kryerjen e detyres dhe nuk bene veprime konkrete refuzuese apo rrebeluese. Ndersa kater prej tyre,

pretendonin se nuk e kishin nenshkruar këtë kerkese dhe se nuk kane qenë pjese e ketij grupi qe kane nenshkruar ate. Gjithashtu, ankuesit pretendonin se, nuk i ishin dhene kopje të dokumentave qe, lidhen drejtperdrejte me ta si, kontrata e punesimit të tyre ne këtë repart, kontrata e dergimit të tyre ne misionin paqeruajtes ne Afganistan, si dhe kopja e urdherit të lirimit nga radhet e Forcave të Armatosura të Republikës se Shqipërisë, duke ju shkelur të drejtën kushtetuese e ligjore të informimit. Nderkohe, ata na sqaronin se, gjatë periudhes kohore qe kane sherbyer ne radhet e FA-se dhe ne misionin paqeruajtes ne Afganistan kane patur rezultate të mira ne pune dhe se nuk kane kryer shkelje disiplinore. Po keshtu ata kane ngritur edhe pretendimin tjeter se, megjithese kerkesen e kane firmosur 86 ushtarake, vetem 27 prej tyre janë liruar nga detyra, ndërsa ndaj të tjereve nuk është marre asnje mase disiplinore. Sipas tyre, nga ana e komandes është mbajtur një qendrim i diferencuar ne trajtimin e ketij rasti.

Pas shqyrtimit qe iu be kesaj çeshtjeje nga ana jone, nga studimi i gjithë dokumentacionit të administruar rreth kesaj çeshtjeje, të ankesave, të pergjigjeve, të kontratave për vazhdimin ne sherbimin ushtarak, të kontratave për pjesmarrje ne misionin ne Afganistan dhe të procesverbalit të pyetjes se Komandantit të Kontigjentit të Misionit të I-re Shtese ne Afganistan dhe ballafaqimit të tyre me aktet normative ne fuqi, arritëm ne konkluzionin se lirimi nga detyra dhe nxjerrja ne lirim i ankuesve ishte e padrejte dhe i pa mbeshtetur ne ligj.

Per të rivendosur ne vend të drejtat kushtetuese e ligjore të shkelura ankuesve, bazuar ne Nenin 44 të Kushtetutes tone, ku percaktohet se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdemtohet ne perputhje me ligjin, ne rast se është demtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshem të organeve shteterore”*, si dhe ne nenet 14, 121/1 dhe 124/1 të K.Pr.Administrative kemi rekomanduar marrjen e masave për revokimin e urdhërit nr. 31, datë 15.03.2010 *“Për nxjerrje në lirim nënoficeri”* për ankuesit.

Me shkresën Nr.970 datë 07.06.2010, pavarësisht argumentave të parashtruara, rekomandimi i sipërtreguar është refuzuar me arsyetimin se revokimi i urdhërave të nxjerrjes në lirim dhe rikthimi i tyre si ushtarakë aktivë është i pamundur nga ana e Komandës së Forcës Tokësore. Kundër urdhërave të lirimit këta ushtarakë kanë bërë ankim në gjykatë. Në këto rrethana Institucioni i Avokatit të Popullit duke parë nenin 14 të Ligjit *“Për Avokatin e Popullit”* sipas të cilit Avokati i Popullit ndërpret hetimin e rastit kur ai është në shqyrtim nga gjykata, ka vendosur në përputhje me këtë dispozitë të ligjit.

**5.** Legjislacioni aktual garanton të drejtën e personave qe kane perfituar statusin e të verberit për të perfituar pagesa për shkak të aftesise se kufizuar. Perfitimet financiare të kesaj shtrese garantohen nga

dispozitat e Ligjit nr.8098 date 28.03.1996 “Per Statusin e të Verberit”, si dhe aktet nenligjore: VKM nr.277 date 18.06.1997 “Per perfitimet nga Statusi i të Verberit” si dhe Udhezimi nr.1766/1 date 17.09.2003.

Gjate trajtimit të ankesave të depozituara është konstatuar se organet e administratës publike, gjatë ushtrimit të veprimtarise se tyre për trajtimin financiar të kesaj kategorie kanë shkelur këtë të drejtë, duke mos u dhene personave qe e perfitojne këtë të drejtë, trefishin e pageses, për shkak të verberise.

Konkretisht u konstatua shkelje e pikes 7, të VKM-se nr.277 date 18.06.1997 “Për perfitimet nga Statusi i të Verberve”, ne të cilin percaktohet se:

*“...Studentet e shkollave të larta dhe ata qe janë perfshire ne studimet pasuniversitare si dhe kane mbrojtur graden doktor i shkencave, perfitojne trefishin e pageses për shkak të verberise, të percaktuar ne piken 4 të ketij vendimi.*

*Keto pagesa do të behen vetem kur vazhdimi i shkollave ose i kurseve vertetohet nga titullaret e shkollave të mesme apo të larta dhe jo me shume nga cikli normal i studimit...”* si dhe pika 8 e Udhezimit nr.1766/1 date 17.09.2003 pika 8, ne të cilin percaktohet se:

*“Kur i verberi ndjek arsimin e larte dhe kursin e kalifikimit njekohesisht perfitojne vetem njerën nga pagesat e percaktuara ne piken 4 të VKM-se nr.277 date 18.06.1997”.*

Ne permbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore ne mbrojtje të te drejtave të fëmijëve, të personave me aftesi të kufizuar dhe të moshuarve, Institucioni i Avokatit të Popullit ne vitin 2009 ndërmori me iniciativen e tij, Inspektive ne 22 Qendra të Perkujdesit Shoqeror, ku trajtohen këto kategori ne nevojë. Gjatë inspektiveve u konstatuan disa shkelje të te drejtave të tyre. Për permiresimin e kushteve të jeteses dhe për një sherbim sa me cilesor ne kuader të plotesimit të standarteve të sherbimeve sociale, proceduam me Rekomandime për Ministrine e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve të barabarta, Sherbimin Social Shteteror si dhe për Kryetaret e Bashkive, ne ato qytete ku funksionojne qendrat rezidenciale. Nga ana e Institucioneve perkatese u moren ne konsiderate Rekomandimet tona dhe na u kthye pergjigje se ne vazhdimesi do të plotesoheshin kerkesat e parashtruara nga ana jone.

Gjate viti 2010, për zbatimin e Rekomandimeve të bëra ne vitin 2009, Avokati i Popullit vijoi inspektimet ne Qendrat e Perkujdesit Shoqeror. U konstatua se nuk ishin plotesuar të gjitha rekomandimet e lena nga ana jone. Duke qenë se ne kuader të reformes për decentralizimin e sherbimeve të perkujdesit shoqeror për kategorie ne nevojë, këto sherbime kane kaluar ne administrim të njesive të qeverisjes vendore, proceduam perseri me rekomandime. Na janë kthyer pergjigje



nga Bashkia Shkoder dhe Durres, ende nuk na janë kthyer pergjigje nga Bashkia Lezhe, Korce, Kavaje, Berat.

*Avokati i Popullit, do të vijojë edhe gjatë vitit 2011 me Inspektime ne këto qendra, deri ne plotesimin e të drejtave të ligjshme të personave qe trajtohen ne Qendrat e Perkujdesit Shoqeror, pasi standartet e sherbimeve shoqerore janë të rendesishme për të garantuar dhe zhvilluar me tej të drejtat e shtetasve shqiptare të sanksionuara si ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë, ne Konventat Nderkombetare të ratifikuara nga Qeveria shqiptare dhe ne legjislacionin e brendshem.*

Gjithashtu jemi të mendimit se për një sherbim sa me cilesor dhe efikas ne Qendrat e Zhvillimit ku strehohen persona ne nevojë, të cilet perfitojne pagesen e aftesise se kufizuar sipas Ligjit nr.9355 date 10.03.2005 “Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore”, të ardhurat e ketyre personave, (aktualisht pagesat merren nga familjaret), të kalojne ne të ardhura të Qendrave. Kjo do të ndikojë ne rritjen e buxhetit, e kerkuar çdo vit nga ana e drejtuesve të qendrave të perkujdesit shoqeror.

Problematika e mesiperme, konkretizohet ne rastet e meposhteme:

Ankesa me **nr.201000078**, Një shtetase me banim ne Tirane, e cila gezonte shtatusin e të verberit, ankohej për mosperfitim të trefishit të pageses për shkak të verberise, sepse pas mbarimit të fakultetit të pare ne vitin 2000, ndiqte një fakultet të dyte. Nga Seksioni i Ndhimes dhe Perkrahes Sociale prane Njesise Bashkiake nr.11 nuk i jepej e drejta për të perfituar trefishin e pageses për shkak të verberise.

Për këtë çeshtje, ne proceduam fillimisht me kerkese për shpjegime dhe duke qenë se konstatuam se ishte shkelur e drejta e saj, i Rekomanduam Kryetarit të Njesise bashkike nr.11, dhenien e trefishit të pageses për shkak të verberise, rekomandim, i cili u pranua dhe ankueses iu dha e drejta e mohuar, duke perfituar trefishin e pageses për periudhen Tetor 2009- Shkurt 2010.

Ankesa me **nr.201000354** e Forumit të Shoqatave të Aftësisë së Kufizuar, Gramsh, kërkonte nxjerrjen e një akti nënligjor për përjashtimin e kategorive në nevojë nga pagimi tarifave të shërbimit në zbatim të Ligjit nr.9975, dt.28.07.2008 “Për taksat kombëtare”. Pas Rekomandimeve të përsëritura drejtuar Ministrit të Financave për ndryshime në Ligjin nr.9975, dt.28.07.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, erdhi reagimi pozitiv që u konkretizua me Ligjin nr.10280, dt.20.05.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9975, dt.28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, ku u shtua Neni 11/1, që përjashtonte invalidët e punës, të luftës kundër kundër pushtuesve nazifashistë, veteranët e luftës dhe personat e verbër nga pagimi i tarifave të shërbimit për shërbimet konsullore, të përdorimit të aparateve televizivë e për Radiotelevizionin Publik, për pajisjen me pasaportë lundrimi, etj.

## Kreu III

### **Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar kundër Torturës**

#### **1. Mandati ligjor dhe veprimtaria monitoruese**

Gjatë vitit 2010 roli i Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është shndërruar në një detyrë funksionale të konsoliduar duke u mbështetur me prioritet të veçantë. Në një hark kohor prej tre vjetësh Institucioni i Avokatit të Popullit ia ka arritur të ngrejë dhe vërë në funksionim një strukturë efektive për t`ju përgjigjur me profesionalizëm çdo fenomeni zyrtar që mbart brënda tij shkelje të të drejtave të njeriut, torturë, trajtim çnjerëzor dhe degradues. Gjatë vitit 2010 kjo veprimtari ka vijuar të shënojë rritje cilësore në parandalimin e fenomeneve të mësipërme, promovimin e praktikave pozitive dhe forcimin e dialogut me autoritetet.

Funksioni i Mekanizmit të Parandalimit të Torturës i është atribuar Institucionit të Avokatit të Popullit që në Janar të Vitit 2008. Ashtu siç kemi permendur edhe në raportimet e mëparshme, kësaj ngjarje i paraprinë propozimet zyrtare të Institucionit tonë mbi mënyrën se si duhet të vihej në zbatim Ligji Nr.9094 dt.03.07.2003 “Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”. Me anë të këtij propozimi, synohej që krijimi dhe vënia në punë e një strukture kombëtare për parandalimin e torturës, siç kërkonte (OPCAT), të atashohej pranë Avokatit të Popullit, i cili përfaqësonte një profil institucional të përshtatshëm. Pranimi i këtij propozimi nga Qeveria Shqiptare, duke shtuar kapacitetet financiare dhe njerëzore për vitin 2008 e vijim, shënoi dhe fillimin e aktivitetit tonë në këtë fushë.

Në punën tonë, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, zbatojme një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare që normojnë dhe mandatojnë veprimtarinë tonë të përditshme. Konkretisht, sipas pikës 1 të nenit 60 të Kushtetutës së Shqipërisë, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”. Nisur nga nevoja për të përmbushur një monitorim më të madh të institucioneve ku liria e personave është e

kufizuar, ku dhe probabiliteti për shkelje është më i lartë, janë paraparë të rëndësishme për zbatim edhe dispozitat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)” miratuar me Ligjin Nr. 9094, dt.03.07.2003.

Këto dispozita parashikojnë parimet bazë të inspektimeve në institucionet e mësipërme dhe garantojnë një aktivitet konform standarteve kombëtare në këtë drejtim.

Gjithashtu, neni 19/1, i Ligjit Nr.8454, date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, autorizon një veprimtari monitoruese dhe hetimore të pavarur, të gjithanshme dhe të plotë për çdo rast torture, trajtimi çnjerëzor dhe degradues, duke garantuar akses te madh në çdo ambjent apo zyrë, ndaj çdo zyrtari pa imunitet dhe mbi çdo dokumentacion, qofte dhe të klasifikuar të organeve të administratës publike.

Edhe ndryshimet e kryera në Mars 2010, në Ligjin Nr.8328 datë 02.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, bën të mundur shfrytëzimin e një hapësire më të madhe të Avokatit të Popullit në funksionin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës (MKPT) për të kryer detyrat e tij gjatë kontrollit të shërbimeve penitenciare. Në Nenin 74 të këtij ligji, Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së, i njihet e drejta si subjekt i veçantë për mbikëqyrjen e zbatimit dhe realizimit të ligjit për të denuarit dhe paraburgosurit. Ai gëzon kompetenca për të vëzhguar rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruar. Gjithashtu, në këtë dispozitë njihet e drejta që ky Institucion të paraqesë në mënyrë specifike raporte dhe rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruar.

Inspektimet, vizitat dhe çdo kontroll tjetër i kryer në Institucionet e Policisë së Shtetit, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (burgje dhe paraburgime), në Spitale Psikiatrike dhe Infektive, në baza dhe reparte ushtarake, në Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit si dhe në qendrat e tjera të strehimit të emigrantëve të paligjshëm dhe personave të trafikuar, ka patur si objektiv të sigurojë një mbulim të plotë monitorues mbi situatën e të drejtave të njeriut në këto organe, të parandalojë shkeljet, si dhe të artikulojë një qëndrim realist zyrtar mbi situatën në terren.

Gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer 162 inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita në të gjitha vendet e privimit

të lirisë dhe institucionet e tjera të përmendura më sipër. Krahas kësaj, kjo strukturë ka trajtuar edhe rreth 370 ankesa të individëve të marra gjatë kontakteve direkte në inspektimet e kryera. I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me 81 rekomandime dhe me një korrespondencë zyrtare të dëndur për të sqaruar shumë detaje dhe fenomene të konstatuara gjatë inspektimeve.

Në dallim nga aktiviteti i zhvilluar në këtë drejtim për vitin 2008, (50 inspektime dhe vizita) dhe gjatë vitit 2009 (150 inspektime, riinspektime dhe vizita), veprimtaria monitoruese për vitin 2010 vijon të rritet në tregues dhe cilësi, duke dëshmuar një rendiment të lartë pune dhe një prezencë të shtuar në terren pranë institucioneve përkatëse.

Rekomandimet dhe ndërhyrjet e mësipërme janë prezantuar kryesisht për respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve, në plotësimin e nevojave të tyre jetësore, shëndetësore dhe arsimore.

Gjithashtu, janë propozuar edhe një sërë masash të tjera për kryerjen e investimeve të brendshme infrastrukturore, në plotësimin e efektivit punonjës me qëllimin mbulimin e plotë të shërbimeve të kërkuara nga këto qendra. Përveç kësaj është mbajtur në konsideratë veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me administratën e burgjeve për të cilën do flitet gjerësisht në vijim. Avokati i Popullit ka vijuar të ndjekë me përparësi cilësinë e komunikimit nëpërmjet numrit pa pagesë që ofron zyra jonë ndaj të dënuarve dhe paraburgosurve si dhe të funksionimit të kutive të posaçme postare që hapen vetëm nga personeli i Avokatit të Popullit në çdo burg dhe paraburgim. Ky projekt, falë dhe ndihmës dhe mbështetjes së dhënë nga Misioni i OSBE-së në Tiranë, vazhdon të jetë efektiv dhe tepër i dobishëm. Për vitin 2010, Avokati i Popullit si Mekanizem Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka realizuar rreth 250 telefonata me të dënuar dhe paraburgosur, nga të cilat janë marrë njoftime dhe janë rregjistruar ankesa konkrete për zgjidhje. Ndërkohë, nga kutitë postare të instaluar në të gjitha qendrat e burgjeve dhe paraburgimit janë marrë edhe 120 ankesa apo kërkesa të cilat janë shqyrtuar me përparësi dhe në shumicën e rasteve ju është dhënë zgjidhje.

Avokati i Popullit si Mekanizem Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambjenteve të Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda Komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre etj.

Gjatë vitit 2010, janë kryer sondazhe në shërbimet policore, mbi mënyrën e trajtimit administrativ të rasteve të shoqërimit të shtetasve, për mbajtjen e objekteve të dyshimta në zyrat e hetimit që mund të provokojnë dhunë psikologjike tek individët, si dhe për rolin e psikologut

të policisë në trajtimin e personave të mitur dhe të efektivave që mund të shfaqin probleme psikologjike gjatë shërbimit. Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve eprore të Policisë së Shtetit. Në bashkëpunimin dhe kryerjen e detyrave të tij në Policinë e Shtetit, Avokati i Popullit vijon të kërkojë zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe të dokumentit të miratuar gjatë vitit 2009 për Metodologjinë e Inspektimeve në Organet e Policisë së Shtetit. Ky dokument ka vazhduar të udhëheqë mbi baza profesionale dhe ligjore punën e bere në këtë fushë, duke dhënë rezultate shumë pozitive.

Një tjetër fushë ku është fokusuar gjatë vitit 2010 aktiviteti i Avokati i Popullit si Mekanizem Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka qenë edhe monitorimi i standarteve të të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kjo veprimtari ka qenë e përqëndruar veçanërisht në trajtimin e të drejtave të ushtarakëve, respektimin e statusit të tyre, kontrollin për masat disiplinore dhe kushteve të dhomave të ndalimit disiplinor. Për këtë qëllim, janë organizuar inspektime të shpeshta në bazat dhe repartet ushtarake, ku janë marrë kontakte me ushtarakët dhe është bere njohja nga afër me kushtet e trajtimit të tyre dhe nivelin e zbatimit të akteve nënligjore që normojnë jetesën e tyre, brenda institucioneve ushtarake.

Produkt i aksesit tonë në këto baza kanë qenë prezantimi i rekomandimeve të veçanta të Avokatit të Popullit, të cilat kanë ngritur veçanërisht probleme mbi hartimin dhe miratimin e rregulloreve të reja për izolimin disiplinor, trajtimin me të drejta të barabarta të efektivit ushtarak sipas statusit ligjor që ata gëzojnë, realizimin e procedurave transparente në rastet e izolimit të tyre, përmirësimin e kushteve të ambjenteve etj.

Për të gjitha këto problematika flitet më gjerësisht në rubrikën përkatëse të këtij raporti.

Gjatë vitit 2010, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer rreth 32 inspektime, ri-inspektime, vizita dhe kontrole tematike në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Elbasan, Qendrat Spitalore Infektive pranë QSUT-së dhe Spitalit Ushtarak, Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, Ambientet e të Deportuarve në Komisarriatin e Policisë Kufitare Rinas-Tiranë, Institutin e të Miturve Kavajë, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Trafikut në Linzë dhe Qendrën Kombëtare të Pritjes së Azilkërkuesve Babrru-Tiranë. Për të gjithë këtë veprimtari janë hartuar mbi 10 rekomandime për përmirësimin e shërbimeve spitalore në respekt të të drejtave të individëve.

Inspektimet kanë patur një rol të madh në evidentimin e problematikave që ekzistojnë në këto institucione lidhur me kushtet dhe

mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse.

Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në respektimin dhe zbatimin e ligjit për të drejtat dhe liritë e individit në këto institucione, por dhe për mënyrën funksionale të strukturës institucionale të përshtatur me profesionalizëm sipas standarteve të kërkuara konform me ligjin, si dhe kushtet infrastrukturore në ambientet e këtyre institucioneve.

Gjithashtu, për arritjen e këtij procesi një rëndësi të veçantë ka dhe trajtimi me rigozitet nga ana jonë e ankesave të shtetasve që trajtohen në këto institucione.

Tematika e inspektimeve në këto institucione shëndetësore dhe qendra sociale, ka qene:

1. Plotësimi i të gjitha kushteve, sipas dispozitave ligjore në ambientet ku qëndrojnë të sëmurët me probleme të shëndetit mendor dhe trajtimi i tyre me profesionalizëm nga stafi mjekësor.

2. Trajtimi i kësaj kategorie personash me terapi psiko-sociale, sipas specifikave të veçanta që parashikon ligji në këto raste.

3. Monitorimi i hapësirave ku aplikohet terapia intensive, si procedurë për raste të veçanta persa i përket kufizimit fizik, nëpërmjet përdorimit të forcës (me mjete të standartizuara) në ambiente ku praktikohet kjo procedurë.

4. Përmirësimi i kushteve në ambientet e rikreacionit për fëmijët me prapambetje mendore, me të gjitha mjetet e nevojshme për rehabilitim psiko-social intensiv, me qëllim përshkallëzimin e gjendjes së mëparshme dhe ndryshimin gradual të tyre, në raport me diagnostikimin fillestar.

5. Monitorimi i ambienteve karantinë në spitalet infektive me qëllim përmirësimin e mënyrës të trajtimit të personave të infektuar në rastet e një epidemie masive.

6. Përmirësimi i kushteve në Spitalet Infektive për mbajtjen e të sëmurëve në dhoma të kategorizuara sipas diagnozave mjekësore, me qëllim evitimin e çdo lloj risku në rikontaminimin e tyre gjatë rehabilitimit në këto spitale.

7. Kontrolli i vazhdueshëm i respektimit të formës së shtrimit të pacientëve me sëmundje infektive të përcaktuar.

8. Respektimi i dispozitave ligjore nga Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për të miturit dhe femrat, parashikuar në ligjin Nr.8328 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve”*, lidhur me kujdesin shëndetësor, riaftesimin në jetën sociale me forma punësimi brenda institucionit, angazhimin total në aktivitete shoqërore, shkollimin me arsim për kategori të ndryshme, liçensimin nëpërmjet kurseve profesionale, ndikimin e stafit përgatitor kujdestar për të mundësuar rehabilitimin shoqëror të tyre.

9.Lidhur me viktimat e trafikut të qënieve njerëzore; monitorimi i kushteve që ofrohen për jetesë, kujdesi shëndetësor ndaj tyre, ndjekja e vazhdueshme për gjendjen e tyre psikologjike, angazhimi në aktivitete sociale me qëllim rehabilitimin e tyre në shoqëri.

10.Këqyrja e kushteve në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Azilkërkuesve, trajtimi i tyre si dhe shërbimi që ofrohet në zbatim të respektimit të të drejtave të tyre në përputhje me ligjin.

11.Inspektimi i ambienteve të qëndrimit si dhe mënyra e trajtimit të personave të deportuar në Komisaritet e Policisë Kufitare ku ka të tilla. Dhënia e detyrueshme e ndihmës juridike si dhe asaj psikologjike kur ka të mitur, sipas përcaktimit të bërë në Ligjin për “*Policinë e Shtetit*”.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit në përfundim të monitorimeve të kryera kanë ngritur një sërë çështjesh me mjaft interes për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të individëve që strehohen përkohësisht në spitalet psikiatrike, spitalet infektive, qendrat komunitare të trajtimit të personave me probleme të shëndetit mendor, në Qendrën e Trajtimit të Viktimave të Trafikut Linzë Tiranë etj. Në tërësinë e tyre problemet e ngritura vijnë të jenë kryesisht për mungesa në pajime, investime ambjentesh të amortizuara, rritje të normës ushqimore, trajtime financiare të personelit punonjës etj.

Nga ana e autoriteteve përgjegjëse për marrjen e këtyre masave është vënë re një reagim i shpejtë dhe tepër pozitiv për shumë çështje me karakter emergjent, gjithësesi mbeten ende për t'u ndjekur edhe në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të individëve që strehohen në këto institucione.

**Raste të shqyrtuara në kuader të inspektimeve në Ambientet e të Deportuarve në Komisaritet e Policisë Kufitare Rinas-Tiranë, Institutin e të Miturve Kavajë, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Trafikut në Linzë dhe Qendrën Kombëtare të Pritjes së Azilkërkuesve Babrru-Tiranë si dhe rekomandime.**

1. Çështja e filluar me inisiativë me **nr.201001024**, në Institutin e të Miturve Kavajë (*bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.9888 datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8328 datë 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”*).

Në këtë institut është konstatuar se, numri i punonjësve të policisë të rolit bazë është i pamjaftueshëm për mbikqyrjen e dhomave të izolimit dhe ambienteve të tjera gjatë natës. Nuk ka angazhim të minorenëve në marrëdhënie pune brenda institucionit dhe mungon një mjek stomatolog për kryerjen e të gjitha mjekimeve, pasi paisjet e duhura ndodhen në këtë institucion.

Pas këtyre konstatimeve nga jone është rekomanduar;

-Të bëhet shtesë në organikën për punonjësit e policisë të rolit bazë për mbikëqyrjen e dhomave të izolimit dhe ambienteve gjatë natës, me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor ndaj të miturve.

-Ngritja e një organike pune për minorenët me qëllim angazhimin e tyre në marrëdhënie pune brenda institucionit për të arritur ri integrimin e tyre në jetën sociale.

-Marrja e masave për shtimin e një stomatologu part-time në organikën mjekësore, me qëllim mundësimin e këtij shërbimi brenda ambienteve të këtij institucioni, pasi pajisjet për këtë shërbim ndodhen në këtë institucion.

Sa më sipër Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në përgjigjen e saj, lidhur me trajtimin e të miturve në I.E.V.Penale Kavajë, shprehet se janë realizuar kërkesat për disa nga problematikat e konstatuara si shtimi me 6 punonjës në organikë për punonjësit e rolit bazë, në lidhje me mbikëqyrjen e dhomës së izolimit dhe ambienteve gjatë natës, me mundësi komandimi derisa të miratohet definitive shtimi në organikë i tyre. Është bërë e mundur ngritja e një organike pune për minorenët me qëllim aktivizimin e tyre në këtë marrëdhënie brenda institucionit dhe së shpejti do të merren masat e duhura për të ofruar një shërbim stomatolog në këtë institucion.

**2. Çështja e filluar me inisiativë me nr.201000405 në I.E.V.P. 313 (bazuar në percaktimet e ligjit Nr.9888 datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8328, datë 16.04.1998 Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”).** Në këtë qendër u konstatua se, në dhomat dhe ambientet e ndryshme të kësaj qendre ka lagështirë. Trajtimi me ndihmë financiare mujore nuk përfitohet nga personat që strehohen në këtë qendër sipas dispozitave ligjore si dhe mungon sistemi parashkollor për fëmijët. Numri i personelit psikolog, kujdestar, mjek ose infermier dhe përkthyes është tepër i limituar për këtë kategori personash, gjithashtu në magazinën e guzhinës nuk ka një frigorifer me përmasa të mjaftueshme për mbajtjen e produkteve ushqimorë.

Pas këtyre konstatimeve nga ana jonë është rekomanduar:

-Rikonstruksioni sa më parë i ambienteve të burgut për regjimin e grave, përmirësimi i plotë i kushteve të të paraburgosurave, evitimi i lagështirës në dhoma, korridore dhe ambiente të tjera.

-Marrja e masave për dizinfektimin e ambienteve për zhdukjen e minjve dhe insekteve, gjë e cila do të ndihmonte në evitimin e ndonjë epidemie të mundshme në sezonin e verës ose zëvendësimin e tualeteve me tualete të rinj, të modeluar për të evituar daljen e brejtësve nëpër qeli.

-Evitimi i dëgjimit të takimeve nga ana e personelit mbikëqyrës dhe krijimi i kushteve normale të privatësisë, sipas ligjit, si dhe krijimi i kushteve më të mira për takimin e minorenëve me familjarët e tyre.



-Krijimi i kushteve për ngrohje në stinën e dimrit në ambientet e paraburgimit të femrave dhe të të miturve.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në përgjigjen e saj njoftoi përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e femrave dhe të miturit duke realizuar disa nga problematikat e konstatuara, si kryerjen e menjëhershme të dizeinfektimit në sektorin e femrave dhe marrjen e masave të nevojshme nga sektori përgjegjës mbikqyrës për evitimin e dëgjimit të takimeve të të paraburgosurit me familjarët. Për vitin 2011-2013, me projekt buxhetin afat mesëm është parashikuar projektimi dhe ndërtimi i një paraburgimi të ri. Por nuk është realizuar një nga pikat e rekomandimit që ka të bëjë me sistemin e ngrohjes në regjimin e femrave dhe të miturve.

Në I.E.V.Penale 313 në regjimin ku qëndrojnë femra e të mitur është konstatuar se, ambientet e qëndrimit të tyre kanë hapësirë të vogël, dritaret e dhomave janë me përmasa të pamjaftueshme për ajrosje, ka amortizim të godinës, prezencë të lagështirës nëpër dhoma dhe korridore si dhe mosfunksionim të sistemit të ngrohjes. Në tualetet e regjimit të femrave ka prezencë të vazhdueshme të brejtësve gjatë stinës së verës. Gjatë takimeve me familjarët nuk ofrohen kushtet e privatësisë nga personeli mbikqyrës sipas ligjit.

**3.**Çeshtja e filluar me inisiativë me **nr.201000522**, në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve (*bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”*).

Pas ketyre konstatimeve nga ana jone është rekomanduar;

-Lëvrimi i fondeve për rikonstruksionin e godinave me qëllim eliminimin e lagështirës në dhoma dhe ambiente të tjera sociale.

-Trajtimi me ndihmë financiare mujore të personave që strehon qendra siç përcakton ligji nr 1060, dt.26.01.2009, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”*”, neni 13/b përcakton se: “*Azilkërkuesit do ti garantohet e drejta e strehimit, e ushqimit, e ndihmës financiare për nevoja ngutësisht vetjake, të ofruara në qendrën kombëtare pritëse për azilkërkuesit*”.

-Krijimi i kushteve financiare për shtimin e numrit të punonjësve me psikolog, kujdestar, mjek ose infermier dhe një përkthyes me kohë të plotë, ose të pjesshme.

-Ngritja e sistemit parashkollor për fëmijet duke caktuar edhe edukator përkatës. Shtimi në magazinën e guzhinës një frigorifer të përmasave të mjaftueshme për mbajtjen e produkteve ushqimore, para afrimit të stinës së verës.

**4.**Në Qendrën Kombëtare të Viktimave të Trafikut Linzë Tiranë konstatohet se, ishte miratuar rregullorja e veçantë për rregullimin e jetës së brendshme të qendrës në gjuhën shqipe dhe angleze. Ishte realizuar hapja e kartelave të veçanta për çdo emigrant që strehohet në qendër si

dhe ishte ngritur komision për ekzaminimin e gjendjes shëndetësore të çdo emigranti. Por verehej se, në katin e dytë të kësaj ndërtese ka lagështirë e cila e bën atë të papërshtatshme për jetesë.

Lidhur me lagështirën që ka objekti në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikimit, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shprehet se, për eliminimin e lagështirës në katin e dytë, është parashikuar fondi prej 5 milion lekë, i cili do të menaxhohet dhe administrohet nga drejtuesi i këtij institucioni.

5. Në Komisarlatin e Policisë Kufitare Rinas Tiranë është konstatuar se, godina e pritjes së të deportuarve përbëhet nga 1 ambient për madhorë, 1 ambient për femra dhe 1 ambient për të mitur. Të 3 ambientet janë me përmasat e duhura dhe me ndriçim të plotë, si dhe të gjitha pajisjet (tavolina, karrike) janë sipas standarteve të kërkuara. Ishin të afishuara të drejtat dhe liria e personave të deportuar përgjatë qëndrimit të tyre në këto ambiente. U vu re se, salla e pritjes dhe ambienti i intervistimit për personat e ndaluar, kishin parametrat dhe kushtet sipas standarteve të kërkuara në ligj. Gjithashtu tualetet ishin të ndarë dhe të veçuar sipas kategorive të këtyre personave, madhorë, femra dhe të mitur. Në të gjitha ambientet, kushtet higjeno-sanitar ofroheshin me një cilësi të pranueshme.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës pasi ka konstatuar të gjitha problematikat e hasura në subjektet e cituara më sipër, ka paraqitur rekomandimet përkatëse në institucionet respektive.

Gjatë vitit 2010 Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), ka kryer rreth 60 inspektime, ri-inspektime dhe kontrole tematike në të gjitha Burgjet dhe Paraburgimet e vendit, të cilat janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrisë së Drejtësisë. Ne perfundim të këtyre inspektimeve, janë hartuar dhe paraqitur 29 rekomandime, në lidhje me përmirësimin e standarteve të të drejtave dhe trajtimit të individëve që strehohen në këto institucione.

Gjatë inspektimeve të kryera janë marrë dhe trajtuar edhe rreth 370 ankesa të të dënuarve dhe paraburgosurve, për të cilat ka patur zgjidhje të rastit nëpërmjet ndërhyrjeve përkatëse. Në këtë numër bëjnë pjesë edhe rreth 120 ankesa të siguruara nëpërmjet kutive postare të vendosura në ambientet e brendshme penitenciare, të cilat hapen vetëm nga punonjës të Avokatit të Popullit për të ruajtur konfidencialitetin. Gjatë inspektimeve janë takuar dhe intervistuar rreth 900 të dënuar, të cilëve krahas ankesave të marra, ju janë dhënë këshillime juridike dhe sqarime të tjera të nevojshme. Me të dënuarit dhe paraburgosurit janë mbajtur kontakte edhe nëpërmjet linjës telefonike falas të vënë në dispozicion të tyre, duke

përmbushur gjatë vitit 2010, rreth 250 komunikime telefonike me tematika të ndryshme.

Për të promovuar edhe më tej të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe paraburgosurve dhe eliminimin e çdo rasti dhune, torture, trajtimi jo human dhe degradues, Avokati i Popullit ka organizuar gjatë vitit 2010 rreth 10 aktivitete të përbashkëta me administratën penitenciare, në të cilat janë kombinuar një seri nevojash të përbashkëta për shkëmbimin e eksperiencës, trajnimin, informimin për standartet ndërkombëtare, ballafaqimin e problemeve dhe nxitjen e dialogut etj.

Sipas referimeve në legjislacionin tonë, brenda termit administratë publike janë të përfshira edhe institucionet shtetërore që mbulojnë sistemin penitenciar (burgjet dhe paraburgimet). Brenda këtyre institucioneve, individit gëzon realisht statusin e personit të privuar nga liria. Kjo kategori e ambjenteve të mësipërme është konsideruar dhe trajtuar gjatë vitit 2010, si objekt monitorimi i punës tonë.

Në realizim të kësaj detyre, Avokatit të Popullit në këtë ligj i njihen edhe një sërë kompetencash të posaçme për të realizuar një akses të plotë në këto ambjente, duke marrë midis të tjerash, çdo informacion në lidhje me numrin e individëve që u është hequr liria dhe vendodhjen e tyre, mënyrën e trajtimit të këtyre individëve, kushtet e tyre të ndalimit etj.

Gjithashtu është parashikuar se në rolin e MKPT-së, institucioni ynë mund të marrë në çdo kohë dhe pa pengesë informacione apo ankesa nga të dënuarit ose nga administrata e burgut dhe paraburgimit, të verifikojë në çdo kohë dokumenta, objekte, pajisje ose mjedise, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, si brenda, ashtu dhe jashtë institucionit penitenciar. Për realizimin e procesit të mbikqyrjes, MKPT i njihet e drejta nga ky ligj që të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse, qofshin këta mjek ligjor, psikolog, psikiatër etj.

### **Problematikat e sistemit penitenciar**

1) Avokati i Popullit ka vijuar të kerkojë me insistim një zgjidhje perfundimtare për strehimin në një ambjent spitalor, jashtë sistemit të burgjeve, të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar. Institucioni ynë e ka ngritur çdo vit kete çështje, madje gjatë vitit 2008, nepermjet Raportit të Veçantë Nr.2, “Për Gjendjen e Shendetit Mendor” paraqitur Kuvendit të Shqipërisë dhe nuk është pajtuar aspak me situatën në të cilën ende këta persona mjekohen brenda ambjenteve të sistemit të burgjeve. Megjithë përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për të krijuar një ambjent të përshtatshëm, trajtimi i kësaj kategorie personash aktualisht vijon të mbetet i paligjshëm.

2) Edhe gjatë vitit 2010, prej burgjeve dhe paraburgimeve në vend vijnë të vuajnë nga probleme të amortizimit, veçanërisht të lageshtirës,

mungesës së ujit, furnizimit me probleme të energjisë elektrike, pranise periodike të brejtesve, kushteve jashte standarteve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambjenteve të ajrimit, dhomave të izolimit, mungeses se ambjenteve të edukimit, ushtrimit të riteve fetare, veprimtarise sportive etj. Avokati i Popullit perserit nevojën urgjente për investime kryesisht të pjesshme që do të përmirësojnë ndjeshëm kushtet ekzistuese. Gjithashtu, konstatohet me mjaft shqetësim se, disa prej burgjeve dhe paraburgimeve të reja, po amortizohen shumë shpejt nga lageshtira, cilësia e dobët e punimeve dhe pajisjeve të instaluar, çka përben një problem të rëndë për garancinë afatgjatë të investimeve në këtë fushë në respekt të standarteve ligjore të kërkuara.

3) Edhe gjatë vitit 2010, në disa prej burgjeve dhe paraburgimeve u konstatuan se nuk ofrojnë auto-ambulanca të kompletuara me mjetet e domosdoshme të ndihmes së parë, por thjesht disa mjete transporti (furgon) për transferimin e të semurve në spitale. Për shkak të mbipopullimit dhe amortizimit të ambjenteve, në disa prej burgjeve dhe paraburgimit dhomat e vizitave mjeksore janë të papershtatshme dhe nuk mundësojnë një shërbim normal shëndetësor. Në disa raste janë vënë re mungesa e kontrollit periodik ndaj ilaçeve të skaduara. Avokati i Popullit vijon të konstatojë me shqetësim se trajtimi financiar i personelit shëndetësor në burgje është i pamjaftueshëm dhe jo i barabartë me shërbimin shëndetësor civil.

4) Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2010 konstatoi se disa prej punonjësve të policisë së burgjeve nuk përfituan shpërblimet e prapambetura për shërbimet jashtë orarit apo ditëve të pushimit. Rroga e tyre është në nivele jo motivuese krahasuar me vështirësitë e punës dhe mungon ende një uniformë e veçantë me shenja identifikuese për çdo punonjës.

5) Gjatë vitit 2010 Avokati i Popullit konstatoi se në disa burgje dhe paraburgime vijon ende të mbetet problem mungesa e kamerave të survejimit, ose mos vendosja e tyre në vende ku të mbulohet i gjithë ambienti penitenciar. Mungesa dhe mos pozicionimi i tyre i saktë, për shkak të numrit të pakët, është bërë në disa raste shkak për mos evidentimin e ngjarjeve të dhunës, si dhe në mos marrjen në kohe të masave për dënimin e ndihmes së parë apo ndërhyrjen në kohe për ngjarje të veçanta brenda rregjimeve të sigurisë.

6) Një problem që vijon të mbetet edhe gjatë vitit 2010 ka qënë llogaritja e kohës së paraburgimit, duke qëndruar në këte rregjim edhe mbasi vendimet gjyqësore kanë marrë formë të prerë. Në këtë drejtim është kërkuar nga të dënuarit që ndaj tyre të zbatohen kërkesat e nenit 57 të K.Penal, ku 1 ditë paraburgim t'u njihet e barabartë me 1 ditë e gjysëm burgim. Nga institucioni ynë ky problem është ngritur disa here, madje edhe Kuvendit të Shqipërisë për faktin se disa persona kanë qëndruar nga

disa muaj në paraburgim mbasi vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë. Per kete, është kërkuar të bëhet plotësim i Ligjit nr.7941 datë 31.05.1995 për hyrjen në fuqi të Ligjit nr.7895 datë 27.01.1995 “Për Kodin Penal në Republikën e Shqipërisë”, që të përfitojnë edhe personat e dënuar dhe të mbajtur për disa kohë në kushte paraburgimi. Kjo kerkese, megjithë interesimin e madh të institucioneve kompetente, nuk ka marre ende nje zgjidhje perfundimtare.

7) Kemi konstatuar se, gjatë vitit 2010, ulja e numrit të të denuarve dhe paraburgosurve ka qenë minimale dhe nuk ka lehtësuar në masë të konsiderueshme mbipopullimin e institucioneve penitenciare. Mbipopullimi ka vijuar të sjellë paraqitjen e ankesave nga ana e të denuarve të cilet pretendojne se nuk respektohet vuajta e denimit prane qendres se banimit siç percakton ligji, ka reduktuar ambientet e brendshme të burgjeve dhe paraburgimeve për qëllime edukative, shendetesore etj. Avokati i Popullit ka shtruar si nevojë emergjente krijimin e hapësirave të reja të paraburgimit veçanerisht në Tiranë për vetë numrin e madh të personave që gjenden në institucionet ekzistuese.

8) Edhe gjatë vitit 2010 burgjet dhe paraburgimet në vend nuk arritën të marrin masa për të trajtuar brenda kushteve minimale të aksesit në veprimtaritë e përditshme jetësore, personat me aftësi të kufizuara (të paralizuar, të sëmurë mendorë, shurdh-memec etj). Ky konkluzion ka dale për shkak të mungesës së personelit për t`ju përgjigjur të gjitha nevojave të kësaj kategorie personash, si dhe mungesës së pajisjeve për të mundësuar një trajtim sa më të pershtatshëm të paaftesisë së tyre.

9) Burgjet dhe Paraburgimet nuk ofrojnë ende një shërbim për të komunikuar me të denuarit apo paraburgosurit e huaj në gjuhën e tyre për të gjitha procedurat dhe shërbimet që atyre duhet t`ju ofrohen si gjithë personat e tjere. Këto institucione shpesh kerkojnë ndihmen e të denuarve apo paraburgosurve të tjere që njohin gjuhë të huaja për të komunikuar me këta persona.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve duhet të vijojë të instruktojë strukturat vartese të policisë së burgjeve mbi nevojën për të standartizuar të gjitha veprimet e tyre në rastet e kontroleve në burgje, duke rritur cilësinë e etikës në komunikimin me të denuarit, duke respektuar maksimalisht të drejtat e tyre të ligjshme, duke shmangur veprime arbitrare të dhunës, shkatërrimit të sendeve personale si dhe duke dokumentuar çdo veprim kontrolli në prezencë të të denuarve për të mos lënë shkas për akuza përvetësimi.

11. Nje problem i ngritur në komunikimet konfidenciale me të denuarit është ai i korrupsionit në disa segmente të administratës së burgjeve. Ky korrupsion është pretenduar nga të denuarit se ndodh kryesisht në rastet e dhënies së lejeve të veçanta dhe shpërblyese, për takimet e veçanta jashtë rradhe me familjarët, për futjen e sendeve të

paligjshme në qeli, kryesisht celularë, si dhe për trajtimin e diferencuar në dhoma të veçanta të disa prej të dënuarve.

Avokati i Popullit megjithëse nuk ka arritur të vërtetojë pretendime të tilla është bërë deshmitar i prezencës së sendeve të ndaluara në qeli dhe i trajtimit të diferencuar të disa të dënuarve. Për çdo rast të denoncuar, Avokati i Popullit ka bashkepunuar edhe me Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë duke mundësuar vijimin e një hetimi më të specializuar nga ana e tyre.

### **Inspektimet e kryera ne burgje dhe paraburgime**

**1. Çështja me nr.201000400.** Nga organizimi i disa inspektime dhe vizitave të kryera gjatë vitit 2010 në Institucionin e Paraburgimit Nr. 313 Tiranë, Avokati i Popullit ka konstatuar një sërë problemesh, të cilat janë prezantuar në rekomandimet përkatëse. Konkretisht, është kërkuar fillimi sa më parë i rikonstruksionit të disa prej ambjenteve të brendshme, përmirësimi i plote i kushteve veçanërisht të seksionit te grave, evitimin e lageshtirës në dhoma, korridore dhe ambjente te tjera, vijimi i dizinfektimit të ambjenteve për parandalimin e përhapjes së brejtësve, blerjen e një lavatriçe per permbushjen plotesisht të nevojave për larje, krijimin e kushteve per ngrohje ne stinen e dimrit ne paraburgimin e femrave dhe të të miturve, krijimin e hapërsirave në dhomat e të miturve, mbulimi i lidhjeve elektrike në tualete në mënyre që të mos rrezikohet jeta dhe shëndeti i të dënuarve, si dhe shtimi i kabinave telefonike në katin e dytë dhe në katin e tretë.

Nga përgjigja e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) jemi vënë në dijeni se për vitin 2011-2013 me projekt-buxhetin afatmesëm eshte parashikuar projektimi dhe ndërtimi i nje paraburgimi te ri ne I.E.V.P 313, si dhe ndërtimi i nje burgu te ri per grate. Kjo masë sipas DPB do të çojë në evitimin e mbipopullimit si dhe në përmirësimin e kushteve në ambjentet e këtij institucioni. Lidhur me marrjen e masave të tjera jemi informuar për disinfektimin e ambjenteve, vendosjen e disa pajisjeve ngrohëse, krijimin e hapërsirave në qelitë e të miturve, vendosjen e kabinave të reja telefonike dhe izolimin e linjave elektrike.

**2. Çështja nr.201000623.** Nga inspektimet dhe vizitat e kryera ne IEVP-ne Nr.325 Tiranë gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit ka rekomanduar sërish rikonstruksionin e ambjenteve për përmirësimin e plotë të kushteve të të dënuarve femra, veçanërisht në tualete, furnizimin normal me ujë, eliminimin e lageshtirës, etj. Nga informacionet e paraqitura, jemi informuar se janë marrë disa masa të pjesshme për sistemimin e tualeteve dhe furnizimit me ujë, por ndërkohë ka filluar një investim i ri në Burgun Rrogozhine për transferimin e seksionit të grave të dënuara në këtë institucion në ambjente krejtësisht të reja dhe brenda standarteve.

**3. Çështja nr.201000835.** Nga inspektimi i kryer ne IEVP-ne Sarandë, Avokati i Popullit, ka vijuar të mbajë qëndrimin e tij për përshpejtimin e krijimit të amjenteve të reja të Paraburgimit Sarandë. Megjithatë janë prezantuar për zgjidhje edhe disa probleme të tjera, si kontrolli i vazhdueshëm i çmimeve të ushqimeve që blihen nga të paraburgosurit, kontrolli i datave të skadencave të ilaçeve, shtimi i ajrimeve për të paraburgosurit, vendosjen e pajisjeve ftohëse të ajrit në kushtet e temperaturave të nxehta etj. Në përgjigjen e paraqitur jemi venë në dijeni se ishin marrë masa për kontrollin e ilaçeve dhe çmimeve të ushqimeve si dhe ishte përmirësuar sistemi i ventilimit të dhomave.

**4. Çështja nr.201000880.** Nga inspektimet dhe vizitat e kryera gjatë vitit 2010 në IEVP-në Krujë, Avokati i Popullit ka rekomanduar planifikimin e fondeve për rikonstruksionin sa më të shpejtë të disa elementeve kryesore të godinave të burgut tejet të amortizuar, për të eliminuar lagështiren në dhoma, në ambjentet e dusheve dhe tualeteve dhe për të krijuar kushte të përshtatshme jetese për të denuarit kryesisht me probleme shendetesore dhe të moshuar. Është kërkuar paisja e të denuarve të pamundur nga ana fizike me pajime higjienike të veçanta dhe krijimi i kushteve logjistike që ti sigurohet ajrimi sipas rregullores. Marrja e masave për përmirësimin e furnizimit me ujë të institucionit, përshtatjen e një ambjenti në një laborator mjeksor brenda institucionit, paisjen e institucionit me një ambulancë të përshtatshme, plotësimin e organikës me personel kujdestarie. Në përgjigje të rekomandimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Burgu Krujë kanë informuar se ishin mundësuar investime të pjesshme për eliminimin e lageshtires, sigurimin e pajimeve per te semuret, ishte hapur një laborator i ri mjeksor, por ishin hasur vështirësi për sigurimin e një ambulance të re si dhe për plotësimin e organikës.

**5. Çështja nr.201000801.** Nga inspektimet dhe vizitat e kryera gjatë vitit 2010 ne IEVP-ne Korçe, Avokati i Popullit rekomandoi krahas të tjerash përshpejtimin e procedurave per vendosjen e kamerave te sigurise, sigurimin e nje auto-ambulance ne kushte te pranueshme per tju pergjigjur nevojave te transportit te te semureve te denuar dhe paraburgosur, si dhe marrjen e masave per venien ne pune te pajisjes se pompimit me qellim permiresimin e furnizimit me uje te IEVP-Korçë.

Nga pergjigja e paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve dhe Burgu Korçe jemi njohur se ishin marrë masat për vënien në funksionim të depos se ujit, kishte përfunduar vendosja e kamerave te sigurise, por nuk ishte siguruar ende fondi për pajisjen me një autoambulancë.

**6.** Nga inspektimet e kryera në IEVP-në Berat gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit, nisur nga kushtet tepër të papërshtatshme të këtij paraburgimi ka vijuar të insistojë për përshpejtimin e krijimit të

ambjenteve të reja të këtij institucioni. Nga informacionet e paraqitura rezulton se janë siguruar fondet dhe sipërfaqja e tokës ku pritet që gjatë vitit 2011, të përfundojnë punimet e plota për realizimin e kësaj godine.

**7. Çështja nr.201001025.** Nga disa inspektime dhe vizita te kryera gjatë vitit 2010 ne IEVP-ne Rrogozhine, Avokati i Popullit, rekomandoi shtimin e organikës në raport me numrin e te dënuarve që strehon ky institucion, sigurimin e fondeve per rikonstruksionin dhe eliminimin e lageshtires se qelive, krijimin e kushteve të përshtatshme të ajrosjes dhe pajisjen sa më parë e këtyre ambjenteve me tenda mbrojtëse. Në përgjigje të këtyre rekomandimeve Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka sqaruar se do investoje ne rikonstruksionin e tre prej godinave të këtij institucioni për periudhën 2011-2013, duke përmirësuar të gjitha kushtet, ndër të cilat edhe krijimin e kushteve te pershtatshme të ajrosjes dhe paisjes së këtyre ambjenteve me tenda mbrojtëse.

**8. Çështja nr.201000681.** Nga inspektimet dhe vizitat e kryera në IEVP-në Durrës gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit rekomandoi paisjen e dentistit të institucionit me mjetet e domosdoshme të punës, paisjen e institucioni me ambulancë, sigurimin e linjës sekondare të furnizimit të institucionit me energji elektrike, riparimin sa me të shpejtë të dusheve, ndriçuesave dhe çelsave elektrik në tualete, eleminimin e lageshtirës, plotësimin e dhomave të tranzitit me pajimet e domosdoshme jetike, krijimin e kushteve të përshtatshme të ajrimit dhe paisja e këtij ambjenti me tenda mbrojtëse vënien në përdorim të uniformave, dorezave, dhe karrocelve në shpërndarjen e ushqimit si dhe marrjen e masave për testimin periodik të cilësisë së ujit te pijshem. Në përgjigje të rekomandimeve Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Paraburgimi Durrës kanë informuar se Kabineti i Shërbimit Stomatologjik në Institucion është pajisur me medikamente dhe me material për shërbimin stomatologjik, është propozuar planifikimi në fondet e vitit 2011 ndërtimi i linjës dytësore elektrike, është miratuar fondi prej 3.9 milionë lekësh për ndërtimin e një pusi uji, janë riparuar në një kohë optimale duset, ndriçuesit, çelsat elektrike e institucionit, sipas standarteve të sigurimit teknik, ishin marrë të gjitha masat për eleminimin e lagështirës, dhoma e tranzitit është lyer dhe pajisur me krevate, dyshekë, çarçafë, jastëkë dhe batanije, janë pajisur shpërndarësit e ushqimit me uniforma, doreza dhe karrocela, po punohej për sigurimin e tendave mbrojtëse, ishin marrë masat për izolimin e tarracës dhe hidroizolimin e jashtëm, si dhe nga ana e Sektorit Shëndetësisë ka filluar të kryhet testimi periodik i cilësisë së ujit të pijshëm.

**9. Çështja nr.201001103.** Nisur nga disa inspektime dhe vizita te kryera në IEVP-në Peqin gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit ka rekomanduar përshtetimin e procedurave për perfundimin e plote të punimeve në tualetet e IEVP-Peqin, marrjen e masave për rregullimin e



bolierve në ambjentet e observimit, mbikqyrjen e vazhdueshme të perdorimit të dorashkave sterile nga stafi i sigurisë dhe ai i guzhinës, desifektimin e ambjenteve për parandalimin e brejtesve, plotësimin dhe shtimin e organikës së IEVP Peqin me mjekë, laborante, infermiere dhe psikolog dhe përditesimin e listës së çmimeve të ushqimeve.

Në përgjigjet e paraqitura për këto rekomandime, jemi vënë në dijeni se ishin marrë masat për rikonstruksionin e plotë të tualeteve në çdo qeli, ishte plotësuar organika e stafit mjekësor, ishte zgjidhur problemi i reklamimit të çmimeve të ushqimeve, ishte siguruar lënda kimike për desifektimin periodik të ambjenteve si dhe ishin izoluar të gjitha linjat elektrike në ambjentin e observimit.

**10.** Në vizitat që Avokati i Popullit ka kryer në Burgun e Tepelenës është vijuar të kërkohet krijimi i një ambjenti për shërbimin shëndetsor dhe një tjetër për takimet me avokatët, permiresimi i cilësisë së ushqimit dhe krijimi i një ambjenti të mbuluar për pritje të familjarëve.

Në informacionet që kemi patur për këto kërkesa jemi vënë në dijeni se janë marrë masa për permiresimin e cilësisë së ushqimit dhe është krijuar një ambjent i ri i mbuluar për familjarët. Për mungesë fondesh vijon të mbetet ende problem ndërtimi i dhomave për asistencën shëndetësore dhe juridike. Kjo pasi me ndërtimin e Burgut të ri në Gjirokastrë, IEVP-ja Tepelenë do të mbyllet.

**11. Çështja nr.201000407.** Nga inspektimet dhe vizitat e kryera në IEVP-ne Burrel gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit rekomandoi marrjen e masave për krijimin e kushteve të përshtatshme të ajrosjes dhe paisjen sa më parë të këtij ambjenti me tenda mbrojtëse, vazhdimin e rikonstruksionit të godinave të burgut të amortizuar për të eliminuar lagështirën, sidomos në ambjentet e dusheve dhe tualeteve, si dhe transferimin e të dënuarve të semurë mendor dhe të moshuar në IEVP-në Krujë.

Nga përgjigjet e paraqitura jemi vënë në dijeni se kanë vijuar meremetimet e pjesshme për eliminimin e lagështirës, si dhe riparimet e sistemit për furnizimin normal me ujë. Ndërkohe ishin marrë masat për vendosjen e disa tendave në terrenet e ajrimit, si dhe ishin transferuar disa nga të dënuarit e semurë në Burgun Krujë.

**12. Çështja Nr.201001426.** Nga inspektimet dhe vizitat e kryera në IEVP-ne Kukës gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit rekomandoi përshtetimin e procedurave për fillimin e punimeve në ndërtesën e re të Institucionit të Paraburgimit Kukës, fillimin e investimit për permiresimin e kushteve në tualete, vendosjen e aparatit telefonik në pozicion të përshtatshëm që të garantojë aksesin dhe privatësinë e të paraburgosurve, krijimin e mjedisit të përshtatshëm për realizimin e takimit të të paraburgosurve me familjarët e tyre, sigurimin e ushtrimit të aktivitetëve

edukative dhe riteve fetare si dhe shtimin në organikën e Institucionit të një psikologu.

Nga përgjigjet e paraqitura jemi vene në dijeni se ishin përshtatur ambjentet për takimet me familjaret dhe komunikimin me telefon, si dhe po vijohej me procedurat për fillimin e punimeve të IEVP së re.

**13. Çështja nr.201001426.** Avokati i Popullit gjatë vitit 2010 ka kryer një vizitë edhe në Paraburgimin Tropoje, i cili kishte përfunduar ndërtimin e godinës së re dhe ishte në fazën e transferimit të shërbimeve dhe pajisjeve. Megjithëse ende e pa vënë në punë, Avokati i Popullit rekomandoi disa masa për IEVP-në e re, duke kërkuar konkretisht, punësimin e një psikologu, krijimin e nje ambjenti për takime me familjarë, krijimin e një ambjenti të brendshem për aktivitete edukuese, trajnuese dhe të nevojave shëndetësore të të paraburgosurve, eliminimin e hekurave të kryqëzuar nëpër dirtare, vendosjen e posterave me informacionet e duhura për institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Nga përgjigja e paraqitur jemi vene në dijeni se të gjitha masat e prezantuara ishin përshtatur në ambjentet e reja, por mbetet problem vetëm punësimi i psikologut.

**14. Çështja nr.201000859.** Avokati i Popullit gjatë vitit 2010 ka kryer inspektime dhe vizita edhe në Burgun Fushë Kruje. Ne perfundim te te cilave rekomandoi disa masa. Konkretisht, rekomanduam punesimin me kohe te pjeseshme apo vizitave te herepashereshme ne institucion te nje personeli mjekesor te specializuar si mjek psikiater dhe kardiolog; plotesimin e stafit mjekesor te ketij institucioni me mjek stomatolog; kryerjen e riparimeve te nevojshme ne rrjetin e ujesjellesit ne mënyrë qe te sigurohet sa me pare furnizimi normal me uje; plotesimin e dhomave te veçimit me pajimet e domosdoshme te fjetjes; krijimin e kushteve te pershtatshme te ajrosjes me venien ne perdorim sa me shpejt te fushes se kalçetos, si dhe instalimin e dusheve ne banjot e dhomave te sektorit te tranzitit. Në përgjigje te rekomandimit Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve informoi se, konsultat e nevojshme nga mjekë specialiste mbulohen nga mjekët e Q.S.Burgjeve dhe Spitali Rajonal Krujë dhe në rastet kur është parë e arsyeshme, është dërguar një ekip mjekësh specialist nga Q.S.Burgjeve. Për sa i përket punësimit të mjekut stomatolog me kohë të plotë, ishte bere shpallja dhe ishin ne pritje të punësimit të tij, ishin marrë masat për përmirësimin e sistemit të ujësjellësit në institucion, dhomat ishin akomoduar me materialet e domosdoshme, gjithashtu ishte planifikuar nje fond i vecante per tualetet e sektorit tranzit.

**15. Çështja nr.20100852.** Avokati i Popullit gjatë vitit 2010 ka kryer inspektime dhe vizita edhe në Burgun Vaqarr Tirane. Ne perfundim te te cilave rekomandoi disa masa. Konkretisht, rekomanduam paisjen e

ketij Institucioni me ambulance; sigurimin e fondeve per hidroizolimn e tarracave; eleminimin e lageshtires ne qeli, si dhe krijimin e kushteve te pershtateshme te ajrosjes dhe pajisja e ketij ambjenti me tenda mbrojtese.

Në përgjigje, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na sqaron se, ishin ne pritje të përfundimit të procesit te tenderimit per blerjen e autoambulancave. Nga ana e Sektorit të Investimeve ishin kërkuar fonde për kryerjen e meremetimeve dhe eleminimin e lageshtires, si dhe permiresimin e kushteve ne ambjentet e ajrimit.

**16. Çështja Nr.20100490.** Avokati i Popullit gjatë vitit 2010 ka kryer inspektime dhe vizita edhe në Burgun Shen-Koll Lezhe, ne perfundim te te cilave rekomandoi disa masa ndër te cilat, plotesimin e organikes se sherbimit mjekesor me stafin e domosdoshem sipas organikes se parashikuar; permiresimin e kushteve higjenike te tualeteve; eleminimin e lageshtires, mykut, lyerjen e tyre dhe vendosjen e kokave statike te dusheve; marrjen e masave per plotesimin me dushe dhe uje te ngrohete te centralizuar nga kaldaja qendrore te te gjithë sektoreve; rregullimin e kaldajes qendrore te furnizimit me uje te ngrohete; heqjen e ngroheseve te ujit provizor shtepiak te cilet janë faktor rreziku per te denuarit; pajisjen e ketij Institucioni me kosha te ri mbeturinash; sigurimin e fondeve per zevendesimin e dritareve te drurit te amortizuara; permiresimin e kushteve dhe ambjenteve te zyrave te punonjesve te policise se sherbimit ne seksione dhe paisjen e tyre me orendi te pershtateshme zyre; eleminimin e instalimeve provizore te frigorifereve dhe televizoreve dhe shtrirjen e telave dhe kablllove elektrik ne toke ne dhomat e te denuarve, si dhe plotesimin e bazeve materiale edukative-sportive dhe krijimin e kushteve per nje zhvillim normal te aktiviteteve per seksionin e te miturve. Megjithë përgjigjet premtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, situata në Burgun Lezhë vijon të mbetet problematike dhe me mungesa të theksuara në investime për përmirësimin e situatës.

**17. Çështja nr. 2010001124.** Avokati i Popullit gjatë vitit 2010 ka kryer inspektime dhe vizita edhe në Paraburgimin Vlorë në përfundim të të cilave rekomandoi përdorimin e dorashkave sterile nga ana e personelit te policise gjatë kontrollit te ushqimeve, si dhe nga ana e sherbimit te kuzhines; kompletimin e të paraburgosurve të mitur me tesha dhe pajime fjetje; përditësimin në kohë të listave të çmimeve të produkteve ushqimore; eleminimin e vonesave në ekzekutimin e menjehershëm te vendimeve gjyqesore te formes se prere per kalimin ne burg te te paraburgosurve. Në përgjigje të rekomandimit Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Paraburgimit Vlorë sqaruan për realizimin e një sërë masash në sherbimin e kontrollit dhe servirjes së ushqimit, furnizimin me pajime te te paraburgosurve dhe përditësimin e çmimeve ushqimore. Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqesore u pretendua se

kjo vonesë vjen si pasoje e korrespondencave të vonuara me organet e tjera.

### **Rekomandime për raste të ndjekura me iniciativë dhe nga ankesat, për gjendjen në burgje dhe paraburgime**

1. Avokati i Popullit si Mekanizem Kombëtar për Parandalimin e Torturës, hetoi një ngjarje në Institutin e të Miturve Kavajë, ku 5 të mitur gjatë shoqerimit të tyre drejt ambjentëve të palestres janë shkeputur nga punonjësit e policisë që i shoqeronin dhe janë drejtuar me vrap në drejtim të shesheve të hapura sportive ku 5 të mitur të tjerë të denuar po luanin futboll, duke filluar t'i godisnin këta të fundit. Pas tyre janë vënë në ndjekje personeli i sigurisë i përbërë nga 3 veta, të cilët janë mundur me vështirësi t'i ndajnë grupet nga konflikti i dhunshëm. Ndërkohe, grupi tjetër prej 5 të miturish që ndodheshin në mësim në katin e dytë të godinës, kanë lënë menjëherë klasën, kanë shkëllmuar dhe hapur 2 dyer sigurie të ndërmjetme dhe kanë dalë në ambjentet sportive për t'u përfshirë në konflikt, nëpërmjet derës së tretë të sigurisë të lënë hapur nga policët si pasoje e harresës dhe urgjencës. Në ndihmë të personelit të sigurisë kanë ardhur në pak minuta edhe disa punonjës të tjerë të policisë si dhe kujdestarë të sektorit të edukimit. Dhuna është zhvilluar rreth 5 minuta në ambjentet sportive, ku ndaj dy të denuarve të mitur janë përdorur mjete të forta (gure) të marra nga disa korniza betoni të pa fiksuara që shërbenin për instalimin e hidranteve të jashtëme të godinës. Personeli i sigurisë dhe edukimit ka bërë të mundur me shumë vështirësi që fillimisht të veçojë grupet në konflikt dhe më pas t'i shoqërojë të denuarit nëpërmjet dhomës. Edhe gjatë shoqerimit në qeli janë vënë në tentativë të dhunshme të disa të denuarve për të hyrë në seksionet e tjera dhe për të vijuar konfliktin fizik. Pas kësaj, nga personeli i sigurisë është konstatuar plagosja e rëndë në koke me gjakderdhje e dy të denuarve të mitur, të cilët janë transportuar menjëherë në Spitalin e Kavajës të shoqëruar edhe nga infermieri i IMK-së.

Nisur nga sa më lart, Avokati i Popullit rekomandoi marrjen e masave disiplinore ndaj stafit përgjegjës që toleroi një situatë të tillë, plotësimin dhe trajnimin urgjentisht të personelit të IMK me staf psiko-social të aftë për të trajtuar dhe zgjidhur konfliktet midis të denuarve, forcimin e elementeve të sigurisë në IMK, duke instaluar dyer të reja me siguri të lartë dhe duke hequr të gjitha mjetet e forta brenda ambjentëve të sigurisë që mund të përbejnë kërcënim për jetën dhe shëndetin e të denuarve dhe stafit, rivendosjen në pozicione të pranueshme të kamerave të sigurisë me qëllim që të mbulonin në mënyrë të plotë të gjitha ambjentet e IMK, si dhe trajnimin maksimal të stafit të sigurisë për të reaguar me masa parandaluese ndaj akteve të tilla. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve jemi informuar se ishin marrë masa ndaj

stafit drejtues të IMK-së duke ndërruar disa prej punonjësve të edukimit dhe atij policor të institucionit me një staf të ri dhe të kualifikuar, ishin hequr të gjitha sendet e rrezikshme, ishin forcuar dyert me elementë shtesë sigurie, si dhe po vijonte puna për realizimin e disa masave të tjera të sigurisë. (Referencë çështja nr.201000551)

2. Avokati i Popullit u vu në dijeni se në disa kontrole të ushtruara nga Sektori i Shoqerimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ishte pretenduar se këto forca policore kishin hyrë nëpër qeli me britma dhe sharje, duke perplasur shkopinj të gomes nëpër zgarat e qelive, duke nxjerre dhe goditur nëpër korridore të denuar dhe paraburgosur, si dhe duke ofenduar edhe stafin policor të vetë IEVP-ve. Ata pretendojnë se kishin kryer kontrole duke demtuar sende të denuarve, duke prishur orë të tjera utilitare, si dhe duke shkelur shtrojet e krevateve dhe duke i ndotur ato. Kjo gjë kishte shkaktuar jo pak probleme tek të paraburgosurit dhe kontrollet e ushtruara janë pritur nga ana e tyre me mjaft frikë dhe nervozizem. Për të parandaluar raste të tilla në të ardhmen me anë të masave konkrete, Avokati i Popullit rekomandoi që veprimet e policisë gjatë kontrolleve në qeli të monitorohen nga kamerat e sigurisë në kushtet e një ndriçimi të plotë të korridoreve, të denoncohen parregullsitë në kontroll, si dhe të dokumentohen me raport shërbimet përkatëse sjellje të paligjshme të policisë, çdo përfundim i kontrollit në qeli të dokumentohet dhe kundershmohet jo vetëm nga stafet policore të IEVP-ve, por dhe nga të denuarit apo të paraburgosurit sipas qelive, duke ju lënë të drejtën të deklarojnë edhe vërejtjet përkatëse, forcat policore duhet të instruktohen për menyrat se si ushtrohet kontrolli pa cenuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve. Gjithashtu, ato duhet të vazhdojnë të trajtohen për vetëpërbajtje dhe ushtrim forçe deri në masën që paralizon veprime aktive të paligjshme të të denuarve. Në asnjë rast, këto forca të detyruara nuk duhet të drejtohen në pjesë vitale të trupit, pasi përben rrezik të shtuar për jetën dhe shëndetin e tyre. Forcat policore duhet të jenë të caktuara me planvendosje të sakta në shërbimet e kontrollit, për të bërë të mundur identifikimin me lehtësi të punonjësve të veçantë që mund të akuzohen se kanë abuzuar me detyrën, të hartohen dhe kundershmohen në çdo rast raportet e kontrollit midis Sektorit të Shoqerimit dhe administratës së burgut që kontrollohet, duke u dokumentuar në këto raport edhe vërejtjet apo rezervat përkatëse në përmbushjen e detyrave, të kontrollohen dhe keshillohen efektivat e policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve mbi nivelin etikës në komunikimin me të denuarit, të paraburgosurit dhe stafin e policive të IEVP-ve dhe të merren masa disiplinore në rastet kur konstatohen shkelje të disiplinës së tyre në detyrë. Në përgjigje të këtij rekomandimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u morën masat për përmirësimin e punës gjatë kontrolleve në burgje, duke

ndryshuar një sere procedurash për eliminimin e abuzimeve në detyrë. (Referencë çështja **nr.201000628**)

**3.** Avokati i Popullit në permiresim të punes dhe evidentimit të sakte te takimeve ne IEVP, si dhe per ti prere rrugen aludimeve për prezencën ose jo të familjarëve apo avokatëve në takime me te denuarit dhe paraburgosurit, rekomandoi riformatimin e regjistrave të takimeve/vizitave, duke hapur një rubrike të veçante, ku pas shenimeve të punonjesit të policise se burgjeve, të kunderfirmoje edhe personi me cilesine e vizitorit, familjarit apo avokatit.

Ky rekomandim u mireprit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe njoftuan masat e marra për ndryshimin e praktikave të plotësimit të rregjistrave të burgjeve me praktikat e propozuara. (Referencë çështja **nr.201000508**)

**4.** Avokati i Popullit një vizitë në IEVP Durrës ku u evidentua amortizimi i ambjenteve të reja pranë këtij institucioni, të cilat u ndërtuan para rreth 1 viti me destinacion ngritjen e Qendrës Spitalore Psikiatriko-Ligjore. Aktualisht, pas refuzimit të Ministrisë së Shëndetësisë për të marrë në dorëzim këtë godinë, kjo e fundit ngeli e abandonuar dhe rrezikon seriozisht të dëmtohet nga amortizimi si pasojë e ndikimit nga faktorë atmosferik. Gjatë kontrollit të brendshëm të ushtruar në këtë ambient, u konstatua se kati i dytë ishte i përmbytur nga uji dhe muret e disa qelive ishin dëmtuar së tepërmi nga lagështira. Avokati i Popullit duke vlerësuar maksimalisht këtë situatë, rekomandoi marrjen e masave urgjente për të marrë sa më parë në dorëzim këtë godinë nga firma ndërtuese dhe më pas për të kryer disa meremetime dhe modifikime të vogla me qëllim përshtatjen e këtyre ambjenteve për shërbime penitenciare. Gjithashtu, u sugjerua që në kushtet e mbipopullimit të IEVP Durrës, apo ambjenteve tepër të amortizuara të seksionit të femrave në Paraburgimin 313 Tiranë, kjo godinë të kategorizohet për strehimin e njëres prej këtyre kategorive me qëllim përmirësimin e kushteve të trajtimit të tyre. (Referencë çështja **nr. 201001542**).

**5.** Avokati i Popullit u njoh me ndryshimet e reja të dates 25.03.2010 të VKM Nr.303 dt.25.03.2009 “*Per miratimin e Rregullores se Pergjithshme te Burgjeve*”. Lidhur me kete zhvillim, deklarua se ato u kryen te nxituara, duke perjashtuar ne menyre flagrante oponencen dhe propozimet e institucioneve qe mbrojne te drejtat e njeriut. Se pari, nga permbajtja dhe interpretimi praktik hartuesit e ndryshimeve nuk kishin respektuar standartet ndërkombetare (Rregullave Europiane te Burgjeve KiE dhe Standarteve Minimale te Burgjeve OKB) dhe ligjore mbi trajtimin e te denuarve dhe paraburgosurve. Se dyti, të paraburgosurve ju mohohen te drejta te fituara me rregullore per te patur nje aparat televiziv ne qeli, frigorifer, pajisje të cilat rregullorja e re, ua kishte hequr. Ne mungese te sallave te perbashketa per te ndjekur sipas grafikeve te

caktuar programe televizive rekomanduam se, ishte e nevojshme qe ky aspekt i jeteses se tyre te realizohej ne qeli. Per sa me lart, kerkuam qe Rregullorja e Pergjithshme e Burgjeve duhet te rishikohej sa me shpejt dhe ne mënyrë teresore, per shkak edhe të nje sere çeshtjesh te tjera qe kerkonin një rregullim të pranueshem. Ministria e Drejtësisë ne pergjigje të ketij rekomandimi dhe te nje sere ndërhyrjesh per kete problem, dergoi per mendim disa propozime te reja te Rregullores se Pergjithshme te Burgjeve që permiresonin dukshem standartet e kërkuara në aspektet e permendura me lart, duke nënkuptuar nxitimin e saj në ndryshimet e bëra me parë. (Referencë çështja **nr.201000508**)

**6.** Avokati i Popullit konstatoi se ne sektorin e te paraburgosurve te mitur nga 14-18 vjeç në IEVP Durres kishte një mbipopullim te shtuar, gje qe kishte shkaktuar shpesh qe te miturit te sistemoheshin ne sektore te tjere te paraburgimit ku strehoheshin madhore, çka perbente nje shkelje te rende ligjore. Per kete qellim, u rekomandua qe Instituti i te Miturve Kavaje, te kategorizohej edhe si institucion paraburgimi per te kaluar aty nje pjese te madhe te te miturve qe strehoheshin ne IEVP Durres. Kjo per faktin se Instituti i te Miturve Kavaje, dispononte kushte dhe hapësira te mjaftueshme per te pritur nje numer te konsiderueshem te miturish te tjere. Ne pergjigje te ketij rekomandimi, Ministria e Drejtësisë percolli informacionin se Instituti i te Miturve Kavaje ishte kategorizuar edhe si qender paraburgimi. Ky veprim i hapi rrugen nje lehtesimi te kushteve dhe trajtimit te te miturve. (Referencë çështja **nr.201000723**)

**7.** Avokati i Popullit ka konstatuar ne IEVP Korçe se cilësia e ujit të pijshëm që mbërrin nga rrjeti i ujës-jellësit në këtë institucion ishte dukshëm jashtë standarteve të pranueshme. Gjatë vizitave në qeli është vënë re me sy të lirë se uji i pijshëm që mbahej në shishe dhe që sigurohej nga rrjeti, përmbante turbullirë dhe papastërti. Në shumicën e qelive të dënuarit dhe paraburgosurit, nisur nga shkaqe financiare, konsumojne vetëm ujë nga rrjeti i burgut dhe per pasoje kanë ngritur shqetësimin e efekteve negative që ai mund të krijojë në shëndetin e tyre. Nisur nga ky konstatim, Avokati i Popullit rekomandoi marrjen e masave urgjente për të përmirësuar cilësinë e ujit të pijshëm në Burgun Korçë, si garanci thelbësore për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve dhe paraburgosurve. Nga pergjigja e Drejtorise se Pergjithshme te Burgjeve dhe Burgut Korçe, jemi informuar se ishin kryer disa punime ne depon e ujit dhe veçanërisht në impiantin e filtrimit dhe pas analizave ishte konstatuar një përmirësim i dukshëm i cilësisë së ujit në rrjet. (Referencë çështja **nr. 201001542**)

**8.** Avokati i Popullit u njoh me disa ankesa të punonjësve të policise së burgjeve, Burgu Rrogozhine, të cilët pretendonin për mos-pagimin e orëve jashte orarit, diteve të festave dhe sherbimeve shtese të kryera për vitin 2009. Nderkohe qe ne disa prej IEVP-ve te tjera ishte

konstatuar se ky problem nuk qendronte dhe pagesat janë kryer ne kohe. Krahas sa me lart, Avokati i Popullit u vu ne dijeni se ende nuk kishte filluar nje trajtim financiar i rregullt sipas gradave te Policise se Burgjeve, megjithese funksionet e mesme dhe te larta kishin kohe qe ishin konvertuar me grada dhe paga te reja. Ky fakt kishte sjelle qe ne disa prej IEVP-ve drejtues te policise te mos merrnin pagen qe u takonte ne baze te funksionit qe kryenin. Per këto arsye, Avokati i Popullit propozoi qe te ngrihej menjehere nje grup pune dhe te niste kontrolli ekonomiko-financiar i te gjitha IEVP-ve që kishin pretendime të tilla.

Ky grup pune duhet te merrte takim me te gjithë efektivat punonjes te policise dhe te priste ankesa prej tyre, te verifikonte pretendimet ne rregjistrat perkates te pagesave dhe ne rast se nuk do te konstatoheshin shkelje financiare, te kishte detyrimin te sqaronte me hollesi punonjësit e policisë perkates. Krahas kesaj mase, ky grup u propozua të rishikonte edhe nje here trajtimin financiar sipas gradave dhe fondin financiar qe levrohej sipas kategorive te veçanta, duke nxjerre parregullsitet e mundshme. Në pergjigje te rekomandimit të mësiperm, Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve informoi se ishin krijuar disa grupe auditi per te pare në terren parregullsitë financiar të trajtimit të efektivave policorë. (Referencë çështja **nr.201000204**)

**9.** Avokati i Popullit pranoi kërkesën e paraqitur nga një i denuar për tu liruar sa më parë nga burgu, pasi vuante nga një sëmundje e pashërueshme dhe ishte në prag vdekje. Ky i denuar kishte paraqitur një kërkesë në gjykatë për tu liruar nga burgu, por kjo kërkesë ende nuk ishte marrë në shqyrtim. Në këto kushte, pasi u verifikua nga afër gjendja e tij shëndetsore, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Elbasan përshpejtimin e shqyrtimit të kërkesës të të dënuarit. Nga përgjigja e Gjykatës Elbasan jemi vënë në dijeni se kjo kërkesë ishte marre ne konsiderate dhe i dënuari ishte liruar. (Reference çështja **nr. 201000146**)

**10.** Avokati i Popullit pranoi ankesën e një shtetasje drejtuar ndaj I.E.V.P Lushnje, në lidhje me trajtimin mjekesor që ky institucion i ofronte djalit të saj të dënuar me burg. Kjo shtetase pretendonte se, djali i saj ishte i sëmurë dhe nuk merrte trajtimin e duhur mjekësor. Pas shqyrtimit që ju bë kësaj ankese rezultoi se, i dënuari vuante nga sëmundje mendore dhe qëndrimi i tij në I.E.V.P Lushnje përbënte rrezik për jetën dhe shëndetin e tij dhe të personave të tjerë. Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi transferimin e të dënuarit në I.E.V.P Krujë, i cili është një institucion i veçantë me një seksion për të sëmurë mendorë. Nga informacionet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve u be e ditur se ishte realizuar transferimi i të dënuarit në Burgun Krujë. (Referencë çështja **nr.201000525**)



**11.** Avokati i Popullit trajtoi edhe ankesën e disa mjekëve të punësuar pranë IEVP-ve, të cilët kudërshtonin si të padrejtë dy pika të një Udhëzimi të Ministrit të Drejtësisë. Ky Udhëzim përfshinte mjekun e burgut në procesin e vendimmarrjes për dhënien e lejeve të veçanta të të burgosurve, duke kërkuar prej tyre, pa të drejtë, që të jepnin vlerësim për gjendjen shëndetësore të të afermit të të dënuarit nisur thjesht nga dokumentacioni i paraqitur. Vendimi i Keshillit të Ministrave, në bazë dhe për zbatim të te cilit kishte dalë udhëzimi i mësipërm, nuk e ngarkonte mjekun e burgut me një detyrë të tillë. Ndaj, Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi revokimin e pikave të Udhëzimit që përfshinin në mënyrë të padrejtë mjekun në procesin e dhënies të lejes së veçantë. Ky rekomandim vijon ende të debatohet me Ministrinë e Drejtësisë lidhur me disa argumenta që sipas saj duhet të përfshijne në procesin e miratimit të lejeve edhe doktorët e burgjeve. (Referencë çështja **nr.201001541**)

## **2. Bashkëpunimi me OJF-të dhe veprimtaria promovuese**

Avokati i Popullit si Mekanizem Kombëtar për Parandalimin e Torturës i ka kushtuar edhe gjatë vitit 2010 një rëndësi të veçantë aktiviteteteve dhe veprimtarive të përbashkëta me OJF-të.

Gjatë vitit 2009, Avokati i Popullit nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Shqiptare të Rehabilitimit të Viktimave të Torturës, Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe Institutin European të Tiranës.

Këto marrëveshje u nënshkruan për të krijuar një koordinim të përbashkët jo vetëm të veprimeve monitoruese në terren, por dhe të ndihmës së ndërsjellë. Gjatë vitit 2010 ky bashkëpunim ka ardhur duke u forcuar edhe më shumë, duke konsoliduar realisht forcën monitoruese të MKPT-së për parandalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor dhe degradues në çdo institucion shtetëror. Ky bashkëpunim ka arritur të sigurojë gjatë vitit 2010 një mbulim të plotë të veprimtarisë monitoruese, një shkëmbim informacioni në kohë reale për çdo ngjarje, si dhe një kombinim efektiv me burime njerëzore të shumicës së inspektiveve në terren.

Edhe gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit me anë të zbatimit të marrëveshjeve të mësipërme arriti të sigurojë një mbështetje të madhe në punën e tij, duke plotësuar dukshëm aspekte të profilizuara profesionale. Pjesëmarrja në inspektimet tona, si dhe marrja e mendimeve të specializuara nga ekspertë mjeko-ligjor, mjek-psikiatër, psikolog dhe punonjës-social të vënë në dispozicion nga OJF-të e mësipërme, ka qenë një ndihmë e madhe për të përballuar me sukses veprimtarinë tonë.

Dublimi i vizitave me grupe të përbashkëta, shkëmbimi dhe verifikimi i ndërsjellë i informacioneve, prezenca e shtuar në institucionet

shtetërore dhe dalja në përfundime të përbashkëta për çdo konstatim në terren kanë qenë risi të një bashkëpunimi mjaft efektiv me OJF-të.

Nga vëzhgimi i rezultateve të këtij bashkëpunimi vërehet se në rekomandimet kryesore të paraqitura nga Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës një përshkrim të veçantë zënë edhe ndihmat konkrete me ekspertizën e pavarur të ofruar nga OJF-të e mësipërme.

Edhe gjatë vitit 2010 Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Viktimave të Torturës ka ofruar mbështetje me ekspertë mjeko-ligjor dhe psikolog veçanërisht për inspektime në burgje dhe paraburgime, mbështetje kjo që ka rezultuar mjaft pozitive në punën tonë. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka qenë tepër i angazhuar për të dhënë kontributin e tij institucional dhe informues në një sërë botimesh që ka publikuar QSHRVT-ja lidhur me parandalimin e torturës dhe përmirësimin e standarteve të trajtimit të individëve me probleme të shëndetit mendor në burgje.

Bashkëpunimi ka vijuar të jetë në nivele të kënaqshme edhe me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, me të cilin janë organizuar vizita monitoruese dhe verifikuese të përbashkëta në sistemin penitenciar, sidomos lidhur me identifikimin e problemeve të adresuara nga grupe të dënuarish. Po ashtu është mbajtur një kontakt dhe korrespondencë e vazhdueshme lidhur me marrjen dhe shkëmbimin e informacioneve, si dhe me verifikimin e ankesave të të dënuarve nga korrespondentë të KSHH-së që punojnë në rrethe. Në fillim të vitit 2010 Avokati i Popullit dhe KSHH-unifikuan qëndrimet e tyre me anë të rekomandimeve të përbashkëta lidhur me përmirësimin e përmbajtjes së Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, duke dhënë mendimet respektive për një sërë çështjesh.

Avokati i Popullit ka realizuar një bashkëpunim të sukseshëm edhe me Institutin European të Tiranës, me të cilin edhe gjatë vitit 2010 janë kryer inspektime të shpeshta të përbashkëta në të gjitha qendrat e paraburgimit në vendin tonë. Krahas kësaj gjatë vizitave monitoruese IET ka ofruar një ekspertizë të veçantë mjeko-ligjore, psikiatrike dhe psikologjike për trajtimin e të dënuarve, të sëmurëve mendorë që mbahen brenda sistemit penitenciar etj. IET ka ofruar ekspertizën e tij me mjek neurolog edhe në një rast, në të cilën Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut kishte kërkuar nga Avokati i Popullit një verifikim të hollësishëm të trajtimit të një të dënuari, objekt shqyrtimi gjyqësor. Edhe gjatë vitit 2010 Avokati i Popullit dhe IET kanë vijuar të ofrojnë propagandimin e përbashkët të të drejtave të paraburgosurve me anë të spoteve publicitare, si dhe të organizojnë një sërë takimesh konsultative për reformën në sistemin e paraburgimit.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka mbajtur në konsideratë rolin mjaft të rëndësishëm të Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas (TLAS) në dhënien e asistencës juridike ndaj të dënuarve dhe paraburgosurve. Në jo pak raste Avokati i Popullit ka adresuar pranë TLAS të dënuar, të cilët kanë kërkuar ndihmë ligjore për zgjidhjen e çështjeve të tyre private në gjykatë. Pjesë e bashkëpunimit tonë me këtë OJF kanë qenë edhe pjesëmarrjet e përbashkëta në disa aktivitete të zhvilluara për të drejtat e të dënuarve dhe ndihmën ligjore ndaj tyre.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës i ka kushtuar edhe gjatë vitit 2010 një rëndësi të veçantë aktivitetit promovues të parandalimit të torturës trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Veprimtaria e MKPT-së ka qenë organizimi i takimeve dhe zhvillimi i një dialogu produktiv për përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe veçanërisht për trajtimin e individëve të privuar nga liria.

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2010 Avokati i Popullit ka bashkëorganizuar me Qendrën Shqiptare të Rehabilitimit të Viktimave të Torturës 7 seminare, ku objekt kryesor të takimeve kanë qenë shkëmbimi i eksperiencës dhe dialogut mbi konstatimet në shërbimet penitenciare dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në këtë fushë. Këto seminare kanë patur si target grup punonjës nga shërbimet shëndetësore, të edukimit, shërbimeve ligjore dhe të policisë së burgjeve dhe paraburgimit nga i gjithë vendi. Vlen të theksohet se këto seminare kanë arritur të krijojnë një klimë bashkëpunimi dhe mirekuptimi mjaft të efektshme me administratën e burgjeve në zgjidhjen e shumë çështjeve të ngutshme në këto shërbime.

Edhe gjatë vitit 2010 Avokati i Popullit së bashku me Institutin Europian të Tiranës kanë zhvilluar 2 workshope dhe 1 konferencë kombëtare lidhur me gjendjen e të drejtave të të paraburgosurve. Në këto aktivitete janë diskutuar dhe debatuar, çështje mjaft të rëndësishme mbi sistemin e paraburgimit në vendin tonë dhe janë koordinuar një sërë qëndrimesh për monitorimin e përbashkët në të ardhmen. Frut i këtij bashkëpunimi ka qenë edhe promovimi i një i Raportit të Dytë të Progresit të sistemit të paraburgimit të publikuar nga IET me kontribut edhe të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i promovimit dhe propagandimit të të drejtave të personave të privuar nga liria ka qenë edhe puna mjaft e mirë që është bërë për informimin publik të veprimtarisë së MKPT-së. Duhet theksuar se përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare të internetit të Avokatit të Popullit me rekomandimet mbi përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut është paraparë si prioritet edhe gjatë vitit 2010. Gjithashtu është konsoliduar bashkëpunimi me organet e medias për

pasqyrimin e punës tonë veçanërisht për rezultatet e inspektimeve, për propozimet e parashtruara në përmirësim të kushteve në burgj, komisariate policie etj. Falë këtij bashkëpunimi, gjatë vitit 2010 ka vijuar të ndjehet në mënyrë të vazhdueshme pasqyrimi i pjesëmarrjes së Avokatit të Popullit në zgjidhjen e mjaft ngjarjeve apo problemeve që kanë shqetësuar qytetarët.

### **3. Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe procesi raportues**

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar gjatë vitit 2010 të funksionojë si strukturë me plane konkrete bashkëpunimi dhe veprimtari të mirëfilltë raportuese në arenën ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2008, në zbatim të OPCAT, janë vendosur lidhje me Nënkomitetin Kundër Torturës së OKB-së, duke paraparë si nevojë të rëndësishme bashkëpunimin dhe marrjen e eksperiencës nga ekspertët ndërkombëtarë të OKB-së, si dhe për të ndërtuar një marrëdhënie komunikimi dhe raportimi të qëndrueshme me NKT në zbatim të Nenit 11 të OPCAT.

Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës së OKB-së, ka shkëmbyer për rreth 3 vjet një korrespondencë të dëndur me zyrën tonë duke qenë i interesuar në mbarëvajtjen e punës për Parandalimin e Torturës dhe rezultatet e saj konkrete. Nëpërmjet Ministrisë së Jashtme Shqiptare por dhe komunikimeve të drejtpërdrejta, Avokati i Popullit është përpjekur të informojë rregullisht këtë strukturë ndërkombëtare lidhur me veprimtarinë për parandalimin e torturës, trajtimin jo human dhe degradues në vendin tonë.

Në Qershor të vitit 2010 në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Avokati i Popullit u thirr për të raportuar në një seancë të veçantë të Nënkomitetit kundër Torturës së OKB-së me seli në Gjenevë. Ky raportim ishte i dyti në nivel botëror dhe kryej vetëm për ato vende të cilat kishin filluar të konsolidonin veprimtarinë e tyre monitoruese sipas OPCAT. Në këtë takim Avokati i Popullit përcolli një informacion raportues mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri, duke ju referuar raporteve vjetore të monitorimit për vendet e kufizimit të lirisë së personit të paraqitura më parë edhe në Kuvendin e Shqipërisë.

Anëtarë të Nënkomitetit të OKB-së parashtruan një sërë pyetjesh dhe opinionesh mbi çështje të ndryshme, të cilat u debatuan më pas nga të dy palët. Në përfundim, Avokati i Popullit mori vlerësime tepër pozitive për punën e bërë dhe u deklarua haptazi mbështetja e plotë ndaj tij në të

ardhmen për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe organizative nga ana e strukturave të OKB-së.

Në këtë seancë raportuese, Shteti Shqiptar mori një sërë vlerësimesh pozitive për seriozitetin në krijimin dhe vënien në funksionim brenda një kohe të shkurtër të një strukture të pavarur dhe funksionale siç është Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Në fjalën e tij përmbyllëse, z.Viktor Rescia, Kryetar i Nënkomitetit të Parandalimit të Torturës, u shpreh ndër të tjera, se; “ *Nga një vend i vogël si Shqipëria arrijmë të marrim mesazhe kaq të mëdha për seriozitetin dhe vendosmërinë për të respektuar aktet ndërkombëtare, liritë dhe të drejtat e individëve*”. Me anë të realizimit të këtij takimi raportues, Avokati i Popullit përmbushi një prej objektivave dhe detyrimeve më të rëndësishme në planin ndërkombëtar si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, duke u bërë një prej vendeve të para në botë që konkretizon implementimin e një akti ndërkombëtar në një nivel kaq të avancuar.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar të veprimtarisë së MKPT-së, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë në disa takime ndërkombëtare të zhvilluara nga Këshilli i Europës në kuadër të projektit “Peer to Peer”. Ky projekt ka për qëllim të trajnojë dhe ofrojë eksperiencë lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në burgje, polici dhe vende të tjera ku liria e personit është e kufizuar. Në këto takime, nga ana e ekspertëve tanë janë dhënë mendime dhe është ofruar eksperiencë dhe informacioni për një sërë praktikash inspektimi dhe mënyrën e veprimtarisë tonë në përgjithësi.

Nisur nga sa më lart, në Qershor 2010 Këshilli i Europës organizoi së bashku me Avokatin e Popullit në Tiranë konferencën ndërkombëtare me pjesëmarrje të 23 vendeve europiane që kane krijuar një MKPT. Kjo konferencë pati si temë kryesore të drejtat dhe liritë e individëve në mardhënie me organet e policisë. Pjesëmarrësit shkëmbyen një sërë mendimesh dhe eksperiencash për praktikën më të mira që duhen zbatuar nga organet policore dhe gjithashtu ranë dakort për të krijuar edhe një manual të përbashkët lidhur me mënyrat e monitorimit të ambjenteve të policisë.

Avokati i Popullit ka vijuar bashkëpunimin edhe gjatë vitit 2010 me një sërë partnerësh të tjerë të huaj që veprojnë në vendin tonë dhe që kanë një rol prioritar në ndihmën për forcimin e standarteve të të drejtave të njeriut. Në jo pak raste, kemi patur kontakte dhe takime me përfaqësues të Zyrës së OSBE-së në Shqipëri dhe kemi shkëmbyer me ta informacione dhe raporte, lidhur me situatën e konstatuar në institucionet ku liria e individëve është e kufizuar. Në fillim të vitit 2010, Avokati i Popullit, së bashku me Misionin Pameca, ka organizuar një workshop për të identifikuar problemet në shërbimet komunitare të Policisë së Shtetit

dhe për kapacitetet e saj infrastrukurore të ambjenteve të izolimit. Ky workshop u shoqërua edhe me një raport përfundimtar drejtuar autoriteteve të Policisë së Shtetit ku u rekomanduan një sërë ndryshimesh dhe përmirësimesh në punën e saj.

Një tjetër partner i rëndësishëm në bashkëpunimin tonë ka qenë dhe Zyra e Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë, me të cilën janë zhvilluar një sërë komunikimesh dhe shkëmbimesh informacioni të vazhdueshëm lidhur me situatën e konstatuar nga monitorimet tona për të drejtat e njeriut. Në kuadër të ndjekjes së detyrave të parashikuara në Raport Progresin e Bashkimit Europian, kjo zyrë ka vlerësuar së tepërmi punën e bërë nga Avokati i Popullit në kuadër të MKPT-se dhe njëkohësisht ka qenë të përzemërtuar për tu njohur me rekomandimet e hartuara nga zyra jonë dhe për procesin e vënies së tyre në zbatim. Frut i këtij interesimi ka qenë së fundi edhe futja në axhendën e procesit të integritetit të vendit tonë të Pikës 12 të Raport Progresit të Asocim-Stabilizimit, në të cilën Qeveria Shqiptare detyrohet të shqyrtojë dhe zbatojë Rekomandimet e Avokatit të Popullit lidhur me gjendjen në burgje, polici dhe ambiente të tjera ku liria e personit është e kufizuar.

Avokati i Popullit vijon të ketë një bashkëpunim serioz dhe eficient me Agjensinë e Parandalimit të Torturës me qendër në Gjenevë Zvicër, e cila ka ofruar një asistencë shumë të madhe teknike gjatë vitit 2010 për trajnimin e punonjësve të NPT shqiptare nëpërmjet manualeve dhe broshurave mbi praktikën më të avancuar didaktike për kryerjen e monitorimeve në mënyrë sa më profesionale.

#### **4. Rekomandimet legjislative**

Një nga veprimtaritë funksionale të Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së ka qenë edhe paraqitja e rekomandimeve me karakter legjislativ, të cilat nëpërmjet propozimit për ndryshime dhe amendime të akteve ligjore dhe nënligjore, ka patur si synim të përmirësojë kuadrin ligjor në fuqi për parandalimin e torturës, trajtimin çnjerëzor dhe degradues, si dhe respektimit të të drejtave të individëve. Sipas dispozitave kryesore të OPCAT, një veprimtari e tillë është konsideruar tepër e rëndësishme në kuadër të parandalimit dhe korigjimit të akteve apo fenomeneve që mund të shkaktojnë torturë, trajtim jo human dhe degradues.

Gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit, në rolin e tij si MKPT, paraqiti pranë Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit një sërë rekomandimesh, në të cilat u kërkua që të nxirreshin akte nënligjore për të parandaluar mbajtjen e sendeve të dyshimta në ambientet e hetimit policor, të miratohej një rregullore e re mbi trajtimin

e personave të arrestuar dhe ndaluar sipas standarteve të reja të parashikuar në Ligjin “Për Policinë e Shtetit”, të qartësohej veprimtaria policore e ambjenteve të izolimit për tu bërë e dallueshme nga sistemi i paraburgimit, të riformatoheshin rregjistrat policor me rubrika të reja për njoftimin e familjarëve dhe avokatit, të ridimensionohej puna e psikologut në Institucionet e Policisë së Shtetit duke treguar vëmendje edhe ndaj punonjësve të policisë që mund të kishin probleme psikologjike, si dhe të rishikoheshin dhe pasuroheshin kurrikulat e Qendrës së Formimit Policor me akte ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Në përgjigje të këtyre rekomandimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka informuar për një sërë masash pozitive që janë marrë duke miratuar një manual të ri për trajtimin e personave të arrestuar dhe ndaluar, duke nxjerrë një urdhër për heqjen nga çdo zyrë të sendeve të dyshimta që mund të shkaktojnë presion psikologjik tek individët si dhe duke ri-formatuar rregjistrat policor sipas rubrikave të reja. Policia e Shtetit është treguar e gatshme për të ofruar asistencë psikologjike ndaj punonjësve të saj, si dhe ka kërkuar ndihmë për një plotësim të kurrikulave mësimore dhe trajtnues për të drejtat e njeriut.

Gjatë vitit 2010, Avokati i Popullit në rolin e tij si MKPT, paraqiti pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve një sërë rekomandimesh në të cilat u kërkuar që të miratoheshin dhe ndryshoheshin akte nënligjore për të përmirësuar Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, për të ndryshuar rregjistrat e takimeve të të dënuarve dhe paraburgosurve, duke vendosur më tepër informacion, për të ulur mbipopullimin në disa burgje, duke kryer rikategorizimin e disa institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, për të shmangur përgjegjësinë e mjekut të burgut në rastet e dhënies së lejeve të veçanta të të dënuarve etj. Në përgjigje të këtyre rekomandimeve Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë informuar për një sërë masash pozitive që janë marrë duke ndryshuar pozitivisht Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve sipas propozimeve tona, duke ndryshuar rregjistrat e institucioneve penitenciare si dhe duke kryer kategorizimin e dy institucioneve penitenciare si burgje dhe paraburgime për të trajtuar në ambjentet e tyre më tepër persona për të ulur mbipopullimin në institucione të tjera.

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka ndërmarrë edhe një sërë iniciativash për të ndërhyrë me rekomandime të veçanta në zgjidhjen e çështjeve që i përkasin trajtimit sipas ligjit të ushtarakëve. Në këtë kuadër janë hartuar rekomandime për përfshirjen sipas ligjit të disa kategorive të ushtarakëve në skemën e kompesimit të qirasë së banesave të tyre. Gjithashtu është prezantuar edhe një rekomandim për rritjen dhe standartizimin e normës ushqimore të pilotëve të Forcave të Armatosura sipas kategorive të tjera

të pilotëve të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe është ndërhyrë me rekomandim për nxjerrjen e një urdhëri për përfitimin e orëve shtesë jashtë orarit normal të punës të disa ushtarakëve në interpretim dhe zbatimin në praktikë të nenit 17 dhe të nenit 31 pika 2 të *Ligjit Nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"*.

## **5. Vlerësime të Përgjithshme**

Avokati i Popullit vëren se roli i tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka intensifikuar veprimtarinë në drejtim të mbrotjes së të drejtave të njeriut dhe trajtimit të ligjshëm të individëve në institucionet shtetërore ku liria e tyre është e kufizuar. Gjatë gjithë vitit 2010 është vënë re një nivel bashkëpunimi serioz dhe eficient me të gjitha organet shtetërore që kanë për detyrë të respektojnë kuadrin ligjor në fuqi dhe të drejtat e njeriut në këtë fushë. Veprimtaritë e përbashkëta, komunikimi dhe dialogu, shkëmbimi i informacioneve dhe rritja e frymës së dialogut kanë qenë një aset me mjaft vlerë për të realizuar ndryshime të qënësishme në favor të të drejtave të qytetarëve.

Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë ka qenë një veprimtari me mjaft vlerë dhe interes për të evidentuar dhe forcuar kapacitetet tona institucionale dhe për t'i shndërruar këto resurse në një faktor të qëndrueshëm ekspertize dhe ndihme ndaj vendeve të tjera. Avokati i Popullit vlerëson punën dhe bashkëpunimin e sukseshëm të OJF-ve dhe organeve të medias, të cilat pa dyshim kanë dhënë një kontribut të madh në forcimin dhe mbulimin e plotë të aktivitetit monitorues në çdo institucion shtetëror.

Në konsideratë të veçantë vlerësohet minimizimi i rasteve flagrante të dhunës, torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues në institucionet shtetërore, çka nënkupton një ndërgjegjesim të lartë të funksionarëve dhe punonjësve të këtyre organeve lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit vëren se ka ende shumë punë për të bërë në konsolidimin e standarteve të të drejtave të njeriut dhe trajtimit të individëve. Si prioritete shikohen me mjaft rëndësi vazhdimi i investimeve infrastrukturore për përmirësimin e ambjenteve të izolimit, trajnimi i vazhdueshëm i efektivave punonjës të sigurisë, promovimi i praktikave të mira në mardhënie me individët e privuar nga liria, rritja e transparencës të veprimtarive në këtë fushë etj.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vlerësuar si të pamjaftueshëm angazhimin institucional, fondet e vëna në dispozicion dhe masat e marra për



përmirësimin e situatës në shërbimet spitalore. Krahas kësaj Ministria e Shëndetësisë është treguar shpesh inaktive për të lëvizuar në kohë dhe për të informuar në çdo rast përmirësimet e kryera nga ana e saj për gjendjen.

Vihet re një bashkëpunim më i mirë dhe korrekt nga ana e Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për të realizuar me shpejtësi propozimet për ndryshimin e gjendjes në disa institucione në varësi të saj.

Në përgjithësi shërbimet shëndetësore dhe sociale që u ofrohen individëve në këto qendra kanë nevojë për më shumë fonde investimi, plotësim organike, shpejtësi në realizimin e projekteve, përqëndrim dhe vëmendje më të madhe në trajtimin human të të sëmurëve si dhe në shtimin e projekteve të reja që do të mundësonin një përmirësim të dukshëm të shumë zërave.

Avokati i Popullit vlerëson maksimalisht bashkëpunimin, klimën e dialogut dhe ndihmës reciproke që ekziton me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtoritë e IEVP-ve.

Zbatimi i reformave dhe masave të marra në përmirësim të sistemit të burgjeve ka sjellë një përmirësim të dukshëm të shërbimeve. Gjithashtu, hapat e ndërmarra në trajnimin e stafit punonjës, përfshirja e tyre në programe shkëmbimi eksperiencash ka qenë një model pozitiv, që ka rritur ndjeshëm ndërgjegjesimin e tyre mbi të drejtat e njeriut.

Megjithatë, vijojnë të mbeten ende problem amortizimi i disa institucioneve penitenciare, mungesa e fondeve financiare për investime, mungesa e përmirësimit të kushteve në disa burgje, krijimi i hapësirave për jetesë, eliminimi i plote i mbipopullimit, si dhe një standartizim i plotë i shërbimeve penitenciare në të gjitha IEVP-te në vend.

Avokati i Popullit beson se përpjekjet institucionale të përbashkëta në përmirësimin të kësaj fushë do të vijojnë të forcohen edhe me shume në të ardhmen për të përmirësuar sa më shpejt detyrimet të rëndësishme mbi të drejtat e njeriut dhe angazhimeve integruese të vendit.

## Kreu IV

### **Informacion i përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit**

Praktika e qeverisjes së mirë dhe ndërveprimi midis autoriteteve publike dhe taksapaguesve sigurohen nga funksionimi i mekanizmave të pavarur e të paanshëm për të shqyrtuar mënyrën se si ka vepruar Qeveria. Sistemi i kontrollit dhe balancës sot është një parim bazë i qeverisjes moderne në të gjithë botën.

Institucioni kushtetues i Avokatit të Popullit, si instancë kombëtare, garante e demokracisë, u parashikua për herë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të miratuar më 28 Nëntor 1998, e cila në 5 nene të saj përcakton detyrat, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Në zbatim të saj, në shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454, dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i cili më pas u shtua dhe ndryshua me Ligjin 8600, datë 10.04.2000 dhe atë nr.9389, date 12.05.2005.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke miratuar legjislacionin për Avokatin e Popullit, ka përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion. Ato janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti, të përcaktuara si Parimet e Parisit e për të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit është çertifikuar edhe nga institucionet kompetente ndërkombëtare që mbikqyrin këto standarte.

Parë nën perspektivën e proceseve integruese të vendit tonë, nënvizojmë se, përveçse ndikimit pozitiv në mirëqeverisje, ngritja dhe konsolidimi i Avokatit të Popullit në Shqipëri plotëson një kusht të kritereve politike të Kartës së Kopenhagës, për pranimin në Bashkimin European. Me vizionin se tashmë në demokraci, graviteti i kahjes së mbrojtjes së të drejtave të njeriut ka ndryshuar nga shteti tek qytetari, Institucioni i Avokatit të Popullit synon që me precedentet e krijuar, qoftë edhe me zgjidhjen e ankesave më të thjeshta, të arrijë të krijojë tek qytetari bindjen se nëpunësi civil apo autoriteti publik tashmë paguhet nga taksat e tij për t’i shërbyer atij, pra qytetarit. Nga ky këndvështrim, sa qytetar, aq edhe politik, pozicioni social dhe mentaliteti i qytetarit shqiptar nuk ka se si të mos ridimensionohet dhe përafrohet me atë të qytetarit European.

Kemi rastin të theksojmë se veçori themelore e institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga qeveria dhe nga çdo ndikim politik, lehtësisë së kontaktimit, shpejtësisë dhe fleksibilitetit në kapjen e problemeve, është efektiviteti dhe forca e rekomandimeve të tij.

Çdo zyrë ombudsmani në botë, sikundër edhe në Shqipëri, faktikisht ndeshet çdo ditë edhe me forma të rezistencës të organeve të administratës apo të autoriteteve publike. Në kushtet tona, kur institucionet ende rezultojnë jo të mësuara e të konsoliduara me ndërgjegjen e shtetit të së drejtës, kjo është edhe më e dukshme. Por, nëse secili do të udhehiqet nga parimi demokratik i pushteteve të kufizuara, mendojmë se ekzistojnë hapësira të mjaftueshme për njëri-tjetrin, ku bashkëpunimi të jetë sa më efikas. Fakti që ligji i mundëson Avokatit të Popullit ngritjen e problemit si për kryetarin e komunës dhe për ministrin deri në Parlament, tregon qartë se instrumenti ynë kryesor, që është Rekomandimi, kur ka brenda argumentin ligjor, ka edhe forcën reale të imponimit, duke realizuar atë që quhet “drejtësi e butë”. Në kushtet kur kjo bëhet me të vetmin qëllim, për të rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit në raport me administratën, rezultati merr edhe më shumë vlerë, sepse para se të jemi shtetarë, policë, prokurorë apo zyrtarë, të gjithë jemi qytetarë.

Institucioni i Avokati i Popullit nuk është një institucion akuze dhe as gjurmimi ndaj administratës publike në Shqipëri. Kritikën apo kërkesat tona për masa ndëshkuese ndaj punës së administratës apo zyrtarëve të veçantë, nuk përbëjnë qëllim në vetvete. Ne kritikojmë veprimet ose mosveprimet e administratës në rekomandimet dhe raportet tona, sikurse veprojnë ombudsmenët në të gjitha vendet.

Qëndrimi që administrata mban ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit është tregues i përgjegjshmërisë së saj ndaj shkeljeve që kryen si edhe i faktit se sa e gatshme është ajo për t'i riparuar ato. Prandaj, veprimtaria jonë, ashtu si edhe deri tani, është mirëkuptuar e trajtuar me drejtësi nga të gjitha palët që bëjnë politikën në Shqipëri.

## **1. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun**

Marrëdhëniet publike fillojnë që nga elementet etike në kontaktet e para me ankuesit, deri tek ato institucionale me zyrtarët e shtetit, pavarësisht nga hierarkia. Kontaktet me ankuesit, në Institucionin tonë, realizohen nëpërmjet Sektorit të Pritjes së Popullit. Në zbatim të Ligjit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet Zyrtare, Nr.8503, datë 30.06.1999, kjo zyrë u krijua si pjesë e infrastrukturës për përballimin në vazhdimësi të fluksit në rritje të individëve, të cilët paraqiten pranë nesh për të parashtruar ankesa ose kërkesa në lidhje me shkelje të të drejtave

dhe interesave të ligjshme të tyre. Për këtë arsye, një nga juristët e institucionit, pret në çdo kohë gjatë orarit zyrtar, pa pengesa, me kulturë e profesionalizëm, ankesat e individëve të ndryshëm. Sektori i Pritjes së Popullit, si pikë takimi e parë e Marrëdhënieve me Publikun, ka ofruar shërbimin e tij, si nëpërmjet përpilimit të ankeses apo kërkesës që individë të ndryshëm parashtrojnë, ashtu dhe nëpërmjet këshillimeve ose orientimeve ligjore profesionale që ata kërkojnë, kur çështja që parashtrohet prej tyre nuk është objekt i veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Qytetarëve u ofrohet informacioni i kërkuar dhe njohja me legjislacionin në fuqi, si dhe u jepen sqarime të mëtejshme për rrugën që ndiqet pas ankesës së bërë.

Gjatë vitit 2010, numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Pritjes së Popullit, është **1651 ankesa apo kërkesa**. Ne tabelën e mëposhtme pasqyrohen ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimit të atyre që kanë qenë brenda juridiksionit e kompetencave të Avokatit të Popullit.

<b>Muaji</b>	<b>Ankesa gjithësej</b>	<b>Ankesa për tu shqyrtuar</b>
Janar	151	65
Shkurt	156	61
Mars	181	101
Prill	160	85
Maj	143	55
Qershor	137	51
Korrik	142	51
Gusht	60	15
Shtator	128	67
Tetor	131	49
Nëntor	122	44
Dhjetor	140	34
<b>Totali</b>	<b>1651</b>	<b>678</b>

Sikundër mund të shikohet nga numri i përgjithshëm i ankesave ose kërkesave verbale, që janë paraqitur pranë Zyrës së Pritjes së Popullit, janë pranuar për shqyrtim 678 ankesa apo kërkesa, ndërsa në 973 raste, ankuesve u është dhënë këshillim profesional, pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre, duhej të shqyrtoheshin nga organet përkatëse të administratës publike sepse nuk ishin shteruar të gjitha rrugët e ankimit administrativ sipas procedurës përkatëse ligjore. Për ato çështje që nuk kanë qenë në juridiksion të Institucionit tonë, u është treguar rruga ligjore që duhet të ndjekin .

## **Problematikat e shfaqura**

Sektori i Pritjes së Popullit ka evidentuar me kujdes, problematikat e ankesave që individët kanë paraqitur, të cilëve u është dhënë konsulenca e nevojshme juridike, për zgjidhjen e problemit të tyre. Nga ky evidentim del se ankesat jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit kanë qenë si më poshtë:

Ankesa ndaj vendimeve të Gjykatave Shqiptare	165
Kërkesa për përfaqësim në gjykatë	167
Konflikte midis individëve	65
Ankesa ndaj subjekteve private	82
Konflikte në familje	85
Ankesa ndaj kompanive të huaja private	78
Ankesa ndaj gjykatave të shteteve të huaja	42
Ankesa ndaj përfaqësive të huaja në Shqipëri	57
Ankesa ndaj shteteve të huaja	58
Ankesa ndaj organeve të policisë së shteteve të huaja	40
Të tjera	134

Ashtu siç mund të shihet në tabelën e mësipërme, numri më i madh i këtyre ankesave, drejtohet ndaj gjykatave shqiptare të të gjitha niveleve.

Këto ankesa zënë rreth 16.9% të të gjitha ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Duke mos qenë dakort me vendimet e gjykatave, individët ankohen për korrupsion e marrje rryshfeti. Një problem tjetër që është evidentuar, janë konfliktet në familje si dhe konfliktet midis individëve, të cilat zënë rreth 15.4% të ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Në të shumtën e rasteve, problematika e këtyre ankesave ka patur të bëjë me probleme në familje, probleme trashëgimie, të pronës etj. Rreth 8.4% e ankesave kanë qenë kundër subjekteve private.

Problemet janë të ndryshme dhe rëndojnë mbi qytetarët edhe për shkak se strukturat e tjera të shtetit nuk veprojnë. Gjithashtu, një pjesë tjetër ankesash, është drejtuar ndaj institucioneve të shteteve të huaja, dhe kanë patur të bëjnë me padrejtesi të ndryshme të pretenduara ndaj shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë.

## **2. “Ditët e Hapura”**

Gjatë vitit 2010 ne vazhduam praktikën e konsoliduar të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, që i kemi quajtur “ Ditët e Hapura “. Kjo ka rezultuar të jetë një praktikë shumë e frutshme që, jo

vetëm shkurton procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, por edhe manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve. Gjatë vitit 2010 janë organizuar “Ditët e Hapura” në 40 bashki e komuna, nga ku janë pritur gjithsej 315 ankues. Nga këto, për 100 raste të parashtruara, janë pranuar ankesat për shqyrtim ndërsa për 215 raste të tjera, ankuesit janë sqaruar apo këshilluar në vënd.

Takimeve tona në “Ditët e Hapura“ u kanë paraprirë bisedat në televizionet lokale si dhe njoftimet e bëra publikut, nga zyrtarët e bashkive dhe komunave përkatëse. Përvoja e fituar në “Ditët e Hapura” dhe nga inspektimet me objekt të caktuar, siç kanë qënë inspektimet në burgje, takimet me efektiva të reparteve ushtarake etj, ka nxjerrë si domosdoshmëri që kjo punë të thellohet në të ardhmen, me synim rritjen e efikasitetit dhe shpejtesise se zgjidhjes se ankesave atje ku lindin.

Natyrisht, dimensionin e tyre më të plotë, marrëdhëniet publike e fitojnë përmes marrëdhënieve me pushtetin e katërt, pra me shtypin e shkruar dhe median në tërësi.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se në kohet e sotme, rruga më efektive e të bërit të njohur është përmes mediave. Metoda se si Avokati i Popullit ka menaxhuar njohjen dhe promovimin e punës së tij kanë qënë kontaktet e përditshme me gazetarët dhe furnizimi i tyre me informacione në mënyrë profesionale, pa sekretomani, pa rendur pas lajmeve që shkaktojnë skandale, por edhe pa iu lidhur duart atyre vetëm me njoftime të thata për shtyp.

Vetëm duke rritur shkallën e njohjes, ndryshuar dhe forcuar imazhin dhe pozicionuar Institucionin drejt në opinionin publik ose qofte edhe në mendimin e një pjese të publikut, ne na rezulton që të kemi krijuar mirëkuptimin dhe mirëdashjen e nevojshme për të realizuar komunikimin me mjedisin dhe integritetin tonë institucional në shoqërinë shqiptare.

Marrëdhëniet me median gjithmonë i kemi parë me përparësi, sepse kemi patur dhe kemi si objektiv të rrisim besueshmërinë e publikut ndaj institucionit tonë në praktikë. Jemi të bindur se sukcesi arrihet duke u bazuar në dy shtylla, të cilat janë zgjidhjet me kompetencë profesionale dhe transparenca në punën tonë. Ajo që kemi synuar është mënjanimi i çdo elementi demagogjik në marrëdhëniet me median. Ne mendojmë se këtë e kemi arritur, duke zbatuar një strategji disi të veçantë të informimit për punën tonë. Paradigma tashmë e konsoliduar në marrëdhëniet me median është përqendruar në tre nivele komunikimi. E para, mediave u kemi dhënë materiale, kryesisht mbi bazën e rasteve konkrete. E dyta, jemi munduar të bëjmë edhe përgjithësime, duke shpjeguar rolin, kompetencat dhe juridiksionin tonë pas çdo rasti konkret, të trajtuar gjithmonë me mjaft transparenca nga ekspertët tanë. E treta, njoftimet për shtypin, të shpërndara për median sipas rasteve dhe aktivitetit të Zyres.

Për vitin 2010, rezulton se Institucioni i Avokatit të Popullit, ka qënë 140 herë i pranishëm në Median e shkruar, dhe 35 herë në Median elektronike. Megjithatë, ne nuk e shohim praninë në shtyp si qellim në vetvete, pasi kjo është diçka e ndryshueshme nga viti në vit. Tregues cilësor është zgjerimi i gjeografisë dhe shumëllojshmërisë tematike të këtij mbulimi mediatic.

Një bashkëpunim konstant, Zyra e AP-se ka vendosur tashmë edhe me Gazetën Europjane të Strukturave Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, përmes së cilës ne shkëmbejmë përvojat tona me parterët ndërkombëtarë.

Një nga të drejtat, të cilën e kemi evidentuar në media gjatë vitit 2010, është ajo e mosdiskriminimit. Në media kemi pasqyruar edhe debatet tona pranë Komisionit të Ligjeve pranë Kuvendit, ashtu edhe prononcimet tona të herëpashershme, për të kulmuar deri në pasqyrimin e aktivitetit vjetor që Avokati i Popullit organizon që nga krijimi i tij, e që për vitin që shkoi ishte nën temën “Shoqëria shqiptare, sfidat e mosdiskriminimit”.

E drejta e pronës është trajtuar në media, përmes investimit të Avokatit të Popullit, si për çështje konkrete, ashtu edhe për rregullim sistematik.

E drejta e mostorturës dhe parandalimi i trajtimit çnjerëzor e poshtëruar ka qënë një temë mjaft e ndjeshme, e pasqyruar në faqet e shtypit të shkruar, por edhe në atë elektronik. Kontrollat e herëpashershme të Njësisë për Parandalimin e Torturës kanë zënë një vend qendror në pasqyrimin mediatic të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Krahas inspektimit rutinor të sistemit penitenciar të vendit, në media ka zënë vend edhe angazhimi i Avokatit të Popullit për rregullimin sistematik të problematikës në fjalë, përmes propozimeve të tij për përmirësimin e rregulloreve të burgjeve, për trajtimin e lejeve shpërblyese të të burgosurve, por edhe për përmirësimin e trajtimit financiar të personelit që shërben në këto institucione.

Cilësia e shërbimeve publike ka qënë dhe mbetet një problematikë në ndjekje nga ana e Avokatit të Popullit dhe kjo kryesisht referuar problemeve dhe ankesave të qytetarëve për shërbime të tilla që kanë pasur të bëjnë me ndërveprimin e Entit Rregullator të Energjisë, me ndërmarrjen e sistemit të shpërndarjes. Të kësaj natyre kanë qënë edhe ndërhyrjet e Avokatit të Popullit për sistemin e taksave vendore, moscënimin e së drejtës së jetës nga aksidentet në rrugë, të drejtat e ish të persekutuarve politikë lidhur me dëmshpërblimin e tyre, e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parë kjo si në rastin e mosnjohimit të rregullt të qytetarëve, ashtu edhe në rastin e moszbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Natyrisht, një vend modest në media, për vitin që shkoi, ka patur edhe situata e krijuar brenda institucionit të Avokatit të Popullit, pas përfundimit të mandatit të ish titullarit, si dhe përpjekjet tona për të sensibilizuar opinionin publik, brenda dhe jashtë vendit, për të zgjidhur situata eventualisht problematike, nëpër të cilat ky institucion do të duhej të kalonte, sikundër ishte edhe momenti i zgjedhjes së komisionerëve. Këtë e konsiderojmë një sukses të përbashkët bashkë me Komisionin e Ligjeve dhe të Drejtave të Njeriut pranë Parlamentit, dhe natyrisht edhe me vetë Parlamentin, si Institucioni më i lartë që legjitimon, ndër të tjera, edhe ekzistencën e Institucionit kushtetues të Avokatit të Popullit.

Përmes Medias ne jemi njohur edhe me ankimet e mjaft individëve, por dhe me prioritetet e Qeverisë shqiptare. Tek media kemi patur aleatin më të sigurtë, për tu bërë pjesë e opinionit publik, në rastet kur na është dashur të ndeshemi me rezistencën e atyre zyrtarëve publikë, të cilët fatkeqësisht ende e konsiderojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit si diçka bezdisëse, aq më shumë ne rastet kur harrojnë se ky instrument, vërtetë është jo detyrues formalisht, por sa kohë që ai është mirëbazuar në ligj, është e qartë se askush nuk i shpëton detyrimit për zbatimin e tij.

Duke përqafuar vlerësimin se gazetarët janë “rojtare publikë”, bashkëpunimin me ta e kemi parë si mjetin, pa të cilin edhe publiku nuk do të dinte si të na drejtohej, sikundër edhe zyrtarët nuk do të njiheshin me forcën praktike të instrumentit tonë, që është Rekomandimi i bazuar në ligj dhe i përpiluar me fuqinë më të madhe të mundshme argumentuese. Veçoria e rekomandimit të Avokatit të Popullit është se për të arritur deri tek ai, kërkohet dhe mundësohet një kohë më e madhe fizike dhe intelektuale, për më tepër kur operohet nga një këndvështrim edhe më i gjerë, sikundër është mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje kryesisht, parashikuar nga neni 13-te i Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. I gjithë spektri i shtypit të përditshëm filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë. Në strategjinë e mbulimit mediatik janë patur parasysh si ndërjegjësimi i publikut, ashtu edhe efekti edukativ i informacionit. Kjo është bërë me pasqyrimin e vazhdueshëm në Mediat të të gjitha rasteve, kur administrata na ka mirëkuptuar, duke rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit.

Duke bërë herë pas here një analizë të secilit seksion për punën e kryer, ne kemi punuar paralelisht edhe për zbatimin e pikave bazë të strategjisë sonë në fushën e marrëdhënieve me publikun, sidomos përmes Medias. Në tërësinë e saj, Strategjia e mbulimit mediatik, si pjesa thelbësore e Marrëdhënieve me Publikun, është formuluar që në vitin 2000 dhe është publikuar edhe në raportet e viteve të mëparshme.



E qëndrueshme ka qenë dhe do të mbetet qasja jonë ndaj gazetarëve si partnerë, duke u ofruar atyre informacione të përshtatura për shtypin, që u shërbejnë nevojave të mediave, si dhe duke i planifikuar nga ana strategjike temat, momentet e publikimit si dhe instrumentet e punës së mediave, për të përcjellë jo vetëm atë që synojmë të japim ne, por edhe atë që publiku ka nevojë dhe të drejtë të dijë.

### **3. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse**

Veprimtaria e Avokatit të Popullit nuk do të mund të ishte e suksesshme pa një bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë aktoret dhe faktorët, të cilet japin kontributin e tyre në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Padyshim që ky bashkëpunim, është vlerësuar si një marrëdhënie ligjore me të gjithë organet e administratës publike dhe të tretët që veprojnë për llogari të saj, në kuadër të opionencës për mënyrën se si ofrohet mirëqeverisja nga ana e këtyre organeve për qytetarët, por edhe si një bashkëveprim me të gjitha ato struktura të shoqërisë civile, të cilat kanë dhënë dhe japin realisht kontribut, për ngritjen dhe konsolidimin e një shoqërie demokratike dhe shtetit të së drejtës në vend.

Aktualisht këto struktura të njohura ndryshe si Organizata Jofitimprurëse, kanë arritur në një numër në mbi 1000 të tilla në vend dhe mendohet se, ky numër mund të jetë edhe më i madh, ndërkohe që të gjitha ato punojnë me projekte dhe financime nga donatorët e huaj. Është fakt se, pa ndihmë financiare nga jashtë, asnjë prej tyre nuk mund të mbijetojë.

Megjithatë, ajo çka mbetet gjithnjë një aspekt pozitiv i veprimtarisë së tyre është fakti që, ato bëhen pjesë e problemeve shoqërore dhe janë mjaft sensibil ndaj punës së tyre.

Dëgjohet shpesh thënia se, marrëdhëniet e shtetit me organizatat jofitimprurëse në Shqipëri, në përgjithësi janë opozitare dhe ka patur mosbesim të dyanshëm. Vleresojmë se zëri i këtyre organizatave ka shërbyer kohe pas kohe në të mirë të politikave qeverisëse, sikundër edhe ka plotësuar dhe plotëson kuadrin pluralist të mendimit dhe organizimit të lirë të individëve.

Është pikërisht ky moment, i cili ka bërë që OJF të ndryshme që ushtrojnë veprimtari aktive dhe serioze në fushën e të drejtave të njeriut, të konsiderohen nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, si partnere shumë të vlefshme, jo thjesht për përmbushjen e veprimtarisë së tij, por si institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, parë në këndvështrimin e parimeve të Kopenhagenit.

Për këtë arsye, pjesë e rëndesishme e punës së njerit prej seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit, përkatesisht të Seksionit të Përgjithshëm, është bashkëpunimi me organizatat jo fitimprurese, sikurse përcaktohet në nenin 31, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Organizatat jofitimprurese vendase dhe të huaja, luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e zbatimit të të drejtave të njeriut, dhe për promovimin e tyre. Shumë prej tyre ofrojnë shërbime të ndryshme për femijet-viktima, si asistencë ligjore falas, kryejnë punë hulumtuese, publikojnë raporte mbi gjendjen e të drejtave të femijeve, si dhe organizojnë trajnime të ndryshme për edukimin e zyrtareve publik, duke rritur ndërgjegjesimin e tyre.

Nuk kanë munguar, gjatë vitit 2010, bashkëpunimet me një sërë organizatash jofitimprurese, për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të femijeve. Kështu, në datën 17 dhjetor 2010 Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijeve në Shqipëri, CRCA, organizoi Debatin e 3-të Kombëtar për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri “Shqipëria dhe Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut”, ku Institucioni i Avokatit të Popullit kishte një rol aktiv. Komisionerja e Seksionit të Përgjithshëm referoi me temën “Roli i Institucioneve të pavarura në mbrojtjen e të drejtave të njeriut”.

Një bashkëpunim shumë të frytshëm dhe të vazhdueshëm kemi patur edhe me organizatën TLAS-Albania, me të cilën bashkëorganizuam Seminarin Kombëtar me temë: "Shoqëria Shqiptare - Sfidat e Mosdiskriminimit".

Vlen të përmendim këtu si bashkëpunim mjaft të frytshëm me këtë organizatë edhe referimin e ndërsjellë të rasteve të ankesave, që na janë drejtuar nga ankues të ndryshëm, me qëllim gjetjen e rrugëve efikase ligjore për zgjidhjen e tyre, duke kombinuar rolin mediator të Avokatit të Popullit, me përfaqesimin ligjor falas në procese gjyqësore që ofrohet nga kjo OJF.

#### **4. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare**

Duke patur parasysh statusin unik të Ombudsmanit, ka rezultuar që ky institucion forcohet më shumë dhe zhvillohet më tej kryesisht përmes bashkëpunimit me zyrat homologe si dhe pjesëmarrjes aktive në forumet ndërkombëtare. Për këtë arsye që në fillim të veprimtarisë së tij, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka bashkëpunuar me Institucionet homologe dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

Avokati i Popullit është aktualisht anëtar me të drejta të plota i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit, i Ombudsmanit Evropian dhe

Shoqatës së Ombudsmanit Frankofon. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia Avokati i Popullit i realizon përmes pjesëmarrjes në aktivitete si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

***Pjesëmarrja e Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitetet e organizuara nga Këshilli i Europës***

Bazuar në direktivën mbi forcimin e parandalimit të torturës në nivel kombëtar në të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës dhe në vijim të Projektit për krijimin e një rrjeti aktiv Evropian të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në kuadër të projektit “Peer-to-Peer Project II”, Këshilli i Evropës zhvilloi në Padova, Itali, më 16-17 janar, seminarin me temë: “Të luftojmë trafikimin dhe të mbrojmë të drejtat njerëzore të viktimave. Roli i Strukturave Kombëtare për të drejtat e njeriut”, ku Institucioni i Avokatit të Popullit prezantoi eksperiencën e tij në temën e diskutimit.

Në kontekstin e projektit: “Heqja e pengesave të moszbatimit të vendimeve gjyqësore. Të sigurojmë një zbatim efektiv të vendimeve të gjykatave vendore”, Këshilli i Evropës, organizoi në Mars 2010 në Strasburg, tryezën e rumbullakët me temë “Zgjidhjet efektive ndaj moszbatimit të vendimeve gjyqësore vendore”, duke ndarë kështu eksperiencën e vendeve anëtare, ku ishte ftuar edhe Institucioni i Avokatit të Popullit për të ndarë përvojën e tij.

Gjithashtu, më 3 Dhjetor 2010 në Strasburg u zhvillua takimi vjetor i personave të kontaktit të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në kuadrin e “Peer-to-Peer Project II” bashkëfinancuar nga Këshilli i Evropës dhe Komisioni Europian, ku u analizua puna vjetore e këtij rrjeti të zyrave të Ombudsmanëve, si dhe u përcaktuan drejtimet ku do të zhvillohet ky bashkëpunim për vitin 2011.

***Pjesëmarrja e Institucionit të Avokatit të Popullit në aktivitetet e organizuara nga Shoqatat Ndërkombëtare të Ombudsmanëve***

Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI) me sloganin “Europa - një Shoqëri e Hapur”, zhvilloi në Barcelonë, më 3-5 tetor 2010, Konferencën e vet Vjetore si dhe mbajti Asamblenë e Përgjithshme të IOI-se.

Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë (AOMF) organizoi më 25-26 maj në Rabat, Marok konferencën me temë: Roli i Mediatorit kundrejt reformave në Administratë”.

Shoqata e Ombudsmanëve Mesdhetare (AOM) organizoi në Madrid, më 14-15 qershor 2010, takimin e katërt të kësaj shoqate me temë “Imigracioni dhe të drejtat e njeriut: sfidë për institucionet e Ombudsmanit”.

Gjatë vitit 2010, Institucioni i Avokatit të Popullit ka shkëmbyer përvojën e tij me institucione homologe ndërkombëtare në aktivitete të ndryshme si konferenca, workshope apo tryeza të rrumbullakta.

### **Vizitat e homologëve ndërkombëtarë pranë Avokatit të Popullit**

Me ftesë të Avokatit të Popullit erdhi në Shqipëri për një vizitë zyrtare Ombudsmani i Marokut, Z. Moulay M'Hamed Iraki, më 23-27 tetor 2010.

Gjatë vizitës së tij pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ai u njoh nga afër me punën dhe arritjet e këtij Institucioni gjatë 10 vjetëve të aktivitetit të tij dhe u prit nga autoritetet më të larta të Shtetit shqiptar.

## **5. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2010**

Krahas aktiviteteve ndërkombëtare, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë dhe në shumë aktivitete të organizuara nga institucionet e tjera shtetërore dhe shoqëria civile. Në të gjitha këto aktivitete, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me problematikën e diskutuar në to, e cila ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme, në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Pjesëmarrja jonë ka qenë gjithmonë aktive, pasi bashkëpunimin me organet e administratës së të tre pushteteve si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë, si mbikqyrës të respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha dimensionet e tyre.

## **6. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit**

Ligji nr. 8600, dt.10.04.2000, “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit””, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës dhe numrit të personelit të tij, kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, sikundër është përcaktuar në nenin 31 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Seksioni i parë* merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, dhe aktualisht drejtohet nga Komisionerja Florina Nuni.

*Seksioni i dytë* merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura, prokurorinë dhe pushtetin gjyqësor dhe drejtohet nga Komisioneri Arben Shkemi.

*Seksioni i tretë*, trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe drejtohet nga Komisionerja Anila Nepravishta.

Organika e Institucionit të Avokatit të Popullit përbëhet nga 48 punonjës, prej të cilëve 26 janë juristë dhe merren direkt me trajtimin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të individëve, kurse pjesa tjetër përbën stafin ndihmës i cili ndihmon për realizimin e detyrave kryesore të institucionit. Ndërmjet punonjësve, 6 janë zyrtarë të lartë (Avokati i Popullit, tre Komisionerët, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Kabinetit), 30 janë punonjës që mbajnë statusin e nënpunësit civil dhe 12 punonjës të kontraktuar sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Përsa i përket cilësive profesionale të personelit të zyrës sonë vëmë në dukje se 9, nga anëtarët e stafit tone, kanë kryer studime pasuniversitare në fusha të ndryshme të së drejtës dhe administrimit.

## 7. Buxheti i Institucionit për vitin 2010

Per vitin 2010 Institucionit të Avokatit të Popullit, mbeshtetur ne Ligjin nr.10190, date.26.11.2009 “Per buxhetin e shtetit te vitit 2010”, i është akorduar një buxhet në shumën prej 90.000.000 leke, në fillim te vitit dhe me rishikimin e tij në bazë të ligjit nr.10310 date.26.07.2010, buxheti i institucionit u ul 3.560.000 lekë në zërin e shpenzimeve operative dhe buxheti perfundimtar për periudhen objekt raportimi ka qënë 87.351.960 lekë.

Ky buxhet është konsumuar në masën 93.15 % e konkretisht:

Nr. Llog.	Emërtimi	Plan lekë	Realizim lekë	Realiz. %
600	Pagat	58.142.484	56.477.912	97.14%
601	Sigurim shoqeror	6.720.000	6.716.189	99.94%
602	Shp operative	15.327.516	15.269.188	99.62%
605	Kuote anetaresie	250.000	250.000	100.00%
604	Pagesa kalimtare	911.960	911.960	100.00%
231	Pajisje	6.000.000	1.472.750	24.55%
	<b>Totali</b>	<b>87.351.960</b>	<b>81.367.999</b>	<b>93.15%</b>

Institucioni ynë, referuar ndryshimeve në buxhetin e vitit 2010, ka rishikuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim më të mirë dhe

me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme të vitit 2010.

Fondi i pagave është realizuar në zbatim të struktues organizative të miratuar. Gjatë 12-mujorit të vitit 2010, numri mesatar i punonjësve është realizuar 47 vetë, nga 48 vetë të miratuar (Avokati i Popullit nuk është zgjedhur akoma nga Kuvendi edhe për këtë periudhë që raportojmë).

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe sigurimeve shoqërore, për këtë periudhë, janë realizuar respektivisht: 56,477,912 lekë ose 97.14% e fondit të planifikuar vjetor të pagave si rrjedhojë e argumentimit të mesipërm, për kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore janë realizuar 6,716,189 lekë ose 99.94% e fondit planifikuar për vitin 2010.

Fondi për shpenzime operative për vitin 2010, në mbështetje të buxhetit të rishikuar dhe të miratuar nga Ministria e Financave, është planifikuar në vlerën 15,327,516 lekë duke është realizuar 15,269,188 lekë ose 99.62%.

Për vitin 2010 shpenzimet operative, janë përdorur për blerje kancelarish, mjete pastrimi, energji elektrike, ujë, ALBTELEKOM, VODAFON, AMC, internet, abonime gazeta, shërbimi postar, karburant, pjese kembimi automjete, shpenzimet e siguracionit, parkim automjetesh, dieta brenda vendit e jashte vëndit, shërbime mirëmbajtjeje, fotokopje e printera, shpenzime pritje-përcjellje të të huajve që kanë vizituar zyrën tonë gjatë vitit 2010 etj.

Punonjësit e institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim dhe të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë në funksion të realizimit të “Ditëve të Hapura”, gjatë vitit 2010 kanë pritur ankesat e qytetarëve në 40 Komuna e Bashki. Shpenzimet për realizimin e një “Dite të Hapur” llogariten rreth 54.000 lekë. Në përlllogaritjen e kësaj shume janë mbajtur parasysh parashikimet e bëra në VKM nr. 1198, datë 03.12.2009, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vëndit”, ndryshuar me VKM nr.997, date 10.12.2010. Gjatë vitit 2010 janë paguar punonjës për shërbimet e kryera nëpër rrethe të ndryshme në shumën 304,100 lekë .

Në lidhje me kuotat e anëtarësisë ne bëjmë pagesën në Institutin European të Ombudsmanëve, Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofonë, Shoqatën e Ombudsmanëve Amerikanë (TOA) dhe Shoqatën e Ombudsmanëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikes (USOA). Këto pagesa janë kryer në kohën e duhur.

Pagesa kalimtare ka të bëjë me zbatimin e ligjit nr.,8097, datë 21.03.1996, kreu II “Shpërblime dhe pensione”, pjesa e parë “Pagesë kalimtare”, neni 7, paragafi i dytë, “Për pensionet shtetërore suplementare

të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, për tre punonjës që u ka mbaruar mandati.

## **8. Statistika përmbledhëse e vitit 2010**

*(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)*

Gjatë vitit 2010 nga Zyra e Avokatit të Popullit janë trajtuar **3264** ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga **3264** ankesa, 460 kanë qenë të mbartura nga viti 2009, **1831** janë raste të regjistruara në vitin 2010 dhe **973** janë raste të cilave u është dhënë përgjigje menjëherë në Zyrën e Pritjes së Popullit. Në vështrim të parë, duket se numri i ankesave për vitin 2010, është më i ulët se viti 2009. Në fakt, referuar dhe shifrave që po prezantojmë në këtë raportim, gjatë vitit 2010 është rritur numri i ankuesve të cilëve u është dhënë përgjigje menjëherë, nga Zyra e Pritjes së Popullit. Per ankesat që ata janë paraqitur prane nesh, një pjesë e mirë e të cilave, rezulton të kenë qënë si jashtë kompetencës ashtu edhe jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit.

Për vitin në raportim, Zyra e Avokatit të Popullit, ka filluar 103 çështje me iniciative sipas parashikimeve të bëra në nenin 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Avokati i Popullit, ka kryer inspektime në institucionet publike dhe autoritetet e tjera administrative. Nga numri i rasteve të regjistruara për shqyrtim në Zyrën e Avokatit të Popullit, për vitin 2010, **29** raste kanë të bëjnë me inspektimet. Shumica e inspektimeve janë kryer në institucionet, ku liria e personit është e kufizuar (paraburgim, burgje, spitale psikiatrike etj). Po kështu janë kryer inspektime dhe ndaj autoriteteve të tjera administrative, si psh. qendrat rezidenciale për fëmijë (shtëpitë e fëmijës), qendra rezidenciale për të moshuarit.

Avokati i Poullit ka kryer inspektime në përputhje me Protokollin Opsional të Konventes së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe trajtimeve të tjera Çnjerezore e Poshtëruese (OPCAT). Nga rastet e trajtuara gjatë vitit 2010, **74** prej tyre kanë rezultuar nga inspektimet e kryera në funksion të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Gjatë vitit 2010 janë përfunduar së shqyrtuari gjithsej **2018** ankesa, nga të cilat ka rezultuar se **286** ankesa, ose **14%** e tyre, kanë qënë jashtë juridiksionit dhe **571** ankesa ose **28.3%** e tyre kanë qënë jashtë kompetencës. Këtu përfshihen ankesat që kanë patur të bëjnë me vendimet gjyqësore dhe çështje të tjera të administrimit gjyqësor të cilat nuk janë në juridiksion të Avokatit të Popullit, çështje që kanë të bëjnë me çështje private të pronësisë, me mosshkrim të rrugëve të ankimit administrativ nga ankuesit etj. Për këto ankesa është bërë punë efektive,

sepse qytetarët janë sqaruar për rrugën që ata duhej të ndiqnin për zgjidhjen e problemit të prezantuar tek ne. **357** ose **17.7%** e ankesave kanë rezultuar të pabazuara, kurse **673** ose **33.3%** e tyre janë zgjidhur në favor. Për **40** ankesa, ose **2%** e ankesave të përfunduara, rekomandimet me shkrim drejtuar organeve përkatëse të administratës për shkelje të konstatuara prej tyre, nga zyra jonë, janë refuzuar. Për **91** raste, ose **4.5%** të tyre, të paraqitura për shqyrtim pranë nesh, ankuesit kanë hequr dorë gjatë procesit të shqyrtimit. Për ankesat e gjetura të bazuara, për **195** prej tyre janë bërë rekomandime apo propozime përkatëse me shkrim, (të cilat janë pranuar), drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike, të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar, tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura të qytetarëve.

Përsa i përket ankesave të cilat kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2011, të cilat janë **370** të tilla, duhet të themi se një pjesë e tyre nuk kanë mundur të perfundojnë se shqyrtuari për shkak të mosdhenies së përgjigjes nga autoriteti të cilit i jemi drejtuar apo mosdhenies së përgjigjes për rekomandimin për rastet për të cilat i jemi drejtuar autoriteteve të administratës publike.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, ashtu si dhe vitet e kaluara, rastet e regjistruara gjatë vitit 2010, nga Zyra e Avokatit të Popullit, të ndara sipas Ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre, ndaj të cilave janë drejtuar ankesat apo kërkesat, duke shprehur shpesh dhe opinionet tona për fushat përkatëse.

<b>1. Këshilli i Ministrave</b>	<b>21,</b> nga
të cilat	
për vetë Qeverinë	12
a. Instituti i Integritit të ish të	
Përndjekurve politikë	4
b. ALUIZNI	5
<b>2. Ministria e Drejtësisë</b>	<b>462</b> nga
të cilat:	
për vetë ministrinë	43
a. Për burgjet dhe paraburgimet	232



b. Zyrat e Përmbartimit	77
c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	65
d. Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	45
<b>3. Organet e pushtetit gjyqësor</b>	<b>154</b>
<b>4. Prokuroria</b>	<b>113</b>
<b>5. Ministria e Brendshme</b>	<b>339</b> nga
te cilat:	
Organet e policisë	137
Organet e pushtetit vendor	202
a. Komunat	31
b. Bashkite	146
c. Prefekturat	11
d. Qarqet	6
dh. Gjendja Civile	8
<b>6. Ministria e Mbrojtjes</b>	<b>121</b>
<b>7. Ministria e Financave</b>	<b>100</b>
Për vetë ministrinë	16
a. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe degët në varesi të saj	5
b. Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe degët në varesi të saj	2
c. Agjensia Kombetare e Privatizimit	4
ç. Instituti i Sigurimeve Shoqërore	73
<b>8. Ministria e Punëve Publike,</b>	<b>107,</b> nga
te cilat:	
<b>Transportit dhe Telekomunikacionit</b>	
Për vetë ministrinë	11
a. Inspektoratet ndërtimore	50
b. Ujësjellës kanalizime	33
c. Albtelekom dhe telefonia mobile	4
ç. Posta Shqiptare	3
d. Enti Kombëtar i Banesave	6
<b>9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës</b>	<b>75,</b> nga
te cilat:	
Për vetë ministrinë	12
<b>KESH + CEZ</b>	<b>62</b>
<i>ERE</i>	<i>1</i>

<b>10. Ministria e Shëndetësisë</b>	<b>46</b>
<b>11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës</b>	<b>35</b>
<b>12. Ministria e Punëve të Jashtme</b>	<b>7</b>
<b>13. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale</b>	<b>26,</b> nga
të cilat:	
<b>dhe Shanseve të Barabarta</b>	
Për vetë ministrinë	23
a. Shërbimi Social Shtetëror	3
<b>14. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit</b>	<b>10</b>
<b>15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave</b>	<b>8</b>
<b>16. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</b>	<b>1</b>
<b>17. Ministria e Integritimit</b>	<b>1</b>
<b>Të tjera</b>	<b>181</b>
<b>TOTALI</b>	<b>1831 ankesa</b>

## SHTYPI I SHKRUAR PER VITIN 2010

NR	DATA	GAZETA	TITULLI	RUBRIKA
1	06.01.2010	Albania	AP i shkruan Ministrin te Drejtesise: "Zbatoni vendimet e gjykates".	Artikull
2	06.01.2010	Koha Jone	AP: "Te perndjekurit politike te demshperblehen menjehere".	Artikull
3	07.01.2010	Shqip	Ish te perndjekurit, greviste te urise takojne AP-ne	Njoftim
4	07.01.2010	Koha Jone	AP: "Do te ndjek deri ne fund problemet e ish te perndjekurve".	Njoftim
5	07.01.2010	Gazeta Shqiptare	Te perndjekurit ankohen tek AP: "Nuk po demshperblehem".	Njoftim
6	07.01.2010	Koha Jone	AP ndihmon 9 te burgosur shqiptare ne Maqedoni	Prononcim, A. Lazebeu
7	08.01.2010	Koha Jone	Ministria e Drejtesise i pergjigjet AP-se per transferimin e 9 te burgosurve shqiptare ne Maqedoni	Njoftim
8	09.01.2010	Sot	AP i kerkon Ministrise se Drejtesise te ndjeke plotesimin e buletinit te denimeve penale	Njoftim
9	09.01.2010	Panorama	I riu SH.M. rrefen para AP-se fyerjet dhe keqtrajtimet ne Komisaratin Nr. 4 te Policise	Njoftim
10	09.01.2010	Albania	Te perndjekurit Ap-se: "Ja si po manipulohet me listat e demshperblimit"	Artikull
11	17.01.2010	Ballkan	Pas raportit te AP-se, 4 oficeret policie pezullohen nga puna	Njoftim
12	17.01.2010	Albania	Veterasja e K.B ne policine e Duresit; pas raportit te AP-se, kater police procedohen	Artikull
13	29.01.2010	Sot	AP debaton me maxhorancen per ligjin mbi antidiskriminimin	Njoftim
14	29.01.2010	Ballkan	Mosdiskriminimi, AP dhe ZMK kunder draftit	Njoftim
15	29.01.2010	Metropol	Mosdiskriminimi, Qeveria perkrah projektin, AP kekon terheqjen e tij	Njoftim
16	29.01.2010	Albania	Shoqeria civile i kundervihet AP-se per kompetencat	Njoftim
17	29.01.2010	Telegraf	Mosdiskriminimi, OJF-te nuk pranojne si mbrojtjes AP-ne	Njoftim
18	01.02.2010	Ballkan	AP i rekomandon Qeverise ndryshime ligjore dhe kontroll mbi territorin	Njoftim
19	02.02.2010	Gazeta Shqiptare	Nese ligjin per antidiskriminimin do t'ia linim Ap-se, do te duheshin 84 vota	Artikull
20	02.02.2010	Koha Jone	Ligji per Gay-t mbetet peng i Komisionerit	Artikull

21	02.02.2010	Standard	Dobjani mbyll mandatin, mungesa e opozites krijon boshllek	Artikull
22	02.02.2010	RD	Grup ekspertesh per ligjin per antidiskriminimin	Njoftim
23	02.02.2010	Shekulli	Antidiskriminimi midis Ap-se dhe draftit te OJF-ve	Artikull
24	02.02.2010	Sot	Ligji i gay-ve i kalon perkoheisht per zbatim AP-se	Artikull
25	03.02.2010	Sot	Komisioni i Punes ia heq perseri Komisionerin Avokatit te Popullit	Njoftim
26	12.02.2010	55	Reagon AO:Nuk kemi bere propozime zyrtare tek Qeveria per eshtrat"	Prononcim, E. Dobjani
27	12.02.2010	Sot	Posti i AP-se perplas Dobjanin me pretendetet	Artikull
28	13.02.2010	Sot	Paradokset e Kushtetutes, AP zgjidhet me 3/5, Presidenti me 71 vota	Artikull
29	14.02.2010	Albania	AP jep alarmin per ndotjen e ambjentit	Njoftim
30	16.02.2010	Tirana Observer	Topi pershendet Dobjanin ne fund te mandatit	Njoftim
31	16.02.2010	Shqip	Institucioni kushtetues i AP-se futet ne krize	Artikull
32	16.02.2010	Albania	Presidenti Topi vlereson punen e bere nga AP, Dobjani	Njoftim
33	16.02.2010	Koha Jone	Topi takon Dobjanin, para mbarimit te mandatit	Njoftim
34	16.02.2010	Panorama	Dobjani mbyll mandatin: Do te rikandidoj	Artikull
35	16.02.2010	Telegraf	Topi pret Dobjanin ne perfundim te mandatit te dyte	Njoftim
36	17.02.2010	Koha Jone	Raportuesi i Komisionit te OKB-se, Filip Alston takon AP-ne	Njoftim
37	17.02.2010	Shekulli	AP akuzes: "Ndiqni penalisht policet per torture".	Artikull
38	17.02.2010	Metropol	AP ne dore te opozites, duhen 84 vota	Njoftim
39	17.02.2010	Gazeta Shqiptare	Ngerçi institucional, Berisha takon Dobjanin	Njoftim
40	17.02.2010	Shqip	AP, Dobjani sot le zyren: Do rikandidoj serish	Prononcim, E. Dobjani
41	17.02.2010	Panorama	Dobjani i le detyren Podes.	Artikull
42	17.02.2010	Standard	Raporteri i OKB-se takon AP-ne	Njoftim
43	18.02.2010	Sot	Dobjani: Do rikandidoj serish per postin e AP-se	Prononcim, E. Dobjani
44	18.02.2010	Ballkan	Dobjani, dita e pare pa postin e AP-se	Prononcim, E. Dobjani

45	19.02.2010	Shekulli	Dobjani: Do te jem serish Avokat i Popullit	Prononcim, E. Dobjani
46	20.02.2010	Albania	Dobjani, kerkese Bodes: Ndryshoni kushtet e daljes ne pension	Artikull
47	20.02.2010	Panorama	Iken Dobjani, plas sherri tek AP. Haluci: Jemi ankuar tek Komisioni i Ligjeve	Artikull
48	21.02.2010	Koha Jone	AP reagon kunder vendimit per krijimin e nje komisioneri te posaçem per diskriminimin: "E bejme ne".	Njoftim
49	21.02.2010	Shekulli	AP: Te ndryshohen pensionet e 1994-1995	Artikull
50	21.02.2010	Panorama	AP:Skema e pensioneve duhet te ndryshoje	Artikull
51	05.03.2010	Republika	AP:"Te korrigojen faturat e energjise"	Prononcim
52	05.03.2010	Standard	AP:"Qytetaret te demshperblehen per faturat e energjise"	Prononcim, S. Haluci
53	06.03.2010	Panorama	Pas rekomandimit te AP-se, financat akordojne fondin per te semuret psikiatrike	Njoftim
54	09.03.2010	Ballkan	AP per mosekzekutimin e vendimeve gjyqesore, ku pale e humbur eshte shteti	Prononcim, A. Lazebeu
55	23.03.2010	Ballkan	Ndeshkimi i komandove, oficeret tek AP	Artikull
56	24.03.2010	Sot	Shteti u heq buken e gojes, komandot tek AP	Artikull
57	24.03.2010	Ballkan	AP nis verifikimin e ankesave te komandove	Prononcim, A. Lazebeu
58	29.03.2010	Panorama	AP:"Qytetaret nuk njoftohen sipas ligjit, ndersa proceset gjyqesore zhvillohen pa dijenine e tyre"	Artikull
59	01.04.2010	Tirana Observer	AP raporton ne 465 faqe per veprimtarine gjate 2009	Njoftim
60	01.04.2010	Standard	Mazhoranca: AP, pune selektive	Artikull
61	01.04.2010	Sot	Raporti i AP-se ne Komisionin e Ligjeve	Njoftim
62	01.04.2010	Shekulli	Raporti ne Kuvend, PD kryqezon AP-ne	Artikull
63	01.04.2010	RD	Mazhoranca: Apne mbrojtje te shkeljeve te Bashkise	Artikull
64	01.04.2010	Republika	Komisioni i ligjeve: Zyra e AP-se, pune selektive	Artikull
65	01.04.2010	Panorama	PD rrezon Dobjanin: Avokat Politik	Artikull
66	01.04.2010	Panorama	Ish AP, Dobjani: "Halimi dhe Alibeaj me sulmuan ngaqe i rrezoi Kushtetuesja"	Prononcim
67	01.04.2010	Metropol	AP nuk kenaq Kuvendin	Artikull
68	01.04.2010	Koha Jone	Deputetet e mazhorances, akuza ndaj AP-se gjate raportimit ne Kuvend	Njoftim
69	01.04.2010	Koha Jone	AP:"Tendence ndaj nje raportimi klasik prej 10 vjetesh"	Njoftim
70	01.04.2010	Gazeta Shqiptare	PD, "Plenium" ndaj AP-se	Artikull

71	01.04.2010	Shqip	Mazhoranca sulmon ashper AP-ne	Artikull
72	01.04.2010	Shqip	AP:"Qendrimi i deputeteve, tendencioz"	Njoftim
73	01.04.2010	Ballkan	Raporti, tre ministra drejtesie sulmojne Dobjanin	Artikull
74	01.04.2010	Ballkan	Reagim i AP-se: Ata jane pergjegjes per ligje antikushtetuese	Njoftim
75	01.04.2010	Albania	PD ne Komisionin e Ligjeve, sulm frontal ndaj AP-se	Artikull
76	05.04.2010	Shqip	AP:"Ushtaraket shqiptare te Afganistanit kane te drejte"	Artikull
77	08.04.2010	Albania	Reagim i AP-se pas sulmeve te mazhorances: "Qeveria po na cenon si Institucion Kushtetues"	Njoftim
78	09.04.2010	Gazeta Shqiptare	AP nis hetimet per perleshjen ne Burgun e te miturve ne Kavaje	Njoftim
79	10.04.2010	Shekulli	AP dhe rasti i dhunes se te miturve ne burgun e Kavajes	Njoftim
80	10.04.2010	Shekulli	AP dhe batutat kuvendore	Artikull
81	11.04.2010	Ballkan	AP rekomandon krijimin e dhomes se detektiveve private	Prononcim, A. Lazebeu
82	11.04.2010	Albania	AP:"Merrni masa per familjet qe jetojne me qira ne pronat e te tjereve"	Artikull
83	12.04.2010	Shekulli	AP kunder rregullores se re te burgjeve	Artikull
84	14.04.2010	Korrieri	Gardianet ankohen tek AP:"Nuk na paguhen oret shtese"	Njoftim
85	14.04.2010	Sot	AP nis verifikimet per ankesat e gardianeve	Njoftim
86	14.04.2010	Tirana Observer	Gardianet e Rrogozhines tek AP	Njoftim
87	14.04.2010	Koha Jone	Gardianet, ankesa per mospagimin e oreve shtese	Njoftim
88	14.04.2010	Ballkan	Revoltohen gardianet:"Na paguani oret shtese"	Njoftim
89	14.04.2010	Albania	100 gardiane nuk kane marre pagesen per oret shtese	Njoftim
90	20.04.2010	Tirana Observer	Emigrantet, AP:"350 ankesa ne vit nga Greqia"	Njoftim
91	21.04.2010	Gazeta Shqiptare	Gazi Radon. AP i kerkon Ministrise se Mjedisit te nise nje studim	Njoftim
92	24.04.2010	Albania	AP fiton betejen ligjore me Keshillin e Ministrave	Njoftim
93	24.04.2010	Telegraf	Gjykata Kushtetuese rrezon ligjin per mbivendosjen e pronave	Artikull
94	24.04.2010	Ballkan	Kushtetuesja, bie ligji per regjistrimin e pronave, ankimuar nga AP	Artikull

95	24.04.2010	Shekulli	Kushtetuesja rrezon ligjin per regjistrimin e promave	Njoftim
96	24.04.2010	Panorama	Gjykata Kushtetuese heq kompetencat e hipotekes per mbivendosjen e pronave	Artikull
97	05.05.2010	Albania	Ja pikat qe kundershtoi AP ne rezoluten e Kuvendit	Artikull
98	13.05.2010	Republika	Institucioni i Avokatit te Popullit, i vetmi Institucion i konsoliduar	Artikull
99	13.05.2010	Albania	AP, shkrese per oret shtese te papaguara te policeve	Artikull
100	13.05.2010	Republika	Besimi i krijuar eshte frut i punes disavjeçare	Prononcim, R. Poda
101	25.05.2010	Gazeta Shqiptare	AP ne Detyre, Riza Poda: "Komandot te rikthehen ne pune".	Prononcim, R. Poda
102	27.05.2010	Ballkan	Ankimimi i AP-se: Kushtetuesja rrezon ligjin per kthimine pronave	Artikull
103	27.05.2010	Zeri i Popullit	AP: Kushtetuesja rrezon qeverine per pronat	Artikull
104	27.05.2010	Shekulli	Kushtetuesja i jep te drejte AP-se per Ligjin e pronave	Artikull
105	27.05.2010	Albania	Kushtetuesja pranon kerkesen e AP-se per ligjin e pronave	Artikull
106	27.05.2010	Telegraf	Kushtetuesja rrezon ligjin e pronave sipas kerkeses se Ap-se	Artikull
107	27.05.2010	Koha Jone	Gjykata Kushtetuese rrezon Qeverine e cila kish miratuar ndryshimet ne Ligjin per pronat	Artikull
108	31.05.2010	Shqip	AP per Policine e Burgjeve: "Nuk ka trajtim financiar sipas gradave"	Artikull
109	31.05.2010	Shqip	Te burgosurit VIP ankohen tek AP per kushtet	Njoftim
110	01.06.2010	Standard	Titujt e Pronesise, Kushtetuesja rrezon pretendimet e Ap-se	Artikull
111	01.06.2010	Panorama	Tapite, Gjykata Kushtetuese rrezon AP-ne	Artikull
112	01.06.2010	Koha Jone	Pronat, Kushtetuesja pro Qeverise	Artikull
113	03.06.2010	Albania	Deshton tentativa e Ap-se per te ndryshuar perberjen e komisioneve per kthimin e pronesise mbi tokat bujqesore	Artikull
114	05.06.2010	Gazeta Shqiptare	AP dhe kushtet e te burgosurve ne burgje	Artikull
115	08.06.2010	Shekulli	AP ne Komisionin e Ligjeve per ligjin e faljes se denimit	Njoftim
116	18.06.2010	Albania	AP kerkon qe ERE te nderhyje per demshperblimet e qytetareve nga OSSH	Artikull
117	22.06.2010	Gazeta Shqiptare	AP: "Te permiresohen kushtet e paraburgimit te te miturve ne Durres"	Artikull

118	24.06.2010	Albania	AP:"Ministria t'u paguaje qirate ushtarakeve"	Artikull
119	02.08.2010	Koha Jone	Krize nuk ka, por kete nuk e perjashtoj ne Tetor	Interviste, A. Lazebeu
120	03.09.2010	Sot	Kerkesa e AP-se per ERE-n lidhur me faturimin e padrejte	Njoftim
121	02.10.2010	Metropol	AP ne Fier pret ankesa dhe bisedon me Kryetarin e Bashkise per ngërçin ne buxhet	Njoftim
122	26.10.2010	Albania	Topalli takon AP-ne e Mbreterise se Marokut	Njoftim
123	26.10.2010	"55"	Topalli:"AP, Institucion kyç per te drejtat e njeriut"	Njoftim
124	26.10.2010	Koha Jone	Ina Rama takon Ombudsmanin e Marokut	Njoftim
125	26.10.2010	Metropol	Presidenti Topi pret Ombudsmanin e Marokut	Njoftim
126	26.10.2010	Metropol	Kryeprokuroerja takohet me Ombudsmanin e Marokut	Njoftim
127	26.10.2010	Tirana Observer	Topalli-Iraki:AP-Institucion kyç	Njoftim
128	26.10.2010	Sot	Topi takohet me AP-ne e Marokut, Muhamed Iraki	Njoftim
129	26.10.2010	Sot	Topalli-Mohamed Maroki, vleresohen marredheniet Shqiperi-Marok	Njoftim
130	26.10.2010	Republika	Topalli takohet me Avokatin e Popullit te Marokut	Njoftim
131	02.11.2010	Sot; K.J;G.SH;	Kandidaturat per Komisioner i AP-se, paraqiten ne Komisionin e Ligjeve	Njoftim
132	04.11.2010	G.SH.K.J; Standard etj	Mazhoranca i ofron opozites te paraqese kandidaturen per AP	Njoftim
133	10.12.2010	Sot	AP ia kushton 10 Dhjetorin, Antidiskriminimit	Prononcim, F.Nuni
134	10.12.2010	Panorama	Kryetari i Prezences se OSBE-se vlereson funksionimin e AP-se	Artikull
135	10.12.2010	Shqip	Lejet shperblyese, mjeket e burgjeve ankohen tek AP	Artikull
136	19.12.2010	Koha Jone	AP vazhdon veprimtarine normale	Artikull
137	24.12.2010	Gazeta Shqiptare	AP ngre probleme te korrupsionit ne administraten e burgjeve	Njoftim
138	24.12.2010	Republika	AP ben apel per shmangien e formave te dhunes ne paraburgim	Artikull
139	24.12.2010	55	AP: "Ka permiresim te kushteve te paraburgimit"	Artikull
140	24.12.2010	Ballkan	Prova dhe fakte te mbledhura nga Instituti Evropjan i Tiranës dhe Zyra e Avokatit te Popullit	Njoftim




## MEDIA ELEKTRONIKE PER VITIN 2010

Nr.	ORGANI	DATA	TITULLI	PASQYRIMI
1	Radio Tirana	14.01.2010	Standardet e te drejtave te njeriut ne Shqiperi	Emisioni "Pa kufij". E. Dobjani
2	TVSH;Vizion+;Top Channel;News24;Klan	28.01.2010	AP debaton ne Komisionin e Ligjeve per Ligjin mbi Antidiskriminimin	Njoftim
3	TVSH;Vizion+;Top Channel;News24;Klan	02.02.2010	Ligji per antidiskriminimin nuk mund t'i kaloje AP-se, sepse duhet bere ndryshime ligjore qe kerkojne 3/5 e votave	Njoftim
4	Zeri i Amerikes	06.02.2010	AP dhe problematika e mireqeverisjes ne Shqiperi	Interviste, E. Dobjani
5	Vizion+	10.02.2010	AP reason per eshtrat e te vrareve gjate komunizmit	Prononcim, E. Dobjani
6	TVSH, Ora News	11.02.2010	AP perseri per ceshtjen e eshtrave te te vrareve	Prononcim, E. Dobjani
7	TVSH	15.02.2010	AP takon reporterin e OKB-se per te drejtat e njeriut, Filip Alston	Njoftim
8	TVSH, Vizion+, Top Channel, Klan, News 24, Ora News	15.02.2010	Presidenti Topi pret Avokatin e Popullit me rastin e perfundimit te mandatit	Njoftim
9	Radio Kontakt	02.03.2010	AP dhe aksidentet rrugore	Prononcim, S. Nushi
10	Vizion+	02.03.2010	AP dhe faturat e energjise elektrike	Emision, S. Haluci
11	News 24	04.03.2010	AP dhe problemet e qytetareve me koston e jeteses	Emision, S. Haluci
12	Scan	13.03.2010	AP dhe sistemi i taksave vendore	Prononcim, A. Lazebeu
13	Top Channel	16.03.2010	AP, faturat e energjise dhe ligji kunder diskriminimit	Emision, A. Lazebeu
14	News 24; Top Channel	23.03.2010	Komandot ankohen tek AP	Njoftim

15	TVSH;Vizion+;Top Channel;News24;Klan; Ora News; Koha Tv etj.	31.03.2010	AP raporton ne Komisionin e Ligjeve, kritika te ashpra dhe akuza ndaj tij	Njoftim
16	News 24	13.04.2010	Debat mbi ligjin per antidiskriminimin	Emission, A. Lazebeu
17	TVSH; Vizion+;Top News	19.04.2010	AP dhe te drejtat e emigranteve	Prononcim, S. Nushi
18	News24;Vizion+;Ora News	23.04.2010	Gjykata Kushtetuese rrezon ligjin per hipotekat, ankimuar nga AP	Njoftim
19	Klan	05.05.2010	Perceptimi i korrupsionit dhe AP	Prononcim, A. Lazebeu
20	Ora News	26.05.2010	AP dhe vendimi i Gjykates Kushtetuese per titujt e pronesise	Prononcim, F. Nuni
21	Ora News	27.05.2010	Pse Gjykata Kushtetuese rrezoi dy nene te Ligjit per Kthimin dhe Kompensimin e Pronave	Interviste, F. Paskali
22	TVSH, News 24, Vizion+, Top Channel	07.06.2010	AP ne Komisionin e Ligjeve per projektligjin per faljen e denimit	Njoftim
23	TVSH, Top Channel, Vizion+, Alsat, Ora News, News 24	09.06.2010	AP dhe Keshilli i Evropes, seminar ndekombetar per parandalimin e tortures ne burgje	Njoftim
24	TVSH, Top Channel, Vizion+, Alsat, Ora News, News 24	09.06.2010	AP si Mekanizem Kombetar per Parandalimin e Tortures	Prononcim, E. Karamuca
25	Planet TV	09.06.2010	Veprimtaria e AP-se per parandalimin e tortures	Interviste, A.Pilo
26	TVSH	26.10.2010	Presidenti Topi takohet me Avokatin e Popullit te Marokut	Njoftim
27	TVSH	26.10.2010	Topalli takohet me Ombudsmanin e Mbreterise se Marokut	Njoftim
28	TVSH;Ora News; News 24;Alsat	01.11.2010	Paraqiten ne Komisionin e Ligjeve, per séance degjimore, kandidaturat per Komisioner te AP-se	Njoftim


29	TVSH:Ora News; News 24; Alsat	03.11.2010	Topalli i ofron opozites te zgjedhe Avokatin e Popullit	Njoftim
30	Ora News	10.12.2010	AP ne ditën boterore te te drejtave te njeriut	Interviste, A. Lazebeu
31	ABC;Ora News; News24	20.12.2010	Shoqeria shqiptare-Sfidat e Mosdiskriminimit	Njoftim
32	ABC	20.12.2010	AP dhe problematika e tij lidhur me mosdiskriminimin	Prononcim,F.Nuni
33	ABC; Ora News; News24; Alsat Vizion+; TVSH	23.12.2010	AP dhe Instituti Evropjan i Tiranes paraqesin raportin per sistemin e paraburgimit	Njoftim

**Ankesa me shkrim te trajtuara gjate vitit 2010**  
**Totali 2291**




- Numri i ankesave të regjistruara gjatë vitit 2010
- Numri i ankesave të mbartura nga viti 2009


**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2010,  
pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit  
Totali 2018**



**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda  
juridiksionit gjatë vitit 2010  
Totali 1161**




**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë  
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2010  
Totali 1651**




- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.

**Ankesa, kërkesa dhe njoftime të trajtuara nga zyra e AP gjatë vitit 2010**  
**Totali 3264**






**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000 - 2010,  
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)  
Totali 35530**




**Ankesa te ardhura ne vite**


**Krahasimi i ankesave të zgjidhura ne favor për vitet 2000 - 2010,  
Totali 6149**



## Shperndarja e ankesave te regjistruara gjate vitit 2010 sipas institucioneve Totali 1831 raste



**Shpërndarja e rasteve të regjistruara gjatë vitit 2010 sipas rretheve**  
**Total 1831 raste**



## Shperndarja e ankesave te vitit 2010 sipas rretheve

Berat	35
Bulqize	2
Delvine	2
Devoll	9
Diber	12
Durres	104
Elbasan	48
Fier	82
Gjirokaster	17
Gramsh	4
Has	7
Kavaje	19
Kolonje	4
Korçe	97
Kruje	40
Kuçove	10
Kukes	11
Kurbin	26
Lezhe	36
Librazhd	10
Lushnje	28
Mallakaster	12
Malesi e Madhe	3
Mat	36
Mirdite	9
Peqin	38
Permet	4
Pogradec	14
Puke	13
Rrogozhine	10
Sarande	23
Shkoder	105
Skrapar	4
Tepelene	31
Tirane	757
Tropoje	10
Vlore	139
Jashte Shqiperise	20
<b>Totali</b>	<b>1831</b>



**Raport Vjetor 2010**  
**1 Janar – 31 Dhjetor**